



◆ KONTROLLI I LARTË I SHPETIT ◆

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SUBJEKTIN**

**“BASHKIA KAMËZ”**

**Tiranë, 2023**



**KONTROLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË KAMËZ”**

**DOKUMENTI 14**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)**

**“BASHKIA KAMËZ”**

**Tiranë 2023**

<b>NR</b>	<b>EMËRTIMI I KAPITUJVE</b>	<b>FAQE</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4 - 18</b>
1.	<i>Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....</i>	<b>4 - 5</b>
2.	<i>Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve .....</i>	<b>5 - 15</b>
3.	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....</i>	<b>15 - 18</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>18 - 23</b>
	a. <i>Titulli.....</i>	
	b. <i>Marrësi.....</i>	
	c. <i>Objektivat dhe qëllimi.....</i>	
	d. <i>Identifikimi i çështjes.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	f. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	g. <i>Kriteret e vlerësimit .....</i>	
	h. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	i. <i>Metodat e auditimi .....</i>	
	j. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>23 - 166</b>
<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....</b>	<b>23 - 24</b>
<b>2.</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....</b>	<b>24 - 166</b>
2.1.	<i>Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin brendshëm.....</i>	<b>24 - 31</b>
2.2	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....</i>	<b>31 - 45</b>
2.2.6	<i>Menaxhimin e të ardhurave, mbi arkëtimin dhe përdorimin e tyre.....</i>	<b>45 - 53</b>
2.3	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021.....</i>	<b>53 - 78</b>
2.4.	<i>Mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për vitin 2021.....</i>	<b>78 - 125</b>
2.4.4	<i>Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike, viti 2021.....</i>	<b>125 - 139</b>
2.5	<i>Mbi planifikim dhe zhvillim territorin.....</i>	<b>139 - 144</b>
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e IMT.....</i>	<b>144 - 147</b>
2.7.	<i>Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.....</i>	<b>147 - 152</b>
2.8	<i>Mbi administrimin e Aseteve. Procedurën e dhënies me qira të pronave publike ..</i>	<b>152 - 165</b>
2.9	<i>Të ndryshme (shqyrtim ankesash).....</i>	<b>165 - 166</b>
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIMI.....</b>	<b>166 - 184</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE.....</b>	<b>184 - 234</b>

## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktor
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ASHK</b>	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.
<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktor.
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonime.
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
<b>OE</b>	Operator Ekonomik.
<b>KSHA</b>	Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>NjP</b>	Njësia e Prokurimit

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 21.11.2022 deri në datë 3.2.2023, realizoi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Kamëz, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje të transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2021, zbatimin e procedurave për dhënien e lejeve të ndërtimit, veprimtarinë e IMTV, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimin objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Kamëz për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një opinion të **opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes** për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2021), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet konkludon me opinion të **kualifikuar**.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Raport Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezultoi se llogaria 468 "Debitore të ndryshëm" pasqyrohet në vlerën 716,700,299 lekë,	I mesëm	Pika 2.3, faqe 53-78	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrë masa për të analizuar llogarinë 468 "Debitore të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	detyrime këto të trashëguara që nga viti 2003, të cilat nuk janë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me shpresë arkëtimi dhe pa shpresë arkëtimi, veprime në kundërshtim me rubrikën 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, të udhëzimit nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022			<i>ndryshëm</i> ” në vlerën 716,700,299 lekë, për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me dhe pa shpresë arkëtimi, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre
2.	Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021, nga Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz është kryer inventari fizik për llogaritë 202, 210, 212, 214, 218, 31 dhe 32, ndërsa për llogarinë 213 inventari është mbyllur vetëm me gjendjen kontabël të tyre, për të cilën informacioni kontabël është i pasaktë, veprime këto në kundërshtim me pikën 74, kreu IV, “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, i ndryshuar	I mesëm	<i>Pika 2.3, faqe 53-78</i>	Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrin masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e aktiveve në Bashkisë Kamëz
3.	Nga auditimi mbi menaxhimin e asetëve në Bashkinë Kamëz, rezulton se nga totali prej rreth 2000 pasuri që i janë transferuar kësaj bashkie, përfshirë zonën e Paskuqanit, janë dërguar për regjistrim <b>93 pasuri</b> , nga të cilat vetëm <b>47 janë regjistruar</b> . Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuar me VKM nr. 775/2013 për Bashkinë Kamëz dhe VKM nr. 454/2011 për ish- Komunën Paskuqan nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kamëz është i papërditësuar, veprime në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Sa u përket pasurive për të cilat Bashkia Kamëz i ka regjistruar në DVASHK Kamëz -Vorë, sipas natyrës së funksionit rezultojnë <b>6 pasuri</b> të llojit truall, pyll dhe livadh me vlerë <b>16,299,900 lekë</b> të cilat nuk janë kontabilizuar sipas	I lartë	<i>Pika 2.2.6, faqe 45-53</i>	- Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet Strukturës së Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtorisë Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrin masa për përditësimin e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në DVASHK Kamëz -Vorë. - Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrë masa për kontabilizimin e vlerës 16,299,900 lekë të 6 pasurive të llojit truall, pyll dhe livadh të regjistruara në DVASHK Kamëz -Vorë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	çmimeve të referencës përcaktuara në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”			
4.	Në lidhje me zbatimin e detyrimeve kontraktore për të gjitha kontratat e qirave rezulton se njësia monitoruese e kontratave të qirasë të realizuar nga Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit (strukturat përgjegjëse), ngritur sipas urdhrit nr. 233 datë 29.03.2019, ka kryer verifikime vetëm në lidhje me detyrimet mujore, por nuk ka kryer verifikime çdo 6 muaj në lidhje me zbatimin e detyrimeve sa u përket kushteve të kontratës për investimet dhe nivelin e punësimeve, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54/2014, datë 05.02.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar	I mesëm	Pika 2.2.6, faqe 45-53	Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit (strukturat përgjegjëse) Bashkia Kamëz, të marrë masa për kryerjen çdo 6 muaj të verifikimit të kushteve të kontratave të lidhura, në lidhje me nivelin e investimeve dhe të punësimit. Për këtë qëllim, ky raport të jetë pjesë integrale e dokumentacionit të shqyrtimit të çdo procesi për rinovim kontrate
5.	Gjatë periudhës ushtrimore objekt auditimi, kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), ku në vitin 2021 ka gjithsej 11 shkresa për ndryshime në buxhet. Të gjitha ndryshimet janë miratuar me VKB dhe janë konfirmuar nga Prefekti. Ndryshimet e shumta në buxhet, tregojnë për planifikime jorealiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtime dhe shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar si dhe nëpërmjet një analize realiste të situatës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të shoqërohen me sa më pak ndryshime dhe vetëm kur është nevoja e domosdoshme dhe e pashmangshme, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354	I mesëm	Pika 2.2 faqe 31-45	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e tjera në Bashkinë Kamëz, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme
6.	Nga auditimi i dokumentacionit mbi realizimin e të ardhurave për vitin 2021, rezulton se ato	I lartë	Pika 2.2 faqe 31-	Bashkia Kamëz (strukturat përgjegjëse), të marrin masa që planifikimi i të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>janë realizuar në vlerën 792,636 mijë lekë nga vlera 1,473,934 mijë lekë të parashikuara ose në masën 53.77%. Mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore ka çuar në mos likuidimin e faturave të shpenzime dhe rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhës ushtrimore, pasi mbi bazën të ardhurave të planifikuara është parashikuar kryerja e shpenzimeve buxhetore të vitit 2021.</p> <p>Niveli i ulët i arkëtimit të të ardhurave tregon se kemi të bëjmë me parashikim jo të mirë argumentuar të të ardhurave nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, etj, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlogaritjes së shpenzimeve, në një mjet joreal, jo të qëndrueshëm dhe efektiv, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime</p>		45	ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta
7.	<p>Bashkia Kamëz në fund të vitit 31.12.2021 raporton detyrime të prapambetura në vlerën 261,171,535 lekë, të cilat nuk janë likuiduar për shkak të mungesës së fondeve si rrjedhojë e mosrealizimit të të ardhurave në nivelet e planifikuara. Detyrimet e prapambetura janë një pengesë e konsiderueshme në mirëmenaxhimin e financave vendore, duke sjellë probleme në realizimin e shpenzimeve publike për ofrimin e shërbimeve dhe kryerjen e investimeve. Praktika e mos likuidimit në afatin e përcaktuar të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe mos shlyerja në kohë e tyre, krijon risk për pagesa penaltitësh duke rënduar në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore, veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014. Ligji nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”..</p>	I lartë	Pika 2.2 faqe 31-45	<p>Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës &amp; Kontabilitetit, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një analizë për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën 261,171,535 lekë, si dhe të hartojë një grafik për likuidimin e tyre sipas radhës së pagesave.</p> <p>Të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse</p>



Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Situata financiare e Bashkisë Kamëz është normale në nivelin e 15.5%			
8.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve rezulton se:</p> <p>Në total janë rekomanduar gjithsej <b>68 masa</b> të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 58 masa ose 85%, janë në proces zbatimi 7 masa ose 10% dhe nuk janë zbatuar 3 masa ose 4% e tyre, si më poshtë vijon:</p> <p><b>a. Nga 16 masa organizative</b>, të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar <b>13 masa</b>, në proces zbatimi <b>1 (një)</b> masë dhe nuk janë zbatuar <b>2 masa</b>.</p> <p><b>b. Nga 15 masa shpërblim dëmi me vlerë 7,260 mijë lekë</b>, pranuar nga subjekti, janë zbatuar 14 masa me vlerë 6,131,882 lekë dhe në proces zbatimi (në gjykatë) 1 masë me vlerë 1,128,914 lekë.</p> <p><b>c. Nga 6 masa për mos efektivitet të fondeve me vlerë 237,884 mijë lekë</b>, pranuar nga subjekti, janë zbatuar plotësisht, ku për personat përgjegjës janë dhënë masa disiplinore sipas aneksit 7.2 bashkëlidhur Raport Auditimit.</p> <p><b>d. Nga 6 masa mungesë të ardhurash me vlerë 901,750 mijë lekë</b>, pranuar nga subjekti, është zbatuar 1 (një) masë në vlerën 250 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 901,500 mijë lekë, <i>ku janë arkëtuar vlera 7,474 mijë lekë</i> dhe mbetet për arkëtim vlera <b>894,026 mijë lekë</b>, e cila është kryesisht detyrime nga taksat e tarifave vendore dhe vlerën më të lartë e zënë abonentët familjarë.</p> <p><b>d. Nga 10 masa disiplinore</b>, të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.</p> <p><b>e. Nga 15 masa administrative</b>, pranuar nga subjekti. Nga bashkia janë aplikuar penalitete në vlerën 900 mijë lekë, vlerë e cila është arkëtuar, sipas aneksi 7.3 bashkëlidhur Raport Auditimit.</p>	I mesëm	Pika 2.7 faqe 147-152	Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 447/3,prot, datë 23.02.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz”.
9.	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “Punë publike”, të zhvilluara gjatë vitit 2021, është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e OE në garë, por janë kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, <i>ku ndër më kryesore janë:</i></p> <p><b>a)- NJP kërkon paraqitjen e kopjeve të bilanceve për 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore.</b></p>	I lartë	Pika 2.4 faqe 78-125	Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Kamëz, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën e fondit limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Kjo kërkesë, pa asnjë argumentim apo arsyetim, është përdorur me dy standarde nga ana e NJP, pasi në disa raste është kërkuar që “bilancet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar”, ndërsa në raste të tjera është kërkuar vetëm që “bilancet të jenë të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse”.</p> <p><b>b)-</b> Janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe natyrën e objektit të prokurimit, <i>konkretisht</i>: NP-11/A; NP – 3/E; NP-12/D; NS – 4/E; NS – 18/B; NP-2/C; NS-2/B; NS-12/B; NS-13/B; NS-14/B; NP-1/B, NP-2/C, NP-3/C, NS-2/B, NS-4/B, NS-12/B, NS-13/A.</p> <p><b>c)-</b> Në përcaktimin e numrit të punonjësve janë përdorur standarde të dyfishta dhe kontradiktore. Konkretisht, për punime të së njëjtës natyrë është kërkuar një numër më i madh punonjësish në procedura me fond limit (volum punimesh) më të vogël në krahasim me numrin e punonjësve të kërkuar për një procedurë tjetër me fond limit (volum punimesh) më të madh.</p> <p><b>d)-</b> Nga NJP në kriteret e përcaktuara janë kërkuar “<i>Inxhinier – Auditues energjie</i>”, “<i>Artitekt</i>”, “<i>Ekspert Zjarrfikës: etj.</i> të panevojshme dhe e paargumentuar, pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë punime që të argumentojë kërkesat e mësipërme.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 <i>Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve</i> dhe 78 <i>Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit</i>” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</p>			<p>teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.</p> <p>Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur</p>
10	<p>Nga auditimi mbi mënyrën e llogaritjes së TNI nga specialistë të Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) Bashkia Kamëz, u konstatua se kjo taksë nuk është llogaritur në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p>Sipas specialistëve të DPZHT, taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogarit në zbatim të Vendimit të KB nr. 29, datë 16.3.2021 “Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020”, në</p>	I lartë	Pika 2.5 faqe 139-144	<p>Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kamëz, të analizojnë paraprakisht në Këshillin Bashkiak ndryshimin e Vendimit të KB nr. 29, datë 16.3.2021 “Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020”, mbi mënyrën e llogaritjes së Taksës së</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 46 <i>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</i> , si dhe me nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.			Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), në përputhje me nenin 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, me qëllim llogaritjen e saktë të Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), për të mos shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kamëz
11	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt <i>“Rikonstruksion i shkollës “Kamza e re””, Bashkia Kamëz</i> , me vlerë kontrate (pa TVSh) 66,659,236 lekë, realizuar nga BOE <b>“Britania” &amp; “Colombo” &amp; “Ndërtimi” SHPK</b> , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>437,741 lekë</b> pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”</i> , i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i> i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i> , si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4049 prot., datë 16.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Britania” & “Colombo” & “Ndërtimi” SHPK.	I lartë	<i>Pika 2.4.4 faqe 125-139</i>	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën <b>437,741 lekë pa TVSh</b> nga BOE <b>“Britania” &amp; “Colombo” &amp; “Ndërtimi” SHPK</b> , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4049 prot., datë 16.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
12	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt <i>“Rikonstruksion i kopshtit “Zall Mner””, Bashkia Kamëz</i> , me vlerë kontrate (pa TVSh) 70,900,000 lekë, realizuar nga BOE <b>“Almo Konstruksion” &amp; “Ulza” SHPK</b> , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>338,752 lekë</b> pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”</i> , i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i> i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i> , si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6137 prot., datë 14.06.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Almo Konstruksion”	I lartë	<i>Pika 2.4.4 faqe 125-139</i>	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën <b>338,752 lekë</b> pa TVSh nga BOE <b>“Almo Konstruksion” &amp; “Ulza” SHPK</b> , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6137 prot., datë 14.06.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	& “Ulza” SHPK			
13	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i kopshtit “Kamza e Re”, Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 29,987,757 lekë, realizuar nga OE “Euro-Alb” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>273,821 lekë</b> pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4802 prot., datë 10.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE “Euro-Alb” SHPK .	I lartë	Pika 2.4.4 faqe 125-139	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën <b>273,821 lekë pa TVSh</b> nga OE “Euro-Alb” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4802 prot., datë 10.05.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera
14	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Ibrahim Rugova”, Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 177,814,562 lekë, realizuar nga BOE “Egeu Stone” & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>479,700 lekë</b> pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4054 prot., datë 19.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Egeu Stone” & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK .	I lartë	Pika 2.4.4 faqe 125-139	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën <b>479,700 lekë pa TVSh</b> nga BOE “Egeu Stone” & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4054 prot., datë 19.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
15	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Ahmet Zogu”, Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (pa TVSh) 163,308,600 lekë, realizuar nga OE “4-AM” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>185,843 lekë</b> pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e	I lartë	Pika 2.4.4 faqe 125-139	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën <b>185,843 lekë pa TVSh</b> nga OE “4-AM” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3963 prot., datë 15.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3963 prot., datë 15.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE "4-AM" SHPK .			
16	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i kopshtit "Ahmet Zogu", Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 57,121,020 lekë, realizuar nga BOE "KUPA" & "LIQENI VII" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>192,914 lekë</b> pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3440 prot., datë 01.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE "Kupa" SHPK & "Liqeni VII" SHPK .	I lartë	Pika 2.4.4 faqe 125-139	Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën <b>192,914 lekë</b> pa TVSh nga BOE "Kupa" SHPK & "Liqeni VII" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 prot datë 12.05.2021 me objekt "Rikonstruksion i kopshtit "Ahmet Zogu", Bashkia Kamëz, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
17	Sipas procesverbal vlerësimit të hartuar nga KVO, thuhet se OE "AVDULI" shpk me ofertë ekonomike 9,845,800 leke pa TVSh është përjashtuar pasi nuk është respektuar afati 5 ditor për paraqitjen e dokumentacionit. Me shkresën nr. 9635, datë 14.10.2021 Bashkia Kamëz i është drejtuar shoqërisë "ATLANTIK" sha për konfiskimin e sigurimit të ofertës më vlerë 259,000 lekë, vlerë kjo e paarkëtuar, veprime në kundërshtim me pikën 6 të nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.	I lartë	Pika 2.4 faqe 78-125	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit të marrin masa për bllokimin e llogarisë dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës në shumën <b>259,000 lekë</b> nga shoqëria "ATLANTIK" shpk.
18	Nga auditimi i 18 procedurave me fond limit 1,846,197 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 5 procedura me vlerë të fondit limit 526,921 mijë lekë ose 28.4% e vlerës së fondit limit të audituar, ku; - Në <b>2 procedura</b> me fond limit <b>149,047 mijë lekë</b> , OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të	I lartë	Pika 2.4 faqe 78-125	Kryetari i Bashkisë Kamëz, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Të konsidrojë faktin se kualifikimi i

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.</p> <p>- Në <b>4 procedura</b> me fond limit <b>377,874 mijë lekë</b>, KVO duhet të vijonte vlerësimin e procedurës me OE mbetur në garë, pasi OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e për zgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit"</p>			<p>operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës</p>
19	<p>Nga auditimi rezulton se në planin e të ardhurave, Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka përfshirë debitorët e taksë së tokës që për vitin 2020 rezultojnë në vlerën 32,386,698 lekë.</p> <p>Për vitin 2021 sipas Vendimit të KB nr. 55, datë 20.12.2019 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz" i ndryshuar, është përcaktuar në vlerën 4,500 lekë/ha/vit, kjo si tokë e kategorisë së tretë. Nga të dhënat Bashkia Kamëz disponon 2399 ha tokë bujqësore, sipas formularit nr.6 nga ku rezulton e ndarë për 2599 familje për sipërfaqen 2129 ha.</p> <p>Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka bashkëpunuar për informacion me DPKZHT Bashkia Kamëz, për sipërfaqet që kanë kaluar për ndërtim objektsh dhe nuk ka informacion nga ASHK për ato sipërfaqe toke që kanë transaksione për shitje tokash apo për regjistrim të lejeve të ndërtimit.</p> <p>Nga të dhënat e Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave sipas listave që administron kjo drejtori rezultojnë se janë debitorë më datë 31.12.2021 për taksë toke gjithsej <b>6703 familje në vlerën 36,566,509 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë</b>, në kundërshtim me ligjin nr. 9632 "Për sistemin e Taksave Vendore" i</p>	I lartë	<p><i>Pika 2.2.6 faqe 45-53</i></p>	<p>- Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marr masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës në vlerën <b>36,566,509 lekë</b> ndaj <b>6703 familjeve</b>.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrëjë grup pune me specialist të fushës për saktësimin e sipërfaqes së tokës arë, pasi nuk janë reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur si rezultat i zënies së saj nga ndërtimet pa leje e me leje ndërtimi, si dhe transaksionet e ndryshme që janë kryer nëpërmjet ASHK, duke ndryshuar pronarë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	ndryshuar, neni 23 dhe VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar.			
20	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI), konstatohet se nga ALUIZNI-t Tiranë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Tiranë. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2014 deri më 31.12.2021, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për <b>8467 persona</b> me vlerë <b>270,787,856 lekë</b>, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kamëz.</p> <p>Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- <i>Taksa e ndikimit në infrastrukturë</i>, pika 3 dhe VKB nr. 167, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr. 55, datë 20.12.2019” pika 5.</p>	I lartë	Pika 2.2.6 faqe 45-53	<p>- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej <b>270,787,856 lekë</b> ndajë <b>8467 personave</b>.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Kamëz të bashkëpunojë me Drejtorinë e ASHK Tiranë ose Ujësjellës Kanalizime sh.a Kamëz, për lidhjen e një aktmarrëveshje si Agjent Tatimorë në arkëtimin e detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për 8467 ndërtimet e raje për uljen e borxhit në vlerën <b>270,787,856 lekë</b>.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tiranë, që të mos pajisë me çertifikata pronësie subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë</p>
21	<p>Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore në mënyrë progresive në vlerën gjithsej <b>323,708,712 lekë</b>.</p> <p>Sipas të dhënave edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 444 subjekte debitorë në vlerën 121,835 mijë lekë, janë aktiv 404 subjekte ose 91 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa në vlerën 117,081 lekë ose 79 % e vlerës së debitorëve, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Kreut XI- “<i>Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara</i>”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.</p> <p>Nga totali prej 19 104 debitorë me vlerë 323,708,712 lekë (<i>debitorë të biznesit për 411</i></p>	I lartë	Pika 2.2.6 faqe 45-53	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën <b>323,708,712 lekë</b> .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>subjekte në vlerën 121,835,012 lekë dhe debitorë familjarë 18 660 familje në vlerën 201,873,700 lekë), nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vijuar me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, janë dërguar për bllokim të llogarive bankare me shkresën nr. 8965, datë 21.09.2021 për 1078 subjekte, barrë siguroese për automjetet me shkresën nr. 9372, datë 06.10.2021 për 1004 subjekte, barrë hipotekore për pronat me shkresën nr. 9371, datë 06.10.2021 për 1004 subjekte nga të cilët kanë arkëtuar detyrime për vitin 2021 në vlerën 33,891,820 lekë.</p>			

## 1.2. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2021, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes**, për llogaritë vjetore të Bashkisë Kamëz, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Kamëz bazuar në analizën e riskut<sup>1</sup>, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë jo të plotësuar, materiale dhe të përhapura që janë baza për dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë **526,921 mijë lekë**.

### Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 6 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **2,167 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në vlerën **631,061 mijë lekë**.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saje.

<sup>1</sup> Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.



Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari te lidhura me to; 467-Kreditore te ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime.

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **a- Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2021**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz për periudhën ushtrimore 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

*Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Kamëz, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2021, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemin e tyre.*

#### **Baza për opinion:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

#### **Theksimi i çështjeve:**

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në vlerën 716,700,299 lekë, të trashëguara që nga viti 2003 e cila nuk rezulton të jenë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e debitorë me shpresë arkëtimi dhe pa shpresë arkëtimi.

- Mos kryerja e inventari fizik të llogarisë 213.
- Mos marrja e masave për zhbllokimin e fondet për 4 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim në vitet 2006-2007, në vlerën 283,214 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, të ngurtësuara në Degën e Thesarit Tiranë.

#### **b- Opinion mbi përputhshmërinë.**

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Kamëz, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Kamëz, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 45,936 mijë lekë për shpenzimet dhe 68,915 mijë lekë për të ardhurat, si dhe rëndësia e anomalive të konstatuara.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Kamëz, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**.”*

#### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem Auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në sektorin e Raportit përfundimtar, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400-499 & ISSAI 4000-4899).

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkinë Kamëz, bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriteret të plotësuara, materiale jo të përhapura, pasi nga 36 procedura të zhvilluara me fondi limit 1,951,205 mijë lekë, në 11 procedura me fond limit 303,698 mijë lekë rezultuan me mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP.

- Në auditimin e zbatimit të kontratave të punëve publike, në 6 kontrata u konstatua një dëm ekonomik në vlerën **2,167 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në vlerën **631,061 mijë lekë**.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të sajë, etj.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kamëz:**

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Kamëz, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime

që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, si dhe në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1023/1, datë 15.11.2022 i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 21.11.2022 deri në datën 03.02.2023, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021 në subjektin Bashkia Kamëz, u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe Përputhshmëri” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Z. Kristaq Gjurgaj, *Përgjegjës Grupi*
2. Z. Përparim Gjuzi, *Auditues*
3. Z. Erand Rroboçi, *Audituese*
4. Znj. Ervina Basha, *Auditues*
5. Zj. Ana Xhabrahimi, *Auditues*
6. Z. Redi Ametllari, *Auditues*
7. Z. Alush Zaçe, *Auditues*

**a- Objekti i auditimit**, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave në fushën e prokurimeve publike, në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, në dhënien e lejeve të ndërtimit, në menaxhimin e aseteve, etj.

**b- Qëllimi i auditimit**, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>2</sup>.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve mbi bazën e procedurave të prokurimit të realizuara për

<sup>2</sup>Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

to, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

**c- Procedura e ndjekur:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Raporti Përfundimtar i Auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Kamëz, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 2939, datë 31/03/2023 (*prot KLSH nr. 1023/9, datë 55.4.2023*), janë paraqitur kundërshtitë mbi Projekt Raportin e Auditimit dërguar në subjekt me shkresën nr. 1023/8 prot datë 01/03/2023. Mbas shqyrtimit me objektivitet dhe profesionalizim të kundërshtive të subjekti, janë marrë në konsideratë ato çështje të cilat kishin argument dhe të mbështetura me dokumentacion justifikues. Ndërsa për çështjet e tjera për të cilat argumentet nuk justifikojnë gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditim, i cili i përcillet subjekti për zbatim dhe përmisimin e gjendjes në të ardhmen, referuar kjo dhe rekomandimeve të KLSH të reflektuara në fund të raportit.

**d- Identifikimi i çështjes:** Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kamëz, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiarë në fuqi.

**e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kamëz, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**f- Përgjegjësitë e Audituesve.**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**g- Kriteret e vlerësimit.**

✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

✓ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21/10/1998, me ndryshime.

- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30/06/2015, i ndryshuar.
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08/08/2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 02/06/2020.
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve.
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.
- ✓ Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
- ✓ Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 408, datë 13/05/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
- ✓ VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24/04/2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.
- ✓ VKM nr. 510, datë 10/06/2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”.
- ✓ UMF nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21/02/2022 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 22, datë 30/07/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- ✓ Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Kamëz.
- ✓ Ligji nr. 8402, datë 10/09/1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve Të Ndërtimit”, i ndryshuar.
- ✓ UKM nr. 3, datë 15/02/2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, etj.

#### **h- Standardet e auditimit:**

- ✓ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ✓ ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI,

- ✓ INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
- ✓ Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

#### **i- Metodatat e auditimit:**

##### *1. Kontrolli aritmetik.*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

##### *2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27/12/2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

##### *3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

##### *4. Kontrolli i vlerësimit.*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

##### *5. Konfirmim nga të tretët.*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

##### *6. Kontrolli sipas një treguesi.*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

##### *7. Intervistimi*

##### *8. Raporte dhe Informacione*

##### *9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.*

#### **j-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.**

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar

të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231), ku vlera e precizonit për vitin 2021 është në shumën 45,936 mijë lekë (gabim lejuar), të dhëna të paraqitura në Aneks 1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon<sup>3</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 2.a. Informacion i përgjithshëm.

Auditimi në Bashkinë Kamëz u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar dhe

<sup>3</sup>Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

paraqitur nga subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP, për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *materiale por jo të përhapura*, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E, në fushën e prokurimeve, në dhënien e lejeve të ndërtimit, në menaxhimin e aseteve si dhe menaxhimin të të ardhurave, *materiale por jo të përhapura*.

Bashkia Kamëz, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27/04/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Kamëz etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Kamëz.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

**Bashkia Kamëz** ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, në veriperëndim të saj. Kufizohet nga veriu me Krujën, nga jugu me Tiranën, nga lindja me Zall-Herrin dhe nga perëndimi me Bërshullin. Terreni në përgjithësi është i sheshtë, me një pjerrësi të lehtë drejt veriperëndimit. Zona ndodhet në një kuotë që varion nga 80-90 m mbi nivelin e detit në pjesën jugore, që zbret në 45 m mbi nivelin e detit, pranë aeroportit të Rinasit në pjesën veriore. Përshkohet nga rruga kombëtare që lidh kryeqytetin me veriun e vendit. Kamëza ndodhet në trekëndëshin strategjik: Kryeqyteti Tiranë - aeroporti i Rinasit - porti i Durrësit. Kamëza ka një sipërfaqe prej 37.18 km<sup>2</sup>, popullsia është 133,499 banorë dhe ka dy njësi administrative:

Bashkia Kamëz pas ndarjes së re territoriale përfshin nën administrimin e saj edhe njësinë administrative Paskuqan.

Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Kamëz	Qyteti Kamëz, fshatrat: Batllorë, Laknas, Vëllas, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner
Paskuqan	Fshatrat: Paskuqan, Babrru Gëndër, Kodër e Kuqë, Shpat, Fushë e Kërqikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër

**2/b. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

**2.1. Auditim mbi Menaxhimi financiar dhe kontrollin e brendshëm.**

1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Kamëz, në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Kamëz, për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296,



datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, rezultoi se:

**1-Mjedisi i kontrollit.** (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010)  
 -Bashkia e Kamëz, ka hartuar Rregullore Bazë, (Brendshme) “Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz”, e cila është miratuar me *Vendimin nr. 76, datë 08.02.2021*, të Kryetarit të Bashkisë. Në rregullore është përcaktuar Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë, parimet e përgjithshme të punës së bashkisë, janë përcaktuar objektivat e përgjithshme, struktura dhe funksionet përkatëse, detyrat funksionale për çdo sektor shërbimi etj. Për vitin 2021 Njësia Vendore në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar projektbuxhetin dhe ka marrë në konsideratë dhe risqet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave. Lidhur me buxhetin e caktuar çdo menaxher dhe strukturë varësie merr informacion krahas takimeve të ndryshme dhe me shkresë zyrtare. Nëpunësit e njësisë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, rregulla të cila janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë. Gjithashtu është përcaktuar procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

#### **Struktura organizative.**

Miratimi i Strukturës për vitin 2021, është kryer me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr 37 datë 14.01.2021, sipas Vendimit të Këshillit Bashkisë nr. 160, datë 23.12.2020 për miratimin e strukturës organizative, konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 203, datë 11.01.2021 ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

#### Ndarja e strukturës

Emërtimi	Viti 2021	
	Plan	Fakt
Aparati i Bashkisë.	276	270
Ndërmarrja e Pastris Gjelbërimit e Treg	90	90
Gjendja Civile	9	9
Zjarfikës	29	29
Bujqësi, Pyje	2	2
Arsimi	256	247
Shuma	662	647

Nga verifikimi për raportin e punonjësve me status dhe me kontratë pune rezulton se:

#### a. Për vitin 2021:

Nga të punësuarit 134 janë me statusin e nëpunësit civil, marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa 141 punonjës janë me kontratë pune marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe 1 i zgjedhur. Sipas strukturës së miratuar me VKB,

- a. Me status të Nëpunësit Civil, gjithsej 134 pozicione, nga të cilat:
  - 2 pozicione të kategorisë së lartë,
  - 16 pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
  - 32 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
  - 84 pozicione të kategorive ekzistuese

b. Pozicione të lira (të paplotësuara).

- 1 pozicion i kategorisë së lartë,
- 1 pozicion i kategorisë së mesme drejtuese
- 2 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- 2 pozicione të kategorive ekzistuese

Vendet vakante në aparatën e Bashkisë Kamëz, mbartin risqe të cenimit të performancës së aktivitetit të institucionit. Në strukturën e aparatit të Bashkisë Kamëz deri në 31 dhjetor 2021 ka 6 vende vakante. Për vitin 2021, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 39 punonjës, dhe në asnjë rast nga punonjësit e larguar nuk kanë dorëzuar punën me procesverbal. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin e informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre. Në këtë mënyrë nuk krijohet një vazhdimësi kronologjike e transmetimit të punës së kryer nga një punonjës te tjetri, por ndërprerje e saj, në varësi të shpeshëtisë së ndërrimit të stafit, e cila sjellë edhe pasojë reale në punën e sektorëve përkatës të njësisë vendore.

Është përcaktuar qartë ndarja e punës dhe e përgjegjësiave. Struktura mbulon të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë dhe bën të mundur qarkullimin e informacionit. Koordinimi dhe bashkëpunimi i drejtorive bëjnë që të jetë strukturë e decentralizuar duke respektuar shkallën hierarkike. Secili sektor dhe drejtori, ka të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe të nëpunësve në përbërje të tyre, përcaktuara në përkrahjet e punës, sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin e KM nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përkrahjet dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014 "Për hartimin e përkrahjet të pozicioneve të punës në shërbimin civil". Bazuar në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 10, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 si dhe në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", Titullari i Institucionit me Vendim nr. 34, datë 09.01.2020, "Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik"(GMS), i ndryshuar me vendimin nr. 4, datë 28.04.2020, në të cilën janë menaxherët më të lartë të institucionit dhe drejtuesit e programeve buxhetore. Punonjësit e njësisë i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe Kodit të Punës. Titullari i njësisë, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se, punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga, drejtuesit dhe ajo është e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara. Në rregulloren e brendshme të institucionit, njësia ka miratuar përkrahjet e punës për çdo pozicion pune në institucion ku përfshihen detyrat që duhen kryer nga çdo strukturë. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2021 punonjësit e kësaj njësia janë trajnuar sipas programeve të hartuara me tematika të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës, të cilat janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Trajnimeve të Administratës Publike (ASPА).Është hartuar plani i trajnimeve dhe është dërguar të SPA me shkresën nr. 2208, datë 04.03.2021. Për vitin 2021 janë ndjekur 313 tema të ndryshme trajnimi (177 trajnime nga ASPA dhe 136 nga institucione të tjera).Kodi i etikës është pjesë e Rregullores së Brendshme. Për mbajtjen e kontabilitetit financiar, punohet me programe kompjuterike si ëord, Excel. Gjurmët e auditimit janë miratuar me aktin nr. 6593, prot. datë 31.08.2020 të cilat përcaktojnë procedurat standarte të auditimit për menaxhimin e aktiveve, për procedurat e zbatimit të buxhetit (alokimin dhe rialokimin e fondeve buxhetore), për prokurimet etj.

**2. Menaxhimi i riskut.** (Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010). Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve hap pas hapi të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore, duke hartuar regjistrat e risqeve për drejtoritë dhe në bazë të nenit 21, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, njësia ka hartuar regjistrin e riskut të miratuar nga titullari me shkresën nr. 204, datë 03.06.2021. Me aktin nr. 523, date 20.12.2016 Bashkia Kamëz ka caktuar një punonjës të drejtorisë së financës si koordinatorë të riskut. Është hartuar regjistri i riskut nga të gjitha drejtoritë në varësi të bashkisë. Regjistri i riskut rishikohet në vazhdimësi. Më vendimin nr. 36, datë 20.03.2020 është hartuar Rregullore “Për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve (inventarizimin vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve), strategjia e menaxhimit të riskut të aktiveve të Bashkisë Kamëz”.

**3. Aktivitetet e kontrollit.** (Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010). Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arrijten e objektivave dhe të misionit të saj. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë.

Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) është ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 140 datë 25.03.2020, nr. 9 datë 06.01.2021 dhe nr. 330 prot. datë 16.06.2021. Planet e Zhvillimit Strategjik dhe planet buxhetore afat mesëm janë miratuar nga GMS, me proces verbale datë 30.03.2021, 04.05.2021, 06.09.2021, 28.10.2021 dhe nga Këshilli Bashkiak Kamëz me VKB nr. 165, datë 23.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA Përfundimtare 2021-2023.

**4. Informim komunikimi.** (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisve. Menaxherët e njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin ka funksionuar në njësi dhe në strukturat vartëse. Titullari, njëkohësisht edhe në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, dhe koordinator i riskut informohet nga drejtuesit e programeve me anë të mbledhjeve, relacioneve, dhe raporteve të ndryshme. Sektori i Financës, raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, raporteve të monitorimit çdo 3-muaj. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme.

Njësia ka në strukturë shërbim të IT-së, ka miratuar rregullore të këtij shërbimi, me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 76/1, datë 08.02.2021 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e informacionit”.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare, dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Dokumentat janë publikuar edhe në faqen zyrtare të Bashkisë në adresën, [kamza.gov.al](http://kamza.gov.al).

**5. Monitorimi.** (Në zbatim të kërkesave të nenin 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullari informohet vazhdimisht nga vartësit mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve, informacioneve apo, raporteve të ndryshme. Drejtuesit nën mbikëqyrjen e Titullarit, raportojnë realizimin e çdo objektiivi në përgjegjësinë e gjithsecilit. Krahas arritjeve analizohen dhe shkaqet e mosrealizimeve.

Deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, është hartuar dhe është dërguar në Ministrinë e Financave me aktin nr. 1696 prot., datë 24.02.2022.

Bashkia Kamëz ka dërguar brenda afateve ligjore në Ministrinë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, raportet e monitorimit për ecurinë dhe masën e realizimit të shpenzimeve për vitin 2021.

**Konkluzion:** Pas analizimit të treguesve të mësipërm, pjesë përbërëse e 5 komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, arrijmë në konkluzionin që: Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë Kamëz ka funksionuar në mënyrën e duhur në 5 komponentët e tij. Bashkia Kamëz ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetorë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2021, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 108, datë 17.11.2016 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. Mjedisi i kontrollit, rezultoi pa mangësi në treguesit e tij. Është miratuar rregullorja e brendshme dhe kodi etik. Në lidhje me menaxhimin e riskut nga auditimi i dokumentacionit dhe nga deklarata e stafit menaxherial u konstatua se Bashkia Kamëz disponon një regjistër rrishtu në nivel institucioni.

## **2.1.2. Për auditimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm.**

*1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;*

*1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm*

- *Organizimi dhe funksionimi i strukturës së Auditit të brendshëm;*

Auditimi i Brendshëm në Bashkinë Kamëz, është ngritur dhe organizuar në nivel drejtorie si pjesë e strukturës së bashkisë që nga viti 2006. Ajo funksionon në bazë të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, pika 1, shkronja “a”, si dhe neni 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pika 3, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, “Për miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Kamëz, për vitin 2021, funksionon në nivel drejtorie, sipas vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 37 datë 14.01.2021, vendim ky bazuar në ligjin nr. 139 datë neni 64, shkronja “j”.

- *Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Kamëz, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2021, e në vazhdim është organizuar në nivel drejtorie me strukture 1 drejtues njësie, 2 auditues.

Për vitin 2021, kjo njësi ka funksionuar 3 punonjës, përkatësisht 1 drejtues dhe 2 specialist auditimi, me profili arsimor të diplomuar 2 në fushën e ekonomisë dhe 1 në fushën e drejtësisë, ku 2 prej tyre janë të çertifikuar ( drejtuesi dhe 1 auditues), 1 (një) auditues i pa çertifikuar (aktualisht në proces certifikimi). Auditimi i pa çertifikuar është emëruar më datë 13.07.2021. Pra në fund të vitit 2021, kjo njësi ka në përbërjen e saj drejtuesin dhe dy auditues, me përvojë pune në fushën e auditimit, drejtuesi dhe një auditues me mbi 10 vjet dhe përvojë profesionale në fushën ku janë diplomuar, duke filluar nga 25-30 vjet, 1 auditues i pa çertifikuar është me përvojë

me përvojë pune 7 vjet. Struktura e kësaj njësie auditimi, në forme tabelore për periudhën e audituar 01.01.2021-31.12.2021, paraqitet si më poshtë:

NGA DATA 01.01.21 DERI MË DATË 23.02.21	FUNKSIONI	ARSIMIMI	VJETË RSI NË PUNË	VJETËRS I NË AUDITIM/ VITE	ÇERTIFIKIMI	TRAJNIME TË VIJUESHME
BESURIE DODA	DREJTORI I NJËSISË	EKONOMIST	25	17	NE VITIN 2008	PO
RAMIZ MEJDANI	AUDITUES	EKONOMIST	32	13	NE VITIN 2011	PO
BLERIM SHEHU	AUDITUES	EKONOMIST	6	5	PA ÇERTIFIKUAR	JO

NGA DATA 23.02.21 DERI MË DATË 13.07.21	FUNKSIONI	ARSIMIMI	VJETË RSI NË PUNË	VJETËRS I NË AUDITIM/ VITE	ÇERTIFIKIMI	TRAJNIME TË VIJUESHME
BESURIE DODA	DREJTORI I NJËSISË	EKONOMIST	25	17	NË VITIN 2008	PO
RAMIZ MEJDANI	AUDITUES	EKONOMIST	32	13	NË VITIN 2011	PO

NGA DATA 13.07.21 DERI MË DATË 31.12.2021	FUNKSIONI	ARSIMIMI	VJETË RSI NË PUNË	VJETËRS I NË AUDITIM/ VITE	ÇERTIFIKIMI	TRAJNIME TË VIJUESHME
BESURIE DODA	DREJTORI I NJËSISË	EKONOMIST	25	17	NË VITIN 2008	PO
RAMIZ MEJDANI	AUDITUES	EKONOMIST	32	13	NË VITIN 2011	PO
ELONA VOKRRI	AUDITUESE	JURISTE	7	0	PA ÇERTIFIKUAR	JO

Sa më sipër Blerim Shehu është emëruar me datë 03.02.2020 me aktin e kryetarit nr. 56 prot. dhe është larguar me datë 23.02.2021 me aktin nr. 105 prot. Në vend të tij është emëruar Elona Vokri me aktin nr. 378 prot., datë 13.07.2021.

- Dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron aktivitetin Drejtoria e Auditimit të Brendshëm. Grupi i auditimit shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, ku konstaton se dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Brendshëm e Njesisë së Auditimit Bashkia Kamëz, miratuar me Vendimin nr. 1216 prot. datë 12.02.2020, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 520 prot., datë 15.10.2020.

2. Planet strategjike si dhe planet vjetore, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të MABP, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm ( kap. III ), pika 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm”, të cilat i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, përkatësisht:

- Plani strategjik i periudhës 2021-2023 dhe plani vjetore 2021 i janë dërguar strukturës përgjegjëse të DHAB në Ministrinë e Financës me shkresën nr. 8317/1prot, datë 19.10.2020, i cili është rishikuar dhe miratuar me shkresën nr. 8317/1, prot, datë 14.7.2021, të cilat i janë dërguar Strukturës Përgjegjëse të DHAB në MF me shkresën nr. 9741prot, datë 15.10.2021 (brenda vitit ushtrimorë).

- Plani strategjik i periudhën 2022-2024 dhe plani për vitin 2022 janë dërguar DHAB (struktura përgjegjëse) në Ministrinë e Financave me shkresën nr/. 9747, datë 15.10.2021.

Plani vjetorë i auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kriteret e procedurës të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planet vjetore të auditimit janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë.

Nga NJAB, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, përkatësisht:

- Raporti vjetor i veprimtarisë së NJAB Bashkia Kamëz për vitin 2020 i janë dërguar DHAB në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1340, datë 11.2.2021.

- Raporti vjetor i veprimtarisë së NJAB Bashkia Kamëz për vitin 2021 i janë dërguar DHAB në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1384, datë 15.2.2022.

Veprimtaria e AB për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB, e cila paraqitet si me poshtë:

Për vitin 2021, janë realizuar:

Raportimi i auditimit të realizuar gjatë vitit 2021 dhe raportuar në fillim të vitit 2022, ku u është kushtuar vëmendja e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar të Bashkisë, prokurimet me fonde publike, administrimit të aseteve, taksat dhe tarifatat vendore, ... etj.

Nga grupi i auditimit janë konstatuar shkelje të procedurave, të meta e mangësi në zbatimin e legjislacionit dhe akteve ligjore e administrative që rregullojnë funksionimin e Institucionit si në drejtim të fushës financiare, pagesave të pa ligjshme, administrimit material e monetar, të prokurimeve publike, të cilat kanë sjellë për pasoje shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë dhe institucioneve të bashkisë në vlerën 6,429 mijë lekë, kjo përkatësisht:

- Nga taksat dhe tarifatat vendore në vlerën	2,454 mijë lekë
- Për paga, shpërblime, trajtime e komisione	3,975 mijë lekë

-Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor, analiza sipas llojeve dhe gjetjeve.

Për vitin 2021 janë parashikuar në planin vjetor 6 (gjashtë) auditime, janë realizuar 6 (gjashtë) auditime nga të cilat 6 (gjashtë) subjekte të planifikuara në planin vjetor dhe 0 (zero) subjekte të paplanifikuara në planin vjetor, rezultoi se janë realizuar në masën 100 %, sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Subjektet	Niveli vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objektet të pa audituara mbi 2-vjet	Realizimi
1	Drejtoria e Financës & Kontabilitetit	I mesëm	I kombinuar	Jo	Po
2	Ndërmarrja e pastrim Gjelbërimit	I mesëm	I kombinuar	Jo	Po
3	Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit	I lartë	I kombinuar	Po	Po
4	Zbatimi i rekomandimeve 2020	I mesëm	I kombinuar	Jo	Po
5	Drejtoria e PZHT	I mesëm	I kombinuar	Jo	Po
6	Ujësullës Kanalizime Kamëz (UKK sh.a)	I lartë	I kombinuar	Jo	Po

Për vitin 2021, janë rekomanduar gjithsej 41 (dyzet e një) rekomandime nga këto:

Rekomandime me karakter organizativ 37 (tridhjetë e shtatë)

Rekomandime me karakter arkëtimi 4 (katër).

Masa Organizative për 6 subjektet si më poshtë:

Në subjektin “Drejtoria e Financës & Kontabilitetit”, 2 (dy) rekomandime;

Në subjektin “Ndërmarrja e pastrim Gjelbërimit”, 6 (gjashtë) rekomandime;

Në subjektin “Drejtoria e Çështjeve Ligjore & Prokurimit Publik”, 6 (gjashtë) rekomandime;

Në subjektin “Zbatimi i rekomandimeve 2020”;

*Në subjektin “Drejtoria e PZHT”, 5 (pesë) rekomandime;*

*Në subjektin “Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK sh.a)”, 22 (njëzet e dy) rekomandime;*

Për vitin 2021 janë dhënë gjithsej 41 (dyzet e një) rekomandime dhe nga përgjigjet e kthyer nga subjektet e audituara rezultoi se 33 (tridhjetë e tre) rekomandime janë zbatuar, 8 (tetë) rekomandime janë në proces zbatimi.

Zbatimi i tyre është rreth 80 %, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm.

*- Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.*

Nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm Bashkia Kamëz, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi”, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit.

Gjatë kryerjes së angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimin për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e konfliktit të interesit, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, ..etj. Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 “Përgatitja e programit të angazhimit...”, ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi prokurimin e fondeve publike, vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, menaxhimi i burimeve njerëzore, administrimi i buxhetit, deklaratave financiare, etj., pra rezultoi se janë zbatuar drejt kriteret, lidhur me fushat prioritare për auditimin e subjekteve, pasi ato kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimtarisë në përputhje me risqet e subjekteve.

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin e MF nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

*- Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt - raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.*

Nga NJAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditimi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të manualit të AB edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim iu reflektuar tek formati 7, kap II të MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësitja e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

dhe të kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të Manualit të Auditimit të Brendshëm , miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016.

*- Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese.*

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

*- Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.*

Nga njësia e AB të bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapit. VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim. Mbi rezultatet e auditimit për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, të dhënat janë dhe në pasqyrat shoqëruese bashkëlidhur materialit.

**Konkluzion:** Për sa më sipër rezulton se veprimtaria e Auditit të Brendshëm për periudhën 01.01.201-31.12.2021 , ka funksionuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

## **2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2021.**

*2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;*

*2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;*

*2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.*

*2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).*

*2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;*

### Programimi i PBA 2022 – 2024

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.

Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si zhvillimi i infrastrukturës së duhur për ujësjellës, kanalizime, rrugë, sheshe publike apo parqe si dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve dhe qendrave shëndetësore. Përmirësimi në vijimësi i shërbimeve publike, kujdesi, pastrimi dhe mbrojtja e mjedisit, mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese, si dhe ndriçimi i ambienteve publike janë ndër prioritetet e Bashkisë Kamëz.



Këto programe afatmesëm janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 7 datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm të njësisë të Qeverisjes Vendore 2022 – 2024” dhe Udhëzimit plotësues të MFE nr. 20 datë 09.07.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm të njësisë të Qeverisjes Vendore 2022 – 2024”. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetit me pjesëmarrje”.

Bazuar në dokumentet e paraqitura (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

- PBA 2022 – 2024 dhe buxheti i vitit 2021 janë miratuar si vijon:

-Këshilli Bashkiak Kamëz ka marrë Vendimin për Miratimin e Kalendarit për Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe Buxhetin Vjetor 2021, me vendim nr . 160, datë 23.12.2020, brenda datës 31 Dhjetor 2020, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 33.

-Me Urdhrin nr. 9, datë 06.01.2021, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024, dhe me urdhrin nr. 330, datë 16.06.2021 është bërë ndryshimi i GMS ku janë hequr 2 anëtarë dhe janë shtuar 6 anëtarë të rinj.

-Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 10.02.2021 janë miratuar tavanet përgatitore të PBA 2022 – 2024.

-Përgatitja e programit buxhetor afatmesëm 2022 – 2024 është kryer në bazë të udhëzimit të brendshëm nr. 2196, dt, 03.03.2021

-Është përgatitur plani Masave dhe Veprimet, nr. 4814 prot., datë 10.05.2021, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024 dhe Projekt buxhetit Vjetor 2021. Në këtë shkresë janë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

- Me shkresën nr. 5605, datë 28.05.2021 është dërguar në MFE projektdokumenti i PBA 2022-2024, i përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar

-Me shkresën nr.10877, datë 18.06.2021, MFE ka dërguar në Bashkinë Kamëz mendimet për PBA 2022 – 2024 .

- Me shkresën nr. 8860, datë 16.09.2021, është informuar Këshilli Bashkiak se dokumenti përfundimtar i PBA 2022-2024 nuk ka ndryshime nga projektdokumenti i PBA 2022-2024.

- Në datë 15.09.2022 Bashkia Kamëz ka njoftuar elektronikisht MFE se dokumenti përfundimtar i PBA 2022-2024 nuk ka ndryshime nga projektdokumenti i PBA 2022-2024.

-Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 79, datë 19.07.2021 është miratuar projekt buxheti afatmesëm për periudhën 2022 – 2024, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 1

Në '000 Lekë

Emërtimi i Programit	Programi	Viti		
		2022	2023	2024
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01110	365,071	206,281	217,948
Çështjet financiare dhe fiskale	01120	50,056	50,556	50,686
Gjendja Civile	01170	18,063	7,323	7,323
Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	01710	0	0	0
Shërbimet e Policisë Vendore	03140	17,266	19,788	19,049
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	122,501	122,501	122,501
Marrëdhëniet me Komunitetin	03600	0	0	0
Mbështetja për zhvillimin ekonomik	04130	0	0	0
Shërbimet e Tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	04160	0	0	0
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja	04220	14,105	13,588	13,588

Bashkia Kamëz		Viti		
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	04240	94,938	103,611	103,611
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	04260	550	550	550
Rrjeti rrugor rural	04520	1,027,928	1,078,512	1,120,637
Transporti publik	04570	7,748	9,214	9,306
Projekte zhvillimi	04740	0	0	0
Zhvillimi i turizmit	04760	0	0	0
Menaxhimi i mbetjeve	05100	135,000	135,000	135,000
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	05200	36,336	15,076	0
Programet e mbrojtës së mjedisit	05320	0	0	0
Ndërgjegjësimi mjedisor	05630	0	0	0
Planifikimi urban vendor	06140	320,360	94,086	96,028
Programet e zhvillimit	06210	0	0	0
Shërbime publike vendore	06260	176,956	176,177	184,725
Furnizimet me ujë	06330	546,672	578,470	590,039
Ndriçim rrugësh	06440	0	0	0
Shërbimet e kujdesit parësor	07220	0	0	0
Sport dhe argëtim	08130	19,152	20,994	23,924
Trashëgimia kulturore, eventit artistike dhe kulturore	08220	37,290	37,663	39,142
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	09120	628,320	360,741	285,862
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	09230	167,153	26,001	26,001
Arsimi profesional	09240	37,554	40,558	43,803
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	10140	32,125	35,628	35,679
Sigurimi shoqëror	10220	0	0	0
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	10430	662,832	593,890	623,584
Papunësia, arsim dhe aftësim	10550	0	0	0
Strehimi social	10661	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>4,517,976</b>	<b>3,726,209</b>	<b>3,748,986</b>

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunoi Grupi i Auditimit

#### - Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2021, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e realizimit të buxhetit në nivel programesh, duke përfshirë misionin, objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

**Për aktivitetin e vitit 2021**, monitorimi është bërë me shkresën nr. 5497, datë 27.05.2021 dërguar në Këshillin Bashkiak dhe me shkresën nr.5494, datë 27.05.2021 është dërguar raporti i monitorimit të zbatimit të Buxhetit për 4 –mujorin e parë të vitit 2021 të Bashkisë Kamëz në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 9251 datë 30.09.2021 është dërguar raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 8 - mujorin e vitit 2021 në Këshillin Bashkiak Kamëz dhe në MFE është dërguar nëpërmjet postës elektronike.

Me shkresën nr. 1485 datë 17.02.2022 është dërguar raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 12 mujorin e vitit 2021 në Këshillin Bashkiak Kamëz dhe me shkresën nr. 1492, datë 18.02.2022 është dërguar në MFE raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 12 mujorin e vitit 2021.

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Buxheti i vitit 2021 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 160, datë 23.12.2020. Buxheti i Bashkisë për vitin 2021 është 2,207,134 mijë lekë ndër të cilat 1,473,934 mijë lekë ose 66.78% nga të ardhurat e veta, 508,692 mijë lekë ose 23.05% nga transfertat e pakushtëzuar dhe 224,508 mijë lekë ose 10.17% nga transfertat specifike, paraqitur dhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Në ,000 lekë	
		Plani vjetor Kamëz 2021	Përqindja në raport totalin
1	Transfertat e pakushtëzuar	508,692	23.05%

Nr.	Emërtimi	Plani vjetor Kamëz 2021	Përqindja në raport totalin
<b>Shuma transfertës e pakushtëzuar</b>		<b>508,692</b>	<b>23.05%</b>
2	Transfertës specifike arsimit parashkollor	147,805	6.70%
3	Transfertës specifike arsimit parauniversitar	10,041	0.45%
4	Transfertës specifike ujitja dhe kullimi	3,611	0.16%
5	Transfertës specifike mbrojtja kundër zjarrit (PMNZSH)	47,768	2.16%
6	Administrimi i pyjeve	550	0.02%
7	Mbrojtja Civile	14,733	0.67%
<b>Shuma transfertës sektoriale</b>		<b>224,508</b>	<b>10.17%</b>
1	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	541,126	24.52%
2	Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	726,562	32.92%
3	Drejtoria e MTPM, Bordi i Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave	3,500	0.16%
4	Të ardhurat nga Drejtoria e Shërbimeve Publike	21,600	0.98%
5	Të ardhurat nga Drejtoria e Transportit dhe Liçensave	58,401	2.65%
6	Të ardhurat nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime	66,244	3.00%
7	Të ardhurat arkëtim nga kopshtet dhe çerdhet	24,000	1.09%
8	Të tjera (tarifa shërbimi; gioba bashkiake & ndërtimore, etj.)	32,500	1.47%
<b>Shuma e të ardhurave</b>		<b>1,473,934</b>	<b>66.78%</b>
Totali i burimeve të financimit		2,207,134	

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti fillestar për vitin 2021 i është nënshtruar 11 herë ndryshimeve, të cilat janë të miratuara sipas VKB të mëposhtme dhe janë konfirmuar nga Prefekti si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3

Nr.	VKB nr. dhe datë	Konfirmimi i Prefektit
1	Nr. 8, datë 10.02.2021	Nr. 212/1 datë 15.02.2021
2	Nr. 26, datë 10.03.2021	Nr. 514/1 datë 30.03.2021
3	Nr. 33 datë 16.03.2021	Nr. 512/1 datë 02.04.2021
4	Nr. 36, datë 31.03.2021	Nr. 579/1 datë 08.04.2021
5	Nr. 45 datë 19.04.2021	Nr. 661/1 datë 28.04.2021
6	Nr. 49 datë 19/05/2021	Nr. 809/1 datë 28.05.2021
7	Nr. 68 datë 18.06.2021	Nr. 966/1 datë 05.07.2021
8	Nr. 80 datë 19.07.2021	Nr. 1146/1 datë 05.07.2021
9	Nr. 84 datë 04.08.2021	Nr. 1222/1 datë 11.08.2021
10	Nr. 98 datë 18.10.2021	Nr. 1655/1 datë 25.10.2021
11	Nr. 140 datë 29.12.2021	Nr. 2061/1 datë 29.12.2021

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunoi Grupi i Auditimit

Buxheti i Bashkisë Kamëz, pas ndryshimeve Buxhetore paraqitet në vlerën 3,365,739 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 janë alokuar nga MFE vlera prej 1,371,676 mijë lekë për programin e Rindërtimit. Konstatohet se me VKB nr. 98, datë 18.10.2021 janë pakësuar për vlerën 333,446 mijë lekë të ardhurat të cilat krijohen nga Bashkia për arsye se nuk ka patur realizim në nivelet e planifikuara. Ndryshimet e shuma në buxhet, tregojnë për planifikime jorealiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar si dhe nëpërmjet një analize realiste të situatës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të shoqërohen me sa më pak ndryshime dhe vetëm kur është nevoja e domosdoshme dhe e pashmangshme.

*Ndryshimet buxhetore paraqiten në Aneks 2.2 bashkëlidhur Raport Auditimit.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Vjollca Smaçi, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

#### **Pretendim i subjektit:**

*Në lidhje me ndryshimet buxhetore, sqarojmë se ato janë bërë pasi kemi qenë të detyruar për shkak të miratimit në Këshillin Bashkiak të fondeve të rindërtimit të miratuara me VKM. Konkretisht janë miratuar në këshillin bashkiak ndryshimet buxhetore sipas VKM-ve, konkretisht: VKM nr. 26, datë 20.01.2021, nr. 201, datë 25.3.2021, nr. 200, datë 25.3.2021, nr.*

211, datë 31.3.2021, nr. 235, datë 14.4.2021, nr. 770, datë 15.12.2021 dhe nr. 714 datë 24.11.2021.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me argumentet e trajtuara në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, grupi i auditimit sqaron se ato **merren pjesërisht në konsideratë**, për arsye se vetëm një pjesë e ndryshimeve buxhetore lidhen drejtpërdrejtë me miratimin e fondeve të rindërtimit me VKM – të e cituara më sipër. Ndryshimet buxhetore gjatë periudhës së auditimit janë kryer dhe për nivelin e planifikuar të të ardhurave që krijon nga Bashkia.

**Titulli i gjetjes 1: Ndryshimet buxhetore gjatë periudhave ushtrimore**

**Situata:**

Gjatë periudhës ushtrimore objekt auditimi, kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), ku në vitin 2021 ka gjithsej **11** shkresa për ndryshime në buxhet. Të gjitha ndryshimet janë miratuar me VKB dhe janë konfirmuar nga Prefekti. Ndryshimet e shumta në buxhet, tregojnë për planifikime jorealiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar si dhe nëpërmjet një analize realiste të situatës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të shoqërohen me sa më pak ndryshime dhe vetëm kur është nevoja e domosdoshme dhe e pashmangshme

**Kriteri:**

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

**Shkaku:**

Mos planifikim i saktë i shpenzimeve buxhetore nga strukturat përgjegjëse

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës dhe Sektori i Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Kamëz, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

- Zbatimi i buxhetit viti 2021. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Në planifikimin e buxheteve për investime, konstatohet se investimet janë planifikuar me afat pagese nga 2 - 3 vjeçare, të cilat janë miratuar në PBA respektive, por referenca ligjore që ato i kanë mbështetur këto financime nuk qëndron, pasi nuk janë investime të reja dhe kontrata shumëvjeçare, por janë investime në vlera të vogla që variojnë nga 20 deri në 50 milionë lekë.

Këto veprime janë kryer nga Bashkia Kamëz, për të rritur numerik e procedurave të prokurimit në një vit buxhetor, por nga pikëpamja financiare çon në rritjen e nivelit të kreditorëve (fatura të palikujduara), duke penguar në një farë mënyrë prioritetet që mund të ketë bashkia në periudhën në vijim, kjo për faktin se fillimisht planifikohen faturat e palikujduara të periudhave të mëparshme dhe më pas planifikim i procedurave të reja, në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Për zbatimin e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tiranë, si për shpenzimet ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tiranë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2021, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 5: Plan- Fakt Shpenzime 2021

Artikull	Plani Përfundimtar 12 mujour 2021			Realizimi Faktik 12 mujour 2021		Realizimi ne (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit Për. Te vitit 2018
	Emërtimi	Vlera	Struktura ne %	Vlera	Struktura ne %	
600+601	Shpenzime të personelit	521,893	12%	507,862	13%	97.31%
602+606	Shpenzime korrente	1,316,408	31%	1,123,350	29%	85.42%
230+231	Shpenzimet kapitale	2,413,147	57%	2,122,245	55%	87.95%
<b>Shuma</b>		<b>4,251,448</b>		<b>3,843,457</b>		<b>90.43%</b>

Burimi: Bashkia Kamëz, përpunoi Grupi i Auditimit

Në vitin 2021 janë planifikuar 4,251,448 mijë lekë shpenzime dhe janë realizuar 3,843,457 lekë në krahasim me planin 12 mujour të vitit 2021, në masën 90.43 %. Shpenzimet e personelit të cilat zënë rreth 13 % të total shpenzimeve në Bashkinë Kamëz, janë realizuar në masën 97.31 % ose 507,862 mijë lekë. Shpenzimet korrente që zënë rreth 29 %, janë realizuar në masën 1,123,350 mijë lekë ose 85.42 %; ndërsa shpenzimet kapitale që zënë rreth 55 % janë realizuar në masën 87.95 % ose 2,122,245 mijë lekë. Sipas paraqitjes në tabelën e mësipërme përqindjen më të lartë në shpenzimet e bashkisë e zënë shpenzimet kapitale në masën 55%.

Tabela nr. 6: Shpenzimet buxhetore sipas zërave dhe burimeve për vitin 2021

Nr.	Emertimi i Shpenzimeve/ Burimet e fondeve	Burimet e fondeve	Viti 2021			%
			Plani	Fakti	466	
1	600 Shpenzimet per pagat		474,737	437,912		92.24%
2	601 Sig shoqërore dhe shëndetësore		84,518	69,951		82.76%
3	602 Shpenzime operative		297,260	178,545		60.06%
4	604+609 Ndihmat ekonomike		38,301	26,884		70.19%
5	230+231 Studime projektme		1,154,466	1,007,920		87.31%

Nr.	Emertimi i Shpenzimeve/ Burimet e fondeve	Burimet e fondeve	Viti 2021			%
			Plani	Fakti	466	
6	466 Mjete ne ruajtje		2,558,956	2,122,245		82.93%
7	Te trashëguara nga viti kaluar	69,924			56,962	
8	Transferta te pa kushtëzuara	527,169				
9	Transferta specifike	236,498				
10	Te ardhurat vendore te vitit	792,637				
11	Fonde për rindërtimin	1,343,894				
12	Donatore					
13	Transferta e Kushtëzuar	1,283,911				
14	Etj.					
	<b>TOTALI</b>	<b>4,254,033</b>	<b>4,608,238</b>	<b>3,843,457</b>	<b>56,962</b>	<b>83.40%</b>

*Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH*

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e tregueseve buxhetore, konstatohet se në total buxheti është programuar për 4,608,238 mijë lekë, realizuar 3,843,457 mijë lekë ose në masën 83.40 %. Pagat janë realizuar në masën 92.24 %, shpenzimet operative janë realizuar 60.06 % dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 87.31 %.

Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:

- 69,924 mijë lekë janë fonde të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e pa përdorur të ardhura të veta dhe grande,
- 527,169 mijë lekë fonde nga transferta të pa kushtëzuara,
- 236,498 mijë lekë fonde nga transferta specifike,
- 1,343,894 mijë lekë fonde për rindërtimin,
- 1,283,911 mijë lekë transfertës e kushtëzuar,

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Vjollca Smaçi, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendimet e Subjektit:**

*Në lidhje me planifikimin e të ardhurave, sqarohet se planifikimi i të ardhurave bëhet nga drejtoritë përkatëse sipas miratimit të paketës fiskale. Para se të hartohet projekt buxheti ju është kërkuar të gjitha drejtorive parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazuar në informacionet që sjellin drejtoritë në formë zyrtare është hartuar projekt buxheti për tu paraqitur në këshillin bashkiak. Konkretisht për buxhetin e vitit 2021 me shkresën nr. 5909 prot. prot. datë 30.07.2020, ju është kërkuar drejtorive të paraqesin të ardhurat dhe shpenzimet për vitet 2021, 2022, 2023. Projekt vendimi (tabela e të ardhurave dhe shpenzimeve) kontrollon dhe nënshruhet nga personat përgjegjës për planifikim. Bashkëlidhur projekt vendimi nr. 149 datë 17.12.2020 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2021,2022,2023”, tabelat e planifikimit të ardhurave si dhe shkresa nr. 5909 prot. prot. datë 30.07.2020 “kërkesë të dhënash për parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për hartimin e projekt buxhetit të vitit 2021 si dhe PBA 2022-2024”.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

**Titulli i gjetjes 2:** *Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2021.*

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi realizimin e të ardhurave për vitin 2021, rezulton se ato janë realizuar në vlerën 792,636 mijë lekë nga vlera 1,473,934 mijë lekë të parashikuara ose në masën 53.77%. Mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore ka çuar në mos likuidimin e faturave të shpenzimeve dhe rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhës ushtrimore, pasi mbi bazën të ardhurave të planifikuara është parashikuar kryerja e shpenzimeve buxhetore të vitit 2021.

Niveli i ulët i arkëtimit të të ardhurave tregon se kemi të bëjmë më parashikim jo të mirë argumentuar të të ardhurave nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit, etj, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlogaritjes së shpenzimeve, në një mjet joreal, jo të qëndrueshëm dhe efektiv.

**Kriteri:**

Ligji nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;; udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Planifikimit i shpenzimeve buxhetore duke u mbështetur në planin e të ardhura kur ky plan nuk realizohet plotësisht çojnë në moslikuidimin e shpenzimeve dhe rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

**Shkaku:**

Mos planifikim i saktë i të ardhurave vendore nga strukturat përgjegjëse.

**Rëndësia: E lartë****Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Kamëz (strukturat përgjegjëse), të marrin masa që planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- *Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2021, referuar programeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:*

Tabela nr. 7

Në 000 lekë

Nr.	Program	Emërtimi i Programit	Plani thesarit 2021	Shpenzime thesari 2021	% realizimi me planin e thesarit 2021
1	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	190,501	182,618	96%
2	01120	Cështjet financiare dhe fiskale	43,333	43,310	100%
3	01170	Gjendja Civile	8,474	8,473	100%
4	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	16,483	16,105	98%
5	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	67,311	46,206	69%
6	04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi i ushqimit	18,539	18,256	98%
7	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	93,153	88,872	95%
8	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	550	550	100%
9	04520	Rrjeti rrugor rural	649,208	649,217	100%
10	04570	Transporti publik	6,297	5,878	93%
11	04960	Blerje ndërtesash për të dëmtuarit nga tërmeti	-	-	0%
12	05100	Menaxhimi i mbetjeve	74,684	74,766	100%
13	05200	Menaxhimi i ujërave të zeza	86,645	86,449	100%
14	06140	Urbanistika e bashkisë	42,335	42,113	99%
15	06180	Zhvillimi i strehimit	12,783	10,257	80%
16	06190	Zhvillimi i strehimit	562,929	487,677	87%
17	06220	Detyrim i prapambetur nga FZHR	-	-	0%
18	06260	Ndërmarrja e Pastrim gjelbërimit	75,647	75,497	100%
19	06260	Shërbimet publike lokale	32,967	30,961	94%

Nr.	Program	Emërtimi i Programit	Plani thesarit 2021	Shpenzime thesari 2021	% realizimi me planin e thesarit 2021
20	06330	Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizime	-	-	0%
21	06370	Ndërtim KUN	455,374	455,374	100%
22	08130	Sport dhe argëtim	20,275	19,407	96%
23	08230	Shërbimet kulturore	17,646	16,671	94%
24	09120	Arsimi 9 - vjeçar, parashkollor dhe ndihmës	834,695	558,597	67%
25	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	259,800	253,813	98%
26	09240	Bursat e shkollës profesionale	37,254	37,085	100%
27	10140	Projekti i PAK	3,582	2,014	56%
28	10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	592,887	586,409	99%
29	10770	Ndihma ekonomike dhe paaftësia	26,037	24,853	95%
30	10910	Emergjencat civile	16,884	16,884	100%
31	01620	Shpenzime për komisionar për zgjedhjet	5,161	5,131	99%
		<b>Totali</b>	<b>4,251,434</b>	<b>3,843,443</b>	<b>90%</b>

*Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH*

Programe me realizim të ulët paraqiten:

*Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile 69%. Për këtë program numri i emergjencave civile ka qenë me ulët nga çfarë ishte parashikuar dhe për këtë arsye niveli i realizimit është në masën 69%*

*Arsimi 9 – vjeçar, parashkollor dhe ndihmës është në nivelin 67% për arsye së një pjesë e investimeve të parashikuara për këtë projekt kanë qenë të njëjta me ato të rindërtimit.*

*Projekti i PAK është në nivelin 56% për arsye se fondet e planifikuara për këtë projekt ishin më të larta sesa nevoja reale e tij.*

**- Analizë e transfertave të kushtëzuara**

Për periudhën e vitit 2021, transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe”, të cilat janë realizuar në masën 99%, dhe ku pjesa më e madhe e projekteve kanë realizim të plotë. Përdorimi i fondeve është i detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 8

Në 000 lekë

KOD	PROG	PROJEKT	ART	Emërtimi	Plan vjetor	Shpenz thesari	Niveli i realizimit në %
2166001	,01170		600	Paga gjendja civile	6,100	6,099,325	100%
2166001	,01170		601	Sigurime shoqërore gj civile	874	873,731	100%
			600999		6,974	6,973	100%
2166001	,01170	91603AB	606	Shpërbim lindje te prapambetura	1,500	1,500	100%
			6029999		0	1,500	100%
2166001	01620		600	Shpenzime per Zgjedhjet e Kuvendit 25.04.2021	4,710	4,710	100%
2166001	01620		602	Shpenzime per Zgjedhjet e Kuvendit 25.04.2021	451	422	94%
			6029999		0	5,161	99%
2166001	06190	91010AC	606	Bonus qera strehimi	7,064	7,056	100%
2166001	06190	91010AE	606	Bonus qera tërmeti	133,739	130,115	97%
					0	140,803	97%
2166001	09230	91104AA	602	Bursa per nxënësi e arsimit parauniversitar 9 vjeçare dhe gjimnazi	1,905	1,905	100%
			6029999		0	1,905	100%
2166001	06190	M100399	231	Përmirësim I banesave ekzistuese per komunitetet e varfra	6,955	6,951	100%
			2319999		0	6,955	100%
2166001	,09240	91011AB	606	Bursa arsimit profesional	37,255	37,085	100%
			6029999		0	37,255	100%
2166001	06370	18BQ398	231	Ndërtim Rrjeti I ujësjetllësit dhe Ndërtim KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku	163,000	163,000	100%
2166001	06370	18BQ399	231	Mbikëqyrës	1,200	1,200	100%
2166001	06370	19AF816	231	Ndërtim Rrjeti ujësjetllësit ne zonën Fushe Kamëz	136,488	136,488	100%



KOD	PROG	PROJEKT	ART	Emërtimi	Plan vjetor	Shpenz thesari	Niveli i realizimit në %	
2166001	06370	19AF817	231	Mbikëqyrës	1,319	1,319	100%	
2166001	06370	19AF818	231	Ndërtim Rrjeti KUZ dhe furnizim me uji I zonës Valias I ri	152,146	152,146	100%	
2166001	06370	19AF819	231	Mbikëqyrës	1,222	1,222	100%	
			2319999	0	455,375	455,375	100%	
2166001	10910	91707AB	604	Mbështetje financiare per familjet banesat e te cilave jane dëmtuar nga fatkeqësi te ndryshme	16,884	16,884	100%	
					16,884	16,884	100%	
2166001	10430	91307AA	606	Ndihme ekonomike	65,569	64,333	98%	
2166001	10430	91307AB	606	Paaftësi e kufizuar (PAK)	459,203	456,092	99%	
			6029999	0	524,772	520,425	99%	
2166001	00424	18AJ905	231	Rehabilitim i digës së rezervuarit Paskuqan faza e parë	38,866	38,866	100%	
2166001	00424	19AF303	231	Rehabilitim i digës së rezervuarit Paskuqan faza e dytë	47,462	47,462	100%	
Totali					0	1,283,911	1,275,730	99%

*Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSII*

Niveli i përdorimit të fondeve me burim transfertës e pakushtëzuar është 99%, ku pjesa më e madhe e projekteve kanë realizim të plotë.

**- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhc kontigjencës, ku për vitin 2021 fondi rezervë është planifikuar në masën 10,000 mijë lekë dhe fondi i kontigjencës është planifikuar në 17,574 mijë lekë. Sipas të dhëna nga fondi i kontigjencës vlerë 17,574 mijë lekë është përdorur e gjithë vlera me Vendimin e KB nr. 98 dt 18.10.2021 "Per nje ndryshim ne VKB nr 160 dt 23.12.202 "Për Miratimin e Detajmit të Buxhetit për Vitet 2021-2023", duke mbetur e papërdorur shuma prej 0 mijë lekë. Fondi i Kontigjencës është përdorur në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të mbuluar shpenzimet të cilat nuk kanë patur mundësi të likujdohen si pasoje e mosrealizimit të të ardhurave në nivelet e planifikuara. Fondi rezerve nuk është përdorur pasi nuk ka qenë e nevojshme.

**- Analizë e transfertave të pakushtëzuara**

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfutur në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet të njëjste të qeverisjes vendore, të përcaktuara në Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë për çdo njësi (që kap diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga persona juridike. Totali i transfertës së pakushtëzuar të planifikuar për në vitin 2021 për Bashkinë Kamëz ishte 508,692 mijë lekë. Gjatë vitin 2021 janë kryer ndryshime në shumën e transferuar dhe vlera totale e transfertës së kushtëzuar alokuar për vitin është 538,760 mijë lekë, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9

Në 000 lekë

Emërtimi	TOTALI		
	Plan	Fakti	Realizimi në %
Paga e Sigurime Shoqërore E Shëndetësore	193,659	185,586	95.83%

Emërtimi	TOTALI		
	Plan	Fakti	Realizimi në %
Shpenzime Operative Shërbime Te Ndryshme	23,472	21,378	91.08%
Shpenzime Operative Arsimit 9 - Vjeçare	8,460	8,438	99.74%
Shpenzime Operative Arsimit Parauniversitar	3,800	3,530	92.89%
Investime Infrastruktura Rrugore	267,631	267,347	99.89%
Investime Shërbimet Publike	8,857	8,857	100.00%
Investime Infrastruktura Arsimore	18,558	18,431	99.32%
Investime Projektme	14,320	12,504	87.32%
<b>TOTALI</b>	<b>538,757</b>	<b>526,071</b>	<b>97.65%</b>

Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertës së pakushtëzuar në total është 97.65%, ku shpenzimet për paga janë realizuar në masën 95.83%, shpenzimet operative në total janë realizuar 94.57% , dhe investimet në total janë realizuar 96.63% .

#### - Analizë e transfertës sektoriale

Për vitin 2021 transferta sektoriale përbëhet nga fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, arsimit parashkollor, arsimit parauniversitar, shërbimi i ujitjes dhe kullimit, administrimi i pyjeve dhe mbrojtja civile, detajuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 10

Në 000 lekë

Emërtimi	TOTALI		
	Plan	Fakti	Realizimi në %
Transfertës specifike arsimit parashkollor	176,473	172,705	98%
Transfertës specifike arsimit parauniversitar	10,041	9,792	91%
Transfertës specifike ujitja dhe kullimi	6,825	2,544	37%
Transfertës specifike mbrojtja kundër zjarrit (PMNZSH)	52,579	46,206	88%
Administrimi i pyjeve	550	550	100%
Mbrojtja Civile	14,733	8,223	56%
<b>TOTALI</b>	<b>261,201</b>	<b>231,797</b>	<b>92%</b>

Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertës sektoriale në total është 92%, ku me realizim të ulët paraqitet shërbimi i ujitjes dhe kullimit me 37% dhe shërbimi i mbrojtjes civile me 56%. Fondet e përdorura janë mbartur për vitin 2022.

#### - Analizë e donacione për Bashkinë Kamëz.

Gjatë vitit 2021 Bashkia Kamëz ka dy projekte me financim nga donatorët konkretisht:

Marrëveshja me World Vison Albania për minigrante për 4 shkollat: “Ahmet Zogu”, “Ibrahim Basha”, “Halit Coka”, “Elez Isuf Ndreu” për blerje pajisjesh për shkollat sipas nevojave të tyre, për të cilat World Vision ka financuar 1,999 900 Lekë dhe Bashkia Kamëz ka financuar 857 100 Lekë

Marrëveshja me World Vision Albania për rikonstruksionin e shtëpisë së z.Gani Kuçi, për të cilat World Vision ka financuar 1,599,823 Lekë dhe Kamëz ka financuar 399,956 Lekë

#### - Analizë e fondeve të rindërtimit

Bashkia ka përfutur fonde për investime për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti. Të detajuara, planifikimi dhe realizimi i projekteve të financuara nga fondet e rindërtimit paraqiten në **Aneks 2.2.1 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.**

Në vitin 2021 janë planifikuar 1,371,675 mijë lekë fonde për investime për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti nga të cilat janë realizuar 1,017,935 mijë lekë ose 74% dhe janë trashëguar për vitin 2022 fonde në vlerën 353,740 mijë lekë ose 36%. Projekte me realizim të ulët paraqiten:

1. Projekti me kod 94902AD Rindërtim i objekteve arsimore me realizim 56%, për shkak se fondet për këtë projekt janë çelur në fund të vitit 2021 përkatësisht me VKM nr. 714, datë 24.11.2021 dhe VKM me nr. 771, datë 15.12.2021.
2. Projekti me kod 94902AE Rikonstruksion dhe ndërtim i infrastrukturës publike me realizim 2%. Pjesa e mbartur e fondeve përfaqëson pagesat për mbikëqyrësit e punimeve e cila nuk është kryer për arsye se nuk kanë përfunduar punimet.
3. Projekti me kod 94902AE Rikonstruksion dhe ndërtim i infrastrukturës publike me realizim 31%. Pjesa e mbartur e fondeve përfaqëson pagesat për mbikëqyrësit e punimeve e cila është kryer në vitin 2022.
4. Projekti me kod 94902AE Rikonstruksion dhe ndërtim i infrastrukturës publike me realizim 0%. Pjesa e mbartur e fondeve përfaqëson pagesat për mbikëqyrësit e punimeve e cila nuk është kryer për arsye se nuk kanë përfunduar punimet.
5. Projekti me kod 94902AE Rikonstruksion dhe ndërtim i infrastrukturës publike me realizim 55%. Pjesa e mbartur e fondeve përfaqëson pagesat për mbikëqyrësit e punimeve e cila nuk është kryer për arsye se nuk kanë përfunduar punimet.
6. Projekti me kod 94902AC Rindërtimi i banesave individuale me realizim 55%, për shkak të vonesave të qytetareve në vijimin e procedurave për paisje me leje ndërtimi.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqesore, vendimet e shpronësimeve.

#### a. Detyrimet e prapambetura 31.12.2021

Detyrimet e prapambetura deri me 31.12.2021 janë në vlerën 261,171,535 leke. Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të palikujduara i zënë investimet në vlerën 172,752,415 lekë ose 66 %. Më pas renditet Mallra dhe Shërbime në vlerën 88,419,120 lekë ose 34 %, vlerë e palikujduara e cili i përket Eco Cleaning Shpk, koncesionare për pastrimin e qytetit. Në tabelën më poshtë paraqiten të detajuara detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kamëz në 31.12.2021.

Tabela nr. 12

Nr.	Përshkrimi	Operatori ekonomik	NIPT	Vlera 31.12.2021
1	Ndërtim rruga Halim Xhelo+Isa Boletini+Leka I madh	Kupa shpk	K51615512C	1,890,829
3	Ndërtim Rruga " Kukësi. Republika e Re"	Ndërtimi shpk	K 11325003 C	15,572,316
3	Rruga " Abaz Ermenji " , rr. Ded Gjo Luli+degzim rr.Arben Broci mbi kanal, rruga Asim Zeneli	Ndërtimi shpk	K 11325003 C	19,999,029
5	Ndërtim Rrua " Zanave", "Kaltersia" (vazhdim +rruga "Bulqiza",+ segm rruga Arberit.	Kthella shpk	J69303023D	10,359,678
6	Ndërtim Rruga Sado Koshenko+ Rruga Sali Murati , Shtese Sali Murati , Rruga Kaci	Kupa shpk	K51615512C	257,280
7	Ndërtim Rruga "Sali Murat Vranishti"+rr."Hasan Zylfia"+rr.Kaci	Kupa shpk	K51615512C	4,694,058
12	Ndërtim Rruga " Oktavia " , Rruga "Meksika", Rruga "Paralel me Nazmi Kryeziun", Rruga "Vazhdim I Selaniku", Rruga "Ankara", Rruga "Selaniku"	Kthella shpk	J69303023D	7,887,675
13	Ndërtim Rruga " Gjirokastër, Rruga "Amsterdam", Rruga "Perjetsia", Rruga "Fierze", Rruga "Jena", Rruga "Kongresi I Manastirit"	BAMI shpk	J94416206R	14,835,042
17	Ndërtim Rruga " Ndoc Deda " dhe vazhdimi I saj seg Mustafa Xhani, rruga Mustafa Matohiti, Rruga Halit Haxhia zgjatim investimit ekzistues	BAMI shpk	J94416206R	7,892,856
18	Ndërtim Rruga "Sali Murat Vranishti" Fillimi , rruga Spiro Kote, rruga Pjeter Budi+Sali Myftia, rruga lidhese Prengaj deri tek rruga Kerciket, rruga Sulejman Vokshi, rruga vazhdim I Zef Serembe	Kthella shpk	J69303023D	11,697,456
22	Rikonstruksion shkolla "Vllazerimi" Fushe Kerçik Babru	Ndregjoni shpk	K31329048I	5,103,751
22	Nd. Rruget ( Iliria+Burimi+Mreteresha Suzane)	Ndregjoni shpk	K31329048I	13,978,219
22	Ndërtim rruga Myslim Shyri+Serafin Kodra"Babru Qebder	Ndregjoni shpk	K31329048I	3,479,748
23	Ndërtim shkolla 9-vjeçare Frutikulture	4 A-M shpk	K92005016L	21,865,037
	Ndërtim Ura Paskuqan I	4 A-M shpk	K92005016L	33,239,441
	<b>Shuma investime</b>			<b>172,752,415</b>
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontrates te koncesionarit per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarita koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390

Nr.	Përshkrimi	Operatori ekonomik	NIPT	Vlera 31.12.2021
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	Pagesa periodike sipas nenit 16 te kontratës te koncesionare per pastrimin e qytetit ( pagesa e autoritetit dhe tarifa koncesionare	ECO CLEANING SHPK	L81811019S	11,052,390
	<b>Shuma mallra dhe shërbime</b>			<b>88,419,120</b>
	<b>Totali llog 486</b>			<b>261,171,535</b>

*Burimi: Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Vjollca Smaçi, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendimet e Subjektit:**

*Në lidhje me detyrimet e prapambetura, sqarojme se detyrimet kanë ardhur në ulje nga një vit në tjetrin për shkak të masave që janë marrë për uljen e debisë (vërtetohet sipas pasqyrave financiare në vite). Në lidhje me debitoret e mbartur sqarojmë se drejtoritë që krijojnë të ardhura marrin edhe masat për uljen e vlerave debitore*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Komentet nga subjekti nuk e ndryshojnë gjendjen e evidentuar nga grupi auditues për periudhën e auditimit dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

- Situata financiare.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi situatën financiare që paraqet Bashkia Kamëz, rezulton se është në nivelin e 15.5 %. Në këtë situatë nuk janë paraqitur faturat e palikujduara me fonde të deleguara (specifike), pasqyra:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzi meve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua sfatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>261,171,535</b>		<b>15.50%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>88,419,120</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime	88,419,120		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
<b>b</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>172,752,415</b>		
b,1	Institucione buxhetore			

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzi meve totale të miratuara të NJVQV-së
b,2	Subjekte private	172,752,415		
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>0</b>		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime	0		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>261,171,535</b>	<b>1,684,722,676</b>	<b>15.50%</b>

**Titulli i gjetjes 3: Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara.**

**Situata:**

Bashkia Kamëz në fund të vitit 31.12.2021 raporton detyrime të prapambetura në vlerën 261,171,535 lekë, të cilat nuk janë likuiduar për shkak të mungesës së fondeve si rrjedhojë e mosrealizimit të të ardhurave në nivelet e planifikuara. Detyrimet e prapambetura janë një pengesë e konsiderueshme në mirëmenaxhimin e financave vendore, duke sjellë probleme në realizimin e shpenzimeve publike për ofrimin e shërbimeve dhe kryerjen e investimeve. Praktika e mos likuidimit në afatin e përcaktuar të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe mos shlyerja në kohë e tyre, krijon risk për pagesa penalitetesh duke rënduar në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore.

Situata financiare e Bashkisë Kamëz është normale në nivelin e 15.5% (1,684,353/261,171,535).

**Kriteri:**

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014. Ligji nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme.

**Shkaku:**

Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës & Kontabilitetit, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një analizë për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën 261,171,535 lekë, si dhe të hartojë një grafik për likuidimin e tyre sipas radhës së pagesave.

Të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

**b. Vendimet gjyqësore**

Më datë 31.12.2021, nuk ka detyrime për shpenzime gjyqësore. Për vitin 2021 janë në proces gjyqësor 14 çështje kryesisht me objekt *ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe kërkesë për dëmshpërblim*, për të cilat ende nuk është marrë një vendim i formës së prerë.

- Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Njësitë vendore përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore në fushat e infrastrukturës rrugore, arsimit, shëndetësisë etj.

Të detajuara, investimet e financuara nga buxheti i shtetit, të cilat nuk janë likuiduar deri më datën 31.12.2021 jepen në Aneksin 2.2.2 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

Deri ne 31.12.2021 vlera e palikujduara arrin ne total 71,286 mijë leke nga të cilat janë detyrim i FZHR – së.

Totali i investimeve të kryera nga FZHR gjatë vitit 2021 është në vlerën 832,752,073 mijë lekë. Në periudhën në auditim, në vitin 2020 FZHR ka likujduar vlerën 212,812 mijë lekë dhe në vitin 2021 FZHR ka likujduar vlerën 548,654 mijë lekë. Deri në 31.12.2020 vlera e palikujduara arrin në total 71,286 lekë nga të cilat 71,286 është detyrim i FZHR- së dhe 0 lekë detyrim i Bashkisë Kamëz.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Vjollca Smaçi, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendimet e Subjektit:**

*Në lidhje me faturat e palikuiduara brenda 30 diteve, sqarojmë se faturat janë likuiduar brenda 30 diteve. Faturat e palikuiduara brenda 30 diteve janë fatura të planifikuara sipas buxhetit për më shume se një vit buxhetor.*

**Oëndrimi i grupit të auditimit:**

Observacioni i subjektit nuk merret në konsideratë.

**2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin ligjor/ nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.**

*Pasqyra e realizimi te ardhurave ne vite, nga te ardhurat e veta, transferta pakushtëzuara dhe transferta te kushtëzuara.*

*Në 000/lekë*

EMERTIMI	VITI 2021	
	PLANI	FAKTI
<b>Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës 2020</b>	<b>69,924</b>	<b>69,924</b>
<i>Nga të cilat:</i>		
-Transferta e pakushtëzuar trashëguara	11,589	11,589
-Transferta Specifike të trashëguara	24,704	24,704
-Të ardhurat e veta	33,631	33,631
<b>EMERTIMI</b>	<b>PLANI</b>	<b>FAKTI</b>
<b>Të ardhurat e vitit ushtrimore 2021</b>	<b>4,531,960</b>	<b>4,184,109</b>
<i>Nga të cilat:</i>		
-Transferta e pakushtëzuar	527,169	527,169
-Transferta Specifike +te kushtëzuara+ rindërtimi+ invalid etj	2,864,303	2,864,303
-Të ardhurat e veta	1,140,488	792,637
<b>Transferta Specifike të Vitit ushtrimor</b>	<b>2,864,303</b>	<b>2,864,303</b>
<i>Nga të cilat:</i>		
- Nga FZHR	548,657	548,657
-Transferta Specifike (nga Min e Financës)	236,498	236,498
- Nga donator të ndryshëm	-	-
- Nga ministritë e linjë	1,343,894	1,343,894
- Invalid etj	735,254	735,254
<b>TOTALI</b>	<b>4,601,884</b>	<b>4,254,033</b>

*Pasqyra e shpërndarjes së të ardhurave sipas natyrës së shpenzimeve*

Emërtimi	Fakt 2021			
	Gjithsej	Tr.Pakushtëzuar dhe Specifike	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar rindërtimi
600-Paga	391,763	330,371	50,583	10,809
601-Sigurime Shoqërore	62,583	52,270	9,440	874
230-Projekte				
602-Shpenzime Operative	158,798	49,792	106,679	2,327
604-Transferta Institucioneve	26,884		10,000	16,884
231-Investime	2,120,170	321,327	513,181	1,285,663
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	1,007,761	8,223	22,429	977,108
Tjera				
<b>SHUMA.....</b>	<b>3,767,960</b>	<b>761,983</b>	<b>712,312</b>	<b>2,293,665</b>

Burimi: Drejtoria e Financës përpunuar nga grupi i KLSH

*Nd. Pastrim Gjellbërimit e Tregtisë*

600 Paga	46,149	3,509	42,640
601-Sigurime Shoqërore	7,367	587	6,780
602-Shpenzime Operative	19,907		19,907
231-Investime	2,075		2,075
	75,498	4,096	71,402

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se në totalin e shpenzimeve, Bashkia Kamëz me të ardhurat e veta mbulon 20.3 % të shpenzimeve të vitit 2021.

Për periudhën objekt auditimi, sipas strukturës organizative, për mbledhjen e të ardhurave për biznesin dhe familjarët të cilët nuk kanë kontratë me UK Sha e ka funksionuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me 2 Sektorë me 33 punonjës, nga të cilët 1 Drejtor, 2 Përgjegjësi sektorësh dhe 30 Specialistë.

Për periudhën objekt auditimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për nivelin e taksave dhe tarifave vendore është mbështetur në paketën fiskale të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave e tarifave në Bashkinë Kamëz për vitin 2020” i cili ky vendim për disa nivele taksash e tarifash vendore gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka pësuar ndryshime me VKB nr. 28, datë 20.03.2020, nr. 41, datë 21.04.2020, nr. 47, datë 02.06.2020, nr. 71 datë 25.06.2020, nr. 76 datë 06.07.2020, nr. 99, datë 31.08.2020, nr. 101 datë 31.08.2020, nr. 106 datë 31.08.2020, nr. 138 datë 18.11.2020, nr. 167 datë 23.12.2020 dhe nr. 86 datë 19.08.2021.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji Biznesit	Viti 2021			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	2438	354	307	2485
B. Madh	483	57	20	520
Transporti	220	35	27	228
<b>Gjithsej</b>	<b>3141</b>	<b>446</b>	<b>354</b>	<b>3233</b>

Për vitin 2021, kanë ushtruar aktivitetet 3233 subjekte (2485 subjekte të biznesit të vogël, 520 subjekte të biznesit të madh dhe 228 subjekte transporti)

Për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 1,140,488 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 788,075 mijë lekë ose 69 %, **me një mosrealizim në vlerën 352,413 mijë lekë**, sipas të dhënave në pasqyrën si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
<b>I</b>	<b>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore</b>	<b>444,705,211</b>	<b>265,536,488</b>	<b>59.7</b>
	<b>Të ardhura nga Biznesi</b>	<b>247,705,211</b>	<b>171,011,655</b>	<b>69</b>
1	Taksë mbi ndërtesën	65,000,000	45,641,452	70
2	Tarifë pastrimi i mbetjeve	70,000,000	69,434,006	99
3	Taksë table	349,560	322,865	92
4	Taksë reklame	4,539,665	3,546,045	78
5	Taksë trualli për qëllim biznesi	7,382,844	5,961,948	81
6	Tarifë shërbimi	765,400	833,233	109
7	Taksë hoteli	178,000	206,598	116
8	Debitorë të vitit	50,000,000	4,029,912	8
9	Taksë e gjelbër	13,645,000	14,325,581	105
10	Taksë mbi tokën	8,240,000	3,829,917	46
11	Taksë e tregjeve dhe zënie të hapësirave publike	374,500	42,700	11
12	Taksë e përkohshme e rrjetit kabllor ajror	1,026,300	290,800	28
13	Taksë e therjeve të bagtis imët e të trashë	3,000,000	1,036,450	35
14	Tarifë ndriçimi	10,021,242	8,532,085	85
15	Taksë e kalimit të pronësisë	3,182,700	239,069	8
16	Taksë vendore e biznesit të vogël (tatim fitimi)	0	5,812,702	0
17	Tarifë vendore për infrastrukturën arsimore	10,000,000	6,910,114	69
18	Të ardhura nga gjobat	0	14,278	0
19	Të tjera tarifa e taksave vendore	0	1,900	0
<b>II</b>	<b>Taksa e tarifa lokale (Familjarët)</b>	<b>197,000,000</b>	<b>94,524,833</b>	<b>48</b>
1	Taksë ndërtese	50,000,000	25,588,406	51
2	Tarifë pastrimi	70,000,000	37,205,107	53
3	Taksë trualli për qëllim banimi	1,000,000	0	0
4	Tarifë gjelbërimiti	14,400,000	5,210,689	36
5	Tarifë ndriçimi	3,600,000	1,314,381	37
6	Tarifë mirëmbajtje varreza	17,552	11,970	68%
7	Taksë vendore për infrastrukturën arsimore	18,000,000	6,098,650	34
8	Taksë dhe tarifa lokale familjarë (Debitorë)	40,000,000	19,107,600	48
<b>III</b>	<b>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit</b>	<b>552,562,913</b>	<b>418,049,352</b>	<b>76</b>
1	Leje ndërtimi leje zhvillimi	510,000,000	391,963,979	77
2	Leje përdorimi	3,900,000	1,079,335	27
3	Ngritje kantier e murë rrethues	792,000	633,184	80
4	Piketim i strukturës	1,200,000	655,063	55
5	Përfundim i themeleve	1,200,000	553,834	46
6	Përfundim në fazën e karabinasë	1,386,000	304,407	23
7	Përfundim i fasadave dhe rifiniturës	1,782,000	1,009,548	57
8	Përfundim i sistemit të jashtëm	2,178,000	148,419	7
9	Tarifë për zhvillim	2,700,000	5,180,761	192
10	Tarifë për leje	3,360,000	1,424,969	42
11	Deklaratë paraprake	1,200,000	0	0
12	Tarifë shërbimi	5,600,000	0	0
13	Taksë e ndikimit në infrastrukturë legalizimet	15,400,000	14,837,028	96
14	Debitorë TNI legalizimet	1,864,913	0	0
15	Tarifë shërbimi të (për VKM 408)	0	258,825	0
<b>IV</b>	<b>Drejtoria e MTPM, Bordi të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave</b>	<b>3,500,000</b>	<b>1,162,829</b>	<b>33</b>
1	Shitje toke	3,500,000	1,162,829	33
<b>V</b>	<b>Drejtoria e Transportit &amp; Licensave</b>	<b>58,401,100</b>	<b>54,215,010</b>	<b>93</b>
1	Taksë e regjistrimit të automjeteve	40,000,000	39,952,759	100
2	Leje transport Takxi	1,460,500	1,997,000	137
3	Leje transport udhëtarësh	2,960,500	3,152,770	106
4	Leje transport mallrash	3,550,000	1,698,219	48
5	Leje aktiviteti	2,320,100	1,551,033	67
6	Autorizim për tregti karburanti me pakicë	6,010,000	5,423,776	90
7	Të tjera tarifa administrative	200,000	125,153	62



Nr	EMERTIMI	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
<b>VI</b>	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	<b>13,696,527</b>	<b>7,080,000</b>	<b>52</b>
1	Shërbime funerale	5,600,000	4,403,000	77
2	Tarifë nga MKZ	8,096,527	2,677,000	33
<b>VII</b>	<b>Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve</b>	<b>33,122,000</b>	<b>78,124</b>	<b>0.2</b>
1	K.U.N familje 2021	10,872,000	0	0
2	K.U.N biznese 2021	22,250,000	78,124	0
3	K.U.N familje debi 2021	0	0	0
4	K.U.N biznese debi 2021	0	0	0
<b>VII</b>	<b>Të tjera</b>	<b>34,500,000</b>	<b>41,953,634</b>	<b>122</b>
1	Taksa të deleguara TAP	23,000,000	27,404,948	119
2	Gjoha INV	3,000,000	2,588,800	86
3	Gjoha Policia Bashkiake	500,000	10,000	2
4	Të ndryshme +biletë shërbimi	6,000,000	3,405,433	57
5	Të ardhura për kopshte dhe çerdhe	2,000,000	1,270,299	0
6	Taksa e akteve dhe pullës	0	70,200	0
7	Debitorë bashkia (KLSH)	0	47,436	0
8	Sponsorizime	0	4,492,542	0
9	Të ardhura nga qera për troje	0	569,600	0
10	Të ardhura nga qera për ndërtesa	0	1,656,295	0
11	Të tjera taksa për shitjen e pasurive të luajtshme	0	437,823	0
12	Grande për Pjesëmarrje	0	258	0
	<b>TOTALI</b>	<b>1,140,487,751</b>	<b>788,075,437</b>	<b>69</b>

Për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej që arkëtohen nga **Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore**, nga 436,465 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 261,706 mijë lekë ose 60 %, **me një mosrealizim në vlerën 174,759 mijë lekë.**

Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë Debitorët e vitit për biznesin, Taksa e kalimit të pronësisë, Taksa ndërtese, Taksë trualli, Tarifa pastrimi gjelbërimi e ndriçimi të planifikuar gjithsej në vlerën **241,943 mijë lekë ose 21 %** e planit vjetor, që janë realizuar 94,964 mijë lekë ose 39%, **me një mosrealizim në vlerën 146,979 mijë lekë, ose 13 % e mosrealizimit të planit të përgjithshëm vjetor.**

**Titulli i gjetjes 1:** *Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

#### **Situata:**

Për vitin 2021, referuar VKB nr. 167, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr 55, datë 20.12.2019” për pikën 5, “Ndërtesa në proces legalizimi” struktura për vjeljen e kësaj takse është DTTV Kamëz. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ALUIZNI-t Tiranë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Tiranë. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2014 deri më 31.12.2021, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultojnë nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **8 467 persona** me vlerë **270,787,856 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kamëz**, rezultojnë se nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3 dhe VKB nr. 167, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr 55, datë 20.12.2019” pika 5, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.			
Numri i objekteve dhe vlera 2014-31.12.2021		Debitorë me 31.12.2021	
Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
13 514	456,900,825	8 467	270,787,856

**Kriteri:**

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3 dhe VKB nr. 167, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr 55, datë 20.12.2019” pika 5.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, në vlerën 270,787,856 lekë.

**Shkaku:**

Mos ndjekje e procedurave ligjore për arkëtimin e kësaj takes.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **270,787,856 lekë**.

Kryetari i Bashkisë Kamëz të bashkëpunojë me Drejtorinë e ASHK Tiranë ose Ujësjiellës Kanalizime sh.a Kamëz, për lidhjen e një aktmarrëveshje si Agjent Tatimorë në arkëtimin e detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e rajë për uljen e borxhit në vlerën **270,787,856 lekë**.

Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tiranë, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Titulli i gjetjes 2: Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2021.**

**Situata:**

Për vitin 2021, referuar VKB nr. 167, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr 55, Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore në mënyrë progresive **në vlerën gjithsej 323,708,712 lekë**, nga të cilët **444 subjekte** të biznesit të vogël, biznesit të madh dhe aktivitet Transporti **në vlerën 121,835,012 lekë dhe 18 660 familje** për taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, **në vlerën 201,873,700 lekë** pasqyra si më poshtë:

*Pasqyra 1*

EMËRTIMI	31.12.2020	31.12.2021	
	Vlera	Vlera	Nr. Subjekte e familje
<b>Debitorë ne total</b>	<b>380,464,702</b>	<b>323,708,712</b>	<b>19,104</b>
<b>Biznesi</b>	<b>116,126,682</b>	<b>121,835,012</b>	<b>444</b>
Biznesi i vogël	18,868,181	18,593,509	294
Biznesi i madh	94,497,040	100,228,979	74
Transporti	2,760,460	3,012,523	76
<b>Familjarë</b>	<b>264,338,020</b>	<b>201,873,700</b>	<b>18 660</b>
Familje për taksa tarifa	33,480,718	147,936,556	15 172
Familje nga UK Kamëz	230,857,302	53,937,145	3 488

Ndërsa sipas statusit të subjekteve gjendja e borxhit paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Statusi i subjekteve debitorë	2021	
	Vlera	Nr. Subjekte
<b>Totali</b>	<b>121,835,012</b>	<b>444</b>
Aktiv	117,081,121	404
Mbyllur	4,753,890	40

Sipas të dhënave edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 444 subjekte debitorë në vlerën 121,835 mijë lekë, janë aktiv 404 subjekte ose 91 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 117,081 lekë ose 79 % e vlerës së debitorëve, në kundërshtim me përcaktimet e kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Nga totali prej 19 104 debitorë me vlerë 323,708,712 lekë (*debitorë të biznesit për 444 subjekte në vlerën 121,835,012 lekë dhe debitorë familjarë 18 660 familje në vlerën 201,873,700 lekë*), nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vijuar me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, janë dërguar për bllokim të llogarive bankare me shkresën nr. 8965, datë 21.09.2021 për 1078 subjekte, barrë siguruese për automjetet me shkresën nr. 9372, datë 06.10.2021 për 1004 subjekte, barrë hipotekore për pronat me shkresën nr. 9371, datë 06.10.2021 për 1004 subjekte nga të cilët kanë arkëtuar detyrime për vitin 2021 në vlerën 33,891,820 lekë.

**Kriteri:**

Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:**

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disjplinojnë taksat dhe tarifavat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore bashkia Kamëz, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në fund të periudhës në vlerën **323,708,712 lekë**.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. Eni BISTRË, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Taksave e Tarifave Vendore, për periudhën e auditimit.*

Për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifavat vendore gjithsej që arkëtohen nga **Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit**, nga 535,298 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 403,212 mijë lekë ose 76 %, **me një mosrealizim në vlerën 132,086 mijë lekë, ose 11.5% e mosrealizimit të planit vjetor.**

**Titulli i gjetjes 3: Mungesë bashkëpunimi midis drejtorive.**

**Situata:**

Nga auditimi rezulton se të gjitha taksat dhe tarifatat të planifikuara nuk janë realizuar në vlerën e plotë përveç tarifës për zhvillim që rezulton me tejkalim, kjo si rezultat i mungesës së informacionit për planifikimin e saj.

Referuar VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar për subjektet e ndërtimit shkronja C. 3, C.3/1, C.3/2 dhe C./33 Ngritje kantieri, Tarifë pastrimi, gjelbërimi dhe ndriçimi ka vendosur që për çdo leje ndërtimi të dhënë nga DPKZHT Bashkia Kamëz i dërgon informacion të plotë DTTV në formë shkresore, me qëllim që kjo e fundit të nxjerrë faturën për arkëtim për arkëtimin e kësaj tarife.

Nga dokumentacioni i vënë dizozicion rezulton se për vitin 2021, DPKZHT Bashkia Kamëz ka dhënë 157 leje ndërtimi (151 leje për punime në objekte private dhe 6 leje për punime në objekte publike). Sa më sipër nga DPKZHT Bashkia Kamëz me shkresë nr. 7164, datë 16.07.2021 dhe nr. 7351, datë 26.07.2021 ka dërguar informacion mbi lejet e ndërtimit për 65 leje (nga të cilat 17 leje që i përkasin vitit 2020 dhe 48 leje për vitin 2021) ndërsa për 92 leje nuk ka dërguar informacion DRTTV, që kjo e fundit të nxjerrë njoftim detyrimin dhe faturën për arkëtim për detyrimet për tarifë pastrimi, në kundërshtim me VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar, për subjektet e ndërtimit shkronja C. Nga auditimi në lidhje me njoftimin dhe faturën për arkëtim për detyrimet për tarifa pastrimi rezulton se nga DTTV Bashkia Kamëz ka nxjerrë faturën për arkëtim për 151 subjekte që janë pajisur me leje ndërtimi (për 137 leje në vitin 2021 dhe 14 leje për vitin 2022).

**Kriteri:**

VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar dhe rregulloren e funksionimit të Bashkisë Kamëz.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga Drejtorja e PZHT Bashkia Kamëz, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendim i subjektit:**

*Drejtori e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit i është drejtuar në mënyrë periodike në mënyrë elektronike (mail) drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për lejet e miratuara në periudhën janar 2021- dhjetor 2021. Janë dërguar në mënyrë elektronike për të qënë me të dhëna me të plota për çdo leje ndërtimi të miratuar, ku deri më datë 26.08.2021 ku janë paraqitura 56 leje të miratuara, deri më datë 20.10.2021 ku janë paraqitura 137 leje të miratuara, deri më datë 07.03.2022 ku janë paraqitura 168 leje të miratuara. Bashkangjitur do jen të printuara listat e lejeve të dërguara në formë elektronike (excel) për vitin 2021, dërguar Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Kjo metodologji është përdorur edhe për vitin 2019 dhe 2020 “në mënyrë elektronike ilustruar me lart nga foto e marra në tabelen send, ku duket dërguesi dhe marësi”. Sipas këtij formati Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore ka aksesuar me emrat e subjekteve ndërtues, sipërfaqet, vlerën e përvetësit, adresën, taksën e ndikimit në infrastrukture etj.*

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Për sa është observuar nga Drejtori e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit Bashkia Kamëz grupi i auditimit e merr në konsideratë dhe do reflektohet në Raportin Përfundimtarë të Auditimit.

Për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej që arkëtohen nga **Drejtorja e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave**, nga 3,500 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 1,163 mijë lekë ose 33 %, **me një mosrealizim në vlerën 2,337 mijë lekë, ose 0.2% e mosrealizimit të planit vjetor.**

#### **Titulli i gjetjes 4: Mungesë bashkëpunimi midis drejtorive për saktësimi i tokës arë.**

##### **Situata:**

Nga auditimi rezulton se në planin e të ardhurave, Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka përfshirë debitorët e taksë së tokës që për vitin 2020 rezultojnë në vlerën 32,386,698 lekë. Referuar nenit 23, 1 ligjit nr. 9632 “Për sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar në pronësi ose përdorim të taksapaguesit, e cila vërtetohet sipas dokumentacionit AMTP ose nga të dhëna të marra nga formulari nr.6, që disponon Bashkia ose duke ngritur grupe pune për verifikim të sipërfaqeve në vend të tokave që disponojnë qytetarët. Për vitin 2021 sipas VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar, është përcaktuar në vlerën 4,500 lekë/ha/vit, kjo si tokë e kategorisë së tretë. Nga të dhënat Bashkia Kamëz disponon 2399 ha tokë bujqësore, sipas formularit nr.6 rezulton e ndarë për 2599 familje për sipërfaqen 2129 ha.

Planifikimi i taksës së tokës nga viti në vit është bërë pa patur një databazë të saktë për ndryshimet që kanë ndodhur në pakësim të kësaj sipërfaqe nga ndërtimet e reja dhe ato informale si dhe transaksionet që janë kryer ndër vite për shitblerjen e saj duke ndryshuar pronarë për pasojë numri i familjeve debitorë nga viti në vit vjen në rritje (*ndarë tokë për 2599 familje dhe me datë 31.12.2021 rezultojnë debitorë 6703 familje në vlerën 36,566,509 lekë*) po ashtu dhe vlera e debisë (*me datë 31.12.2020 vlera debisë në shumën 32,386,898 lekë dhe në fund të vitit 2021 në shumën 36,566,509 lekë*) me rritje për vlerën 4,179,611 lekë. Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka bashkëpunuar për informacion me DPKZHT Bashkia Kamëz, për sipërfaqet që kanë kaluar për ndërtim objektësh dhe nuk ka informacion nga ASHK për ato sipërfaqe toke që kanë transaksione për shitje tokash apo për regjistrim të lejeve të ndërtimit. Nga të dhënat e Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave sipas listave që administron kjo drejtori rezultojnë se janë debitorë më datë 31.12.2021 për Taksë Toke, **6703 familje në vlerën 36,566,509 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9632 “Për sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 23 dhe VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar.

##### **Kriteri:**

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 23 dhe VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar.

##### **Ndikimi/Efektiviteti:**

Mungesë të ardhurash për buxhetin Bashkisë Kamëz, në vlerën 36,566,509 lekë.

##### **Shkaku:**

Mungesë e zbatimit me rigorozitet të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar neni 23 dhe VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar.

##### **Rëndësia: E lartë**

##### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave në Bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marr masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës në vlerën **36,566,509 lekë**.

Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrëjë grup pune me specialist të fushës për saktësimin e sipërfaqes së tokës arë, pasi nuk janë reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur si rezultat i zënies së saj nga ndërtimet pa leje e me leje ndërtimi si dhe transaksionet e ndryshme që janë kryer nëpërmjet ASHK, duke ndryshuar pronarë.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. Faik Sula, me detyrë Drejtor MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, për periudhën objekt auditimi.*

### **2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021.**

3.1. *Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.*

3.2. *Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.*

3.3. *Opinionin mbi pasqyrat financiare.*

- *Mbajtja e kontabilitetit dhe përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:*

Është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27/12/2011, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 24.11.2014 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; me udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme“, ku në pikën 28, të tij përcakton se: “Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2021”.

- *Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.*

Bashkia Kamëz për vitin 2021, ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi ka në varësi njësinë shpenzuese, Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit e Treg.

Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021, janë hartuar në përputhje me formatet e miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ato janë firmosur nga z. Rakip Suli me detyrë kryetar, në cilësinë e Nëpunës Autorizues dhe nga znj. Vjollca Smaçi me detyrë drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, si dhe janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën përcjellëse nr. 2548 prot, datë 30.03.2022, brenda afatit ligjor.

- *Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.*

Për vitin 2021, nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës, për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2, me aktrakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat, për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Në fund të periudhës ushtrimore 2021, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale janë të plotësuar.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në librin e madh/centrilizatori dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e llogarive të ndryshme, të bankës, të arkës, e të magazinës, ditari i hyrjeve dhe i daljeve, ditari i të ardhurave, ditari i regjistrimit të aktive.

Bashkia Kamëz është përfshirë në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), për raportimin financiar, në vitin 2022. Mbajtja e evidencës kontabël e kësaj bashkie për vitin 2021, periudhë nën auditim, është bërë me programin Excel.

**Auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar nëse (Formati nr. 1)** pasqyra individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyrojnë në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet,

detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes vendore në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues.

**- Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara:**

**a.** Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

*Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

**b.** Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve.

Në pasqyrën financiare ushtrimore të vitit 2021:

**Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët – Pasivët = 12,881,443,348 lekë.**

- Aktivët	14,451,318,854 lekë
- Pasivët	1,569,875,506 lekë
- Aktivët neto	12,881,443,348 lekë

Aktivët afatshkurta më datë 31.12.2021, në pasqyrën financiare paraqiten në vlerën **1,999,764,472 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 461,947,066 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 29,542,532 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 866,303,339 lekë dhe
- “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 641,971,535 lekë.

**I. Auditimi i Aktiveve Afatshkurtra.**

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”** në mbyllje të vitit 2020, është në vlerën 78,230,210 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 461,947,066 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

**Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** në aktiv të bilancit për 2021, paraqitet në vlerën 461,947,066 lekë dhe kuadron me pasqyrën e flukseve monetare në rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor”. Në analizë kjo llogari është paraqitur në tabelën e mëposhtme, si dhe në mënyrë të detajuar, në shpërndarje kapitujsh, paraqitet sipas aneksit nr. 1, pika 3, bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Kapitulli 1	42,105,366
Kapitulli 5	1,633,086
Kapitulli 1 (rindërtimi)	311,007,585
Të ardhurat	536,399
Kapitulli 6	45,063,998
Llogaria 466 (ngurtësimi 5%)	61,600,632
<b>Totali</b>	<b>461,947,066</b>

Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” është e rakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit Tiranë, në përputhje me kërkesat e kapitullit III, pikat 29, 30, 50 të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Per procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022.

**- Inventarizimi i aktiveve.**

Në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 08/07/2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe të udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, për periudhën raportuese ushtrimore 2021, titullari i institucionit ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 370, datë 12.07.2021 “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e aktiveve si dhe vlerësimin e aktiveve për dalje nga përdorimi”, për 4 institucione arsimore, për arsye rikonstruksioni. Grupi i punës ka përbërjen e 5 anëtarëve: Vjollca Smaçi kryetare, Luan Marku, Fatbardha Pasha, Dava Buraku dhe Hane Nika anëtarë. Grupi i punës ka kryer inventarizimin e gjendjes fizike të aktiveve dhe kanë mbajtur procesverbalin e vlerësimit. Me urdhrin e brendshëm nr. 371, datë 12.07.2021 titullari i institucionit, ka urdhëruar “Mbi ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve” me përbërjen e 5 anëtarëve të tjerë, Ardian Peka kryetar, Mirjana Abazaj, Luan Dedja, Arjana Cani dhe Shkëlzen Korbi anëtarë. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin e nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve për institucionet arsimore, ku janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

**Institucione arsimore**

Nr.	Objekti Institucionet arsimore	Kodi / Llogaria ekonomike			Vlera Lekë
		214	218	327	
1	Gjimnazi “I. Rugova”	992,686	8,938,282	-	9,930,968
2	Kopshti “A. Zogu”	-	900,480	-	900,480
3	Gjimnazi “A. Zogu”	2,353,518	7,996,520	-	10,350,038
4	Gjimnazi “I.Boletini”	1,107,460	3,902,426	275,520	5,285,406
	<b>Shuma</b>	<b>4,453,664</b>	<b>21,737,708</b>	<b>275,520</b>	<b>26,466,892</b>

Nga auditimi u konstatua se, në procesverbalin e mbajtur me zërat e materialeve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi, ishin pasqyruar të dhënat: koha e hyrjes së tyre, mënyra e ardhjes në institucion (blerje) dhe vlerën e tyre, vlerën e mbetur, si dhe normën e amortizimit, në përputhje me përcaktimet e pikës 95 dhe 104, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, të udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

Në përfundim të procedurës është mbajtur relacioni i vlerësimit sipas përcaktimeve të pikës 106, të udhëzimit të udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, të ndryshuar.

Me VKB nr. 83, datë 04.08.2021, “Për miratimin e efekteve financiare të nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve me vlerë 26,191,372 lekë, si dhe materialeve me vlerë 275,520 lekë, pas konfirmimit ligjor nga prefekti i qarkut Tiranë, është miratuar dalja nga përdorimi.

Pas miratimit për dalje nga përdorimi janë bërë dalje, aktivet sipas fletë daljes nr. 125, datë 31.12.2021, me vlerë 26,466,892 lekë.

Titullari i institucionit me urdhrin e brendshëm nr. 600, datë 15.11.2021, ka urdhëruar “Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e aktiveve si dhe vlerësimin e aktiveve për dalje nga përdorimi”, për aktivet e bashkisë dhe të shkollave, me përbërjen e 5 punonjësve, 1 kryetar + 4 anëtarë.

Nga auditimi u konstatua se, çdo fletë inventari është e firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit. Para fillimit të inventarit në magazinë, ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes me nr. 116 dhe fletë daljes me nr. 96, datë 26.11.2021, nëpërmjet procesverbalit të mbajtur midis përgjegjëses së materialeve dhe komisionit të inventarizimit. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur procesverbal me nr. 12058/1 prot., datë 31.12.2021, ku shprehen se midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël nuk rezultuan diferenca. Nga vlerësimi i



aktiveve ka rezultuar se ka patur aktive për dalje nga përdorimi, për të cilat është hartuar dokumentacioni.

Me urdhrin e brendshëm nr. 601, datë 15.11.2021 ka urdhëruar “Mbi ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve” me përbërjen e 5 punonjësve, 1 kryetar + 4 anëtarë. Janë bërë dalje jashtë përdorimi materialet dhe pajisjet e zyrave të aparatit të Bashkisë Kamëz, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Bashkia Kamëz Aparati	Kodi / Llogaria ekonomike			Vlera lekë
		214	218	327	
1	Sekretaria	-	55,680	-	55,680
2	Zv/kryetari 1	-	236,160	-	236,160
3	Zv/kryetari 2	-	18,400	-	18,400
4	Sekretari këshillit	-	63,336	-	63,336
5	Këshilltarët e kryetarit	-	180,000	-	180,000
6	Auditi	-	211,280	-	211,280
7	Financa	-	446,280	-	446,280
8	Proc. Publike	-	103,116	-	103,116
9	B. Njerëzore	-	186,132	5,000	191,132
10	IT	-	975,360	-	975,360
11	Sp. urbanistika	-	214,344	-	214,344
12	Sp. urbanistika 2	-	176,400	1,700	178,100
13	Kadastra pergj.	-	63,756	-	63,756
14	Kadastra	-	92,712	-	92,712
15	Arka	-	38,175	-	38,175
16	Sp. Licenca	-	217,778	-	217,778
17	Dr. Ndihmë Ekonomike	-	133,667	-	133,667
18	Gj. Civile	-	106,246	-	106,246
19	One Stop Shop	-	222,000	-	222,000
20	Bashkia ndërtesë	-	40,000	-	40,000
21	Tatimet	-	129,111	13,000	142,111
22	L. Bathore	-	20,100	-	20,100
23	P. kulturës	-	1,450,703	-	1,450,703
24	Media	-	300,880	-	300,880
25	Sh. publike	-	150,102	-	150,102
	<b>Totali</b>	-	<b>5,831,718</b>	<b>19,700</b>	<b>5,851,418</b>

Për institucionet arsimore janë bërë dalje jashtë përdorimi materialet dhe pajisjet sipas tabelës së mëposhtme:

#### Institucione arsimore

Nr	Procesverbali Datë	Objekti Institucione arsimore	Kodi / Llogaria ekonomike			Vlera lekë
			214	218	327	
1	25.11.2021	Shk.9 vjeç."I Basha"	-	454,790	-	454,790
2	24.12.2021	Shk.9 vjeç."100 Vjetori"	-	455,072	135,720	590,792
3	24.11.2021	Shk.9 vjeç."Kamza e re"	-	299,970	183,120	483,090
4	24.11.2021	Kopshti "Kamza e re"	-	1,397,422	-	1,397,422
5	25.11.2021	Shk."Demokracia"	-	103,800	-	103,800
6	25.11.2021	Kopshti "N. Tereza"	-	50,940	-	50,940
7	25.11.2021	Shk.9 vjeç."D. N. Kacorri"	-	-	8,640	8,640
8	23.11.2021	Gjimnazi "I. Rugova"	-	1,025,671	43,200	1,068,871
9	23.11.2021	Gjimnazi Bathore	-	1,389,177	38,880	1,428,057
10	23.11.2021	Shk."S. Elezi"	-	636,372	-	636,372
11	23.12.2021	Shk. H. Klinton	-	-	135,720	135,720
12	25.11.2021	Kopeshti Bulcesh	-	154,140	-	154,140
13	12.11.2021	Shk.Z"A. Hajdari"	-	873,610	20,000	893,610
14	25.11.2021	Kopshti Z. Mner	-	120,960	-	120,960
15	26.11.2021	Shk.9 vjeçare"H. Coka"	-	3,074,106	135,720	3,209,826

Nr	Procesverbali Datë	Objekti Institucione arsimore	Kodi / Llogaria ekonomike			Vlera lekë
			214	218	327	
16	17.11.2021	Kopshti "H. Coka"	-	506,100	-	506,100
17	01.12.2021	Kopshti bathore 5	-	1,806,240	-	1,806,240
18	01.12.2021	Shk.9 vjec. "Arberia"	-	179,488	0	179,488
	<b>Totali</b>		-	<b>12,527,858</b>	<b>701,000</b>	<b>13,228,858</b>

Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

Daljet nga përdorimi të materialeve dhe pajisjeve në Njësinë Administrative Paskuqan dhe institucionet arsimore pranë kësaj njësie sipas tabelës së mëposhtme:

#### Njësia Administrative Paskuqan

Nr	Procesverbali Datë	Objekti Institucionet Arsimore	Kodi / Llogaria ekonomike			Vlera lekë
			214	218	327	
1	20.11.2021	Nj.A. Paskuqan	-	190,674	-	190,674
2	14.11.2021	Shk."A. Hajdari"babrru	-	255,660	-	255,660
3	14.11.2021	Kopshti Babrru Qendër	-	269,760	31,180	300,940
4	14.11.2021	Shk.9. vjeçare "T. Sinani"K. Kuqe	-	1,362,440	63,200	1,425,640
5	20.11.2021	Shk.9. vjeçare"D.N. Kacorri" Babrru	-	346,560	-	346,560
6	20.11.2021	Shk.9. vjeçare "Z. Hasanaj" Babrru	-	95,400	31,220	126,620
7	14.11.2021	Shk.mesme "G. Palushi"	-	862,269	-	862,269
8	20.11.2021	Shk.9. vjeçare "J. Hoxha" Paskuqan 2	-	-	437,802	437,802
9	20.11.2021	Shk.mesme "I. Boletini" Paskuqan	-	3,543,662	-	3,543,662
10	20.11.2021	Shk.9. vjeç "L. Prizrenit" Paskuqan 2	-	-	67,250	67,250
11	20.11.2021	Kopshti(shk)"L. Prizrenit" Pask.2	-	83,020	16,800	99,820
	<b>Totali</b>		-	<b>7,009,445</b>	<b>647,452</b>	<b>7,656,897</b>

Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

Në përfundim të procedurës është mbajtur relacioni i vlerësimit sipas përcaktimeve të pikës 106, udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik", i ndryshuar.

Me VKB nr. 135, datë 31.12.2021, "Për miratimin e efekteve financiare të nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve me vlerë 25,369,021 lekë, si dhe materialeve me vlerë 1,368,152 lekë, pas konfirmimit ligjor nga prefekti i qarkut Tiranë, është miratuar dalja nga përdorimi.

Pas miratimit për dalje nga përdorimi janë bërë dalje, aktivet sipas fletë daljes nr. 126 datë 31.12.2021, me vlerë 26,737,173 lekë.

Aktivitet që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimit, janë hequr nga regjistri i aktiveve në përdorim dhe janë asgjësuar nga komisioni duke i djegur e groposur.

Procedura e inventarizimit, vlerësimit dhe e nxjerrjes jashtë përdorimi të pajisjeve dhe materialeve në Bashkinë Kamëz, është bërë në zbatim të përcaktimeve të udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik", i ndryshuar.

**Klasa 3 "Gjendje inventari qarkullues"** aktivet qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 25,990,241 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 29,542,532 lekë. Diferenca e tyre në rritje në vlerën 3,552,291 lekë, rakordon me gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" në formatin nr. 2 "Pasqyra e performancës financiare", e cila përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit të materialeve dhe objekteve të inventarit të imët. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

Klasa 3	Gjendje Inventari Qarkullues	29,542,532	25,990,241
31	Materiale	196,215	493,184
32	Inventar i imët	29,346,317	25,497,057

**Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 493,184 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021, në vlerën 196,215 lekë. Këto vlera janë pasqyruar në bilanc dhe ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël. Lëvizjet e llogarisë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë 31	Vlera në lekë
Gjendje 31.12.2020	493,184
Hyrje në magazinë gjatë vitit 2021	17,361,535
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	17,658,503
<b>Gjendja më 31.12.2021</b>	<b>196,215</b>

**Gjendja e llogarisë 327 “Inventar i imët”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 25,497,057 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021, në vlerën 29,346,317 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 3,849,260 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2021. Këto vlera janë pasqyruar në bilanc dhe ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

Lëvizjet e llogarisë 327	Vlera në lekë
Gjendje 31.12.2020	25,497,057
Hyrje në magazinë gjatë vitit 2021	5,492,932
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	1,643,672
<b>Gjendja më 31.12.2021</b>	<b>29,346,317</b>

**Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”** pasqyrohet në bilanc në mbyllje të vitit 2020, për vlerën 796,437,039 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021, në vlerën 866,303,339 lekë, detyrime të cilat:

**Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, e cila paraqitet në mbyllje të vitit 2020, me vlerën 747,025,095 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021, paraqitet në vlerën 716,700,299 lekë, me një zbritje në vlerën 30,324,796 lekë.

**Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2021**

Nr.	Debitorë llogaria 468 Bashkia Kamëz	Gjendja më 31.12.2020	Shtesa gjatë vitit 2021	Pakësime gjatë vitit 2021	Gjendja më 31.12.2021
1	Lista e tatimeve biznesi	113,329,862		8,505,150	104,824,712
2	Lista e tatimeve familjare	264,338,020		62,464,320	201,873,700
3	Lista e drejtorisë së transportit	7,913,750		1,180,000	6,733,750
4	Lista e PKZHT (legalizime)	237,287,232	33,500,624		270,787,856
5	Lista e IVMT	114,353,102	12,427,019	2,908,800	123,871,321
6	Lista Individ	5,248,586		1,194,169	4,054,417
7	Lista Individ Paskuqani	4,554,543			4,554,543
	<b>Totali</b>	<b>747,025,095</b>	<b>45,927,643</b>	<b>76,252,439</b>	<b>716,700,299</b>

Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

Në analizë të tabelës së mësipërme, nga auditimi u konstatua se:

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Kamëz, me shkresën nr. extra prot., datë 25.03.2022, kanë dhënë informacion për debitorët, deri më datë 31.12.2021, në Drejtorinë e Financës, ku ndër të tjera:

Për kategorinë biznes, me numër subjektsh 444, debia është me vlerë 104,824,712 lekë. Me këtë vlerë është mbyllur edhe bilanci i vitit 2021, në llogarinë 468.

Me shkresën nr. 3461 prot., datë 21.04.2022, e kanë ridhënë informacionin për debitorët, si më poshtë:

Për kategorinë biznes, me numër subjektsh 444, debia është me vlerë 121,835,012 lekë;

Për kategorinë familjarë, ku numri i tyre është 18,660, debia është me vlerë 201,873,700 lekë;

Për kategorinë legalizime, ku numri i tyre është 8467 (numër individësh), debia është në vlerën 270,787,856 lekë.

Të pyetur nga grupi i auditimit të KLSH, në lidhje me këtë fakt, drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), paraqiti një relacion në të cilin sqaroi se, ndryshimi në vlerë ka ardhur si pasojë e një gabimi në llogaritjen e vlerës së debisë në sistemin Informatik të DTTV, për subjektin OSSHEE me vlerë 24,888,538 lekë. Pas rishikimit vlera e debisë së subjektit të sipërcituar është 41,898,838 lekë. Kjo vlerë është faktuar me paraqitjen e faturës së printuar nga sistemi Informatik.

-Lista debitor individ, me vlerë 4,054,417 lekë, përfaqëson debinë e 28 individëve që nga viti 2003-2008, të cilët janë debitorë me urdhër të titullarit të institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH, në auditimet e kryera.

-Lista debitor individ Paskuqan, me vlerë 4,554,543 lekë, përfaqëson detyrime që janë trashëguar nga ish komuna Paskuqan, të cilat janë lënë rekomandim (tatimi mbi pagën, i pambajtur), nga KLSH në vitin 2008. Urdhri i Kryetarit nr. 56, datë 27.05.2008, për 296 punonjës.

Lista e plotë e gjendjes së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2021, gjendet në aneksin nr. 2, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

**Titulli i gjetjes 1:** *Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, me detyrime të trashëguara që nga viti 2003.*

**Situata:**

Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në vlerën 716,700,299 lekë, detyrime këto të trashëguara që nga viti 2003, të cilat nuk janë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me shpresë arkëtimi dhe pa shpresë arkëtimi.

**Kriteri:**

Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publiku”, të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, datë 21/02/2022.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mosndjekjen e plotë e procedurave për arkëtimin e detyrimeve, ka rritur nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Mungesa e bashkëpunimit dhe e moszbatimit të kuadrit ligjor.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrë masa për të analizuar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 716,700,299 lekë, për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me dhe pa shpresë arkëtimi, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre.

***Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”*** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020, me vlerën 49,411,944 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në shumën

149,603,040 lekë. Kjo llogari kuadron me llogarinë 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” në formatin nr. 2, “Pasqyra e performancës financiare”.

**Gjendja e llogarisë 481 “Shpenzime per t'u shpërndarë në disa ushtrime”** në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 380,800,000 lekë. Vlera e kësaj llogarie përfaqëson detyrime për investime të kryera, por të pafinancuara në vitin ushtrimor, të cilat janë të planifikuara në tre vite buxhetore (PBA 2021-2023). Analiza analitike e kësaj llogarie, *Furnitorë të periudhave të ardhshme* gjendet në aneksin nr. 3, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

**Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 261,171,535 lekë.

**Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” më datë 31.12.2021**

Llogaria 486	Gjendja më 31.12.2020	Pakësime gjatë vitit 2021	Shtesa gjatë vitit 2021	Gjendja më 31.12.2021
Investime / Detyrime ndaj subjekteve private	208,125,590	153,627,202	118,254,027	172,752,415
Mallra dhe shërbime / Kontratë koncesionare për pastrimin e qytetit.	55,261,950	55,261,950	88,419,120	88,419,120
Detyrime nga vendimet gjyqësore lidhur me personelin E. Kordhaku & Z. Lala	1,275,395	1,275,395		
Detyrime nga vendimet gjyqësore lidhur me shpronësimet, A.Lleshi	724,605	724,605		
<b>Total</b>	<b>265,387,540</b>	<b>210,889,152</b>	<b>206,673,147</b>	<b>261,171,535</b>

*Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.*

Vlera e kësaj llogarie në shumën 261,171,535 lekë, përfaqëson shpenzime të kryera, realizimi faktik i të cilave ndodh në vitin ushtrimor 2021, por që nuk janë likujduar për mungesë fondesh, si dhe janë të regjistruara në sistem në degën e thesarit. Analiza e investimeve dhe detyrimet ndaj subjekteve private, gjatë dhe deri më 31.12.2021, në shumën 172,752,415 lekë, dhe e kontratës koncesionare për pastrimin e qytetit, gjendet në aneksin nr. 4, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Paraqitja e tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, është kryer në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 42, e cila përcakton: “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pafinancuara.....”

**II. Auditimi i Aktiveve Afatgjata:**

**a. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata, janë që të sigurohemi nëse:**

Aktivitet ekzistojnë fizikisht; a i përkasin subjektit; a janë të vlerësuar dhe regjistruar në mënyrë korrekte; a është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve afatgjata? Informacionet që ndodhen në aneksin përkatës a janë të plota dhe korrekte?

**b. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

Për auditimin e aktiveve afatgjata, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë sipas parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

**c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata:**

1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27/12/2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në analizë “Aktivet afatgjata” në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, në vlerën 12,451,554,382 lekë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

**Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”.**

**Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020, në shumën 48,892,367 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 104,285,997 lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur. Në formatin 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 114,733,050 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën prej 182,876,537 lekë, ku diferenca në rritje prej 68,143,487 lekë i përket 5 projekteve të shtuara gjatë vitit 2021. Sipas të dhënave kontabël, shtesat gjatë vitit 2021, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" gjatë vitit 2021**

Nr.	Emërtimi i aktiveve	Shtesa gjatë vitit 2021
1	Studim-Projektim ndërtimi i parkut të liqenit Paskuqan.	5,396,400
2	Hartim i projektit të ndërhyrjeve rehabilituese përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve.	5,490,000
3	Projektim parku, kompleks sportiv.	37,837,121
4	Projekt elektrik për çerdhen Babrru 20% e vlerës.	118,800
5	Hartim i projektit të ndërhyrjeve rehabilituese përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve.	19,301,166
	<b>Totali</b>	<b>68,143,487</b>

Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

Analiza analitike e kësaj llogarie, gjendet në aneksin nr. 5, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Në formatin nr. 1 “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021, në shumën totale prej 9,157,226,382 lekë. Ndërsa sipas formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 13,173,312,238 lekë.

**Klasa 21 "Aktive Afatgjata materiale".**

**Gjendja e llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene"** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 58,990,966 lekë. Edhe në formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021, paraqitet me të njëjtën vlerë 58,990,966 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar në tabelën e mëposhtme:

**Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" më datë 31.12.2021**

Nr.	Emërtimi i aktiveve	Gjendja më 31.12.2020	Shtesa gjatë vitit 2021	Pakësi me gjatë vitit 2021	Gjendja më 31.12.2021
1	Shpronësim toke për ndërtim shkollash	14,170,000			14,170,000
2	Varreza Kamëz	8,213,211			8,213,211
3	Varreza Bathore	7,919,880			7,919,880
4	Pus Shkolla Bathore	124,000			124,000
5	Betonite pastrimi	581,231			581,231
6	Kont F Zh SH	2,501,535			2,501,535
7	Hapje terrene	1,110,809			1,110,809
8	Lulishte Kamëz	700,000			700,000
9	Tokë Troje, ardhur shkresa nga Prefektura	25,300			25,300
10	Shpronësim toke për shkollën 9-vjeçare Lagjja 5, Kamëz	3,975,000			3,975,000
11	Shpronësim toke për shkollën 9-vjeçare Lagjja 5, Bathore	14,170,000			14,170,000
12	Shpronësim toke për shkollën 9-vjeçare Laknas	1,766,875			1,766,875
13	Shpronësim toke për shkollën 9-vjeçare Laknas	983,125			983,125
14	Shpronësim toke për shkollë	2,750,000			2,750,000
	<b>Total</b>	<b>58,990,966</b>			<b>58,990,966</b>

Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

**Konkluzion:** Bashkia Kamzës ka marrë certifikatat e pronësisë për 47 pasuri (troje), nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK, por nuk janë të regjistruara në kontabilitet.

**Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione"** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerë neto 31,475,704 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën neto 29,901,918 lekë. Ndërsa sipas formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 36,234,936 lekë, pasi gjatë vitit 2021, në këtë llogari ka pasur shtesë me vlerë 12,481,158 lekë, për blerje pemë dekorative dhe më pas pakësim, pasi i janë bërë dalje Ndërmarrjes së Gjellbërimit.

**Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën neto 2,359,634,800 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 2,426,646,125 lekë. Ndërsa sipas formatit nr. 7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,889,367,536 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 3,074,380,233 lekë. Pra, kemi rritje në vlerën 185,012,697 lekë, (sipas formatit nr. 7/A) shumë e cila përbëhet nga blerje me pagesë, në vlerën 47,902,014 lekë, plus vlerën 137,110,683 lekë e cila është rindërtim + riparim i shkollës "Dom Nikoll Kaçorri", financim i Bashkimit Evropian, Projekti EU4Schools.

Nga auditimi u konstatua se, ky financim është përfshirë në aktivet e Bashkisë Kamëz në vitin 2021, më parë se sa të dalë VKM nr. 197, datë 06.04.2022 "Për kalimin të Bashkitë Durrës, Kavajë, Kamëz, Krutë dhe Kurbin të objekteve arsimore". Vendim i mbështetur në pikën 5 dhe 6, neni 20, të Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" në të cilën përcaktohet se: "5. Në përfundim të realizimit të projektit, donatori përgatit

listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave. 6. Këshilli i Ministrave, me vendim, i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoritetit përgjegjës shtetëror”.

Shtesat që janë bërë gjatë vitit 2021, në këtë llogari, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Shtesat gjatë vitit 2021 të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”**

Nr. USH	Datë	Emërtimi i aktiveve	Vlera në lekë
1154	26.10.2021	Mbikëqyrës ndërtim shkolla 9 vjeçare Lagjja Frutikulturë Kamëz	2,259,801
1461	20.12.2021	Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion Gjinnazi Isa Boletini.	1,331,600
1109	19.10.2021	Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion Gjinnazi I. Rugova	1,100,000
1504	29.12.2021	Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion Kopshti Ahmet Zogu	140,000
1138	21.10.2021	Ndërtim Çerdhe Q. Babru (bashkëfinancim)	42,682,710
1137	21.10.2021	Ndërtim Çerdhe Q. Babru (mbikëqyrës)	387,903
		<b>Total shtesa me pagesë (1)</b>	<b>47,902,014</b>
VKM nr.197	transferim	Rindërtim i shkollës dhe i kopshtit Dom Nikoll Kaçori (financim i BE) (2)	<b>137,110,683</b>
		<b>Total (1+2)</b>	<b>185,012,697</b>

**Burimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

Analiza analitike e llogarisë 212, gjendet në aneksin nr. 6, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

**Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 5,771,513,025 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,447,422,661 lekë. Në formatin nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 6,828,728,101 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 7,801,263,547 lekë. Gjatë vitit 2021, janë bërë shtesat në vlerën 972,535,446 lekë, ku janë kryer investime në ndërtime e ristrukturime rrugësh, ndërtim rrjeti ujësjellësi etj. Amortizimi për vitin 2021 është llogaritur 296,625,810 lekë.

**Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 9,813,421 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në shumën 6,806,289 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 23,130,170 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, paraqitet në vlerën 18,748,506 lekë për të cilat ka inventar fizik në lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet gjatë vitit 2021, paraqiten të analizuara në tabelën e mëposhtme:

**Gjendja e llogarisë 214 “Inst. teknike, makineri, pajisje, vegla pune” më datë 31.12.2021**

Nr.	Emërtimi i aktiveve	Gjendja më 31.12.2020	Shtesa gjatë vitit 2021	Pakësime gjatë vitit 2021	Gjendja më 31.12.2021
	<b>Bashkia Kamëz</b>				
1	Inst. teknike, makineri, pajisje, vegla pune	23,130,170	72,000	4,453,664	18,748,506

**Burimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.



Nga analiza e tabelës, shtesa me vlerë 72,000 lekë, është kryer blerja e 1 kondicioneri, me urdhër shpenzimin nr. 803, datë 10.08.2021. Ndërsa vlera 4,453,664 lekë janë nxjerrë jashtë përdorimi.

**Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 13,861,659 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 24,795,328 lekë. Në formatin nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 22,328,459 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 37,280,459 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar është 12,485,131 lekë. Kemi rritje me vlerën 14,952,000 lekë gjatë vitit 2021, ku me urdhër shpenzimin nr. 746, datë 22.07.2021, është kryer blerja e 1 automjeti zjarrfikës. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet gjatë vitit 2021, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti” më datë 31.12.2021**

Nr.	Emërtimi i aktiveve	Gjendja më 31.12.2020	Shtesa gjatë vitit 2021	Pakësime gjatë vitit 2021	Gjendja më 31.12.2021
	<b>Bashkia Kamëz</b>				
1	Furgonë Ford AA936LH	643,259			643,259
2	Autovetura Hyundai AA883YL	5,664,000			5,664,000
3	Automjet zjarrfikës MAN AA593ZH	13,140,000			13,140,000
4	Automjet zjarrfikës DAF AA932ZA		14,952,000		14,952,000
5	Fuoristradë Mercedes Benz AB937AY	2,881,200			2,881,200
	<b>Total</b>	<b>22,328,459</b>	<b>14,952,000</b>	<b>-</b>	<b>37,280,459</b>

**Burimi:** Drejtorja e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

Nga auditimi rezultoi se, institucioni i disponon të 5 automjetet në gjendje pune, si dhe me dokumentacion të rregullt në: certifikatat e pronësisë, policën për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve, taksën vjetore të mjetit, lejen e qarkullimit si dhe kontrollin teknik të tyre.

**Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 126,184,276 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 162,663,095 lekë. Në formatin nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 190,497,724 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën kontabël 218,076,091 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit të akumuluar e përllogaritur, është në shumën 55,412,997 lekë.

Në analizë të kësaj llogarie, gjatë vitit 2021 janë kryer hyrje (blerje), me pagesë në vlerën 14,418,036 lekë, si dhe hyrje në formë transferimi në vlerën 60,267,060 lekë. Me shkresën nr. 1239 prot, datë 24.12.2021, Zyra Vendore Arsimore Kamëz (ZVA), i ka dorëzuar Drejtorisë së Financës në Bashkinë Kamëz, dokumentacionin e inventarëve të bazës materiale të shkollave nën juridiksionin e ZVA Kamëz, ku bashkëngjitur shkresës gjendet tabela me pajisje për institucionet arsimore.

**Lista e pajisjeve për institucionet arsimore**

Nr.	Emërtesa	Sasia	Vlera në lekë
1	Bazë materiale	10,412	58,500,000
2	Kompjuteri Dell	19	1,767,000
3	<b>Totali</b>		<b>60,267,060</b>

Fletë hyrja e pajisjeve të ardhura nga ZVA Kamëz për institucionet arsimore, gjendet në aneksin nr. 7, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

**Titulli i gjetjes 2: Moskryerja e inventarit fizik, të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.**

**Situata:**

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021, nga Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz është kryer inventari fizik për llogaritë 202, 210, 212, 214, 218, 31 dhe 32, ndërsa për llogarinë 213 inventari është mbyllur vetëm me gjendjen kontabël të tyre, për të cilën informacioni kontabël është i pasaktë.

**Kriteri:**

Pika 74, kreu IV, “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” i udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Moskryerja e inventarit fizik, të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, paraqet informacion kontabël të pasaktë.

**Shkaku:**

Komisioni i inventarizimit nuk ka zbatuar si duhet kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrin masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e aktiveve në Bashkisë Kamëz.

**Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”** paraqitet në Pasqyrën Anekse Statistikore, formati nr. 7/B.

**Amortizimi i vitit 2021 është 474,254,564 lekë.**

Amortizimi i aktiveve afatgjata është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, në të cilën përcaktohet se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%”.

**Testi substancial i amortizimit.**

Nga auditimi i pasqyrës statistikore formati 7, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

Llog. nr. 202 “Amortizim, studime dhe kërkime” = 12,749,857 lekë;

Llog. nr. 211 “Amortizim, pyje, kullota plantacione” = 1,573,785 lekë;

Llog. nr. 212 "Amortizim ndërtim dhe konstruksione" = 118,001,372 lekë;  
 Llog. nr. 213 "Amortizim Rruge, Ura, Rrjete, Rezervuare" = 296,625,810 lekë  
 Llog. nr. 214 "Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" = 3,079,132 lekë,  
 Llog. nr. 215 "Amortizim Mjete transporti" = 4,018,332 lekë;  
 Llog. nr. 218 "Amortizim Inventar ekonomik" = 38,206,276 lekë.

Për aktivet e llogarive 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe llogaria 218 "Inventar Ekonomik", llogaritja e amortizimit është bërë aktiv për aktiv sipas formatit të miratuar.

**Gjendja e llogarisë 231 "Investime"** për aktive afatgjata materiale sipas të dhënave të paraqitura në bilanc për vitin 2021, paraqitet në vlerën 1,261,704,503 lekë. Kjo llogari ka një analizë të detajuar sipas objekteve dhe gjendet në aneksin nr. 8, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

## B. Pasivet (Detyrimet)

### I. Pasivet Afatshkurtra

Nga analiza e Pasivit (Detyrimet) rezulton se, *Pasivet afatshkurtra* janë paraqitur në vlerën 1,569,875,506 lekë, e cila përbëhet nga llogari të pagueshme si dhe detyrimet afatshkurtra, të cilat trashëgohen në vitin 2021. Për shqyrtimin e llogarive të debitorëve, llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në vlerën 365,325,634 lekë, kontrolluam rregullaritetin e operacioneve të regjistruara në kontabilitet, që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

**Llogaritë e detyrimeve të personelit dhe të tjera detyrime të lidhura me to** - Në këto llogari janë evidentuar detyrimet për paga të personelit dhe detyrimet e tjera të lidhura me to, të pagueshme në fund të periudhës ushtrimore, si pasojë e pagave të llogaritura për muajin Dhjetor 2021. Në mënyrë të përmbledhur detyrimet e njohura për këto paga janë të kontabilizuara në llogaritë analitike: në llogarinë 42 "Detyrime ndaj personelit" për 31,335,714 lekë, në llogarinë 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për 2,569,990 lekë, në llogarinë 435 "Sigurime Shoqërore" në vlerën 8,372,835 lekë, në llogarinë 436 "Sigurime Shëndetësore" në vlerën 1,161,688 lekë të cilat janë në pasiv të bilancit me vlerë totale 43,440,227 lekë.

Llogaria	Emërtimi	Gjendja 31.12.2021	Gjendja 31.12.2020
<b>B</b>	<b>PASIVET (DETYRIMET)</b>	<b>1,569,875,506</b>	<b>1,524,630,662</b>
	<b>I.Pasivet Afatshkurtra</b>	<b>1,569,875,506</b>	<b>1,524,630,662</b>
	<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>1,569,875,506</b>	<b>1,524,630,662</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	365,325,634	387,267,935
42	Detyrime ndaj personelit	31,335,714	23,370,994
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	2,569,990	1,743,991
435	Sigurime Shoqërore	8,372,835	6,893,404
436	Sigurime Shëndetësore	1,161,688	956,840
467	Kreditorë të ndryshëm	382,808,714	349,066,320

**Gjendja e llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)"** paraqitet më datë 31.12.2021, me vlerë 149,603,040 lekë. Llogaria 401-408 me vlerë 365,325,634 lekë + llogarinë 481 me vlerë 380,800,000 lekë e barabartë me vlerën 746,125,634 lekë. Detajimi i llogarisë 401 dhe 404 gjendet në aneksin nr. 9, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

**Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin 5% të garancive të ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 8,306,083 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 61,600,632 lekë. Për këtë gjendje të llogarisë 466, është bërë raportimi në Degën e Thesarit Tiranë, e cila paraqitet si më poshtë:

**Llogaria 466, 5% i ngurtësimit të vlerës së investimit të palikujduara deri më 31.12.2021**

Viti	Emërtimi	Gjendja 31.12.2020	Shtesa 2021	Pakësimet 2021	Gjendja 31.12.2021
2006	Qendra shëndetësore Kamëz	1,237			1,237
2006	Shkolla 9-vjeçare Bathore	99,263			99,263
2007	Qendra Shëndetësore Valias	135,931			135,931
2007	Qendra Shëndetësore Kodër Kamëz	579,367		532,584	46,783
2020	Ndërtim shkolla 9 vjeçare Frutikulture Kamëz	6,150,213			6,150,213
2020	Rikonstr. i shkolla 9 vjeçare "Nene Tereza Laknas" situacion nr 1	354,101		354,101	0
2020	rehabilitim Përforsim te banesave ekzistuese	439,327			439,327
2020	rehabilitim I Digës Rezervuari Paskuqan	308,854			308,854
2021	Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Ahmet Zogu		4,566,544		4,566,544
2021	Rindërtim I shkollës Kamza e re		1,505,448		1,505,448
2021	Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Niko Hoxha		2,136,150		2,136,150
2021	Rikons Shkollës Mesme "I. Rugova "		8,356,905		8,356,905
2021	Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Niko Hoxha		2,845,191		2,845,191
2021	Rindërtim I Çerdhe Kamëz		1,500,000		1,500,000
2021	Rikons Shkollës Mesme "I. Boletini "		2,928,100		2,928,100
2021	Rehabilitimi I Digës Rezervuarit Paskuqan faza 2 , 1		5,170,752		5,170,752
2021	Ndërtim Rrjeti KUZ dhe furnizim me uji I zonës Valias I ri		7,607,307		7,607,307
2021	Ndërtim Rrjeti ujësjellësit ne zonën Fushe Kamëz		6,824,424		6,824,424
2021	Ndërtim Rrjeti i ujësjellësit dhe Ndërtim KUN Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture Shkendija Shebeniku		6,650,001		6,650,001
2021	Perdorim i fondit te rindertimit per financimin e Hartimit te projekteve te parkut dhe kompelsit sportiv ne zonën e re		3,783,712	3,783,712	0
2021	Rikonstruksion kopshti Kamza e re		1,073,878		1,073,878
2021	permiresim I banesave ekzistuese per komunitetet e varfra dhe te oafavorizuara		228,035		228,035
2021	Ndërtim kopshti Zall-Mner		496,917		496,917
2021	Ndërtim kopshti Ahmet Zogu		1,288,782		1,288,782
	<b>Totali 1</b>	<b>8,068,293</b>	<b>56,962,146</b>	<b>4,670,397</b>	<b>60,360,042</b>
	Taks pulle	97,200	631,800	729,000	0
	Bio Produkt garanci	139,590			139,590
	Hatihe Koldashi	1,000			1,000
	Kthim pagese per Alban Elezaj		76,867	0	76,867
	Kthim pagese besjana rajta e dede papplekaj		100,000	0	100,000
	Depozitime te tjera ne ruajtje, te vitit ne vazhdim		1,180,000	256,867	923,133
	<b>Totali 2</b>	<b>237,790</b>	<b>1,988,667</b>	<b>985,867</b>	<b>1,240,590</b>
	<b>Totali (1+2)</b>	<b>306,083</b>	<b>58,950,813</b>	<b>5,656,264</b>	<b>61,600,632</b>

Në vitin 2021, vlera prej 61,600,632 lekë, është e vendosur në disponibilitete në thesar, në masën 5% garanci, për investimet e kryera sipas situacioneve përfundimtare.

Nga auditimi u konstatua se, nuk janë zhblokuar fondet për 4 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim në vitet 2006-2007, në vlerën 283,214 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Tiranë.

**Titulli i gjetjes 3: Garancitë e vjetra (5%) të viteve 2006-2007, të mbetura në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.**

**Situata:**

Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” me kundërpartinë llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”, ka gjendje vlerën 61,600,632 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat u mbahen operatorëve ekonomik si garanci për kontratat e nënshkruara. Nga verifikimi analitik i kësaj llogarie, vlera 283,214 lekë i përket viteve 2006-2007 dhe rezulton ende e patërhequr. Këto garanci punimesh janë të vjetra dhe normalisht duhet të ishin paguar në favor të operatorëve ekonomik ose duhet të ishin mbajtur si penalitet për shkak të mospërbushjes së kontratës në kohë apo defekteve gjatë periudhës së garancisë.

Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit dhe Ekonomike, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

**Kriteri:**

Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21/02/2022, kapitulli III, rubrika 3.1, pika nr. 30.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Llog.466 / llog.520 është e ngarkuar me vlerën 283,214 lekë.

**Shkaku:**

Nuk është shlyer kundrejt OE apo kaluar në llogari të Bashkisë Kamëz, vlera 283,214 lekë.

**Rëndësia: E mesëm**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit në bashkëpunim Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Kamëz dhe me Degën e Thesarit të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet që janë marrë në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratë, të bëjnë njoftimet e subjekteve për marrjen e garancive të punimeve në masën 5%, ose vlera të kalojë në favor të autoritetit kontraktor për mospërbushje të kushteve të kontratës.

**Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 349,066,320 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 382,808,714 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara. Në analizë, kjo llogari për vitin 2021, është në vlerën 121,637,179 lekë, e pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

**Llogaria “467 “Kreditorë të ndryshëm”**

Emërtimi	Gjendja më 31.12.2020	Shtesa gjatë 2021	Pakësime gjatë 2021	Gjendja më 31.12.2021
OSHE	-	3,310,478		3,310,478
Filiali i Postës Sha	-	40,810		40,810
Albtelecom	-	119,480		119,480
Ndërmarrja e Ujësjetës Kamëz	-	385,734		385,734
Ekzekutim vendimesh gjyqësore	16,874,978		16,874,978	-
Detyrime për shpërblim lindje	10,461,000		1,500,000	8,961,000
Pagesa pastrimi	55,261,950	108,819,677	55,261,950	108,819,677
Shërbim me sistem alarmi	23,280		23,280	-
Telefon	15,972		15,972	-

Emërtimi	Gjendja më 31.12.2020	Shtesa gjatë 2021	Pakësime gjatë 2021	Gjendja më 31.12.2021
Mirëmbajtje dhe zhvillim i sistemit të taksava e tarifave vendore (shërbim)	453,600		453,600	-
Shërbime marrje vinçi me qira	588,000		588,000	-
<b>Totali</b>	<b>83,678,780</b>	<b>112,676,179</b>	<b>74,717,780</b>	<b>121,637,179</b>

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” më datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 261,171,535 lekë, e cila i shtohet llogarisë 467 me vlerë 121,637,179 lekë. Në bilanc janë pasqyruar më vete llogaria 486 me vlerën 261,171,535 lekë dhe llogaria 467 me vlerë 382.808.714 lekë (kjo është e barabartë me shumën 121,637,179 lekë + 261,171,535 lekë), në zbatim të paragrafit të II, pika nr. 15, të udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21/02/2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

**Auditimi i pasqyrës së performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (Formati nr. 2)** do të përfshijë verifikimin e të gjitha llogarive në aspektin e pohimeve të auditimit. Nëse totali i të ardhurave është i barabartë me shumën e totalit të të ardhurave nga taksat dhe tatimet, totalit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të të ardhurave jo-tatimore, totalit të të ardhurave financiare, totalit të granteve korrente, totali të të ardhurave të tjera, si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve.

Nëse totali i shpenzimeve është i barabartë me shumën e totalit të shpenzimeve për pagat dhe përfitimet e punonjësve, totalit të shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të shpenzimeve për blerje të mallrave dhe shërbimeve, totalit të shpenzimeve për subvencione, totalit të shpenzimeve për transferime korrente, totalit të shpenzimeve financiare, totalit të shpenzimeve për kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara, totalit të shpenzimeve që rrjedhin nga ndryshimi i gjendjes së inventarit, si dhe totalit të shpenzimeve të tjera; nëse pasqyra e performancës financiare përfaqëson tepricën apo deficitin e periudhës (rezultatit e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur).

## **Të ardhurat**

### **Pasqyra e Performancës Financiare Format 2**

1	Klasa 7	TË ARDHURAT	2,169,450,116	1,684,976,191
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	548,951,939	383,178,805
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	5,812,702	8,638,706
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogël	5,812,702	8,638,706
8	702	2.Tatimi mbi Pasurinë	75,807,733	135,279,089
9	7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	75,130,841	76,249,410
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshëm	239,069	3,228,862
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurinë	437,823	55,800,817
12	703	3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	467,261,304	238,515,810
17	7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	467,261,304	238,515,810
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtare	70,200	745,200

Në analizë të dhënat e tabelës së mësipërme, të ardhurat nga taksat dhe tatimet, klasa 7.

**Gjendja e llogarisë 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2021, në vlerën 548,951,939 lekë.

**Gjendja e llogarisë 7002 “Tatim mbi biznesin e vogël”** paraqitet në bilanc për vitin 2021, në vlerën 5,812,802 lekë.

**Gjendja e llogarisë 702 “Tatim mbi pasurinë”** e cila përfaqëson taksën mbi ndërtesën dhe truallin, pasqyrohet në bilanc për vitin 2021, në shumën 75,807,733 lekë. Kjo gjendje përbëhet nga llogaria 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” në vlerën 75,130,841 lekë, llogaria 7021 “Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme” në vlerën 239,069 lekë, si dhe llogaria 7029 “Të tjera tatime mbi pasurinë” në vlerën 437,823 lekë.

**Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020, në vlerën 238,515,810 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 467,261,304 lekë, me një rritje prej 228,745,494 lekë ose 51%. Në këtë llogari janë përfshirë taksat e hotelerive, të pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike.

**Gjendja e llogarisë 708 “Të tjera tatime e taksa kombëtare”** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 70,200 lekë, kjo vlerë përfaqëson të ardhura për akte e pulla poste.

### Pasqyra e Performancës Financiare Formati 2

34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	237,144,392	162,833,347
35	710	1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
36	7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	235,155,725	162,233,947
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	229,194,239	158,635,824
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	2,677,000	332,139
42	7112	Takse per veprime gjyqesore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve		756,271
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	3,284,486	2,509,713
46	7116	Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
47	719	3.Të tjera të ardhura jo tatimore	1,988,667	599,400

Në analizë të dhënat e tabelës së mësipërme, të ardhurat jo tatimore, klasa 7.

**Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhura jo tatimore”** paraqitet në bilancin e vitit 2021, në vlerën 237,144,392 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin e Degës së Thesarit.

**i. Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare”** paraqitet në bilancin e vitit 2021, në vlerën 235,155,725 lekë, e cila përfshin tarifa për leje transporti, tarifa pastrimi dhe higjeno, gjoha të Inspektoriati Ndërtimor, gjoha të Policisë Bashkiake etj.

**ii. Gjendja e llogarisë 719 “Të tjera të ardhura jo tatimore”** paraqitet në bilancin e vitit 2021, në vlerën 1,998,667 lekë.

### Pasqyra e Performancës Financiare Formati 2

53	72	V.GRANTE KORENTE	1,383,353,785	1,138,964,040
54	720	1.Grant korent i brendshëm	1,383,353,785	1,138,964,040
55	7200	Nga Buxheti per NJQP (Qendrore)		
56	7201	Nga Buxheti per NJQP (Vendore)	1,229,258,203	1,088,867,296
57	7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti per mbulim deficit (ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim i pritshëm nga buxheti	149,603,040	49,411,944
62	7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)	4,492,542	684,800
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		

Në analizë të dhënat e tabelës së mësipërme, Grante Korente, klasa 7.

**Gjendja e llogarisë 72 “Grant korent i brendshëm”** paraqitet në bilancin e vitit 2021, në vlerën 1,383,353,785 lekë.

**Gjendja e llogarisë 7201 “Nga buxheti për NJQP (Vendore)”** paraqitet në bilancin e vitit 2021, në vlerën 1,229,258,203 lekë, e cila përfshin taksat e automjeteve e renta minerare.

**Gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** paraqitet në vlerën prej 149,603,040 lekë, kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në vlerën 149,603,040 lekë.

**Gjendja e llogarisë 7207 “Sponsorizime të brendshme (nga të tretë)”** paraqitet në bilancin e vitit 2021, në vlerën prej 4,492,542 lekë. Kjo shumë përfshin sponsorizime e dy organizatave joqeveritare United Nations Development dhe World Vision Albania. Vlerat e llogarisë 7, të ardhurat, kuadrojnë me akt rakordimit e Degës së Thesarit.

#### **Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2021.**

Gjatë vitit 2021 shpenzimet janë në rritje në krahasim me vitin e mëparshëm, për **155,249,889** lekë.

**Gjendja e llogarisë 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** për vitin 2021, paraqitet në bilanc dhe sipas akt-rakordimit me thesarin në vlerën 401,185,817 lekë, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm.

**Gjendja e llogarisë 601 “Kontribute të Sigurimeve”** paraqitet në bilanc në vlerën 63,635,612 lekë, e ndarë në vlerën 57,157,712 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore, si dhe në vlerën 6,477,900 lekë, për kontributet e sigurimeve shëndetësore. dhe sipas akt-rakordimit me thesarin.

**Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 dhe sipas akt rakordimit me Thesarin në vlerën 257,589,332 lekë, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2021.

**Gjendja e llogarisë 604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2021 dhe sipas akt rakordimit me Degën e Thesarin në vlerën 103,110,660 lekë.

**Gjendja e llogarisë 606 “Transferime për buxhetet familjare e individët”** në vlerën 943,582,261 lekë, e cila përfaqëson ndihmë paaftësie, ekonomike, grante nga tërmeti, bonus qiraje, bursa shkolle etj.

Për vitin 2021, totali i të ardhurave është në vlerën 2,169,450,116 lekë dhe totali shpenzimeve është në vlerën 1,765,551,391 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 403,898,725 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor”.

Gjithashtu, edhe gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është e barabartë me ndryshimin e gjendjes së inventarit qarkullues, klasa 3, në pasqyrën e pozicionit financiar, ku për vitin 2021 është në vlerën -3,552,291 lekë.

#### **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës. Testimi i Llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”.**

Në mbështetje të germës “j”, neni 64, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe neni 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë Kamëz; -Me Vendimin nr. 160, datë 14.01.2021, ka miratuar strukturën organizative të Bashkisë Kamëz për vitin 2021, ku numri total i punonjësve është 277.

-Me Vendimin e titullarit të institucionit nr. 320, datë 14.06.2021, “Për një ndryshim në vendimin nr. 37, datë 14.01.2021, për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”, numri i punonjësve të bashkisë, ndryshohet në 275.

-Me Vendimin e titullarit të institucionit nr. 8346, datë 01.09.2021, numri i punonjësve të bashkisë, ndryshohet në 276.

Nga auditimi u konstatua se, në listëpagesat e muajve Janar 2021, Qershor 2021 dhe Shtator 2021 është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.



-Listëpagesat janë të firmosura nga specialisti i pagave, drejtori i Drejtorisë së Financës, drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë.

-Forma, elementët dhe plotësimi i listpagesave mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimeve për pagat, janë përgatitur në zbatim të urdhrit nr. 1, datë 21.05.2021, i Departamentit të Administratës Publike.

### Hartimi i listpagesave mbi bazën e listëprezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2021.

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e muajve Janar, Mars, Korrik, Tetor dhe Dhjetor 2021 ku u konstatua se ishin plotësuar konform rregullave. Listëpagesat ishin plotësuar mbi bazën e listëprezencave mujore të nënshkruara nga Titullari i Bashkisë.

Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar listëprezenca në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Kamëz, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH".

Është përgatitur përmbledhësja e listpagesave e cila është e firmosur nga drejtori i Drejtorisë së Financës, drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë. Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, në Bashkinë Kamëz nuk është bërë asnjë ndalesë tjetër.

### Paraqitja në formë tabelle e burimit të financimit.

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit				
				Trans. e Pakush.	Fonde te trasheguara	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transfertës specifike
Viti 2021	4,608,238	4,254,033	92	527,169	69,924	792,637	2,627,805	236,498

### Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë.

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 31/12/2021		
		Plani	Fakti	%
1	Fondi i Pagave	409,378	391,183	95.5
2	Fondi i Sig. Shoqërore	76,132	62,583	82
3	Fondi i Veçantë	16,375	2,581	16

- Nga testi i kontrollit në lidhje me veprimet, arkë dhe bankë për vitin 2021:
- Rregullshmëria e veprimeve me arkë:

Nga kontrolli i veprimeve me arkën për të gjithë periudhën objekt auditimi, u konstatua se është zbatuar disiplina financiare dhe dokumentacioni është mbajtur në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël", ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore (taksë mbi tokën bujqësore) në njësinë administrative. Gjendja e arkës nuk e kalonte limitin e saj. Derdhjet e të ardhurave të realizuara, janë bërë në mënyrë periodike në bankën, në llogarinë likuiduese të institucionit. Për të ardhurat e arkëtuara

janë prerë mandatarkëtimet përkatëse të cilat janë pasqyruar në librin e arkës. Për vitin 2021, janë bërë veprime me arkën me mandatarkëtimin nr. 01, datë 05.01.2021 deri me mandatarkëtimin nr. 424, datë 30.12.2021. Gjatë vitit 2021 janë arkëtuar nga arka shuma prej 300.747 lekë. Po kështu edhe për shpenzimet, janë prerë mandatpagesat përkatëse të cilat janë pasqyruar në librin e arkës. Regjistrimet në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë kronologjike, veprim pas veprimi, duke përfshirë çdo të dhënë të dokumentit justifikues ku mbështetet ky regjistrim. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen në librin e arkës. Debiti i llogarisë 580 "Xhirime të brendshme" e bankës, është e barabartë me kredinë e kësaj llogarie në ditarin e arkës në vlerën 3500 lekë.

Nga auditimi u konstatua se, dokumentet ishin plotësuar në përputhje me pikën nr. 26, të nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me pikën nr. 34 dhe 35, shkronjat a, b dhe c të kreut III, të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

- Rregullshmëria e veprimeve me bankë:

Nga kontrolli me zgjedhje i kryer mbi dokumentacionin e bankës rezultoi se, shpenzimet e kryera nëpërmjet bankës janë plotësuar me dokumentacionin justifikues. Të gjitha veprimet nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës duke përfshirë çdo të dhënë të dokumentit justifikues ku mbështetet ky regjistrim. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen e ekstraktit të fund muajit të thesarit.

Pagesat për blerjet me vlera të vogla janë bërë në bazë të kërkesave të hartuara nga punonjësit e administratës, urdhrave të prokurimit, procesverbalit të blerjes dhe faturës të lëshuar nga operatori ekonomik fitues, është plotësuar procesverbali i testimi të tregut ku janë të evidentuar ofertat e marra nga operatorë të ndryshëm ekonomik për mallrat e kërkuara si dhe procedura elektronike për rastet e procedurës elektronike.

- Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet nëpërmjet magazinën.

Nga kontrolli me zgjedhje i dokumentacionit të magazinës për vitin 2021, rezultoi se, është mbajtur dokumentacioni për çdo lëvizje malli, janë prerë fletë hyrjet dhe fletë daljet, të cilat janë plotësuar me të gjitha ekstremitetet, janë hapur kartela për çdo artikull, janë hapur kartelat e zyrave të inventarit ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina.

Nga inventari fizik i disa artikujve me zgjedhje, i ushtruar në magazinë nga ana jonë, rezultoi se nuk kishte diferenca.

- Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin e karburantit.

Për vitin 2021, periudhë nën auditim, hyrjet dhe daljet e karburantit janë paraqitur në aneksin nr. 10, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

**Balanca e karburantit në datë 31.12.2021**

Emërtimi	Karburanti (lloji)	Sasia / litra
Hyrjet 01.01.2021 - 31.12.2021	Diezzel	34,140
	Benzine	4,800
Daljet 01.01.2021 – 31.12.2021	Diezzel	34,140
	Benzine	4,800
<b>Diferenca</b>	<b>Diezzel</b>	<b>0</b>
	<b>Benzine</b>	<b>0</b>

Konsumi i karburantit nga automjetet në përdorim, në aparatën e Bashkisë është bërë në bazë të dokumenteve justifikuese. Për çdo lëvizje është hartuar fletë udhëtimi me të gjithë ekstremitetet e nevojshme dhe është firmosur nga përdoruesi i automjetit. Me urdhrin nr. 01, datë 05.01.2021

të kryetarit të bashkisë, është ngritur grupi i punës “Për përcaktimin e normave të harxhimit të karburantit”, që përbëhet nga 5 punonjës (1 kryetar + 4 anëtarë).

Grupi i punës sipas procesverbalit të datës 06.01.2021, pas vendosjes në lëvizje të automjeteve ka përcaktuar normat e harxhimit të karburantit. Nga auditimi u konstatua se është hartuar dokumentacioni i tërheqjes dhe shpenzimit të karburantit për çdo makinë si:

- *urdhri i drejtorit të Drejtorisë së Financës, drejtuar magazinës;*

- *kartela limit;*

- *fleta e udhëtimit;*

- *procesverbali i furnizimit të nënshkruar nga personat përgjegjës.*

Në fund, janë hartuar pasqyrat përmbledhëse duke paraqitur në to, sasitë e furnizuara, km e përshkruara, harxhimin në fakt, si dhe diferencat në krahasim me limitin. Nga auditimi u konstatua se, nga kryerja e kryqëzimit me të dhënat midis lëvizjeve të shoferëve dhe fletë udhëtimcvc të plotësuara për lëvizjet e brendshme, për të cilat është bërë tërheqja e karburantit bazuar në kilometrat e përshkruar, disponoheshin të dhëna të lëvizjeve, në koherencë me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se është hartuar dokumentacioni për furnizimin me naftë për kaldajat e ngrohjes, të instaluara në kopshte dhe shkolla si:

- *urdhri i drejtorit të Drejtorisë së Financës për daljen e karburantit;*

- *kartela limit;*

- *pasqyra e orëve të punës së kaldajës;*

- *procesverbali i furnizimit të nënshkruar nga personat përgjegjës. Në bazë të dokumentacionit të mësipërm është tërhequr sasia e karburantit.*

- *Mbi ndjekjen e procedurave të fondeve të rindërtimit, gjatë vitit 2021.*

Në zbatim të ligjit nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; aktit nr. 09, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij; Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë dhe Lezhë”, u auditua ndjekja e procedurave për fondet e rindërtimit, gjatë vitit 2021.

**Komisioni i Posaçëm**, i ngritur me urdhrin nr. 155, datë 23.04.2020, të titullarit të institucionit, ka kryer verifikimet e dokumentacioneve referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 06.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, dhe akteve nënligjore të tjera, dalë për zbatim të tij. Shqyrtimi është bërë me anë të dokumentacioneve si më poshtë:

- Aplikimin e qytetarit;
- Përbërja familjare në momentin e aplikimit;
- Aktekspertiza e thelluar, e lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme;
- Çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar.

**Funksionimi i komisionit për vlerësimin e ankesave të aplikantëve jo fitues.**

**Titulli i gjetjes 4:** *Mosfunksionimi i komisionit të apelimit në shqyrtimin e dosjeve gjatë vitit 2021.*

**Situata:**

Komisioni i apelimit nuk ka shqyrtuar dosje gjatë vitit 2021, pasi të gjitha dosjet që nuk janë kualifikuar nga Komisioni i Posaçëm, janë dërguar pranë njësive administrative me qëllimin se ata ndodhen më pranë terrenit dhe banorëve. Nga auditimi u konstatua se, komisionet e ngritura pranë njësive administrative për shqyrtim të mëtejshëm të dosjeve, nuk kanë përfunduar procesin duke penguar kështu punën e komisionit të apelimit.

**Kriteri:**

Akti nr. 09, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij.

Vendimi nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë dhe Lezhë”.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Vonesë në procesin e punës për shqyrtimin e dosjeve që nuk janë kualifikuar nga komisioni i posaçëm.

**Shkaku:**

Komisionet në terren nuk kanë përfunduar procesin e shqyrtimit të dosjeve.

**Rëndësia: E mesëm**

Procedura që është ndjekur për shpërndarjen e fondeve DS4-DS5, ku të gjithë subjektet e kualifikuar me VKB, të cilët kanë zgjedhur të trajtohen me grant rindërtimi, për të rindërtuar në mënyrë individuale banesën e dëmtuar, janë dërguar për miratim pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit. Subjektet janë pajisur me lejen përkatëse të ndërtimit dhe kanë lidhur një kontratë noteriale me një subjekt ndërtues të licensuar për rindërtimit e objektit. Pas plotësimit të kushteve, subjekti ka nënshkruar kontratën e kalimit të grantit me institucionin, 60% të vlerës mund ta përdorë mbasi pajiset me leje ndërtimi. Sipas kontratës së nënshkruar në fazën karabina të objektit të rindërtuar procedohet me kalimin e kështit të dytë.

Procedura e kualifikimit për objektet e klasifikuara “DS4-rikonstruksion” është e përcaktuar në VKB nr.101, datë 10.11.2021. Vlerën e plotë të rikonstruksionit e përfitojnë sipas preventivit të paraqitur, individët ose familjet, shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4, por në çdo rast, jo më shumë se 70% të vlerës së rindërtimit miratuar në VKB nr. 21, datë 19.02.2021 “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindërtimit, për banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmsh për shembje”, prej:

*2,100,000 lekë për përfituesit me 1-2 anëtarë;*

*2,500,000 lekë për përfituesit me 3-4 anëtarë;*

*2,800,000 lekë për përfituesit me 5-6 anëtarë.*

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur, bonusi i qirasë për vitin 2021, që kanë përfituar familjet e prekura nga tërmeti, i cili në total është në vlerën 130,078,000 lekë.

**Bonusi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti**

Nr.	Muaji	Familje përfituese	Vlera në lekë
1	Janar	573	8,452,000
2	Shkurt	590	10,983,000
3	Mars	609	11,311,000
4	Prill	616	11,291,000
5	Maj	617	11,333,000
6	Qershor	593	10,951,000
7	Korrik	594	10,978,000
8	Gusht	595	11,019,000
9	Shtator	599	11,113,000
10	Tetor	583	10,790,000
11	Nëntor	586	11,091,000
12	Dhjetor	585	10,766,000

Nr.	Muaji	Familje përfituese	Vlera në lekë
	<b>Totali</b>	<b>7140</b>	<b>130,078,000</b>

Burimi: Drejtoria e Strehimit dhe e Emergjencave Civile, përpunuar nga audituesi.

Në aneksin nr. 10, pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit, gjenden tabella me grantet e tërmetit për vitin 2021, me vlerë totale 119,740,000 lekë, e ndarë te përfituesit në dy pjesë, 60% të vlerës dhe më pas në 40% të saj.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur fondet e rindërtimit për vitin 2021. Plani vjetor të granteve, janë në vlerën 231,451,960 lekë, nga të cilat vlera 188,361,166 lekë, janë realizuar deri më 31.12.2021 dhe vlera 43,090,794 lekë janë fonde të trashëguara për vitin 2022, vlera të cilat rakordojnë me thesarin.

#### Evidenca e fondeve të rindërtimit, viti 2021

Kap.	Llog.	Emërtimi i Projektit	Planifikimi 2021	Realizimi 31.12.2021	Fondet e trashëguara për vitin 2022
01	606	Rikonstruksion/riparim i banesave individuale, i mjediseve në (grante)	108,470,000	108,112,000	358,000
06	606	Rindërtimi i banesave individuale	95,200,000	52,520,000	42,680,000
06	230	Financimin e Hartimit te Projektit te ndërhyrjeve rehabilituese.	19,323,960	19,301,166	22,794
06	606	Grante tërmeti trashëguar nga viti 2020	8,458,000	8,428,000	30,000
		<b>Total Grante</b>	<b>231,451,960</b>	<b>188,361,166</b>	<b>43,090,794</b>

Burimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Kamëz, përpunuar nga audituesi.

#### - Pasqyra e flukseve monetare, Cash Flow. (Formati nr. 3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjenden më datë 31.12.2021.

Nr. Rubrike	PËRMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	5,175,250,271	1,753,993,276
II	Veprimtaritë e investimeve	-2,120,170,481	-815,062,502
III	Transferta e të tjera	-83,737,799	-80,383,557
V	Teprica në fillim të vitit ushtrimor	78,230,210	96,679,631
VI	<b>Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor</b>	<b>461,947,066</b>	<b>78,230,210</b>

Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 461,947,066 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" e cila paraqitet në shumën 461,947,066 lekë.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i Pasqyrës së Flukseve Monetare ( Cash Flow ), është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare", i ndryshuar.

#### Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (Formati nr. 4)

Nr. Llogarie	EMËRTIMI	Fonde bazë dhe Grante Kapitale	Fonde të tjera të veta	Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/Deficit	Gjithsej Aktive/neto Fonde/ Neto
b	c	1	3	5	6
101	<b>I. Aktivët neto/fondet neto</b>				12,881,443,348
	<b>II.Ndryshimet ne aktivet/ fondet neto (1+2)</b>	9,215,635,587	3,261,909,036	403,898,725	12,881,443,348
	<b>1.Nga burime te brendshme</b>	9,215,635,587	3,261,909,036	403,898,725	12,881,443,348
105	Nga grantet e brendshme kapitale (+)				0
1016, 1059	Nga transfertat e brendshme të AAGJ, dhurata në natyre, (+-)	9,215,635,587	1,790,304,247		11,005,939,834
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor (+, -)	0		403,898,725	403,898,725
115	Nga Fondet e veta te investimeve (+, -)	0	2,009,900,904		2,009,900,904
1013	Nga konsumi i AAGJ (-)	0	-474,254,564		-474,254,564
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet (-)	0	-64,041,551		-64,041,551
	<b>2.Nga burime te jashtme</b>	0	0	0	0
	<b>Totali i fondeve te veta(I+II)</b>	<b>9,215,635,587</b>	<b>3,261,909,036</b>	<b>403,898,725</b>	<b>12,881,443,348</b>

Nga auditimi, rezultoi se vlera totale e aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 12,881,443,348 lekë. Në këtë pasqyrë është paraqitur rezultati i vitit të mëparshëm, si dhe rezultatet e ushtrimit.

Vlera prej 403,898,725 lekë, përfaqëson shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor. Vlera prej 474,254,564 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor.

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto", i ndryshuar.

#### **Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore së bashku me njësinë e varësisë.**

Bashkia Kamëz për vitin 2021, ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore së bashku me njësinë e varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare, konfirmuar me shkresën nr. 2548 prot, datë 30.03.2022, janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, brenda afatit ligjor.

Veprimet janë në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"; neni 9, pika 4, gërma "d", neni 12 pika 2. gërma "b"; si dhe udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

Pasqyrat vjetore të konsoliduara të vitit 2021 (sipas Aneksit 2.3 bashkëlidhur Projektraport Auditimit), janë plotësuar në përputhje me nenin 51, të ligjit nr. 68, datë 27/04/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 9, pika 1.3, gërma ç, neni 34, pika 6, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të udhëzimit nr.30, datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 5, datë 21/02/2022 Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

"Në formatin F1 konstatohet se "Pasqyra e pozicionit të konsoliduar financiar", aktivi është i barabartë me pasivin në këtë pasqyrë në vlerën 14.575.329.293 lekë në mënyrë të përmbledhur si vijon:

❖ **Aktivët afatshkurtra** në vlerën prej 2,006,858,310 lekë dhe konkretisht:

1. Disponibilitete në thesar në vlerën 461,947,066 lekë.
2. Gjendje inventari qarkullues në vlerën 31,257,502 lekë.

3. Llogari të arkëtueshme në vlerën 871,682,207 lekë.

- ❖ **Aktivitet afatgjata** në vlerën 12,568,470,982 prej lekë dhe konkretisht:
  - afatgjata jomateriale (studime/kërkime) në vlerën 104,285,997 lekë
  - afatgjata materiale (toka/troje/terrene) në vlerën 58,990,966 lekë
  - afatgjata materiale (pyje/plantacione) në vlerën 132,292,559 lekë
  - afatgjata materiale (ndërtesa/konstruksione) në vlerën 2,426,646,125 lekë
  - afatgjata materiale (rrugë, rrjete, vepra ujore) në vlerën 6,447,422,661 lekë
  - afatgjata materiale (instalime teknike, makineri e pajisje) në vlerën 11,698,813 lekë
  - afatgjata materiale (mjete transporti) në vlerën 33,190,449 lekë
  - afatgjata materiale (inventari ekonomik) në vlerën 163,901,410 lekë

- ❖ **Investimet**
  - aktivitet afatgjata materiale në vlerën 1,261,704,503 lekë.

## 2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.

- 4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
- 4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.
- 4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.
- 4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

### - Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, sipas Aneks 2.4.1 bashkëlidhur Projektraporti Auditimit.

### - Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2021 nga subjekti Bashkia Kamëz, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej 36 procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 1,951,205 mijë lekë, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

Në 000/lekë

Periudha viti 2021	Proc me vlere te larte			Diferenca me fond limit	
	Nr.	Fond limit	Vlere kontrate	Vlera	%
<b>Procedura te realizuara gjithsej, nga e cila</b>	<b>36</b>	<b>1,951,205</b>	<b>1,880,922</b>	70,283	3.6
- Të hapura	6	280,101	226,575	53,527	19.1
- E hapur e thjeshtuar	4	28,494	24,175	4,319	15.2
- Kërkesë me propozim	2	6,463	4,616	1,847	28.6
- Marrëveshje kuadër	23	1,634,481	1,623,914	10,567	0.6

Periudha viti 2021	Proc me vlere te larte			Diferenca me fond limit	
	Nr.	Fond limit	Vlere kontrate	Vlera	%
<i>Negocim pa shpallje</i>	1	1,666	1,642	24	1.5
<b>Vlerësuar për auditim</b>	<b>18</b>	<b>1,846,197</b>	<b>1,782,991</b>		
<i>Shprehur ne %</i>	44.7	95	95		

Në totalin e procedurave të zhvilluara, konstatohet se me financim të Bashkisë Kamëz (me të ardhurat e veta dhe grande të pakushtëzuara) është financuar vlera 300,712 mijë lekë ose 15.41% e totalit. Ndërsa me të ardhurat e buxhetit të shtetit (grane specifike nga fondet e rindërtimit nga tërmeti), paraqitet vlera 1,634,480 mijë lekë ose 84 % e totali të fondit limit, konkretisht:

Me Vendim të KM nr. 26, datë 20.01.2021 është miratuar fondi “Për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Kamëz dhe Kavajë”, me vlerë 1,223,429 mijë lekë, ku Bashkia Kamëz ka përfutuar fondin me vlerë 754,430 mijë lekë pa TVSh i detajuar si vijon:

- a- Rindërtim i shkollës 9-vjecare “Niko Hoxha” me vlerë 189,845 mijë lekë.
- b- Rindërtim i çerdhes “Kamëz” me vlerë 67,638 mijë lekë.
- c- Rikonstruksion i shkollës së mesme “Ibrahim Rrugova” me vlerë 178,500 mijë lekë.
- d- Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Ahmet Zogu: me vlerë 163,800 mijë lekë.
- e- Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare “Kamza e Re” me vlerë 66,780 mijë lekë.
- f- Rikonstruksion i kopshtit “Kamza e Re” me vlerë 30,170 mijë lekë.
- g- Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu” me vlerë 57,697 mijë lekë.

Në zbatim të këtij vendimi këto fonde janë deleguar nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së kushtëzuar.

Me Vendim të KB nr. 8, datë 10.02.2021 është bërë miratimi i fondeve të deleguara nga buxheti i shtetit në zbatim të VKM nr. nr. 26, datë 20.01.2021

Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratave të lidhura është me një diferencë për verën 70,283 mijë lekë ose 3.6% e vlerës së fondit.

Në këto procedura kanë marrë pjesë 142 OE, nga ku janë skualifikuar 43 OE.

Mbi bazën e materialitetit të bërë nga grupi i KLSH, nga 36 procedura prokurimi të zhvilluara me fond limit 1,951,205 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim nga 18 procedura me fond limit 1,846,197 mijë lekë ose 95% e totalit të procedurave.

Nga auditimi i 18 procedurave me fond limit 1,846,197 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 6 procedura me vlerë të fondit limit 526,921 mijë lekë ose 16.4% e vlerës së fondit limit të audituar. Shkeljet kanë konsistuar në këto drejtime:

**Titulli i gjetjes 1:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë, duke përdorur kritere të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe të pa-argumentuara, konstatuar kjo në 12 procedura prokurimi.

#### **Situata:**

**Hartimi i kriterëve:** Në aplikimin e kriterëve nga AK Bashkia Kamëz, konstatohet se në 10 procedura kriteret janë vendosur jo në përputhje me kuadrin ligjorë të LP dhe tipologjinë e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose skualifikimin e tyre gjatë provës së vlerësismit, ku më kryesorët janë:

1. *AK në lidhje me kërkesën mbi “Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar”.*

- Ndër të tjera, AK për të vërtetuar kriterin e sipërcituar, kërkon nga OE pjesëmarrës paraqitjen e kopjeve të bilanceve për 3 (tre) vitet e fundit ushtrimorë. Kjo kërkesë, referuar procedurave të



sipërcituara, është përdorur me dy standarte nga ana e NJP. Në disa raste) është kërkuar që “bilancet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar”, ndërsa në disa raste të tjera është kërkuar vetëm që “bilancet të jenë të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse”.

Në lidhje sa më sipër, ky kriter paraqet konfuzion tek OE eventualë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në garë. AK duhet të konsiderojë se “akt ekspertiza e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar”, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur ata janë në kushtet që parashikon neni 41 gërma “c” e ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin...”.

**2. AK në lidhje me kërkesat mbi “Kapacitetin Teknik” dhe konkretisht me licencat profesionale të zbatimit, të nevojshme për zbatimin e kontratës.**

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit, konkretisht: NP-11/A; NP – 3/E; NP-12/D; NS – 4/E; NS – 18/B; NP-2/C; NS-2/B; NS-12/B; NS-13/B; NS-14/B; NP-1/B, NP-2/C, NP-3/C, NS-2/B, NS-4/B, NS-12/B, NS-13/A. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

Vendosja si kriteri i licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht çënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

**3- AK në lidhje me kërkesën mbi “Kapacitetin Teknik” dhe konkretisht me punësimin e 1 (një) mjeku të përgjithshëm të punësuar që të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë.**

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se nga AK në të gjitha rastet është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme (shih tabelën). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

**4. AK në lidhje me kërkesat mbi “Kapacitetin Teknik” dhe konkretisht me numrin mesatar dhe afatin e punonjësve të punësuar, të nevojshëm për zbatimin e kontratës.**

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh	Op. Fitues	Nr. Punonjësve të kërkuar	Afati I zgjatjes se punimeve
1	Ndertim Rruga Demokracia Lot III, Bathore	147,987,273	Liqeni VII	100	165 ditë
2	Ndertim rruga "Havzi Nela" Paskuqan 1	12,972,706	Kronos Konstruksion	36	3
3	Ndertim rruga "Luz i Vogel" & "Rrethimi i Varrezave Bathore	70,269,070	Shendelli	70	94 ditë
4	Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare "Niko Hoxha"	189,845,078	Egeu stone +5 Vllezerit+Boshnjaku	220	12 muaj
5	Rikonstruksionin e shkollës së mesme "Ibrahim Rugova",	178,500,000	Egeu stone +5 Vllezerit+Boshnjaku	220	12 muaj
6	Rikonstruksionin e shkollës mesme "Ahmet Zogu",	163,800,000	4A-M	200	6 muaj
7	Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare "Kamza e Re"	66,780,000	Britania+Colombo +Ndertimi	100	12 muaj
8	Rindërtimi i godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar në fshatin Valias	203,034,301	Sireta 2 F	125	6 muaj

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh	Op. Fitues	Nr. Punonjësve të kërkuar	Afati I zgjatjes se punimeve
9	Rindërtimi i çerdhes "Valias" në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias	82,267,780	Britania+Colombo+Ndërtimi	130	12 muaj
10	Riforcim i njërive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Kamëz	223,232,381	Britania+Colombo+Ndërtimi	160	12 muaj
11	Rikonstrukcion i kopshtit "Zall Mner"	71,400,000	Almo Konstruksion+Ulëza Ndërtim"	60	7 muaj
12	Rikonstrukcion gjimnazit "Isa Boletini",	292,810,000	Sireta 2 F	120	12 muaj
		<b>1,702,898,589</b>	<b>0</b>		

Referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se, nga ana e njësisë së prokurimit në përcaktimin e numrit të punonjësve janë përdorur standarte të dyfishta, thellësisht subjektive dhe kontradiktore. Konkretisht, për punime të së njëjtës natyrë është kërkuar një numër më i madh punonjësish në procedura me fond limit (volum punimesh) më të vogël në krahasim me numrin e punonjësve të kërkuar për një procedurë tjetër me fond limit (volum punimesh) më të madh. (P.sh.: Për procedurën me objekt "Ndërtim Rruga Demokracia Lot III, Bathore" me fond limit 147,987 mijë lekë pa TVSh janë kërkuar 100 punonjës, kur nga ana tjetër, për procedurën me objekt "Rikonstrukcionin e shkollës 9 vjeçare "Kamza e Re" me fond limit 66,780 mijë lekë pa TVSh (më shumë se 44.8% më të vogël) janë kërkuar 100 punonjës, pra një numër i barabartë punonjësish.

Gjithashtu, për procedurën me objekt "Ndërtim Rruga Demokracia Lot III, Bathore" me fond limit 147,987 mijë lekë pa TVSh janë kërkuar 100 punonjës, kur nga ana tjetër, për procedurën me objekt "Rindërtimi i çerdhes "Valias" në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias" me fond limit 82,267 mijë lekë pa TVSh (rreth 55.7% më të vogël) janë kërkuar 130 punonjës, pra një numër më i madh punonjësish prej 30 punonjës.

#### **Kriteri:**

Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

#### **Ndikimi/Efektiviteti:**

Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa e konkurrencës.

#### **Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

#### **Rëndësia: E lartë**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Kamëz, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të

barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfiturar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**Titulli i gjetjes 2:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 10 procedura prokurimi.*

**Situata:**

Nga auditimi i 18 procedurave me fond limit 1,846,197 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 5 procedura me vlerë të fondit limit 526,921 mijë lekë ose 28.4% e vlerës së fondit limit të audituar, ku;

- Në **2 procedura** me fond limit **149,047 mijë lekë**, OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

- Në **4 procedura** me fond limit **377,874 mijë lekë**, KVO duhet të vijonte vlerësimin e procedurës me OE mbetur në garë, pasi OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret.

**Kriteri:**

Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit".

**Ndikimi/Efektiviteti:**

KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri të LPP, pasi nuk plotëson kriteret e DT.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*)).

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:**

**1- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje mjet për MZSH", me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje mjet për MZSH".		
1. Urdhër Prokurimi nr. 4993, datë 17.5.2021	3. Njësia e Prokurimit nr. 4993, datë 17.5.2021	4. Komisioni VO nr. 5006, datë 117.5.2021

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "hapur",	Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	Elvis Gjika Luan Dedaj Etjola Agolli
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,583,333 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) "R&R GROUP" ShPK me vlerën e ofertës 12,460,000 lekë pa TVSh, me afat 15 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 123 lekë pa TVSh ose 0.97 %.
8. Data e hapjes së tenderit 9.6.2021 i # me dt. 16.6.2021 REF -96330-05-24-2021	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimim JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	13. Përgjigje KPP
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6939, Datë 8.7.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 12,460,000 lekë me afat 10 ditë	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

**Titulli i gjetjes 3:** Mungesa e stafit dhe mos aplikim i kritereve të domosdoshme në procedurën e blerjes së mjeteve.

**Situata:**

Me shkresën nr. *ska*, datë 2.3.2021 të shefit të M.Z.SH dhe miratim të Zv/Kryetarit të Bashkisë Kamëz z. Hasan Bara është kërkuar blerja e një mjete për M.Z.SH në sasinë 1 (një) copë. Nga auditimi, konstatohet se asnjë nga anëtarët e komisionit mbi aplikimin e specifikimeve teknike nuk është i profilit (ing. Mekanik), të cilat kanë aplikuar specifikimet teknike. Gjithashtu konstatohet fakti se në kriteret e aplikuar, konstatohet se si nga komisioni i hartimit të specifikimeve teknike dhe ai i kritereve të DST, nuk është kërkuar që për procedurën e blerjes së mjeteve, shoqëritë pjesëmarrës duhet të jenë të licencuara/ ose autorizim në QKL për këtë lloje aktiviteti.

**Kriteri:**

Veprime në kundërshtim me pika 3.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 "Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, nenet 56-Titullari i AK ose zyrtari i autorizuar dhe 57- Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", si dhe nenit 12/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 "Për Autoriparimin, Shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to" ndryshuar me ligjin nr. 10137 / 2009".

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mungesa e personelit përkatës dhe mos aplikimi i saktë i kritereve në procedurën e blerjes së mjete, çon në përdorim të fondeve jo me efektivitet, pasi subjektet pjesëmarrës nuk kanë kapacitet e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit.

**Shkaku:**

Përgjegjësi e stafit në zbatimin dhe njohjen e akteve ligjore.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa që në procedura me aktivitet të veçanta të përcaktojë specialist të fushën së objektit të prokuruar, si në hartimin e specifikimeve teknike po ashtu dhe kritereve kualifikues, kjo për të siguruar efektivitet të fondeve të prokuruar.

Me PV datë 24.5.2021, NJP në zbatim të nenit 41, pika 1 shkronja (a), nenit 42 pika 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ka përcaktuar llojin e procedurës “ E hapur”, referuar kufirit monetarë në bazë të analizës së kostos.

Me PV datë 24.5.2021 nga NJP janë hartuar kriteret, ku nga auditimi u konstatua se nuk ka kritere në kundërshtim me dispozitat e LPP.

Me PV datë 24.5.2021 është bërë miratimi i DST nga NJP, ku znj. Shpresa Xhekrosa është autorizuar për nisjen e procedurës në elektronike.

Me shkresën datë 28.5.2021 (shtojcë #), NJP ka bërë ndërhyrje në kritere, duke ndryshuar datën e hapjes së procedurës nga data 9.6.2021 për datën 16.6.2021.

- **Zhvillimi procedurës:**

Me PV datë 16.6.2021 nga KVO është bërë hapja e procedurës nga ku konstatohet se në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë 1 (një) OE, konkretisht shoqëria “**R&R GROUP**” shpk me nr. NIPT: K51423028P me vlerën **12,460,000 lekë pa TVSH**.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “R&R GROUP” shpk, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 12,460,000 lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë me datë 01.7.2021

Ankesa: **Nuk ka**

Me shkresën nr. S'ka, datë 01.7.2021 nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës sipas LPP, raport i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. Rakip Suli, duke shpallur fitues OE të vetëm të paraqitur në garë shoqërinë “R&R GROUP” ShPK me ofertë 12,460,000 lekë pa TVSh.

Midis shoqërisë “R&R GROUP” ShPK me ofertë 12,460,000 lekë pa TVSh dhe NSHP Bashkia Kamëz është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 6939, datë 8.7.2021 për “*Blerjen e mjet zjarfikëse*”, me afat 10 ditë nga lidhja e kontratës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditmit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni.

**1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrugës Luz i Vogël + Rrethim i Varrezave”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Luz i Vogël + Rrethim i Varrezave”.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.7973, datë 17.8.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Suela Vladi	<b>4. Komisioni VO nr. 7973/1, dt. 17.8.2021</b> Prel Gjonpalaj Luan Dedaj Miranda Kumrija i # me zj. Emanuela Mëziu sipas urdhrin nr. 2293/1, dt. 23.3.2022
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur”,		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 70,269,070 lekë REF-03078-08-17-2021	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “SHËNDELLI” ShPK me vlerën e ofertës 56,944,505 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 13,325 lekë pa TVSh ose 18.9 %.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 2.9.2021 i # me dt 9.9.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Të ardhurat e bashkisë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 6 OE</b> pjesëmarrës. 1. OE “Ndërtim Montim Patos” shpk me ofertë 52,633,429 lekë. 2. OE “SHËNDELLI” shpk me ofertë 56,944,505 lekë

		<p>3. OE "ALMO Konstruksion" shpk me ofertë 62,783,556 lekë.</p> <p>4. OE "ULZA NDËRTIM" shpk me ofertë 68,795,200 lekë</p> <p>5. OE "NDËRTIMI" shpk me ofertë 70.240.390 lekë</p> <p>6. OE "KACDEDJA" shpk me ofertë 70,241,175 lekë</p> <p><b>Janë skualifikuar 4 OE, konkretisht</b></p> <p>1. OE "Ndërtim Montim Patos" shpk me ofertë 52,633,429 lekë.</p> <p>2. OE "ULZA NDËRTIM" shpk me ofertë 68,795,200 lekë</p> <p>3. OE "NDËRTIMI" shpk me ofertë 70.240.390 lekë</p> <p>4. OE "KACDEDJA" shpk me ofertë 70,241,175 lekë</p> <p><b>Janë kualifikuar 2 OE, konkretisht:</b></p> <p>1. OE "SHËNDELLI" shpk me ofertë 56,944,505 lekë</p> <p>2. OE "ALMO Konstruksion" shpk me ofertë 62,783,556 lekë</p>
<b>11. Ankimime</b>	12. Përgjigje Ankesës nga AK	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3206, datë 26.4.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 56,944,505.lekë me afat 94 ditë	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

*Nga auditimi i dokumentacionit mbi OE të skualifikuar, u konstatua se vlerësimi i bërë nga KVO është i saktë, pasi OE e skualifikuar nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST të miratuara nga AK.*

### **ANKESA**

Me vendim nr. 242/2022, datë 10.3.2022 të KPP ka dalë vendimi mbi ankesën e OE "Almo Konstruksion" shpk, duke shpjeguar se pretendimet e shoqërisë ankimes nuk qëndrojnë.

Me urdhër nr. 268, datë 16.3.2022 Titullari i AK ka urdhëruar NJP në vijimin e procedurës sipas vendimit të KPP nr. 242/2022, datë 10.3.2022

Me PV nr. 5, datë 21.4.2022, KVO ka bërë vlerësimin përfundimtar ku fitues është shpallur shoqëria "**SHËNDELLI**" SHPK, me një vlerë të përgjithshme prej **56,944,505 lekë pa TVSh**.

Me datë 21.4.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës i cili është miratuar dhe nëpunësi i autorizuar z. Urada Elezi, në cilësinë e titullarit të AK

Me shkresën nr. 53/2, datë 28.01.2022 (prot Bashkia Kamëz nr. 1176, datë 9.2.2022) nga Instituti i Ndërtimit është përcjellë openenca teknike mbi objektin "Ndërtim rruga Demokracia (loti III), sipas kërkesës nr. 197, datë 10.01.2022 bërë nga Bashkia Kamëz.

Me urdhër nr. --, datë 23.7.2021 të titullarit të AK është ngritur grupi i punës për hartimin e fondit limit, i përbërë nga ing. Hajredin Murgu, ing. Ramadan Hysa dhe ing. Emanuela Meziu.

Me PV datë 30.7.2021 nga grupi i punës është hartuar fondi limit në vlerën 70,269,070 lekë pa TVSh, sipas manualit të çmimeve VKM nr. 354, datë 11.5.2016 "për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori..."

### **Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të

tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

Kategori NP-4/C (rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroplani)  
NP-18/A – Punime topogjeodezike (rilevim topografik, piktetim i aksit te rrugëve, ndjekje të topografisë gjatë zbatimit)

Në pikën 2.3.11 të DST, është kërkuar një numër i lartë i makinerive për zbatimin e projektit, numër ky i paargumentuar me volumin e zërave sipas preventivit.

**Konkluzioni:** Aplikimi i kritereve në mënyrë jo të mirëargumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, kanë çuar në uljen e OE pjesëmarrës në procedurë **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Suela Vladi.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*-Në lidhje me kategori NP-4/C Njësia e Prokurimit argumenton se kjo pikë licence është e domosdoshme pasi do të kryhen punime ndërtim në rrugë dhe operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën “NP-4”.*

*Klasifikim ‘C’ është vendosur nga ana e njësisë së prokurimit nisur nga zërat e preventivit dhe volumet e punimeve për vlerën nga 51 - 100 milion lekë, që i përkasin kësaj pike licensë pasi objekt në total është përlogaritur me një fond limit prej 70,269,070 lekë dhe kemi të bëjmë me ndërtimin e rrugës sipas Standartit të kohës.*

*-Kategori N.S - 18 (Punime topogjeodezike). Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale, që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh). Objekti ka një gjatësi 1100 ml prandaj duhet bërë vendosja e piktave me shumë saktësi për ndërhyrjet dhe duhet që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencën “NS-18 A” Punime topogjeodezike ”.*

*Klasifikim ‘A’ që përfshin vlerën (0 -20.000.000) është vendosur nga ana e njësisë së prokurimit nisur nga zërat e preventivit dhe volumet e punimeve që i përkasin kësaj pikë licensë.*

*Gjykojmë se arsyetimi i njësisë së prokurimit për kërkesat e pikave të licensave përkatëse është i justifikuar me preventivin dhe natyrën e objektit në mënyrë tepër të saktë pasi zërat e punimeve përkatës dhe vetë objektet përkojnë me këto pika pa cënuar kërkesat e LPP dhe duke mos rrezikuar nivelin e konkurrencës në objekt.*

*Agjencia e Prokurimit Publik, e ka monitoruar këtë procedurë prokurimi në lidhje me kriteret dhe nuk ka rekomanduar rishikimin e licensave, pasi janë konsideruar si kriter në përputhje me ligjin natyrën dhe volumin e kontratës.*

*-Kërkesa për numrin e makinerive është përcaktuar duke u bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar).*

*Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete, që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e usete të tjera fizike, aftësitë organizative.*

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuara nuk qëndrojnë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsyet e mos marrjes në konsideratë. **Procedura mbetet me probleme në aplikimin e kriteve.**

**- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se shoqëria "SHËNDELLI" ShPK, nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

Shoqëria "SHËNDELLI" shpk nuk plotësohet pikas 2.13 e DST, mbi certifikatat ISO, pasi sipas dokumentacionit në sistemin SPE dhe verifikimit në faqen e internetit të shoqërisë që lëshon certifikatat ISO (AQSCERT-Certification & Inspection Bady), **rezulton se certifikatat e mëposhtme nuk janë të regjistruara në faqen e internetit të shoqërisë licencues, konkretisht** : Certifikata ISO 9001-2015 me nr. AQS/Q/32632018.

Nuk plotëson pikën 2.3.11 të DST për mjetet dhe pajisjet, pasi nga auditimi disa nga mjetet dokumentacioni shoqërues, *konkretisht*:

Mjeti me targë AA043XL, **ka jashtë afatit TAX datë 11.8.2021.**

Buldozeri me kontratë qiraje me z. Fation Aliu, **nuk ka foto të mjetit sipas kërkesave të DST.** Autofshasa me KQ nr. 2382/932 datë 8.9.2021 me shoqërinë "GPG Kompani", **nuk ka asnjë dokumentacion sipas kërkesave të DST. Gjithashtu nuk disponon dhe foto.**

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam grupi konkludon se procedura është në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit", pasi OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriteve dhe KVO do duhej të vijonte vlerësimin e OE te mbetur ne garë, **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: Prel Gjonpalaj, Luan Dedaj dhe Emanuel Mëziu.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni.

**2- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Ndërtim i rrugës Demokracia, loti III ""**, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Ndërtim i rrugës Demokracia, loti III ""		
1. Urdhër Prokurimi Nr.6613, datë 28.6.2021		4. Komisioni VO nr. 6613/1, dt. 28.6.2021
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapu",	3. Njësia e Prokurimit Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Suella Vladi	Elvis Gjika i # me Prel Gjonpalaj sipas urdhrin nr. 7141, dt. 15.7.2021 Luan Dedaj I # me Luan Marku nr. 10386/2, datë 8.11.2021 (raport mjekësor) Eglantina Disha
5. Fondi Limit (pa TVSh) 147,987,273 lekë REF-99369-06-28-2021	6. Oferta fituese (pa TVSh) "LIQENI VII + S.M.O UNION + A.L ASFALT" ShPK me vlerën e ofertës 117,745,409 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 30,242 lekë pa TVSh ose 20 %.
8. Data e hapjes së tenderit dt 15.7.2021 i # dt. 22.7.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 6: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 6 0E



<b>11. Ankimime</b> Nr. 7987, dt. 17.8.2021 nga OE "LIQEINI VII"	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Nr. 7987/1, dt. 23.8.2021	<b>13. Përgjigje KPP</b> Nr. 872/2021, dt. 01.11.2021
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 11742, datë 21.12.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 117,745,409.lekë me afat 165 ditë	

**Burimi të dhënave:** *Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).*

Me vendim të KB nr. 160, datë 23.12.2020 "Për miratimin e detajimi të buxhetit të vitit 2021, 2022, 2023" është miratuar objekti "Ndërtim i rrugës Demokracia, loti III".

Me urdhër nr. 6096, datë 11.6.2021 të titullarit të AK është ngritur grupi i punës për hartimin e fondit limit, i përbërë nga ing. Hajredin Murgu, ing. Ramadan Hysa dhe ing. Flora Muca.

Nga grupi i punës është hartuar fondi limit në vlerën 147,987,273 lekë pa TVSh, sipas manualit të çmimeve VKM nr. 354, datë 11.5.2016 "për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori..."

Me urdhrin e prokurimit nr. 6613, datë 28.6.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 147,987,273 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "E hapur" me mjete elektronike ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 6613/1, datë 17.3.2021, KVO dhc data c hapjes së tenderit në datën 15.7.2021 i # dt. 22.7.2021.

Me shkresën datë 14.7.2021, Kryetari i KCO z. Elviz Gjika ka kërkuar titullarit të AK largimi nga KVO, kjo referuar autorizimit nr. 6898, datë 7.7.2021 në të cilën është emëruar "Zyrtar i Autorizuar" në procesin e prokurimeve.

Me urdhër nr. 7141, datë 15.7.2021 të titullarit të AK është bërë zëvendësimi i z. Elvis Gjika me z. Prel Gjonpalaj

Nga NjP është mbajtur PV nr. 3, datë 28.6.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 6613, datë 28.6.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 15.7.2021 i # dt. 22.7.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

**Në pikën 2.3.4 të DST**, është kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të ketë në stafin e tij të punësuar një mjek, i cili të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

**Në pikën 2.3.6 të DST**, është kërkuar një numër punonjësit prej 100 veta, numër ky i paargumentuar me zërat e preventivit dhe sipas manualeve.

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualeve teknike, çon në mospjesëmarrjen e OE në garë dhe rritjen e konkurrencës për një përdorim me ekonomicitet të fondit të prokuruar, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Suela Vladi.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 "Mbi Projektraportin e

Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur, që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore.*

*Si më lart, jemi të mendimit se nuk mund të citojmë fjalë për fjalë të gjithë bazën ligjore për secilin nga kriteret, pasi kjo krijon paqartësi dhe i bën kriteret e veçanta të gjata në mënyrë të panevojshme. 1.Operatorët që nuk janë në dijeni të kërkesave të legjislacionit kanë të gjithë hapësirat dhe afatet e nevojshme ligjore për të ankimuar këto kritere dhe në këtë mënyrë krijimin e kushteve për shqyrtimin dhe shpjegimin e thelluar të secilit prej këtyre kritereve.*

*Gjithashtu Bashkia Kamëz ka qenë e hapur për sqarimin e çdo informacioni apo pretendimi nga palët, dhe nuk ka pasur asnjë pretendim në asnjë kohë.*

*Duke marrë shkas nga rekomandimi i bërë nga APP për kërkesën për disponimin e mjekut si pjesë të stafit të punësuar , të vërtetuar me kontratë pune, nëpërmjet shtojcës datë 09.07.2021 kriteri për disponimin e mjekut është riformuluar.*

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuara nuk qëndrojnë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsyet e mos marrjes në konsideratë. **Procedura mbetet me probleme në aplikimin e kritereve.**

**- Zhvillimi procedurës:**

Me PV nr. 3, datë 6.8.2021 është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se ka 6 OE pjesëmarrës.

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta
1.	Liqeni VII + Al “ALSFALT”+S.MO. Union”	117,745,409
2.	KACDEDJA + Vashtemia	150,378,036
3.	Shëndelli+B93 II	143,968,451
4	Biba X + Aurora Konstruksion	119,799,245
5	EVEREST	177,352,207
6.	Klajger Konstruksion + Varaku E + Rafaelo 2002	117,854,555

Me PV nr. 4, datë 9.8.2021, KVO është bërë vlerësimi përfundimtar i dokumentacion teknik/ligjorë të OE pjesëmarrës, ku nga 6 OE pjesëmarrës është skualifikuar 2 (dy), konkretisht: BOE “LIQENI VII” + “ALSFALT” + “S.M.O UNION” me ofertë 117,745,409 lekë dhe shoqëria “EVEREST” me ofertë 177,352,207 lekë.

Në përfundim sipas KVO nga 6 OE pjesëmarrës është skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 4 OE, konkretisht:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta
1	KACDEDJA + Vashtemia	150,378,036
2	Shëndelli+B93 II	143,968,451
3	Biba X + Aurora Konstruksion	119,799,245
4	Klajger Konstruksion + Varaku E + Rafaelo 2002	117,854,555

KVO në përfundim vlerëson se BOE “Klajger Konstruksion + Varaku E + Rafaelo 2002” shpk, plotëson kushtet për kualifikim pasi ka ofertën më të ulët se OE mbetur në garë.

**ANKESA**

Në Bashkinë Kamzë është depozituar ankesa e shoqërisë “LIQENI VII” shpk për skualifikim të padrejtë, prot bashki nr. 7987, datë 17.8.2021. kjo kërkesë është bërë brenda 7 ditëve nga dita kur ankuesi është vënë në dijeni.

Me urdhër nr. 418, datë 18.8.2021, titullari i AK nëpërmjet NA z. Elvis Gjika është bërë pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e ankesës.

Me urdhër nr. 419, datë 18.8.2021 nga titullari i AK nëpërmjet NA z. Elvis Gjika është ngritur KSHA i përbërë nga : Uarda Elezi, Bledar Koskija dhe Dava Buraku.

Me vendim nr. 7987/1, datë 23.8.2021, KSHA pasi verifikoj pagesën e tarifës datë 16.8.2021, mori në shqyrtim duke dalë me vendim përfundimtar se pretendimet e shoqërisë “LIQENI VII” nuk qëndrojnë.

Me shkresën nr. 1518/10, datë 01.11.2021, KPP ka përcjellë vendimin nr. 827/2021, datë 01.11.2021 ku ka konkluduar se pretendimet e shoqërisë “LIQENI VII” shpk qëndrojnë dhe se KVO duhet të anulojë vendimin për skualifikim të padrejtë, sipas Vendimit nr. 930/201 datë 23.11.2021 (përcjellë me shkresën nr. 1518/2, datë 23.11.2021), KPP.

Me shkresën nr. 10386/1, datë 8.11.2021, titullari i AK nëpërmjet NA z. Elvis Gjika ka vendosur zbatimin e vendimit të KPP nr. 827/2021, datë 01.11.2021 për shpalljen fitues të **BOE “LIQENI VII” + “ALSFALT” + “S.M.O UNION” SHPK**, duke kthyer për rivlerësim në SPE procedurë.

Me PV nr. 4/1, datë 12.11.2021 nga KVO është bërë vlerësimi përfundimtar i procedurës bazuar dhe në vendimin e KPP duke shpallur fitues **BOE “LIQENI VII” + “ALSFALT” + “S.M.O UNION” SHPK me ofertë 117,745,409 lekë pa TVSh.**

Me shkresën datë 16.11.2021, KVO ka kërkuar titullarit të AK vendim për miratimin e procedurës.

Me shkresën datë 17.11.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i cili është nënshkruar dhe nga titullari i AK nëpërmjet NA z. Elvis Gjika.

Me PV datë 20.12.2021, KVO ka vlerësuar dhe marrë në dorëzim dokumentacioni e BOE **“LIQENI VII” + “S.M.O UNION” + ‘A.L ASFALT’ shpk**, si fitues të procedurës.

Me shkresën nr. 10782, datë 18.11.2021, AK njoftim KPP mbi zbatimin e vendimit të KPP.

**3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Ahmet Zogu ””, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Ahmet Zogu ”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.1497, datë 15.2.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 1497/1, dt. 15.2.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh) “4-AM ”</b> ShPK me vlerën e ofertës 163,308,600 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 492 lekë pa TVSh ose 0.3 %.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 163,800,000lekë REF-87061-02-15-2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 4, OE,</b> konkretisht: 1. BOE “SIRETA 2F” shpk + “Vëllëzërit Hysa” shpk dhe K12911201C 2. OE “4 AM” shpk. 3. BOE “ALBA Konstruksion’ shpk + “FUSHA” shpk 4. BOE ‘Alko Impex Gerenar Konstruction” shpk + “MF Invest Group’ shpk
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021		

		<b>Janë skualifikuar 2 OE, si më poshtë vijon:</b> 1. BOE "SIRETA 2F" shpk + "Vëllezërit HYSA" shpk. 2. BOE "Alko Impex Gerenar Konstruktion" shpk 'MF Invest Group' shpk <b>Janë kualifikuar për n fazën e dytë shoqëritë:</b> 1. OE "4 AM" shpk. 2. BOE "Alba Konstruktion" shpk + "FUSHA" shpk
11. Ankimime S'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. S:ka	13. Përgjigje KPP S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3963, datë 15.4.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 163,308,600.lekë me afat 6 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me urdhrin e prokurimit nr. 1497, datë 15.2.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 163,800,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 1497/1, datë 15.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.2.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 1497, datë 15.2.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Me PV datë 22.2.2021, NjP në referencë të sugjerimeve të APP mbi kriteret e aplikuar ka bërë ndryshimin e disa prej kriterëve të rekomanduara, kryesisht për kategoritë e licensave, numrin e inxhinierëve, certifikatat ISO, etj.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

**Në pikën 2.3.4 të DST, është kërkuar 1 (një) ARTITEKT**, kërkesë kjo e paargumentuar, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri ose hartimi i projekti, por me zbatim punimesh (rikonstrukcion). Gjithashtu ky kriter është ezauruar gjatë fazës së hartimit të preventivit.

**Në pikën 2.3.6 të DST, OE duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listë pagesa për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2020, 1 (një) mjek të përgjithshëm**

**Në pikën 2.3.7 të DST, ku OE pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tij 1 (një) ing. Kimist mjedisi. Kërkesa për ing. Kimist Mjedisi dhe 1 (një) ing. Tekomunikacioni janë kërkesë e tejkualuar pasi ne preventivin e punimeve nuk ka zëra punimesh që kërkojnë ing kimist mjedisi dhe telekomunikacioni si dhe tejkalojnë nevojat për realizimin e kësaj kontrate.**

**Gjithashtu është kërkuar 1 (nje) Inxhinier – Auditues energjie (i pajisur me "Certifikate per auditimin e energjisë per ndërtesa dhe procese).**

Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "Për efincencën e energjisë" parashikohet se: " 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që

kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Eficiencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.”

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të eficiencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjitik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të eficiencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë”, AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjitik me një procedurë të veçantë.

**Në pikën 2.3.2 të DST**, janë kërkuar kategori punimesh të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së tij, konkretisht: NP- 3/D; NP – 12A; NS – 3A; NS – 4/B; NS- 8A; NS – 9A; NS – 10A; NS – 12B; NS – 14 B.

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualeve teknike, çon në mospjesëmarrjen e OE në garë dhe rritjen e konkurrencës për një përdorim me ekonomicitet të fondit të prokuruar, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/nj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

- *A.K në lidhje me kërkesën mbi pjesën e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.4, është kërkuar dhe - 1(një) Arkitekt. Vendosija e këtij kriteri nga ana e njësisë së prokurimit, duke marrë shkas dhe nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin paraprak të punimeve), Vendosija e këtij kriteri zgjidh problemet e mundshme për organizimin dhe funksionalitetin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të objektit, Ndjekjen e të gjitha proceseve të punës, që kanë lidhje me hidroizolimet, termoizolimet dhe bojrat, vlerësojmë se AK për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e të paktën nje arkitekti në fjalë. Sjellim në vëmendje se, në hartimin e kriterit për të është përmbajtur përcaktimeve të LPP.*

- *1 (nje) Inxhinier Mekanik drejtimi Materiale. Vendosija e këtij kriterit nga ana e njësisë së prokurimit është bërë pasi për këtë projekt parashikohen të kryhen punime ndërtimore, arkitekturore, elektro-mekanike, punime hidraulike, punime mjedisore dhe rievime të ndryshme mjedisore dhe për këtë arsye, për realizimin e punimeve në fjalë është kërkuar ky inxhinier. Nevoja për inxhinierin e mësipërm në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjisllacioni për punimet e ndërtimit, nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mire në kryerjen e punimeve.*

- *Kërkesa që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar një mjek. AK për vendosjen e këtij kriteri është referuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që me rren me çështjet*

e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, ku parashikohet domosdoshmëria e mjekut, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

- Në pjesën e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.7 është bërë kërkesa për 1 (një) kimist mjedisi.. Kjo kërkesë është vendosur pasi ky inxhinier në fazën e project zbatimit është I rëndësishëm pasi studion efektin e përparimeve teknologjike në mjedis, duke adresuar çështje mjedisore lokale dhe botërore si shiu acidik, ngrohja globale, shterimi i ozonit, ndotja e ujit dhe ndotja e ajrit nga shkarkimet e automjeteve dhe burimet industrial.

- **Operatori ekonomik duhet që një Inxhinier Auditues Energjie (I pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë për ndërtesë dhe procese).** AK argumenton se kërkesa për Auditues Energjie është vendosur pasi ato janë përgjegjës për vlerësimin dhe analizimin e çdo lloj energjie që do përdoret në ndërtesë apo instalim dhe kudo tjetër ku kemi konsum të energjisë. Për të patur një analizë të detajuar të përdorimit të energjisë dhe kostove të saj kërkohet që të bëhet verifikohen mundësitë për ruajtjen apo kursimin e energjisë së përdorur, si dhe të rekomandohen masa të zbatueshme me kosto optimale në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë. Për këtë, kërkohet që audituesi të jetë i aftë të përdorë metoda llogaritëse inxhinierike, përfshirë një analizë ekonomike dhe simulime kompjuterike për të dhënë një vlerësim të kursimeve potenciale dhe të mundësive për kursim me kosto të ulët përmes përmirësimeve të praktikave operative dhe të mirëmbajtjes.

- Në pikën 2.3.2 të DST janë kërkuar kategori punimesh të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së tij, konkretisht: NP-3/D; NP-12/A; NS-3/A; NS-4/B; NS-8/A; NS-9°; NS-10°; NS-12/B; NS-14/B.

Në lidhje me kategoritë e licencës profesionale të shoqërisë, të kërkuara më pikën 2.3.8, të kapacitetit Teknik, A.K argumenton se kategoritë e kërkuara, janë vendosur sipas natyrës së punimeve që parashikohen të kryhen, për realizimin e objektit në fjalë, dhe A.K i është përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 5, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane..”.

#### **Qëndrim i grupit të KLSH-së:**

Në lidhje me argumentet e paraqitura nga subjekti mbi mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e paargumentuara, **qëndrojnë pjesërisht** duke u marrë në konsideratë dhe që nuk gjetjet pasqyrim në këtë Projektraport Auditimi. Ndërsa në lidhje me disa nga kriteret e tjera për të cilat argumentet e paraqitura nuk argumentonin gjetjet e grupit të KLSH, mangësi të cilat janë dhënë në fazën e konstatimit të kriterit të panevojshëm **nuk qëndrojnë**, sqarime të cilat janë dhënë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

#### **- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultoi se vlerësimi i bërë nga KVO është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si OE e skualifikuar dhe OE ‘4-AM’ shpk i shpallur fitues janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të të dyja fazave.

**4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rindërtim i godinës Admin në zonën e re Valias “, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rindërtim i godinës Admin në zonën e re Valias".</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.3032, datë 24.3.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 3032/1, dt. 24.3.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik,		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 203,034,301 lekë REF-90942-03-24-2021	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> "SIRETA 2F" ShPK me vlerën e ofertës 202,500,000 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 534 lekë pa TVSh ose 0.26 %.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 6.4.2021 i # dt. 9.4.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 2:</b> a- Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 2 OE
<b>11. Ankimime</b> S'ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Nr. S;ka	<b>13. Përgjigje KPP</b> S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 3963, datë 15.4.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 202,500,000.lekë me afat 6 muaj	

**Burimi të dhënave:** *Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).*

Me Vendim të KM nr. 150, datë 10.3.2021 është miratuar fondi "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të godinës administrative në zonën e Re për zhvillim të detyruar fshati Valias", me vlerë 203,034,301 lekë, ku për vitin 2021 nga buxheti i shtetit do alokohet fondi në vlerën 40,606,860 lekë.

Me vendim të KB nr. 33, datë 16.3.2021 është bërë ndryshimi i buxhetit sipas VKB nr. 160, datë 23.12.2020.

Me urdhrin e prokurimit nr. 3032, datë 24.3.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 203,034,301 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020 me elektronik", ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3032/1, datë 15.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 6.4.2021 i # dt. 9.4.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 24.3.2021 për hartimin e dokumenteve të tencrit referuar urdhrin të prokurimit 3032, datë 24.3.2021, ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 6.4.2021 i # dt. 9.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenin 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe neni 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe neni 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit* si dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht: **Në pikën 2.3.6 të DST**, OE duhet të kctë pjesë të stafit të punësuar një mjek, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listë pagesa për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2020, 1 (një) mjek të përgjithshëm

**Në pikën 2.3.4 të DST**, është kërkuar staf mbështetës, punonjësit dhe certifikimit. OE duhet të ketë në stafin e tij **1(nje) Auditues Energjie** shoqëruar me CV, Certificate Dip lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe librezë pune.

Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125/2015 "Për efincencën e energjisë" parashikohet se: " 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që

aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Eficiencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.”

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të eficiencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjistik të licencuar.

Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të eficiencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë”, AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjistik me një procedurë të veçantë.

Gjithashtu dhe stafi tjetër mbështetës trajtuar mësipërm nuk është mirëargumentuara dhe me tipologjinë e projektit.

Në **pikën 2.3.7 të DST**, janë kërkuar kategori punimesh të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së tij, konkretisht: N.P–2/D Ndërtime civile dhe industriale; N.P–3/D Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada; N.P–11/B ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë; N.P – 12/D Punime të inxhinierisë së mjedisit; N.S – 1/C Punime për prishjen e ndërtimeve; N.S- 2/C Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre; N.S- 4/D Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese; N.S – 8/C Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri; N.S – 9/C Punime strukturore speciale; N.S – 10/D Shtresa dhe mbistruktura speciale; N.S – 12/B Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit; N.S – 14/B Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj; N.S – 16/B Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij; N.S – 18/B Punime topogjeodezike; N.S.- 19/B Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë dhe N.S.- 20/B Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të argumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualeve teknike, çon në mospjesëmarrjen e OE në garë dhe rritjen e konkurrencës për një përdorim me ekonomicitet të fondit të prokuruar, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*A.K. argumenton se nëpërmjet këtij kriteri nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvogëlimin e konkurrencës, por ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore. Gjithsesi jemi të mendimit se kjo nuk e kufizon garën, pasi Operatoret Ekonomike*



janë në çdo rast të informuar. Gjithashtu Bashkia Kamëz ka genë e hapur për sqarimin e çdo informacioni apo pretendimi nga palët dhe nuk ka pasur asnjë pretendim në asnjë kohë.

Si më lart, jemi të mendimit se nuk mund të citojmë fjalë për fjalë të gjithë bazën ligjore për secilin nga kriteret, pasi kjo krijon paqartësi dhe i bën kriteret e veçanta të gjata në mënyrë të panevojshme. Operatorët që nuk janë në dijeni të kërkesave të legjislacionit kanë të gjithë hapësirat dhe afatet e nevojshme ligjore për të ankimuar këto kritere dhe në këtë mënyrë krijimin e kushteve për shqyrtimin dhe shpjegimin e thelluar të secilit prej këtyre kritereve.

2. Në lidhje me kërkesën e pikën 2.3.4 të DST është kërkuar staf mbështetës, punonjësit dhe certifikimit „,op. Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) Auditues Energjie shoqëruar me CV, Certifikatë DIP lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe librezë pune.

A.K. argumenton se, audituesi i energjisë është kërkuar pasi është përgjegjës për vlerësimin dhe analizimin e cdo lloj energjie, që do të përdoret në ndërtesë apo instalim dhe kudo tjetër ku kemi konsum të energjisë. Për të patur një analizë të detajuar të përdorimit të energjisë dhe kostove të saj kërkohet, që të bëhet të verifikohen mundësitë për ruajtjen apo kursimin e energjisë së përdorur, si dhe të rekomandohen masa të zbatueshme me kosto optimale në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

Për këtë duhet që audituesi të jetë i aftë, që të përdorë metoda llogaritëse inxhinierike, duke përfshirë një analizë ekonomike dhe simulime kompjuterike për të dhënë një vlerësim të kursimeve potenciale dhe të mundësive për kursim me kosto të ulët përmes përmirësimeve të praktikave operative dhe të mirëmbajtjes.

3. Në lidhje me kërkesën sipas pikën 2.3.7 të DST janë kërkuar kategori licence të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së objektit konkretisht:

A.K. argumenton se bazohet në nenin 46, pika 1/a të LPP dhe neni 26, pika 8/a, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "8.a) Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; ..."

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kritere të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane.", VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr.10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

#### **Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuar nuk qëndrojnë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsyet e mos marrjes në konsideratë. **Procedura mbetet me probleme në aplikimin e kritereve.**

**- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si OE e skualifikuar dhe OE ‘SIRETA 2F’ i shpallur fitues janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të të dyja fazave.

**5- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i gjimnazit “Isa Boletini”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i gjimnazit “Isa Boletini””.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.3972, datë 15.4.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 3972/1, dt. 15.4.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh) “SIRETA 2F”</b> ShPK me vlerën e ofertës 291,989,859 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 821 lekë pa TVSh ose 0.28 %.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 292,810,000lekë REF-93255-04-15-2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 10,</b> konkretisht: <i>Shoqëria “SIRETA 2F” shpk</i> <i>Shoqëria “VËLLEZËRIT HYSA” shpk.</i> <i>Bashkimi OE “AGRI Construcion “ + “KACDEDJA” shpk.</i> <i>Shoqëria ‘SHTATOR 90’ shpk.</i> <i>Shoqëria “NDËRTIMI” shpk.</i> <i>Shoqëria “DAJTI PARK 2007” shpk.</i> <i>Shoqëria ‘EURO ALB’ shpk.</i> <i>Shoqëria “KUPA” shpk.</i> <i>Shoqëria “ALKO IMPAX General Construcion” shpk.</i> <i>Shoqëria ‘VIANTE Konstruksion” shpk.</i> <b>Janë skualifikuar 7 OE, si më poshtë vijon:</b> <i>Shoqëria ‘SHTATOR 90’ shpk.</i> <i>Shoqëria “NDËRTIMI” shpk.</i> <i>Shoqëria ‘DAJTI PARK 2007’ shpk.</i> <i>Shoqëria “KUPA” shpk.</i> <i>Shoqëria ‘VIANTE Konstruksion” shpk.</i> <i>Shoqëria “ALKO IMPAX General Construcion” shpk</i> <i>Shoqëria “EURO ALB” shpk</i> <b>Janë kualifikuar 7 OE, si më poshtë vijon:</b> <i>Shoqëria “SIRETA 2F” shpk</i> <i>Shoqëria “VËLLEZËRIT HYSA” shpk .</i> <i>Bashkimi OE “AGRI Construcion “ + “KACDEDJA” shpk</i>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 26.4.2021 i # 30.4.2021		
<b>11. Ankimime</b> S’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Nr. S;ka	<b>13. Përgjigje KPP</b> S’ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 5993, datë 9.6.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 291,989,859.lekë me afat 12 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me vendim të KM nr. 200, datë 25.3.2021 është miratuar fondi “Për rindërtimin dhe financimi e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamëz”, me vlerë 292,810,000 lekë për objektin “*Rikonstruksion i gjimnazit “Isa Boletini”* dhe vlera 71,400,000 lekë për rikonstruksionin e kopshtit “Zall Her.

Për vitin 2012 fondi i alokuar nga buxheti i shtetit do jetë në shumën 72,842,000 lekë.

Me vendim të KB nr. 36, datë 31.3.2021 është bërë ndryshimi i buxhetit sipas VKB nr. 160, datë 23.12.2020.

Me urdhri prokurimin nr. 3972, datë 15.4.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 292,810,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “*I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik*”, ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3972/1, datë 15.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 26.4.2021 i # 30.4.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.4.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit *referuar urdhrin të prokurimit 3972, datë 15.4.2021*ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (*datë 26.4.2021 i # 30.4.2021*), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

- **Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht:*

**Në pikën 2.3.9 të DST**, OE duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**Në pikën 2.3.4 të DST**, është kërkuar staf mbështetës, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) Auditues Energjie shoqëruar me CV, Certificate Dip lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe libeze pune.

**Në pikën 2.3.6 të DST**, janë kërkuar kategori punimesh të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së tij, konkretisht: N.P – 2 D Ndërtime Civile dhe Industriale; N.P – 3D Rikonstruksion dhe mirëmbajtjesh godinash civile dhe industriale, veshje fasade; N.P – 11 B Punime per N/stacionet; N.P – 12D Punime të inxhinierisë së mjedisit; N.S - 1 C Punime për prishjen e ndërtimeve; N.S - 2 C Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre; N.S - 4 D Punime Rifiniture te muraturës dhe te lidhura me to, rifiniture me lastic druri, lastic, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyrës teknike ndërtuese; N.S - 8 C Ndertim parafabrikat beton arme , struktura metalike dhe druri; N.S - 9 C Punime strukture speciale; N.S – 12 B Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit; N.S – 14 B Impiante te brendshme, elektrike , telefoni, radio dhe TV; N.S - 18 B Punime topogjeodezike; N.S – 19 B Sisteme kundra zhurmës per infrastrukture; N.S – 20 B Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime per ujë.

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualeve teknike, çon në mospjesëmarrjen e OE në garë dhe

rritjen e konkurrencës për një përdorim me ekonomicitet të fondit të prokuruar, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Në pikën 2.3.6 të DST është parashikuar që operatorët ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek.*

*-A.K. argumenton se nëpërmjet këtij kriteri nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvogëlimin e konkurrencës, por ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore. Gjithsesi jemi të mendimit se kjo nuk e kufizon garën, pasi Operatorët Ekonomike janë në çdo rast të informuar. Gjithashtu Bashkia Kamëz ka qenë e hapur për sqarimin e çdo informacioni apo pretendimi nga palët, dhe nuk ka pasur asnjë pretendim në asnjë kohë.*

*Si më lart, jemi të mendimit se nuk mund të citojmë fjalë për fjalë të gjithë bazën ligjore për secilin nga kriteret, pasi kjo krijon paqartësi dhe i bën kriteret e veçanta të gjata në mënyrë të panevojshme. Operatorët që nuk janë në dijeni të kërkesave të legjislacionit kanë të gjithë hapësirat dhe afatet e nevojshme ligjore për të ankimuar këto kritere dhe në këtë mënyrë krijimin e kushteve për shqyrtimin dhe shpjegimin e thelluar të secilit prej këtyre kritereve.*

*Në pikën 2.3.4 të DST është kërkuar staf mbështetës, punonjësit dhe çertifikimit „,op. Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) Auditues Energjie shoqëruar me CV, Certifikatë DIP lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe librezë pune...*

*-A.K. argumenton se, audituesi i energjisë është kërkuar pasi është përgjegjës për vlerësimin dhe analizimin e çdo lloji energjie që do të përdoret në ndërtesë apo instalim dhe kudo tjetër ku kemi konsum të energjisë .Për të patur një analizë të detajuar të përdorimit të energjisë dhe kostove të saj kërkohet që të bëhet verifikohen mundësitë për ruajtjen apo kursimin e energjisë së përdorur, si dhe të rekomandohen masa të zbatueshme me kosto optimale në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.*

*Për këtë duhet që audituesi të jetë i aftë që të përdorë metoda llogaritëse inxhinierike, duke përfshirë një analizë ekonomike dhe simulime kompjuterike për të dhënë një vlerësim të kursimeve potenciale dhe të mundësive për kursim me kosto të ulët përmes përmirësimeve të praktikave operative dhe të mirëmbajtjes.*

*Në pikën 2.3.6 të DST, janë kërkuar kategori punimesh të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së tij, konkretisht: N.P – 2 D Ndërtime Civile dhe Industriale; N.P – 3D Rikonstrukcion dhe mirëmbajtjesh godinash civile dhe industriale, veshje fasade; N.P – 11 B Punime per N/stacionet; N.P – 12D Punime të inxhinierisë së mjedisit; N.S - 1 C Punime për prishjen e ndërtimeve; N.S - 2 C Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre; N.S - 4 D Punime Rifiniture te muraturës dhe te lidhura me to, rifiniture me lastic druri, lastic, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyrës teknike ndërtuese; N.S - 8 C Ndertim parafabrikat beton arme , struktura metalike dhe druri; N.S - 9 C Punime strukture speciale; N.S – 12 B Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit; N.S – 14 B Impiante te brendshme, elektrike , telefoni, radio dhe TV; N.S - 18 B Punime topogjeodezike; N.S – 19 B Sisteme kundra zhurmës per infrastrukture; N.S – 20 B Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per ujë.*

*-A.K. argumenton se kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 46, pika 1/a të LPP dhe neni 26, pika 8/a, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "8.a) Për të provuar kapacitetet teknike dhe*

profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

**Qëndrim i grupit të KLSH:** Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuara **nuk qëndrojnë**, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsyet e mos marrjes në konsideratë.

#### - **Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si OE e kualifikuar dhe OE “SIRETA 2F” shpk i shpallur fitues janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST në të dyja fazat e zhvillimit të procedurës.

**6- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rindërtim i shkollës 9 vjeçare “Niko Hoxha”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rindërtim i shkollës 9 vjeçare “Niko Hoxha””.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.1497, datë 15.2.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 1497/1, dt. 15.2.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 189,845,078 lekë REF-87054-02-15-2021	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> ““EGEU-STONE + PESE VËLLEZËRIT + BOSH NJAKU B”” ShPK me vlerën e ofertes 185,800,000 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 4,045 lekë pa TVSh ose 2.1 %.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 7,</b> konkretisht: 1. Shoqëria “EGEU-STONE + PESE VËLLEZËRIT + BOSH NJAKU B” shpk 2. Shoqëria “4 AM” shpk 3. Bashkimi i OE “2T” + “BE-IS” shpk. 4. Bashkimi i OE “ILIRIA 2020 + BAJRAMI N” shpk. 5. Shoqëria “VALONA KONSTRUKSION” shpk. 6. Bashkimi i OE “SIRETA 2F + Vëllëzërit HYSA” shpk. 7. Bashkimi i OE “AGRI Construcion + KACDEDJA + R&T shpk. <b>Janë kualifikuar 6 OE, si më poshtë vijon:</b> 1. BOE “2T” + “BE-IS” shpk.

		<p>2. Bashkimi i OE "ILIRIA 2020 + BAJRAMI N" shpk.</p> <p>3. Shoqëria "VALONA KONSTRUKSION" shpk.</p> <p>4. Bashkimi i OE "SIRETA 2F + Vëllëzërit HYSA" shpk.</p> <p>5. Bashkimi i OE "AGRI Construcion + KACDEDJA + R&amp;T" shpk.</p> <p><b>Janë kualifikuar 2 OE, si më poshtë vijon:</b></p> <p>1. Shoqëria "EGEU-STONE + PESE VËLLEZËRIT + BOSHNJAKU B" shpk</p> <p>2. Shoqëria "4 AM" shpk.</p>
11. Ankimime S'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. S:ka	13. Përgjigje KPP S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3799, datë 12.4.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 185,800,000.lekë me afat 12 muaj (1 muaj hartim projekti dhe 11 muaj zbatim)	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me vendim të KM nr. 26, datë 20.01.2021 është miratuar fondi "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamëz", me vlerë 189,845,078 lekë për objektin "Rindërtim i shkollës 9 vjeçare "Niko Hoxha". Me vendim të KB nr. 08, datë 10.2.2021 është bërë ndryshimi i buxhetit sipas VKB nr. 160, datë 23.12.2020.

Me urdhrin e prokurimit nr. 1497, datë 15.2.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara), është përcaktuar fondi limit 189,845,078 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik", ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 1497/1, datë 15.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.2.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 1497, datë 15.2.2021, ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

**Në pikën 2.2 të DST është** kërkuar që OE duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2017, 2018, 2019 të paraqitur pranë autoritetit përkatës tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në pikën 2.3.2 të DST është** kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime të përgjithshme ndërtimi NP – 1/D; NP – 2/D; NP – 3/D; NP-12/A; NP – 5/C; NS – 1/C; NS – 4/F; NS – 8/C; NS – 10/C; NS- 12/B; NS – 13/B; NS – 14/C; NS – 18/B NS – 20/B.

- 1 **Mjekë**, të punësuar, me kontrate individuale pune të vlefshme referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, diplomë dhe liçensë. Në rast bashkim operatorësh të paktën njëri duhet ta plotësojë këtë kriter.”.

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualët teknike, çon në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, ku ulja e numrit të OE pjesëmarrës çojnë në mos miradministrimin e fondit të prokuruar si rezultat i mungesës së konkurrencës nga mos pjesëmarrja ose skualifikimit nga mos plotësimi i kriterëve të aplikuar në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

- Në pikën 2.2 të DST është kërkuar kërkuar që OE të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2017,2018,2019 të paraqitura pranë autoritetit përkatës tatimor, të konfirmuara nga ky autoritet sipas legjislacionit në fuqi.

**A.K. argumenton se** përcaktimi për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- Në pikën 2.3.2 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime të përgjithshme ndërtimi NP – 1/D; NP – 2/D; NP – 3/D; NP-12/A; NP – 5/C; NS – 1/C; NS – 4/F; NS – 8/C; NS – 10/C; NS- 12/B; NS – 13/B; NS – 14/C; NS – 18/B NS – 20/B, konkretisht:

**A.K. argumenton se** kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 46, pika 1/a të LPP dhe neni 26, pika 8/a, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "8.a) Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret e përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane..”.

- Montator, Sharrxhi kultivues pemësh dhe Mjekë

**Ak. Argumenton si vijon:** Është kërkuar **montatori** pasi është konsideruar një specialist i domosdoshëm për të qenë i pranishëm gjatë të gjitha proceseve të montimit në objekt.

**Sharxhi, kultivues pemësh** pas konstatimit nga APP, A.K ka rivlerësuar nevojën duke ulur numrin nga 4 në 2. Prania e një specialisti të tillë është parë e nevojshme pasi në oborrin e shkollës ka pemë ekzistuese dhe është e nevojshme prania e sherrxhiut për ti prerë dhe për t'ju përshtatur sistemit të sheshit sipas projektidese paraprake.

- **A.k** nëpërmjet kriterit për **mjekun** nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvogëlimin e konkurrencës, por ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore. Gjithsesi jemi të mendimit se kjo nuk e kufizon garën, pasi Operatoret Ekonomike janë në çdo rast të informuar.

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në lidhje me argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH mbi kriteret kualifikuese të paargumentuara, **qëndrojnë pjesërisht** duke u marrë në konsideratë dhe që nuk gjetje pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Ndërsa në lidhje me mangësitë e tjera mbi kriteret pretendimet **nuk qëndrojnë**, sqarime të cilat janë dhënë në këtë Projektraport auditim.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si OE e skualifikuar dhe bashkimi i OE **“EGEU-STONE” + “PESE VËLLEZËRIT” + “BOSHNJAKU B”** janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST.

**7- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksionin e shkollës se mesme Ibrahim Rugova”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksionin e shkollës se mesme Ibrahim Rugova”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.1497, datë 15.2.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 1497/1, dt. 15.2.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “Egeu-STONE + PESE Vëllezërit + Boshnjaku B” ” ShPK me vlerën e ofertës 177,814,562 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 686 lekë pa TVSh ose 0.38 %.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 178,500,000 lekë REF-87059-02-15-2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 7:</b> 1. Shoqëria “EGEU-STONE + PESE VËLLEZËRIT + BOSHNJAKU B” shpk 2. Shoqëria “4 AM” shpk. 3. Bashkimi i OE “2T” + “BE-IS” shpk. 4. Bashkimi i OE “ILIRIA 2020 + BAJRAMI N” shpk. 5. Bashkimi i OE “NDREGJONI” + “CARA” + “RAIFAN COMPANY” shpk. 6. Bashkimi i OE “SIRETA 2F + Vëllezërit Hysa” shpk. 7. Bashkimi i OE “AGRI Construcion + KACDEDJA + R&T shpk.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021		



		Janë skualifikuar 5 OE, si më poshtë vijon: BOE "2T" + "BE-IS" shpk. BOE "ILIRIA 2020 + BAJRAMI N" shpk. Shoqëria "NDREGJONI" + "CARA" + "RAIFAN COMPANY" shpk. BOE "SIRETA 2F + Vëllezërit HYSA" shpk. BOE "AGRI Construcion + KACDEDJA + R&T" shpk. Janë kualifikuar 2 OE, si më poshtë vijon: 1. Shoqëria "EGEU-STONE + PESE VËLLEZËRIT + BOSHNJAKU B" shpk 2. Shoqëria "4 AM" shpk.
11. Ankimime S'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. S;ka	13. Përgjigje KPP S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4054, datë 19.4.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 177,814,562.lekë me afat 12 muaj (1 muaj hartim projekti dhe 11 muaj zbatim)	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Vendim të KM nr. 26, datë 20.01.2021 është miratuar fondi "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamëz", me vlerë 178,500,000 lekë për objektin "Rikonstruksionin e shkollës së mesme Ibrahim Rugova".

Me Vendim të KB nr. 08, datë 10.2.2021 është bërë ndryshimi i buxhetit sipas VKB nr. 160, datë 23.12.2020.

Me urdhrin e prokurimit nr. 1497, datë 15.2.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 178,500,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik", ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 1497/1, datë 15.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.2.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 1497, datë 15.2.2021, ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 26.2.2021 i # dt. 01.3.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

**Në pikën 2.2 të DST** është kërkuar që OE duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2017, 2018, 2019 të paraqitur pranë autoritetit përkatës tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas legjislacionit në fuqi.

Në pikën 2.3.2 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime te përgjithshme ndërtimi NP – 1/C; NP – 3/D; NP-12/A; NS – 1/C; NS – 4/F; NS – 8/C; NS – 10/B; NS- 12/B; NS – 13/B; NS – 14/C; NS – 18/B .

Në pikën 2.3.14 të DST, 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar - **Mjekë**, 1 të punësuar, me kontrate individuale pune të vlefshme referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë pune te vlefshme, diplomë dhe liçensë. Në rast bashkim operatorësh të paktën njëri duhet ta plotësoj këtë kriter.”

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualët teknike, çon në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, ku ulja e numrit të OE pjesëmarrës çon në mos miradministrimin e fondit të prokuruar si rezultat i mungesës së konkurrencës nga mos pjesëmarrja ose skualifikimit nga mos plotësimi i kriterëve të aplikuar në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

- Në pikën 2.2 të DST është kërkuar që OE të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2017,2018,2019 të paraqitura pranë autoritetit përkatës tatimor, të konfirmuara nga ky autoritet sipas legjislacionit në fuqi.

**A.K. argumenton se** përcaktimi për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- Në pikën 2.3.2 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime te përgjithshme ndërtimi NP – 1/C; NP – 3/D; NP-12/A; NS – 1/C; NS – 4/F; NS – 8/C; NS – 10/B; NS- 12/B; NS – 13/B; NS – 14/C; NS – 18/B, konkretisht:

**A.K. argumenton se** kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 46, pika 1/a të LPP dhe neni 26, pika 8/a, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "8.a) Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit

teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane..”.

- Në pikën 2.3.14 të DST operatori duhet të ketë të punësuar një mjek për një periudhë 1 vit konsiderohet si kriter i shfuqizuar nga ligji.

**A.K. argumenton** se nëpërmjet këtij kriteri nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvogëlimin e konkurrencës, por ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore. Gjithsesi jemi të mendimit se kjo nuk e kufizon garën, pasi Operatorët Ekonomike janë në çdo rast të informuar. Gjithashtu Bashkia Kamëz ka qenë e hapur për sqarimin e çdo informacioni apo pretendimi nga palët dhe nuk ka pasur asnjë pretendim në asnjë kohë.

Si më lart, jemi të mendimit se nuk mund të citojmë fjalë për fjalë të gjithë bazën ligjore për secilin nga kriteret, pasi kjo krijon paqartësi dhe i bën kriteret e veçanta të gjata në mënyrë të panevojshme. Operatorët që nuk janë në dijeni të kërkesave të legjislacionit kanë të gjithë hapësirat dhe afatet e nevojshme ligjore për të ankimuar këto kritere dhe në këtë mënyrë krijimin e kushteve për shqyrtimin dhe shpjegimin e thelluar të secilit prej këtyre kritereve.

**Qëndrim i grupit të KLSH:** Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuar nuk qëndrojnë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsyet e mos marrjes në konsideratë. **Procedura mbetet me probleme në aplikimin e kritereve.**

#### - Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si OE e skualifikuar dhe bashkimi i OE “EGEU-STONE” + “PESE VËLLEZËRIT” + “BOSHNJAKU B” i shpallur fitues janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DST.

**8- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare “Kamza e Re”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare “Kamza e Re” ”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr.1497, datë 15.2.2021	3. Njësia e Prokurimit Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	4. Komisioni VO nr. 1497/1, dt. 15.2.2021 Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	6. Oferta fituese (pa TVSh) “BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO” me vlerën e ofertës 66,659,236 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 121 lekë pa TVSh ose 0.18%.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 66,780,000 lekë REF-87063-02-15-2021	9. Burimi Financimit Buxheti shtetit	10. Operatorë Ekonomike 3 OE, konkretisht: 1.BOE “BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO” shpk
8. Data e hapjes së tenderit dt 01.3.2021		

		2. BOE "Ndregjoni + Rafin Company" shpk. 3. OE "SIRETA 2F" shpk. Sipas PV datë 10.3.2021 është bërë vlerësimi i procedurës, ku pas vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës KVO bëri mbylljen e procedurës së fazës së parë. KVO ka bërë vlerësimin përfundimtarë të fazës së parë të OE pjesëmarrës, duke kualifikuar të 0 OE dhe skualifikuar 3 OE.
11. Ankimime S'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. S;ka	13. Përgjigje KPP S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4049, datë 16.4.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 66,659,236.lekë me afat 12 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me urdhrin e prokurimit nr. 1497, datë 15.2.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 66,780,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 1497/1, datë 15.2.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 01.3.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.2.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 1497, datë 15.2.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 01.3.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

**- Vlerësimi i kritereve:**

Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

**Në pikën 2.3.8 të DST është** kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime te përgjithshme ndërtimi NP-1/B, NP-2/C, NP-3/C, NS-2/B, NS-12/B, NS-13/B, NS-14/B .

**Në pikën 2.3.4 të DST OE duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontrate pune te vlefshme me afat tetor 2020 – dhjetor 2020. - Artitekt, 1 të punësuar.**

Kërkesa për 1 (një) Artitekt, është e paargumentuar, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri ose hartimi i projekti, por me zbatim punimesh (rikonstruksion). Gjithashtu ky kriter është ezauruar gjatë fazës së hartimit të preventivit.

**2.3.10. OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.**

**Konstatimi:** Aplikimi i kritereve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualet teknike, çon në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, ku ulja e numrit të OE pjesëmarrës çojnë në mos miradministrimin e fondit të prokuruar si rezultat i mungesës së konkurrencës nga mos pjesëmarrja ose skualifikimit nga mos

plotësimi i kriterëve të aplikuara në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkrcës nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

- Në pikën 2.3.8 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, punime të përgjithshme ndërtimi: NP-1/B; NP-2/C; NP-3/C; NS-2/B; NS-12/B; NS-13/B; NS-14/B;

Në lidhje me kategoritë e licencës profesionale të shoqërisë, të kërkuara më pikën 2.3.8, të kapacitetit Teknik, A.K argumenton se kategoritë e kërkuara, janë vendosur sipas natyrës së punimeve që parashikohen të kryhen, për realizimin e objektit në fjalë, dhe A.K i është përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 5, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane..".

- Në pikën 2.3.8. të DST OE duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontratë pune të vlefshme me afat (tetor 2020-dhjetor 2020). Arkitekt, 1 të punësuar

**Arkitekt**, është kërkuar me qëllim për zgjidhjen e problemeve të ndryshme për organizimin dhe funksionalitetin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të objektit, Ndjekjen e të gjithë proceseve që lidhen hidroizolimet, termoizolimet dhe bojrat.

- Në pikën 2.3.10 të DST është parashikuar, që operatorët ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listë pagesa për periudhën, për të paktën 3 muajt e fundit ....si një kriter i shfuqizuar

**A.K. argumenton** se nëpërmjet këtij kriteri nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvogëlimin e konkurrencës, por ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore. Gjithsesi jemi të mendimit se kjo nuk e kufizon garën, pasi Operatoret Ekonomike janë në çdo rast të informuar. Gjithashtu Bashkia Kamëz ka qenë e hapur për sqarimin e çdo informacioni apo pretendimi nga palët dhe nuk ka pasur asnjë pretendim në asnjë kohë.

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuara nuk qëndrojnë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsytet e mos marrjes në konsideratë. **Procedura mbetet me probleme në aplikimin e kriterëve.**


- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO nuk është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si bashkimi i OE “BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO”, nuk është në kushtet e plotësisht të të gjitha kriterëve të DST, konkretisht.

a- Nga shoqëritë “BRITANIA” shpk dhe “NDËRTIMI” shpk nuk plotësohet pika 2.3.8 e DST, mbi disponimin e kategorie të licensave, konkretisht:

- Shoqëria “BRITANIA” shpk nuk plotëson kategoritë NP-2/C, NP-3/C, NS-2/B, NS-3/A, NS-4/B, NS-9/B, NS-12/B, NS-13/B, NS-14/B dhe NS-18/A.
- Shoqëria “NDËRTIMI” shpk nuk plotëson kategoritë NP-2/C, NS-2/B, NS-12/B, NS-13/B, NS-14/B.

b- Nga bashkimi i OE “COLOMBO” shpk, “NDËRTIMI” shpk dhe ‘BRITANIA’ shpk, nuk kërkesa mbi pagesën e energjisë elektrike, pasi në detyrime është deri në muajin dhjetor 2020, pa përfshirë muajin janar 2021, ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 01.3.2021, foto;



**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam shoqëria “BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO” shpk, nuk është në kushtet për tu shpallur fitues, pasi ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe në plotësim të kriterëve të DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III, duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: **Evis Gjika, Luan Dedaj dhe Ramadan Hysa.**

Nga subjekti audituar Bashkia Kamëz nuk janë paraqitur kundërshti ne fazën e Projekt Raport Auditimit mbi kualifikimin në kundërshtim me kërkesat e DST.

**9- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rindërtim i çerdhes Valias në zonën e re për zhvillim të detyruar”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rindërtim i çerdhes Valias në zonën e re për zhvillim të detyruar”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr.3031, datë 24.3.2021	3. Njësia e Prokurimit Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	4. Komisioni VO nr. 3031/1, dt. 24.3.2021 Elvis Gjika Urada Elezi Ramadan Hysa
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	6. Oferta fituese (pa TVSh) “Britania + Ndërtimi + Colombo” me vlerën e ofertës 82,100,000 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 167 lekë pa TVSh ose 0.59%.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 82,267,780 lekë REF-90960-03-24-2021	9. Burimi Financimit Buxheti shtetit.	10. Operatorë Ekonomike 4 OE, konkretisht:
8. Data e hapjes së tenderit dt 6.4.2021 i # dt. 9.4.2021		

		1. BOE "Britania + Ndërtimi + Colombo" shpk 2. BOE "Ndregjoni + Rafin Company" shpk. 3. OE "SIRETA 2F" shpk. 4. PE "EURO-ALB" shpk Nga KVO jane kualifikuar të 4 OE për fazën e dytë, pasi plotësonin kriteret.
11. Ankimime S'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. S;ka	13. Përgjigje KPP S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4803, datë 10.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 82,100,000.lekë me afat 12 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Vendim të KM nr. 151, datë 10.3.2021 është miratuar fondi "Për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit për financimin e rindërtimit të çerdhes "Valias", me vlerë 82,267,780 lekë.

Me Vendim të KB nr. 33, datë 16.3.2021 është bërë miratimi i fondeve të deleguara nga buxhetit i shtetit në zbatim të VKM nr. nr. 151, datë 10.3.2021.

Me urdhër prokurimi nr. 3031, datë 24.3.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 82,267,780 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3031/1, datë 24.3.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 6.4.2021 i # dt. 9.4.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 24.3.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 3031, datë 24.3.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 6.4.2021 i # dt. 9.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit, të cilat janë miratuar me PV nr. 1, datë 24.3.2021

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

**Në pikën 2.3.8 të DST është** kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime te përgjithshme ndërtimi NP-1/B, NP-2/C, NP-3/C, NP-12/A, NS-2/B, NS-4/B, NS-12/B, NS-13/A, NS-14/B.

**Në pikën 2.3.4 të DST OE duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontrate pune te vlefshme me afat tetor 2020 – janar 2021. - Artitekt, 1 të punësuar.**

Kërkesa për 1 (një) Artitekt, është e paargumentuar, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri ose hartimi i projekti, por me zbatim punimesh (rikonstruksion). Gjithashtu ky kriter është ezauruar gjatë fazë së hartimit të preventivit.

**2.3.10. OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë punc dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.**

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualët teknike, çon në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, ku ulja e numrit të OE pjesëmarrës çojnë në mos miradministrimin e fondit të prokuruar si rezultat i mungesës së konkurrencës nga mos pjesëmarrja ose skualifikimit nga mos plotësimi i kriterëve të aplikuar në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

- **Në pikën 2.3.8 të DST janë kërkuar kategori punimesh të cilat nuk përputhen me volumin e punimeve sipas zërave të preventivit dhe tipologjisë së tij, konkretisht: NP-1/B; NP-2/C; NP-3C; NP-12/A; NS-2/B; NS-4/B; NS-12/B; NS-13/A; NS-14/B..**

Vendosja e këtij kriteri nga ana e njësisë së prokurimit, për përcaktimin e kategorisë së licencave bazohet në kriterë të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane..", VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr.10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

- **AK në lidhje me kërkesat mbi "kapacitetin teknik" dhe konkretisht me pika 2.3.4, Arkitekt:**

Vendosja e këtij kriteri nga ana e njësisë së prokurimit, duke marrë shkas dhe nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin paraprak të punimeve), Vendosja e këtij kriteri zgjidh problemet e mundshme për organizimin dhe funksionalitetin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të objektit, Ndjekjen e të gjitha proceseve të punës, që kanë lidhje me hidroizolimet, termoizolimet dhe bojrat, vlerësojmë se AK për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e të paktën nje arkitekti në fjalë. Sjellim në vëmendje se, në hartimin e kriterit për të është përmbajtur përcaktimeve të LPP.

- **AK në lidhje me kërkesat mbi "kapacitetin teknik" dhe konkretisht pika 2.3.10 OE duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm.**

AK për vendosjen e këtij kriteri është referuar në VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që me rren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", i ndryshuar, ku parashikohet domosdoshmëria e mjekut, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

- **Në lidhje me kriterin e parashikuar në pikën 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij Inxhinier Elektronik Min. 1 (një).**



*Njësia e prokurimit për hartimin e këtij kriteri ka synuar që nisur nga natyrën e objektit, tipologjia e punimeve të ndryshme të cilët kërkojnë specialiste të kualifikuar që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike, apo pajisjet elektronike. Referuar edhe Rregulloreve të sigurimit dhe Shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe Instalimet elektrike elektronike si dhe Ligjit Nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike", i ndryshuar. Punonjësit e pajisur me dëshmi kualifikimi garantojnë autoritetin kontraktor se stafi është i kualifikuar dhe i trajnuar për të shmangur incidentet gjatë kryerjes së punimeve.*

*Nevoja për këtë staf në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit mbështetës sipas profilit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në kryerjen e punimeve dhe duke dale në ndihmë të drejtuesve teknik për secilin profil.*

#### **Qëndrim i grupit të KLSH-së:**

Në lidhje me argumentet e paraqitura nga subjekti mbi mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH për kriteret e paargumentuara, **qëndrojnë pjesërisht** duke u marrë në konsideratë dhe që nuk gjetje pasqyrim në këtë Projektraport Auditimi. Ndërsa në lidhje me disa nga kriteret e tjera për të cilat argumentet e paraqitura nuk argumentonin gjetjet e grupit të KLSH, mangësi të cilat janë dhënë në fazën e konstatimit të kriterit të panevojshëm **nuk qëndrojnë**, sqarime të cilat janë dhënë në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

#### **- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultojnë se vlerësimi i bërë nga KVO nuk është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si bashkimi i OE "BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO", nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST, konkretisht:

Nga shoqëritë "BRITANIA" shpk dhe "NDËRTIMI" shpk nuk plotësohet pika 2.3.8 e DST, mbi disponimin e kategorive të licensave, konkretisht:

Shoqëria "BRITANIA" shpk nuk plotëson kategoritë NP-2/C, NP-3/C, NP-12/A, NS-2/B, NS-3/A, NS-4/B, NS-9/B, NS-12/B, NS-13/B, NS-14/B dhe NS-18/A.

Shoqëria "NDËRTIMI" shpk nuk plotëson kategoritë NS-3/A, NS-4/B, NS-9/B, NS-12/B, NS-13/B dhe NS-18/A.

Nga bashkimi i OE nuk plotësohet kriteri mbi certifikatat ISO, konkretisht:

Shoqëria "BRITANIA" shpk, CEN/TR 1452-1:2009 nuk është e depozituar në sistemin e procedurës SPE.

Nga shoqëritë pjesëmarrëse si BOE., nuk plotësohet pika 2.3.4 e DST, që stafi teknik (drejtuesi teknik), nuk është angazhuar në kontrata të tjera, pasi megjithëse nga shoqëritë është deklaruar se stafi nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, konstatohet se ky staf është dhe në dy kontrata të tjera po me bashkinë Kamëz, konkretisht:

*Kontrata nr. 4049, datë 16.4.2021 me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Kamza e re me vlerë 66,659,236 lekë dhe afat 7 muaj nga fillimi i punimeve.*

Nga bashkimi i OE "COLOMBO" shpk, "NDËRTIMI" shpk dhe "BRITANIA" shpk, nuk plotësohet pika 2.3.12 mbi disponimin e makinerive, pasi të gjitha makineritë e deklaruara janë të angazhuara dhe në dy kontrata të tjera në Bashkinë Kamëz (**deklarim i rremë**), konkretisht:

*Kontrata nr. 4049, datë 16.4.2021 me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Kamza e re me vlerë 66,659,236 lekë dhe afat 7 muaj nga fillimi i punimeve.*

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam shoqëria "BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO" shpk, nuk është në kushtet për tu shpallur fitues, pasi ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe në plotësim të kriterëve të DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përgjithshme", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i

ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III, **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: Evis Gjika, Urada Elezi dhe Ramadan Hysa.**

Nga subjekti audituar Bashkia Kamëz nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projekt Raport Auditimit mbi kualifikimin në kundërshtim me kërkesat e DST.

#### 10- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion kopshti Kamza e Re”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion kopshti Kamza e Re”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr.3035, datë 24.3.2021	3. Njësia e Prokurimit Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	4. Komisioni VO nr. 3035/1, dt. 24.3.2021 Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	6. Oferta fituese (pa TVSh) “EURO-ALB” me vlerën e ofertës 29,987,757 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 183 lekë pa TVSh ose 0.60%.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 30,170,000 lekë REF-90988-03-24-2021	9. Burimi Financimit Buxheti shtetit.	10. Operatorë Ekonomike 3 OE, konkretisht: 1. OE “EURO-ALB” shpk 2. BOE “KUPA + LIQENI VII” shpk. 3. Shoqëria “SIRETA 2F” shpk. Me PV datë 26.4.2021 është bërë vlerësimi i ofertave <b>duke kualifikuar të tre OE.</b>
8. Data e hapjes së tenderit dt 6.4.2021	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. S;ka	13. Përgjigje KPP S’ka
11. Ankimime S’ka		
<b>b. Kontrata</b>		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4802, datë 10.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 29,987,757.lekë me afat 6 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me urdhrin e prokurimit nr. 3035, datë 24.3.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 30,170,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik”, ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3035/1, datë 24.3.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 6.4.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 24.3.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 3035, datë 24.3.2021, ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 6.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit, të cilat janë miratuar me PV nr. 1, datë 24.3.2021.

Pas vlerësimit të observacioneve në fazën e akt-konstatimeve, u konstatua se procedura është në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP dhe në plotësim të kërkesave të DST. Kështu si OE e skualifikuar dhe OE i shpallur fitues KVO ka bërë vlerësim të saktë të procedurës.

Gjithashtu dhe kriteret e aplikuar janë në përputhje me tipologjinë e procedurës dhe të dispozitave të LPP, shpjegime të cilat janë dhënë në fazën e Projektraport Auditimit.

**11- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i kopshtit Zall Mner’ , me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i kopshtit Zall Mner’ ”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.3973, datë 15.4.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjekrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 3973/1, dt. 15.4.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik,	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “Almo Konstruksion + Ulza Ndërtim” me vlerën e ofertës 70,900,000 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 500 lekë pa TVSh ose 0.7%.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 71,400,000 lekë REF-93242-04-15-2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 5 OE,</b> konkretisht: 1. BOE “ALMO Konstruksion + ULZA NDËRTIM” shpk 2. Shoqëria “SHTATOR 90” shpk 3. BOE “SIRETA 2F” shpk. 4. Shoqëria “DAJTI EKSPRES 2007” shpk 5. Shoqëria ‘COLOMBO’ shpk <b>Janë skualifikuar 2 OE, si më poshtë vijon:</b> 1. BOE “DAJTI EKSPRES 2007” shpk. 2. OE “SHTATOR 90” shpk. <b>Janë kualifikuar 3 OE, si më poshtë vijon:</b> 1. BOE “ALMO Konstruksion + Ulza Ndërtim” shpk 2. BOE “SIRETA 2F” shpk. 3. Shoqëria ‘COLOMBO’ shpk
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 26.4.2021 i # dt. 30.4.2021	<b>11. Ankimime</b> S’ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Nr. S:ka
	<b>13. Përgjigje KPP</b> S’ka	
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 6187. datë 14.6.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 70,900,000 lekë me afat 7 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Vendim të KM nr. 200, datë 25.3.2021 është miratuar fondi “Për rindërtimin dhe financimi e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kamëz”, me vlerë 292,810,000 lekë për objektin “Rikonstruksion i gjimnazit “Isa Boletini” dhe vlera 71,400,000 lekë për rikonstruksionin e kopshtit “Zall Her”.

Për vitin 2012 fondi i alokuar nga buxheti i shtetit do jetë në shumën 72,842,000 lekë.

Me Vendim të KB nr. 36, datë 31.3.2021 është bërë ndryshimi i buxhetit sipas VKB nr. 160, datë 23.12.2020.

Me urdhër prokurimin nr. 3973, datë 15.4.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 71,400,000 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020” me elektronik” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr 3973/1, datë 15.4.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 26.4.2021 i # dt. 30.4.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 15.4.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit *referuar urdhrin të prokurimit 3973, datë 15.4.2021* ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (*datë 26.4.2021 i # dt. 30.4.2021*), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendim i subjektit:**

- Në pikën 2.3.8 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, punime të përgjithshme ndërtimi: NP-2/C; NP-3/C; NP-12/A; NS-2/B; NS-3/A; NS-8/A; NS-9/A; NS-12/B; NS-13/B; NS-14/B; NS-18/A.

Në lidhje me kategoritë e licencës profesionale të shoqërisë, të kërkuara më pikën 2.3.8, të kapacitetit Teknik, A.K argumenton se kategoritë e kërkuara, janë vendosur sipas natyrës së punimeve që parashikohen të kryhen, për realizimin e objektit në fjalë, dhe A.K i është përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 5, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Në materialin e përgatitur nga NJHDT observacion ndaj aktkonstatimi nr. 19 janë specifikuar konkretisht zërat e punimeve të preventivit paraprak për të cilat janë të nevojshëm kategoritë e licencave të vendosura

Në tabelën e mëposhtme do të gjeni të detajuar pasqyrimin e çdo zëri të parashikuar në preventivin paraprak për të cilin nevojitet kategoria përkatëse e licencës.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-2/C	Ndërtime civile dhe industriale	I gjithë objekti	C	51 – 100 milion lekë Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NP-3/C	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	I gjithë objekti	C	51 – 100 milion lekë Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NP-12/A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Pika 9 Sistemime të jashtme dhe punime të ndryshme, specifkisht: An.1/9 “Shtresë humusi për mbjellje (t=10 cm)”; 3.643 “Mbjellje bari (Even Green)”; An 164 “F.V Fidane peme dekorative”;	A	0-20 milion lekë Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
		An 165 "F.V Fidane peme dekorative (të zonës)"		
NS-2/B	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Pika 10 Sistemi i furnizimit me ujë, furnizimi me ujë nga rrjeti; Pika B Paneli i shpërndarjes së kuzhinës; Pika 15 Mobilimi specifikisht 9.Tavoline ngrenie ne ambientin e kuzhines; 15. Kuzhie me banak dhe kanata (sipër /poshtë) me material MDF; 21 F.V Frigorifer; 22. F,V Lavastovilje; 23. F.V lavamane për kuzhinën; 24. F.V Aspirator; 25. F.V Njësi Gatimi (Furr + Pianur + mikrovale)	B	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-8/A	Ndërtim parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.	Pika 3 Betoni dhe beton armeja	A	0-20 milion lekë Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-9/A	Punime strukturore speciale	Pika 5. Punime Shtresash dhe pika 7, Punime terrace	A	0-20 milion lekë Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-12/B	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	Pika 13. Impianit i ngrohjes qendrore	B	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-13/B	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	Pika L Paisje Elektrike Pila L.-2 Lan and Telephone netëorë Pika M. Instalimet e sistemit CCTV	B	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-14/B	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	B. Paneli i shpërndarjes në kuzhine; Pika c. Paneli i shpërndarjes në kat; D Paneli i shpërndarjes së pompave; E.Kanalina metalike; F linja e kabllit te fuqisë s ëulët dhe ndriçimit; H. Rrjeti i rrymave të dobëta; I Sistemi i alarmit dhe mbrojtjes nga zjarri; J Sistemi i tokëzimit dhe rufepriësit; K. Instalimet e sistemit Televiziv; L. Pajisjet elektrike; L-4 Rrjeti Televiziv	B	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar
NS-18/A	Punime topogjeodezike	Piketimi, Kuotat e sistemimit, Kuotat e kanalizimit të ujrave të zeza, Pusetat etj	A	0-20 milion lekë Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar

Në pikën 2.3.4. të DST OE duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontratë pune të vlefshme me afat nëntor 2020-shkurt 2021.

-Drejtuës teknik inxhinier mekanik, 1 të punësuar

-Arkitekt, 1 të punësuar

-Teknik Ndërtimit

-Inxhinier me licencën "Eksperti privat zjarrfikës"

**A.K. argumenton se kërkesa, që ofertuesit të disponojnë inxhinierët e sipërcituar në rolin e drejtuesit teknik është përcaktuar referuar zërave të preventivit dhe rëndësisë së objektin duke qenë se kemi të bëjmë me objekt arsimor.**

**Inxhinier Mekanik** është përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve mekanike, ndjek cilësinë e materialeve mekanike (Sistemi ngrohës dhe ftohës , sistemi pompave,). Duke parë rëndësinë e objektit dhe duke qenë se punimet mekanike, instalimet mekanike, janë parashikuar në preventivin dhe projektin paraprak atëherë vendosja e kërkesës për inxhinier mekanik pjesë e stafit është i konsideruar e domosdoshëm. Konkretisht në preventivin paraprak është parashikuar pika 12. Punime të ngrohjes Qëndrore.

**Është kërkuar teknik ndërtimi** për të qenë në mbështetje të stafit dhe për të organizuar punën e punëtorëve në kantier

**Është kërkuar Inxhinier me licencën “Eksperti privat zjarrfikës”** pasi prania e ekspertëve në fjalë kërkohet për hartimin e projekteve dhe raporteve teknike mbi masat e marra për mbrojtjen kundra zjarrit. Gjithashtu në preventivin paraprak është parashikuar si zë **“Mbrojtja nga zjarri” në një vlerë të konsiderueshme prej 433,702 lekë pa TVSh.**

Lidhur me natyrën e veçantë të objektit, pasi kemi të bëjmë me një objekt arsimor, Prania e Inxhinier me licencën “Eksperti privat zjarrfikës” është konsideruar si në kërkesë e domosdoshme për mbarëvajtjen dhe realizimin me sukses të kontratës.

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuar **qëndrojnë dhe merren në konsideratë.**

**- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO nuk është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si bashkimi i OE “ALMO KONSTRUKSION + ULZA NDËRTIM”, nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST, konkretisht.

Nga shoqëria “ALMO KONSTRUKSION” shpk, nuk është plotësuar kriteri i punimeve të ngjashme, pasi punimet e paraqitura nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, ku janë kryesisht punime në rrugë dhe volumi i punimeve të zërave.

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam shoqëria “ALMO KONSTRUKSION + ULZA NDËRTIM” shpk, nuk është në kushtet për tu shpallur fitues, pasi ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe në plotësim të kriterëve të DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III, **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: Evis Gjika, Luan Dedaj dhe Ramadan Hysa.**

Nga subjekti audituar Bashkia Kamëz nuk janë paraqitur kundërshti ne fazën e Projekt Raport Auditimit mbi kualifikimin në kundërshtim me kërkesat e DST.

**12- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Riforcim i njërive të banimit në ndërtim Pallati, Bashkia Kamëz’, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Riforcim i njërive të banimit në ndërtim pallati, Bashkia Kamëz’”.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.3863, datë 13.4.2021	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Luan Marku	<b>4. Komisioni VO nr. 3863/1, dt. 13.4.2021</b> Elvis Gjika Luan Dedaj Ramadan Hysa
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b>		

"I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik,		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 223,232,381 lekë REF-92932-04-13-2021	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> "BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO" me vlerën e ofertës 223,019,964 lekë pa TVSh.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 213 lekë pa TVSh ose 0.09%.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> dt 26.4.2021	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti shtetit.	<b>10. Operatorë Ekonomike 4, OE, konkretisht:</b> 1. BOE "Britania + Ndërtimi + Colombo" shpk 2. OE "NDREGJONI" shpk. 3. OE "SIRETA 2F" shpk. 4. OE "VËLLEZËRIT HYSA" shpk. <b>Janë skualifikuar 2 OE, si më poshtë vijon:</b> 1. OE "SIRETA 2F" shpk. 2. OE "NDREGJONI" shpk <b>Janë kualifikuar 2 OE, si më poshtë vijon:</b> 1. BOE "Britania + Ndërtimi + Colombo" shpk 2. OE "Vëllëzërit HYSA" shpk.
<b>11. Ankimime</b> S'ka	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> Nr. S;ka	<b>13. Përgjigje KPP</b> S'ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 5994, datë 9.6.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 223,019,964.lekë me afat 12 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me urdhrin e prokurimit nr. 3863, datë 13.4.2021 nxjerrë nga Titullari i AK (me porosi nga NA z. Hasan Bara) është përcaktuar fondi limit 223,232,381 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "I kufizuar në kuadër të procesit të rindërtimit, sipas udhëzimit të APP nr. 1, datë 13.2.2020" me elektronik" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 3863/1, datë 13.4.2021, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 26.4.2021.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 13.4.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 3863, datë 13.4.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 26.4.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Nga vlerësimi i dokumentacionit mbi OE të skualifikuar, rezulton se skualifikimi është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE pjesmarrjes nuk plotësonin kriteret e DST të miratuara nga AK.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, konkretisht:

Në pikën 2.3.8 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; punime te përgjithshme ndërtimi NP – 3/E; NP-12/D; NS – 4/E; NS – 18/B .

Në pikën 2.3.3 të DST OE duhet të këtë staf të kualifikuar me inxhinier/specialistë me kontrate pune te vlefshme me afat nëntor 2020 – shkurt 2021. - **Artitekt, 1** të punësuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se kërkesat për inxhinierët e mësipërme nuk janë në përputhshmëri me tipologjinë e kontratës, pasi referuar zërave të preventivit që ato përfaqësojnë nuk ka punime që kërkon ekzistencën e këtyre inxhinierëve.

Kërkesa për 1 (një) Artitekt, është e paargumentuar, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri ose hartimi i projekti, por me zbatim punimesh (rikonstruksion). Gjithashtu ky kriter është ezauruar gjatë fazë së hartimit të preventivit.

2.3.11 OE ofertues duhet të këtë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçensë per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**Konstatimi:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara, duke mos u mbështetur në tipologjinë e procedurës dhe manualët teknike, çon në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë, ku ulja e numrit të OE pjesëmarrës çojnë në mos miradministrimin e fondit të prokuruar si rezultat i mungesës së konkurrencës nga mos pjesëmarrja ose skualifikimit nga mos plotësimi i kriterëve të aplikuar në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: Shpresa Gjokrosa, Skënder Selita dhe Luan Marku.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

**Pretendim i subjektit:**

- Nuk merren në konsideratë shpjegimet në lidhje me kriterin e parashikuar në pikën 2.3.8 të DST është kërkuar licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, N.P – 3E, N.P – 12.D, N.S – 4 E, N.S - 18B Vendosija e këtij kriteri nga ana e njësisë së prokurimit, për përcaktimin e kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me Standartet kombëtare ose evropiane..”, VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar”. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr. 10081 date 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën



dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

-Nuk merren në konsideratë shpjegimet në lidhje me kriterin e parashikuar në pikën 2.3.3, ndër të tjera, AK ka kërkuar ndër tjera, Arkitekt 1(nje). Në bazë të nenit të 46, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të objektit te prokurimit ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.3, kapaciteti teknik në DST.

- Nga AK në lidhje me kërkesat mbi "kapacitetin teknik" dhe konkretisht me punësimin e 1 (një) mjeku të përgjithshëm të punësuar që të rezultojë në listepagesën e shoqërisë....

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me këtë kriter specifik, për 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listepagesat e shoqërisë. Ju sqarojmë se për sa më lart Njësia e Prokurimit nëpërmjet këtij kriteri nuk ka pasur asnjëherë qëllim zvogëlimin e konkurrencës, por ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Për shkak të legjislacionit të bollshëm në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë dhe dinamikës së shpjegjetë të ndryshimeve të këtij legjislacioni mund të ketë ndodhur që nuk është referuar në kriteret e kualifikimit baza e duhur ligjore. Gjithsesi jemi të mendimit se kjo nuk e kufizon garën, pasi Operatorët Ekonomike janë në çdo rast të informuar. Gjithashtu Bashkia Kamëz ka qenë e hapur për sqarimin e çdo informacioni apo pretendimi nga palët, dhe nuk ka pasur asnjë pretendim në asnjë kohë.

**Qëndrim i grupit të KLSH:** Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuara nuk qëndrojnë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur argument shtesë nga ato të paraqitura në fazën e akt-konstatimit, për të cilën grupi i KLSH është shprehur në fazën e Projekt Raport Auditimit duke shpjeguar dhe arsyet e mos marrjes në konsideratë. **Procedura mbetet me probleme në aplikimin e kriterëve.**

#### **- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se vlerësimi i bërë nga KVO nuk është në përputhje me dispozitat e LPP, pasi si bashkimi i OE "BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO", nuk është në kushtet e plotësisht të të gjitha kriterëve të DST, konkretisht.

Nga shoqëritë pjesëmarrëse si BOE, nuk plotësohet pika 2.3.4 e DST, që stafi teknik (drejtuesi teknik), nuk është angazhuar në kontrata të tjera, pasi megjithëse nga shoqëritë është deklaruar se stafi nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, konstatohet se ky staf është dhe në dy kontrata të tjera po me bashkinë Kamëz, konkretisht:

Kontrata nr. 4049, datë 16.4.2021 me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Kamza e re me vlerë 66,659,236 lekë dhe afat 7 muaj nga fillimi i punimeve.

Kontrata nr. 4803, datë 10.5.2021 me objekt "Rindërtimi i çerdhes "Valias" ne zonën e re per zhvillim te detyruar, ne fshatin Valias" me vlerë 82,100,000 lekë dhe afat 7 muaj nga data e fillimit të punimeve.

Nga shoqëritë "BRITANIA" shpk dhe "NDËRTIMI" shpk nuk plotësohet pika 2.3.8 e DST, mbi disponimin e kategorie të licensave, konkretisht:

Shoqëria "BRITANIA" shpk nuk plotëson kategoritë NP-3/E, NP-12/D, NS-4/E dhe NS-18/B.

Shoqëria "NDËRTIMI" shpk nuk plotëson kategoritë NP-3/E, NP-12/D, NS-4/E.

Nga bashkimi i OE "COLOMBO" shpk, "NDËRTIMI" shpk dhe "BRITANIA" shpk, nuk plotësohet pika 2.3.12 mbi disponimin e makinerive, pasi të gjitha makineritë e deklaruara janë të angazhuara dhe në dy kontrata të tjera në Bashkinë Kamëz, konkretisht:

Kontrata nr. 4049, datë 16.4.2021 me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Kamza e re me vlerë 66,659,236 lekë dhe afat 7 muaj nga fillimi i punimeve.

Kontrata nr. 4803, datë 10.5.2021 me objekt "Rindërtimi i çerdhes "Valias" ne zonën e re per zhvillim te detyruar, ne fshatin Valias" me vlerë 82,100,000 lekë dhe afat 7 muaj nga data e fillimit të punimeve.

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam shoqëria "BRITANIA + NDËRTIMI + COLOMBO" shpk, nuk është në kushtet për tu shpallur fitues, pasi ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe në plotësim të kriterëve të DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit", si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kapitulli III, duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: Evis Gjika, Luan Dedaj dhe Ramadan Hysa.

Nga subjekti audituar Bashkia Kamëz nuk janë paraqitur kundërshti ne fazën e Projekt Raport Auditimit mbi kualifikimin në kundërshtim me kërkesat e DST.

**13- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Ndërtim rruga Havzi Nela, Paskuqan 1", me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Ndërtim rruga Havzi Nela, Paskuqan 1".		
1. Urdhër Prokurimi Nr.6560, datë 25.6.2021	3. Njësia e Prokurimit Shpresa Gjokrosa Skënder Selita Suella Vladi	4. Komisioni VO nr. 6560/1, dt. 25.6.2021 Elvis Gjika i # me shkresën nr. 7140, dt. 15.7.2021 Prel Gjonpalaj Luan Dedaj Ramadan Hysa
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapu" me elektronik,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,972,706 lekë REF-99257-06-25-2021	6. Oferta fituese (pa TVSh) "KRONOS KONSTRUKSION" ShPK me vlerën e ofertës 12,047,990 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 925 lekë pa TVSh ose 7.1 %.
8. Data e hapjes së tenderit dt 13.7.2021 i # 20.7.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 6 OE, konkretisht: 1. OE "NIKA" shpk me ofertë ekonomike 8,869,020 lekë pa TVSh 2. OE "AVDULI" shpk me ofertë ekonomike 9,845,800 leke pa TVSh 3. OE "KUPA" shpk me ofertë ekonomike 12,776,550 leke pa TVSh. 4. OE "ANTE GROUP" shpk me ofertë ekonomike 12,122,600 leke pa TVSh. 5. OE "Kronos Konstruksion" shpk me ofertë ekonomike 12,047,990 leke pa TVSh. 6. OE "RSM Company & Desaret COMPANY" shpk me ofertë ekonomike 9,718,760 leke pa TVSh. Janë skualifikuar 3 Ofertuesit e mëposhtëm: 1. BOE "RSM COMPANY" & "DESARET COMPANY"

		2.OE NIKA 3. OE AVDULI <b>Janë kualifikuar 3 OE të mëposhtëm:</b> 1. OE "KUPA" shpk. 2. OE "ANTE GROUP" shpk. 3.OE "KRONOS Konstruksion" shpk
<b>11. Ankimime</b> Nr. 8605, dt. 9.9.2021 nga OE "RSM Company & Desaret COMPANY"	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. 8605/3, dt. 10.9.2021	<b>13. Përgjigje KPP</b> Nr. 872/2021, dt. 01.11.2021
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 9675, datë 14.10.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 12,047,990.lekë me afat 36 ditë	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

*Nga auditimi i dokumentacionit të OE të skualifikuar, rezulton se KVO ka vepruar në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP, pasi OE e skualifikuar nuk plotësonin kriteret e DST, ku gjerësisht janë trajtuar në Projekt Raport Auditim.*

Me urdhrin e prokurimit nr. 6560, datë 25.6.2021 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 12,972,706 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit "E hapur" me mjete elektronike ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 6560/1, datë 25.6.2021, KVO dhe data e hapjes së tendrcit në datën 13.7.2021 i # 20.7.2021.

Me shkresën datë 14.7.2021, Kryetari i KVO z. Elviz Gjika ka kërkuar titullarit të AK largimin nga KVO, kjo referuar autorizimit nr. 6898, datë 7.7.2021 në të cilën është emëruar "Zyrtar i autorizuar" në procesin e prokurimeve.

Me urdhër nr. 7140, datë 15.7.2021 të titullarit të AK është bërë zëvendësimi i z. Elvis Gjika me z. Prel Gjonpalaj

Nga NjP është mbajtur PV nr. 3, datë 25.6.2021 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 6560, datë 25.6.2021 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 13.7.2021 i # 20.7.2021), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Me PV datë 9.7.2022, NJP në referencë të sugjerimeve të APP mbi kriteret e aplikuar ka bërë ndryshimin e disa prej kriterëve të rekomanduara, kryesisht për kategoritë e licensave, numrin e inxhinierëve, certifikatat ISO, etj.

**- Vlerësimi i kriterëve:**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z/znj. Shpresa Gjokrosa, Suela Vladi, Luan Marku, Skënder Selita, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

**1. Kategori NP-11/A përfshin (Ndërtim për N/Stacion, kabina e transformuar, lina e TM dhe shpërndarja e energjisë). Është konsideruar si një licencë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi në preventivin e punimeve janë parashikuar punime për ndriçimin të përfshira tek shuma III nga zëri nr. 1 deri tek zëri nr.13, për të cilat është e domosdoshme, që operatori ekonomik të jetë i licencuar për kategorinë NP 11/A**

**2. Kategori NS-8/A përfshin (Prodhim parafabrikat, me beton të armuar, struktura metalike dhe druri).**

Është konsideruar si një licencë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune të kategorisë **punime strukturore special (elementë betoni), struktura monolite betoni c 20/25 tek shuma nr.1, zëri nr. 3, sipas analizës nr. 3.244, të cilat shtrajnë të nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licencuar për kategorinë NS-8.** Nga ana tjetër Agjencia e Prokurimit Publik pas kontrollit të kriterëve nuk ka lënë rekomandim për rishikim të Licencave NP-11/A dhe NS-8/A pasi kategoritë e kërkuara janë bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të parashikuara në preventiv.

**Qëndrim i grupit të KLSH:**

Në argumentet e paraqitura nga subjekti në lidhje me konstatimet e grupit të KLSH mbi kriteret e aplikuara qëndrojnë **dhe merren në konsideratë argumentet e paraqitura.**

Bashkimi i OE "RSM COMPANY & DESARET COMPANY" shpk, ka paraqitur ankesë për vendimin e KVO mbi vlerësimin e ofertave sipas formularit të ankesës me nr. 8605, datë 09.09.2021.

Bashkimi i OE "RSM COMPANY & DESARET COMPANY" shpk, është tërhequr nga ankesa me shkresën protokolluar me nr.8657 date 10.09.2021.

Ne baze të vendimit të KSHA nr. 423 date 10.09.2021, Njoftimi i Fituesit për këtë procedurë prokurimi, është hedhur pas përfundimit të afateve të ankimit të parashikuar në LPP.

OE fitues i radhës "**AVDULI**" shpk, nuk u paraqit për të dorëzuar sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar dhe për këtë arsye u njoftua ofertuesi vijues në klasifikimin përfundimtar i cili është shoqëria "**KRONOS KONSTRUKSION**" shpk.

Me urdhër nr. 8605/1, datë 9.9.2021, Titullari i AK (në mungesë dhe porosi z. Elvis Gjika) është urdhëruar pezullimin e procedurës.

Me urdhër nr. 8605/2, datë 9.9.2021, titullari i AK (në mungesë dhe porosi z. Elvis Gjika), është ngritur KSHA me vetëm një anëtare, **konkretisht z. Luan Marku.**

Me shkresën nr. 8605/3, datë 10.9.2021, z. Luan Marku në cilësinë e anëtarit të KSHA ka bërë më dije z. Elvis Gjika në cilësinë e personit përgjegjës të ndjekjes së procedurës, se në zbatimin të shkresës nr. 39, datë 9.9.2021 (prot Bashkia Kamëz nr. 8657, datë 10.9.2021) të BOE "Rrugë Sinjalistikën Mirëmbajtje & Hidro Company + Desart Company" shpk, **ku kërkon tërheqjen nga ankesa e bërë.**

Në respektim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2021 "Për Prokurimin Publik" me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", është rekomanduar pezullimi i shqyrtimit të ankesës, heqjen e pezullimit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të procedurës me objekt "Ndërtim rruga Havzi Nela, Paskuqan 1".

Me vendim nr. 453, datë 10.9.2021, AK Bashkia Kamëz ka urdhëruar heqjen nga pezullimi dhe vijimin e procedurës.

Më shkresën nr. 8714, datë 13.9.2021 AK Bashkia Kamëz, njoftim KPP vendimin e AK nr. 453, datë 10.9.2021 në lidhje me shqyrtimin e ankesës së shoqërisë "RSM Company & Desaret COMPANY" shpk, e cila nuk është marrë në shqyrtim pasi me shkresën e sajë nr. 39, datë 9.9.2021 (prot bashkia Kamëz nr. 8657, datë 10.9.2021), është tërhequr nga ankesa.

Midis shoqërisë “**KRONOS KONSTRUKSION**” shpk dhe AK është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 9675, datë 14.10.2021 për “*Ndërtim rruga Havzi Nela, Paskuqan I*” me vlerën 12,047,990 lekë me TVSh. me afat punimesh 36 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

**Titulli i gjetjes 4: Mos konfiskimin e sigurimit të ofertës.**

**Situata:**

Sipas PV vlerësimit të hartuar nga KVO, thuhet se OE “AVDULI” shpk me ofertë ekonomike 9,845,800 leke pa TVSh është përjashtuar pasi nuk është respektuar afati 5 ditor për paraqitjen e dokumentacionit.

Me shkresën nr. 9635, datë 14.10.2021 Bashkia Kamëz i është drejtuar shoqërisë “ATLANTIK” sha për konfiskimin e sigurimit të ofertës me vlerë 259,000 lekë.

**Kriteri:**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Nga verifikimi i të dhënave në Drejtorinë Ekonomike, konstatohet se ky konfiskim nuk është zbatuar, **veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë për shumën 259,000 lekë për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z. Elvis Gjika për mos ndjekje të procedurës.**

**Shkaku:**

Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për bllokimin e llogarisë dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës në shumën **259,000 lekë** nga shoqëria “ATLANTIK” shpk.

**- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, konstatohet se shoqëria “KRONOS KONSTRUKSION” shpk e shpallur fitues **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave të LPP**, pasi nga kjo shoqëri nuk janë plotësuar disa nga kriteret sipas DST, *konkretisht:*

a- Nga AK bashkia Kamëz nuk është kërkuar me shkresë që shoqëria “KRONOS KONSTRUKSION” të paraqes me inventarë të rregullt dokumentacionin ligjorë sipas kërkesave të DST në mbështetje të të dhënave sipas formularit të vetdeklarimit (shtojca 8) dhe me inventarë të rregullt, veprime në kundërshti me neni 26 pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021.

b- Në formularin e vetdeklarimit **nga shoqëria nuk është deklaruar 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”,** e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

c- Nuk plotësohet disa nga mjetet që janë kërkuar në pikën 2.3.7 të DST, konkretisht:

- Sipas vetëdeklarimit është deklaruar 2 copë mineskavator, ku sipas vetdeklarimit thuhet me faturë, por pa nr/datë, **si dhe që nuk ka dokumentacion bashkëlidhur të paraqitur nga subjekti, kjo sipas dokumenteve të paraqitura në dosje.**

- Nuk paraqet me dokumentacion Autobitumatriçe copë një, ku sipas vetdeklarimit thuhet me datë nr. 24, datë 30.12.2016, **si dhe që nuk ka dokumentacion bashkëlidhur të paraqitur nga subjekti, kjo sipas dokumenteve të paraqitura në dosje..**

Autoboti i ujit me targë TR3527U në pronësi të shoqërisë, nga verifikimi i dokumentacioni, rezulton se dokumentat nuk janë në afatin e kërkuar, pasi si TAX e kolaudimit

nga datën 15.5.2021 dhe SGS mban datën 25.5.2021 si afat përfundimi, ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 9.7.2021. **Për të njëjtën mangësi KVO ka skualifikuar shoqërinë “RSM COMPANY” & “DESARET COMPANY ” shpk me ofertë më të leverdishme.**

- Mjeti autovinç me targë AA219JS, ku sipas vetëdeklarim është në pronësi të shoqërisë, nga auditimi i dosjes rezulton se **nuk ka dokumentacion bashkëlidhur të paraqitur nga subjekti, kjo sipas dokumenteve të paraqitura në dosje.**

d- Nga verifikimi i mjeteve që shoqëria ka në inventarin e pasqyrave financiare të paraqitura, rezulton se disa nga mjetet të cilat shoqëria i deklaroi si të vetat, nuk rezulton në inventar të, gjë e cila tregon se deklarimi i bërë është i rremë, konkretisht në inventarin e bilancit nuk disponohet mjetet si: minieskavator copë 2, Autobitumatriçe copë 1, autovinç copë 1.

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuam shoqëria “**KRONOS Konstruksion**” shpk, nuk është në kushtet për tu shpallur fitues, pasi ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe në plotësim të kriterëve të DST, në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Amulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III, **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: Luan Dedaj dhe Ramadan Hysa.**

Nga subjekti audituar Bashkia Kamëz nuk janë paraqitur kundërshtit në fazën e Projekt Raport Auditimit mbi kualifikimin në kundërshtim me kërkesat e DST.

#### **2.4.4. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.**

Nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 01.01.2021 – 31.12.2021, rezulton se janë realizuar **18** procedura në investime për punë publike me Fond Limit në vlerën **1,835,280 mijë lekë pa TVSH** dhe vlerë kontrate **1,772,173 mijë lekë pa TVSH**. Diferenca e FL me vlerën e kontratave është **63,106 mijë lekë pa TVSH**, respektivisht:

Nga analiza e bërë, u arsyetua që si objekte/kontrata me risk në realizimin e punimeve të ndërtimit, të cilat janë kërkuar për t’u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës më të lartë të kontratës, llojit të objekteve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të lartë në zbatimin e veprave ndërtimore, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelë.

Nga objektet e prokuruar, u konsideruan si objekte me risk dhe u planifikuan për t’u audituar nga grupi i auditimit investimet/shërbimet si vijon:

Për periudhën e auditimit, u planifikuan për tu audituar **6** kontrata për punë publike, në vlerën **566,291 mijë lekë pa TVSH** ose 32% e vlerës së kontratave të lidhura.

Nga Auditimi kanë rezultuar mangësi trajtuar si vijon:

#### **1. “Rikonstruksion i shkollës “Kamza e re””, Bashkia Kamëz.**

##### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me nr. 2738/2021, me nr. 4049 prot., datë 16.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz, të përfaqësuar nga zv. Kryetari z. Hasan Bara dhe BOE “Britania” SHPK, me përfaqësues ligjor z. Shkëlqim Aliaj, me licencë profesionale NZ 6671/4 & “Colombo” SHPK, me përfaqësues ligjor znj. Diana Laba, me licencë profesionale NZ. 0021/13 & “Ndërtimi” SHPK, me përfaqësues ligjor z. Luan Bali, me licencë profesionale NZ 0823/15. Vlera e kontratës është 66,659,235 lekë pa TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5 muaj dhe një muaj për detajimin e dosjes së projektzbatimit, nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6232, datë 15.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “Land & Co”, me përfaqësues z. Përparim Ndoj, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1830/5 & “Dricons” ShPK dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 878,090 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1680 prot., datë 24.02.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “MCE” SHPK, me administrator z. Emil Nova, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/6 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 87,825 lekë me TVSh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 04.03.2022.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit nga Bashkia Kamëz me datë 08.03.2022, e hartuar nga grupi i punës, me përbërje ing. Miranda Kumrija, ing. Hajredin Murgu dhe ing. Ramadan Hysa.

#### Projektpreventivi

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se është dhënë leje ndërtimi me Vendimi nr. 8, datë 16.06.2021 i Këshillit Teknik të Bashkisë Kamëz.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 18.06.2021 dhe kanë përfunduar me datë 18.11.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Është bërë pezullimi i punimeve me procesverbalin e datës 23.08.2021, për shkak të moslirimit të ambienteve të kopshtit nga baza materiale, si dhe nga mospostimi i sahatit elektrik nga OSHEE. Sipas procesverbalit të administruar në dosje, kanë rifilluar punimet në datën 23.12.2021. Ky proces është materializuar me Amendamentin nr. 2, datë 23.12.2021, sipas të cilit janë shtyrë punimet me 123 ditë.

-Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve nr. 36 prot., datë 01.04.2022, sipërmarrësi i punimeve “Britania” SHPK & “Colombo” SHPK & “Ndërtimi” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Zenit & Co” SHPK dhe titullari i Bashkisë Kamëz, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 189,978 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 189,978 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës “Kamza e re””, Bashkia Kamëz</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 4049 prot., datë 16.04.2021	<b>15. Vlera e kontratës (pa TVSh)</b> 66,659,236 lekë <b>BOE fitues “Britania” SHPK &amp; “Colombo” SHPK &amp; “Ndërtimi” SHPK</b>	<b>16. Likuiduar deri</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar dt</b> <b>12.04.2022</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 1+5 muaj, Zbatuar 340 ditë.	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka

-Vlera pa TVSh 66,659,236 lekë	Fillimi punimeve: 25.06.2021 Përfundimi punimeve : 11.04.2022			
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "Land & Co" ShPK & "Dricons" ShPK	Licenca Nr: MK 1208/14	Kontrata nr. 6232, datë 15.06.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE "MCE" SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata nr. 1680 prot., datë 24.02.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 04.03.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim dt 08.03.2022		24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **437,741 lekë pa TVSh**.

**Titulli gjetjes 1:** *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i shkollës "Kamza e re"', Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve BOE "Britania" SHPK & "Colombo" SHPK & "Ndërtimi" SHPK, për zërat e punimeve A-5.1, A-8.6 dhe C-1.8*

#### **Situata:**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Termoizolim me polisterol + grafiato+skela", "Kornizë alumini për dritaret, e lyster me bojë" dhe "FV hekur betoni", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

#### **Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4049 prot., datë 16.04.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6232, datë 15.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1680 prot., datë 24.02.2022.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kamëz.

#### **Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

#### **Rëndësia: E mesme**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **437,741 lekë pa TVSh** nga BOE "Britania" & "Colombo" & "Ndërtimi" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4049 prot., datë 16.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:



1. Z. Përparim Ndoj me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Petrit Muja me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni.

## **2. “Rikonstrukcion i kopshtit “Zall Mner”, Bashkia Kamëz.**

### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me nr. 5204/2021, me nr. 6137 prot., datë 14.06.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz, të përfaqësuar nga zv. Kryetari z. Hasan Bara dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Almo Konstruksion” SHPK, me përfaqësues ligjor z. Alfons Bitri, me licencë profesionale NZ 2306/16 & “Ulza”, me përfaqësues ligjor z. Nikolin Shpani, me licencë profesionale NZ 1718/15. Vlera e kontratës është 70,900,000 lekë pa TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Është mbajtur Amendamenti nr.1, datë 28.01.2022 sipas të cilit është bërë shtyrja e kontratës me 28 ditë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6718, datë 30.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “HMK Consulting” SHPK, me përfaqësues z. Gëzim Pajo, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2720/6 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 632,747 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1819 prot., datë 01.03.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “Land & Co” SHPK, me administrator z. Përparim Ndoj, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1830/5 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 76,735 lekë me TVSh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 01.03.2022.

### **Projektpreventivi**

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se është dhënë leje ndërtimi me Vendimin nr. 14, datë 03.09.2021 i Këshillit Teknik të Bashkisë Kamëz.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “Erald-G” SHPK.

### **Zbatimi i punimeve**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.09.2021 dhe kanë përfunduar me datë 28.02.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Me shkresën pa nr prot, datë 23.11.2021 të mbikëqyrësit të punimeve, është kërkuar shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve, për shkak të motit të keq gjatë 12 ditëve brenda afatit të kryerjes së punimeve.

Me shkresën nr. 285 prot, datë 03.12.2021 është mbajtur procesverbali për pezullimin e punimeve, për shkak të temperaturave të ulta, i nënshkruar edhe nga titullari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli.

Me shkresën nr. 318 prot, datë 28.01.2022 është mbajtur procesverbali për rifillimin e punimeve. Pas këtyre shkresave, është hartuar Amendamenti nr. 1 me nr. 6137/1 prot, datë 28.01.2022, sipas të cilit është bërë shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 28 ditë pune gjithsej.

-Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve nr. extra prot., datë 14.02.2022, me procesverbalin datë 18.02.2022 sipërmarrësi i punimeve “Almo Konstruksion” SHPK & “Ulza” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “HMK Consulting” Shpk dhe titullari i Bashkisë Kamëz, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar nga AK, me punime që shtohen prej 9,780,389 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 8,075,511 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i kopshtit “Zall Mner””, Bashkia Kamëz			
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 6137 prot., datë 14.06.2021	<b>15. Vlera e kontratës (pa TVSh)</b> 70,900,000 lekë <b>BOE fitues “Almo Konstruksion” SHPK &amp; “Ulza” SHPK</b>		<b>16. Likuiduar deri dt</b>
<b>17. Situacioni Përfundimtar dt</b> <b>12.04.2022</b> -Vlera pa TVSh 70,900,000 lekë	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 170 ditë. Fillimi punimeve: 09.09.2021 Përfundimi punimeve : 28.02.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendamenti nr. 1 me nr. 6137/1 prot, datë 28.01.2022, shtyrje 28 ditë pune
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “HMK Consulting” SHPK	Licenca Nr: MK 2720/6	Kontrata nr. 6718, datë 30.06.2021	Likuiduar lekë
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “Land & Co” SHPK	Licenca Nr: MK 1830/5	Kontrata nr. 1819 prot., datë 01.03.2022	Pa likuiduar (.....lekë)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 01.03.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> Nuk ka		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **338,752 lekë pa TVSh.**

**Titulli gjetjes 2:** *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i kopshtit “Zall Mner”, Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve BOE “Almo Konstruksion” SHPK & “Ulza” SHPK, për zërat e punimeve 3.2, 6.2 dhe 9.18.*

**Situata:**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Pllakë themeli, tratë e bazamente (shkallë metalike + rampë)”, “Suva brenda mur tulle h ~ 4 m” dhe “Mure betoni C 12/15 (t=20 cm)”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6137 prot., datë 14.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6718, datë 30.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1819 prot., datë 01.03.2022.

**Ndikimi/Efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **338,752 lekë** pa TVSh nga BOE **“Almo Konstruksion” & “Ulza” SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6137 prot., datë 14.06.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Gëzim Pajo *me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;*
2. Z. Përparim Ndoj *me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni mbi gjetjen nga KLSH-ja.

### **3. “Rikonstruksion i kopshtit “Kamza e re””, Bashkia Kamëz.**

#### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me nr. 4124/2021, me nr. 4802 prot., datë 10.05.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz, të përfaqësuar nga zv. Kryetari z. Hasan Bara dhe OE “Euro - Alb” SHPK, me përfaqësues ligjor z. Bujar Murati, me licencë profesionale NZ 3279/17. Vlera e kontratës është 29,987,757 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5 muaj dhe një muaj për detajimin e dosjes së projektzbatimi, nga data e lidhjes së kontratës. Është mbajtur Amendamenti nr.1, datë 25.06.2021 sipas të cilit është bërë shtyrja e kontratës me 37 ditë kalendarike, për shkak të lidhjes me vonesë të kontratës me mbikëqyrësin e punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6230, datë 15.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Zenit & Co”, me përfaqësues z. Arqile Peri, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1208/14 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 401,140 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1937 prot., datë 04.03.2022 (nuk administrohet në dosjen teknike, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “Novatech Studio” SHPK, me administrator z. Emil Nova, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 15.04.2022.

#### **Projektpreventivi**

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se është dhënë leje ndërtimi” me Vendimin nr. 11, datë 25.06.2021 të Këshillit Teknik të Bashkisë Kamëz.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “InfraTech” SHPK.

#### **Zbatimi i punimeve**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 25.06.2021 dhe kanë përfunduar me datë 11.04.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë dy amendamentet.

Është bërë pezullimi i punimeve me procesverbalin e datës 23.08.2021, për shkak të moslirimit të ambienteve të kopshtit nga baza materiale, si dhe nga mospostimi i sahatit elektrik nga OSHEE. Sipas procesverbalit të administruar në dosje, kanë rifilluar punimet në datën 23.12.2021. Ky proces është materializuar me Amendamentin nr. 2, datë 23.12.2021, sipas të cilit janë shtyrë punimet me 123 ditë.

-Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve nr. 36 prot., datë 01.04.2022, sipërmarrësi i punimeve “Euro-Alb” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Zenit & Co” SHPK dhe titullari i

Bashkisë Kamëz, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 189,978 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 189,978 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i kopshtit “Kamza e Re””, Bashkia Kamëz</b>				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 4802 prot., datë 10.05.2021	<b>15. Vlera e kontratës (pa TVSh)</b> 29,987,757 lekë <b>OE fitues “Euro-Alb” SHPK</b>		<b>16. Likuiduar deri</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera pa TVSh 29,987,757 lekë	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 1+5 muaj, Zbatuar 340 ditë. Fillimi punimeve: 25.06.2021 Përfundimi punimeve : 11.04.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> -Amendament nr.1, dt 25.06.2021, shtyrje 37 ditë. - Amendamentin nr. 2, dt 23.12.2021, shtyrje 123 ditë	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “Zenit & Co” SHPK	Licenca Nr: MK 1208/14	Kontrata nr. 6230, datë 15.06.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “Novatech Studio” SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata nr. 1937 prot., datë 04.03.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 15.04.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> Nuk ka		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **273,821 lekë pa TVSh.**

**Titulli gjetjes 3:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i kopshtit “Kamza e Re””, Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve OE “Euro Alb” SHPK, për zërat e punimeve A.3.2+4, A.5.1 dhe B.9.1.

**Situata:**

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i kopshtit “Kamza e Re””, Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve OE “Euro Alb” SHPK, për zërat e punimeve A.3.2+4, A.5.1 dhe B.9.1.

**Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4802 prot., datë 10.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6230, datë 15.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1936 prot., datë 04.03.2022.

**Ndikimi/Efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **273,821 lekë pa TVSh** nga OE “Euro-Alb” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4802 prot., datë 10.05.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Arqile Pcri me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Emil Nova me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni mbi gjetjen nga KLSH-ja.

**4. “Rikonstrukcion i shkollës së mesme “Ibrahim Rugova””, Bashkia Kamëz.**

**Kontratrat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me nr. 2743/2021, me nr. 4054 prot., datë 19.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz, të përfaqësuar nga zv. Kryetari z. Hasan Bara dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Egeu Stone” SHPK & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B”, me përfaqësues ligjorë respektivish z. Gazim Bregu, me licencë profesionale NZ 7327/2, Shkëlqim Dulla me licencë profesionale NZ 6804 dhe Bashkim Dulla me licencë profesionale NZ 5433/16. Vlera e kontratës është 213,377,475 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 9 muaj dhe një muaj për detajimin e dosjes së projektzbatimi, nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6231, datë 15.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Novatech Studio” SHPK, me përfaqësues z. Emil Nova, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,683,077 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1728 prot., datë 25.02.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Zenit & Co” SHPK, me administrator z. Arqile Peri, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1208/14 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 168,361 lekë me TVSh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 06.03.2022.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit nga Bashkia Kamëz me datë 08.03.2022, e hartuar nga grupi i punës, i ngritur me Urdhrin nr. 331, datë 08.03.2022, me përbërje ing. Eglantina Disha, ing. Hajredin Murgu dhe ing. Ramadan Hysa.

**Projektpreventivi**

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se është dhënë leje ndërtimi me Vendimin nr. 5, datë 16.06.2021 të Këshillit Teknik të Bashkisë Kamëz.
- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “Infratech” SHPK.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 18.06.2021 dhe kanë përfunduar me datë 04.02.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

-Me procesverbalin datë 29.09.2021 sipërmarrësi i punimeve “Egeu Stone” SHPK & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve shoqërisë “Novatech Studio” Shpk dhe titullari i Bashkisë Kamëz, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar nga AK, me punime që shtohen prej 3,452,241 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 7,312,287 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi në terren, rezulton se zërat e punës “Shtresë tartani fusha sportive dhe pista e hedhjes” dhe “Ulluk shkarkimi vertikal me bakër me D=120 mm”, nuk janë realizuar sipas emërtimit në preventiv. Në dosjen teknike nuk administrohet asnjë dokument për trajtimin e zërave të realizuar si zëra të rinj pune, për të cilat duhet të ishte bërë negociimi i çmimit. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori, sipërmarrësi dhe grupi i marrjes në dorëzim të objektit.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Ibrahim Rugova””, Bashkia Kamëz</b>				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 4054 prot., datë 19.04.2021	<b>15. Vlera e kontratës (pa TVSh)</b> 177,814,562 lekë <b>BOE fitues “Egeu Stone” SHPK &amp; “Pesë Vëllezërit” &amp; “Boshnjaku B” SHPK</b>		<b>16. Likuiduar deri dt</b>	
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> <b>Vlera pa TVSh 173,954,516 lekë</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 1+9 muaj, Zbatuar 218 ditë. Fillimi punimeve: 18.06.2021 Përfundimi punimeve : 04.02.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “Novatech Studio” SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata nr. 6231, datë 15.06.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “Zenit & Co” SHPK	Licenca Nr: MK 1208/14	Kontrata nr. 1728 prot., datë 25.02.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 06.03.2022	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim dt 08.03.2022</b>		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **479,700 lekë pa TVSh.**

**Titulli gjetjes 4:** *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Ibrahim Rugova””, Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve BOE “Egeu Stone” SHPK & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK, për zërin e punimeve IX.8.*

### Situata:

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës “Rrethim fushe me rrjet gabioni dhe koloncina metalike”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4054 prot., datë 19.04.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6231, datë 15.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1728 prot., datë 25.02.2022.

**Ndikimi/Efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **479,700 lekë pa TVSh** nga BOE “Egeu Stone” & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4054 prot., datë 19.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Emil Nova, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Arqile Peri, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni mbi gjetjen nga KLSH-ja

**5. “Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu”, Bashkia Kamëz.**

**Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me nr. 2625/1/2021, me nr. 3440 prot., datë 01.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz, të përfaqësuar nga zv. Kryetari z. Hasan Bara dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Kupa” SHPK, me përfaqësues ligjor z. Qamil Kupa, me licencë profesionale NZ 4901/15 & “Liqeni VII”, me përfaqësues ligjor zj. Resilda Kalia. Vlera e kontratës është 57,121,120 lekë pa TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 9 muaj dhe një muaj për detajimin e dosjes së projektzbatimi, nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6236, datë 16.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “Hydro-Eng Consulting” SHPK & “Invictus” ShPK & “BN Project”, me përfaqësues z. Evis Qyrku, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3730 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 662,250 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1936 prot., datë 04.03.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “Novatech Studio” SHPK, me administrator z. Emil Nova, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të

kontratës së shërbimit 66,226 lekë me TVSh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 15.04.2022.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit nga Bashkia Kamëz me datë 08.03.2022, e hartuar nga grupi i punës, i ngritur me Urdhrin nr. 331, datë 08.03.2022, me përbërje ing. Eglantina Disha, ing. Hajredin Murgu dhe ing. Ramadan Hysa.

#### Projektpreventivi

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se si “leje ndërtimi” për këtë objekt, është konsideruar Vendimin nr. 12, datë 12.07.2021 të Këshillit Teknik të Bashkisë Kamëz. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 29 “Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë”, sipas të cilit “Kryetari i bashkisë është përgjegjës për: a) vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë”.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “NET Group” SHPK.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 12.07.2021 dhe kanë përfunduar me datë 12.04.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

-Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve nr. 10 prot., datë 03.03.2022, me procesverbalin datë 10.03.2022 sipërmarrësi i punimeve “Kupa” SHPK & “Liqeni VII” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Hydro-Eng Consulting” SHPK & “Invictus” ShPK & “BN Project” Shpk dhe titullari i Bashkisë Kamëz, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar nga AK, me punime që shtohen prej 264,684 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 264,684 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu””, Bashkia Kamëz				
14. Lidhja e kontratës Nr. 3440 prot., datë 01.04.2021	15. Vlera e kontratës (pa TVSh) 57,121,120 lekë OE fitues “Kupa” SHPK & “Liqeni VII” SHPK		16. Likuiduar deri	
17. Situacioni Përfundimtar -Vlera pa TVSh 57,121,020 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 1+9 muaj, Zbatuar 270 ditë. Fillimi punimeve: 12.07.2021 Përfundimi punimeve : 12.04.2022		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “Hydro-Eng Consulting” SHPK & “Invictus” ShPK & “BN Project” SHPK	Licenca Nr: MK 3730	Kontrata nr. 6236, datë 16.06.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE “Novatech Studio” SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata nr. 1936 prot., datë 04.03.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 15.04.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim Nuk ka		24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	



Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **192,914 lekë pa TVSh**.

**Titulli gjetjes 5:** *Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin "Rikonstruksion i kopshtit "Ahmet Zogu"", Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve BOE "Kupa" SHPK & "Liqeni VII" SHPK, për zërat e punimeve A.7, B.2.2 dhe C.6.*

**Situata:**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Prishje suvatimi ckzistues", "Shtresë lustër çimento 1:2", "FV kabull 4/50" dhe "Bordura trotuari 20x35 cm të parapërgatitura", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3440 prot., datë 01.04.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6231, datë 15.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1936 prot., datë 04.03.2022.

**Ndikimi/Efekti:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa, të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën **192,914 lekë** pa TVSh nga BOE "Kupa" SHPK & "Liqeni VII" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 prot datë 12.05.2021 me objekt "Rikonstruksion i kopshtit "Ahmet Zogu"", *Bashkia Kamëz*, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Evis Qyrku me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Emil Nova me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni mbi gjetjen nga KLSH-ja.

**6. "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Ahmet Zogu"", Bashkia Kamëz.**  
**Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me nr. 2745/2021, me nr. 3963 prot., datë 15.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz, të përfaqësuar nga zv. Kryetari z. Hasan Bara dhe OE “4 AM” SHPK, me përfaqësues ligjor z. Ardit Metaliaj, me licencë profesionale NZ 9546/15. Vlera e kontratës është 195,970,320 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5.5 muaj dhe një muaj për detajimin e dosjes së projektzbatimi, nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6317, datë 18.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Net Group” SHPK, me përfaqësues z. Valter Begaj, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3101/10 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,557,334 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1729 prot., datë 25.02.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “LEAD Consulting” SHPK, me administrator z. Ardit Kane, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3336/1 & “Arabel Studio” SHPK, me administrator znj. Ana Nishku, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2692/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 155,735 lekë me TVSh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 25.03.2022.

#### Projektpreventivi

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se si “leje ndërtimi” për këtë objekt, është konsideruar Vendimi nr. 6, datë 16.06.2021 i Këshillit Teknik të Bashkisë Kamëz. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 29 “Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë”, sipas të cilit “Kryetari i bashkisë është përgjegjës për: a) vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë”.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga JV “4 A-M” SHPK & “Arkonstudio” SHPK.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 18.06.2021 dhe kanë përfunduar me datë 02.12.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

-Me procesverbalin datë 12.10.2021 sipërmarrësi i punimeve “4 AM” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve shoqërisë “NET Group” Shpk dhe titullari i Bashkisë Kamëz, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për rishikimin e volumeve të punimeve”, i cili është miratuar nga AK, me punime që shtohen dhe punime që pakësohen në vlerë 8,469,796 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi në terren, rezulton se zëri i punës “Shtresë parketi laminat”, i cili është kryer në palestrën e shkollës në sasinë 398 m<sup>2</sup>, ka pësuar difekt në pjesën anësore të palestrës, në një gjatësi prej rreth 6 ml. Gjthashtu janë vënë re edhe probleme lagështie në korridorin dhe dhomat e zhveshjes në pjesën lidhëse të shkollës me palestrën. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi sipërmarrësi i punimeve, i cili duhet të bëjë riparimin e defekteve brenda periudhës së garancisë së defekteve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Ahmet Zogu””, Bashkia Kamëz		
14.Lidhja e kontratës Nr. 3963 prot., datë 15.04.2021	15.Vlera e kontratës (pa TVSh) 163,308,600 lekë OE fitues “4 AM” SHPK	16.Likuiduar deri

<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera pa TVSh 163,308,600 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 1+5.5 muaj, Zbatuar 165 ditë. Fillimi punimeve: 18.06.2021 Përfundimi punimeve : 02.12.2021		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE "NET Group" SHPK	Licenca Nr: MK 3101/10	Kontrata nr. 6317, datë 18.06.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> BOE "LEAD Consulting" SHPK & "Arabel Studio" SHPK" SHPK	Licenca Nr: MK 3336/1 MK. 2692/3	Kontrata nr. 1729 prot., datë 25.02.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 25.03.2022	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Nuk ka		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **185,843 lekë pa TVSh**.

**Titulli gjetjes 6:** *Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Ahmet Zogu"', Bashkia Kamëz, nga zbatuesi i punimeve OE "4 A-M" SHPK, për zërat e punimeve A.4.6 dhe A.6.7.*

**Situata:**

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Dritare d/alumini dyfish xham" dhe "Rrjetë teli xingato", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3963 prot., datë 15.04.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6317, datë 18.06.2021.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1729 prot., datë 25.02.2022.

**Ndikimi/Efekt:**

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Financës & Kontabilitetit bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **185,843 lekë pa TVSh** nga OE "4-AM" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3963 prot., datë 15.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Valter Begaj me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Ardit Kane me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacioni mbi gjetjen nga KLSH-ja

## **2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit**

5.1. *Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor.*

5.2. *Auditimi mbi organizimi dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS.*

5.3. *Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike.*

5.4. *Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.*

5.5. *Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve.*

**Titulli gjetjes 1:** *Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se nuk është respektuar përdorimi i lejuar i tokës.*

### **Situata:**

Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se në lejen objekt shërbimesh 1-2 kate me zhvillues shoqëria "Vëllezërit Hallaçi" shpk me adresë Rruga "Nato" Lagjia Valias, Bashkia Kamëz, dhe Objekti "Godine banimi dhe shërbimi 1-3 kat" e zhvillues z. Fatjon Hidaj me adresë Rruga "Dajti" Lagjia Bathore nr.5, Bashkia Kamëz prot,2359, **nuk kanë respektuar përdorimin e tokës.**

### **Kriteri:**

VKM-së 408 ,Neni 9 Leja e zhvillimit 1. Dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja, nga autoritet e zhvillimit, dhe përmban, në nivel prone apo grup pronash, sa vijon: a) përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme.

### **Ndikimi/Efekti:**

Mosrespektimi i përdorimit të lejuar të tokës ndikon mënyrën e zhvillimit të territorit ku jepen leje për përdorime të cilat nuk janë të lejuara për atë zonë duke ndikuar direkt në jetën e banorëve

### **Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës..

### **Rëndësia: E mesme**

### **Për këtë rekomandojmë:**

Nga ana e DPZHKT bashkia Kamëz të merren masa për tu respektuar përdorimi i lejuar i tokës sipas legjislacionit në fuqi.

**Titulli gjetjes 2:** *Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se distanca e lejuar nga kufiri i pronës nuk është respektuar.*

### **Situata:**

Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se në leje ndërtimi **nuk është respektuar distanca e lejuar nga kufiri i pronës**, konkretisht lejet:

- Objekt shërbimesh 1-2 kate me zhvillues shoqëria “Vëllezërit Hallaçi” shpk me adresë Rruga “Nato” Lagjia Valias, Bashkia Kamëz.

- Objekti “Godinë banimi dhe shërbimi 1-3 kat” me zhvillues z. Fatjon Hidaj ADRESA: Rruga "Dajti" Lagjia Bathore nr.5, Bashkia Kamëz prot,2359.

- Objekti “Ndërtese 2kat (zyra 1kat, magazinë grumbullimi 1kat)” me zhvillues z. Filip Zefi ADRESA: Rruga "Tetova" Lagjia nr.4 Kamëz, Bashkia Kamëz prot.2057.

- Zhvilluesit: z. Simon Dokaj, subjekti ndërtues me të dhënat; shoqëria “Eri -06”sh.p.k me licencë nr.NZ .5314/3 leja e ndërtimit per punimet: “Godinë polifunksionale 4 kat me 1 kat podrum me destinacion banimi” me adresë Rruga "Gjergj Kastriot Skënderbeu" Lagjia Frutikulture.

- Zhvilluesit shoqëria "MEHILLAJ" shpk subjekti ndërtues me të dhënat e mëposhtme: shoqëria "MEHILLAJ" shpk me licencë nz. 2961/6 leja e ndërtimit per punimet: “ Godinë banimi dhe shërbimi 9kat me 1kat nëntoke” ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Rruga ”Roma” Lagjia nr.1 Kamëz.

**Kriteri:**

**VKM-së 408 , Neni 35** “*Distanca e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ( $d = nr. k + 1m$ ) ku:  $d$  - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe  $nr. k$  - numri i kateve.*

**Ndikimi/Efekti:**

Mosrespektimi i distancave të lejuara nga kufiri i pronës ndikon në zhvillimin normal të territorit si dhe aksesin në pronën që zhvillohet apo në pronën kufitare duke penguar zhvillimin normal të kufitarit, duke ndikuar në sigurinë e objektit dhe komoditetin.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës..

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Nga ana e DPZHTK bashkia Kamëz të merren masa për tu respektuar distanca e lejuar nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar kundërshtitë e paraqitura nga DPZHT Bashkia Kamëz me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nuk ka asnjë element të ri nga ato të kundërshtuara në fazën e akt-konstatimeve.

**Titulli gjetjes 3:** *Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se nuk është respektuar Intesiteti i lejuar.*

**Situata:**

Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se në lejen “Leje ndërtimi” objekti: “Godinë shërbimi 1kat”, me zhvillues shoqëria “Lugano Home Collection” shpk me adresë Rruga “Monte Karlo” Lagjia nr.4 Kamëz, Bashkia Kamëz **nuk është respektuar Intesiteti i lejuar.**

**Kriteri:**

**VKM-së 408 , Neni 38** Intesiteti i ndërtimit

1. Intesiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore. 2. Intesiteti (I) ekzistues në nivel njësie strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme

të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e (I) për njësinë nuk përfshihen rrugët dhe hapësirat publike, përveç sa përcaktohet në legjislacionin sektorial në fuqi. 3. Intensiteti (I) për çdo njësi pa PDV, përcaktohet nga dokumenti i planifikimit dhe zbatohet në çdo parcelë të ndërtueshme brenda njësisë përkatëse, përjashtuar rrugët dhe hapësirën publike. 4. Intensiteti (I) për një zonë përcaktohet në përputhje me këtë rregullore, ligjin dhe legjislacionin e posaçëm në fuqi. 5. Intensiteti (I) si rregull matet në  $m^2/m^2$ , por për ndërtime në funksion të aktiviteteve bujqësore dhe industriale-ekonomike, (I) mund të matet edhe në  $m^3/m^2$ , sipas akteve ligjore të posaçme në fuqi.

**Ndikimi/Efekti:**

Mosrespektimi intensitetit të lejuara ndikon në kequrbanizim të zonave duke sjellë si efekt negativ në sigurinë dhe konfortin e objekteve me njëra tjetrën.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës..

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Nga ana e DPZHKT bashkia Kamëz të merren masa për respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

**Titulli gjetjes 4:** Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se distanca e lejuar nga objekti në objekt.

**Situata:**

Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se në leje ndërtimi **nuk është respektuar distanca nga objekti në objekt**, konkretisht lejet:

- Zhvilluesit: z. Simon Dokaj subjekti ndërtues me të dhënat e mëposhtme: shoqëria "ERI - 06" sh.p.k me liçencë nr.nz .5314/3 leja e ndërtimit per punimet: "Godinë polifunksionale 4kat me 1kat podrum me destinacion banimi" *adresa e realizimit të punimeve:* Rruga "Gjergj Kastriot Skënderbeu" Lagjia Frutikulture.

- Zhvilluesit: Shoqëria "Lala Konstruksion -2010 shpk subjekti ndërtues me të dhënat e mëposhtme: shoqëria "Lala Konstruksion -2010" shpk me liçencë . nz 6376/1 leja e ndërtimit per punimet: " 2 Godinë banimi dhe shërbimi 1,2 dhe 8kat me 1kat nëntoke" *adresa e realizimit të punimeve:* Rruga "Bavaria" Lagjia nr.2 Kamëz.

**Kriteri:**

**VKM-së 408 , Neni 34** *Distanca minimale midis ndërtimeve 2. Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:  $d = nr. k \text{ obj.A} + nr. k \text{ obj.B} + 2m$ , ku:  $d$  - distanca minimale midis dy ndërtimeve.  $nr. k$  - numri i kateve.*

**Ndikimi/Efekti:**

Mosrespektimi intensitetit të lejuara ndikon në kequrbanizim të zonave duke sjellë si efekt negativ në sigurinë dhe konfortin e objekteve me njëra tjetrën.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës..

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Nga ana e DPZHKT bashkia Kamëz të merren masa për tu respektuar distanca e lejuar nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar kundërshtitë e paraqitura nga DPZHT Bashkia Kamëz me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nuk ka asnjë element të ri nga ato të kundërshtuara në fazën e akt-konstatimeve.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në kundërshtim me dispozitat e ligjit të ndërtimit ngarkohen me përgjegjësi: zj. Fiqirete Rustemaj** me detyrë Specialiste Sektori në DPZHT, **z. Robert Dervishi** me detyrë ish- Përgjegjës Sektori i DPZHT, **z. Erlend Baballeku** me detyrë Drejtori i DPZHT.

**Titulli gjetjes 5:** *Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se kufiri i planvendosjen së objektit prek pronës shtet.*

**Situata:**

Nga auditimi në sistemin e -leje u konstatua se në lejen me zhvillues shoqëria **"Bi Construction" shpk & Shoqëria "Dael Construction" shpk**, me subjekt ndërtues shoqëria "Bi Construction" shpk me liçencë nr.nz .6341 për lejen e ndërtimit të punimeve **"Godinë banimi dhe shërbimi 1 dhe 8kat, me 1kat nëntoke"**, me adresë Rruga "Bulevardi Blu" Lagjia nr.2 Kamëz, **kufiri i planvendosjen prek pronës tokë shtet.**

**Kriteri:**

VKM nr. 408, neni 10 Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën;

Neni 15 Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi

b) Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga DPZHT, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Subjekti i audituar me anë të shkresës me nr. Prot 1312 datë 10.02.2023, se nga ana e ASHK - së ku shprehet se leja e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbimi 1 dhe 8kat, me 1kat nëntoke" me zhvillues "BI-Construction dhe Deal Construction" shpk lëshuar nga bashkia Kamëz nuk prek në pronën me nr. pasurie 89/29 me pronësi shtet.*

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit sqaron se dokumentacioni i vënë në dispozicion për pretendimin e paraqitur, është i plotë për të gjykuar nëse përputhshmëria e hartës treguese të pronës shtet nuk preket nga planvendosjen e miratuar e lejes së ndërtimit.

- *Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve*

**Titulli gjetjes 6:** *Pasaktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI) nga objektet me leje ndërtimi.*

**Situata:**

Nga auditimi mbi mënyrën e llogaritjes së TNI nga specialistë të Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) bashkia Kamëz, u konstatua se kjo taksë nuk është llogaritur në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi. Kështu sipas specialistëve të DPZHT, taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur në zbatim të VKB nr. 29, datë 16.3.2021 “Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020”, në referencë të Projekt Vendimit nr. 26, datë 11.3.2021 të paraqitur në Këshillin bashkia, ku në pikën 2 të tij thuhet:

*2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind të çmimit të shitjes për metërkatror të sipërfaqeve të shfrytëzueshme\**

Kjo mënyrë llogaritje është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 46 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, si dhe me nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Në asnjë paragraf të dispozitave të mësipërme nuk thuhet sipërfaqe e **shfrytëzueshme**, por sipërfaqe për **metërkatrorë**.

Gjithashtu sqarohet se TNI është taksë ndërtimi në infrastrukturë që paguhet para fazës së marrjes së lejes së ndërtimit, e cila ka të bëjë me sipërfaqen e ndërtimit për ndikimin në infrastrukturë dhe jo me fazën e shitjes ose kalim pronësie.

#### **Kriteri:**

Ligjit 107/2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 46 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, si më poshtë vijon:

*1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.  
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.*

si dhe nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ku thuhet se:

*1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit....  
2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror....*

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mos aplikimi i saktë i detyrimeve për TNI, çojnë në mos llogaritjen e saktë të ardhurave në buxhetin e bashkisë Kamëz.

#### **Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

#### **Rëndësia: E lartë**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kamëz, të analizojnë paraprakisht në Këshillin Bashkiak ndryshimin e Vendimit të KB nr. 29, datë 16.3.2021 “Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020”, mbi mënyrën e llogaritjes së Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), në përputhje me nenin 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, me qëllim llogaritjen e



saktë të Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), për të mos shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kamëz.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar kundërshtitë e paraqitura nga DPZHT Bashkia Kamëz me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nuk ka asnjë element të ri nga ato të kundërshtuara në fazën e akt-konstatimeve.

## **2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**

6.1. *Auditim mbi plotësimi i kritereve arsimore për punonjësit e IMT, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” etj.*

6.2. *Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.*

6.3. *Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.*

6.4. *Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatimin në teren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (neni 81-Inspektimi, pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, etj.).*

**Titulli gjetjes 1:** *Nga auditimi i IMTV bashkia Kamëz u konstatua se nuk është kryer inspektimi i territorit që mbulon kjo bashki nga ndërtimet e reja për periudhën e auditimit 2021-2022*

### **Situata:**

Nga auditimi dhe ballafaqimi i dy fotografimeve ajrore nga sistemi google earth dhe google maps, u konstatuan disa raste të ndërtimeve për të cilat Drejtoria e Planifikimit Zhvillimi Territorit Bashkia Kamëz, pasi ju dhanë pozicionet se ku ndodheshin nuk kishte dijeni, që do të thotë nuk kishte lëshuar leje zhvillimi apo ndërtimi për këto ndërtime. Nga ana e IMTV Bashkia Kamëz po ashtu nuk është mbajtur asnjë proces-verbal kundërvajtjeje apo vendim pezullimi, gjobe, prishje për këto objekteve, gjë e cila tregon se nga IMTV Bashkia Kamëz nuk ka informacion mbi ndërtimet e ndryshme pa leje që zhvillohen në territorin e kësaj bashkie.

### **Kriteri:**

Ligji 9780 për kontrollin e territorit neni 4 Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësisë të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.”.

### **Ndikimi/Efekti:**

Moskryerja e inspektimeve nga ana e IMTV bashkia Kamëz për të pasur nën kontroll territorin e administruar prej tyre dhe mos lejuar objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi çon në një kaos urban duke ndikuar drejtpërdrejtë në jetët e banorëve

### **Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e IMTV bashkia Kamëz, duke ngarkuar me përgjegjësi z. Arben Laci me detyrë Kryeinspektor i IMT.

**Rëndësia: I lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Inspektoriat i Mbrojtjes Territorit vendorë bashkia Kamëz të ushtrorë kontrole të vazhdueshme në territorin e bashkisë për të gjitha ndërtimet e zhvilluara në këtë zonë me ose pa leje ndërtimi dhe për rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje të ushtrorë kompetencat në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për kontrollin e territorit.

**Titulli gjetjes 2:** Për objektet me leje ndërtimi të miratuara nga ana e DPZHDK bashkia Kamëz nga ana e IMTV bashkia Kamëz nuk është bërë asnjë kontroll.

**Situata:**

Nga auditimi, u konstatua se për objektet të cilat janë me leje ndërtimi miratuar nga DPZHDK nuk është bërë inspektim nga IMTV për të verifikuar nëse këto objekte të cilat ndërtohen respektojnë projektin e miratuar apo shtojnë volume në lartësi apo në njollën e miratuar, ndryshojnë në formë, në planimetritë e miratuara etj.

**Kriteri:**

Ligji 9780 Neni 5 Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme: a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; b) vendos gjoha, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati; ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme; f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", të këtij neni. Fjala "ndërtim/punim", sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gjurmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes 4 aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit." .

**Ndikimi/Efekti:**

Moskryerja e inspektimeve nga ana e IMTV bashkia Kamëz për të pasur nën kontroll territorin e administruar prej tyre duke kërkuar respektimin e projektit të miratuar nga DPZHDK çon në kaos urban duke ndikuar direkt tek jeta e banorëve.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e IMTV bashkia Kamëz.

**Rëndësia: I lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit vendorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillim Territorit të ushtrorë kontrole të vazhdueshme në të gjitha subjektet e pajisura me leje ndërtimi duke filluar nga piketimi i objektit dhe deri për mbylljen e tij, për mos devijimin e lejes së ndërtimit të miratuar nga DPZHT dhe Kryetari i Bashkisë, kjo në zbatim të ligjit për kontrollin e territorit.

**Titulli gjetjes 3:** *Nga auditimi i grupit të auditimit u konstatua se ka punonjës të cilët kanë arsim të mesëm dhe arsim të lartë por në degë të cilat nuk i përshtaten atij vend pune.*

**Situata:**

Nga auditimi mbi strukturën organizative të IMTV bashkia Kamëz, rezulton se disa nga inspektorët janë pa arsimin përkatës konform legjislacionit në fuqi.

**Kriteri:**

Nr. 9780, datë 16.7.2007 Neni 11 Arsimitimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.”.

**Ndikimi/Efekti:**

Moskryerja e inspektimeve nga ana e IMTV bashkia Kamëz për të pasur nën kontroll territorin e administruar prej tyre duke kërkuar respektimin e projektit të miratuar nga DPZHKT çon në kaos urban duke ndikuar direkt tek jeta e banorëve.

**Shkaku:**

Neglizhencë nga ana e IMTV bashkia Kamëz, **duke ngarkuar me përgjegjësi z. Arben Laci me detyrë Kryeinspektor i IMT.**

**Rëndësia: I lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e organikës të Inspektoriati Mbrojtjes Territorit vendorë bashkia Kamëz me specialist me arsim përkatës sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraport Auditimit, nga subjekti i audituar kundërshtitë e paraqitura nga IMTV Bashkia Kamëz me shkresë nr. 2939 prot, datë 31.3.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nuk ka asnjë element të ri nga ato të kundërshtuara në fazën e akt-konstatimeve.

## **2.7. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

**Titulli gjetjes 1:** *Realizimi i pjesshëm i rekomandimeve sipas plan veprimit të hartuar nga subjekti, duke pasqyruar punën e bërë dhe analizuar rekomandimet e realizuara plotësisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë realizuar plotësisht.*

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve rezulton se:

Në total janë rekomanduar gjithsej **68 masa** të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 58 masa ose 85%, janë në proces zbatimi 7 masa ose 10% dhe nuk janë zbatuar 3 masa ose 4% e tyre, si më poshtë vijon:

**a. Nga 16 masa organizative**, të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar **13 masa**, në proces zbatimi **1 (një)** masë dhe nuk janë zbatuar **2 masa**.

**b. Nga 15 masa shpërblim dëmi me vlerë 7,260 mijë lekë**, pranuar nga subjekti, janë zbatuar 14 masa me vlerë 6,131,882 lekë dhe në proces zbatimi (në gjykatë) 1 masë me vlerë 1,128,914 lekë.

**c. Nga 6 masa për mos efektivitet të fondeve me vlerë 237,884 mijë lekë**, pranuar nga subjekti, janë zbatuar plotësisht, ku për personat përgjegjës janë dhënë masa disiplinore sipas aneksit 7.2 bashkëlidhur Raport Auditimit.

**d. Nga 6 masa mungesë të ardhurash me vlerë 901,750 mijë lekë**, pranuar nga subjekti, është zbatuar 1 (një) masë në vlerën 250 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 901,500 mijë lekë, ku janë arkëtuar vlera 7,474 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera **894,026 mijë lekë**, e cila është kryesisht detyrime nga taksat e tarifave vendore dhe vlerën më të lartë e zënë abonentët familjarë.

**d. Nga 10 masa disiplinore**, të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

**e. Nga 15 masa administrative**, pranuar nga subjekti. Nga bashkia janë aplikuar penalitete në vlerën 900 mijë lekë, vlerë e cila është arkëtuar, sipas aneksi 7.3 bashkëlidhur Raport Auditimit.

#### **Kriteri:**

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 447/3 datë 23.02.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz”.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në shumën 1,128,914 lekë dhe mungesë të ardhurash në shumën **984,026 mijë lekë**.

#### **Shkaku:**

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse.

#### **Rëndësia: E mesme**

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 447/3, prot, datë 23.02.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz”.

### **Masat për të cilat kërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si vijon:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit me objekt “Punë publike”, me vlerë 341,522,287 lekë pa TVSH, të zhvilluara gjatë vitit 2020, konkretisht për procedurat: “Ndërtim KUN "Laknas" +KUN" Paralel me rrugën Adem Jashari; Ndërtim Rr. Deja + Rr. Bilal Xhaferri + Rr. Bujar Bishanaku; Rr. Hali Hoxha + Rr. Islam Spahia+ Rr.Ded Gjon Luli (Fundi); Ndërtim rruga “ Nik Ndreka”; Ndërtim KUN "Skejave"+ KUN" Mustafa Lita"; Ndërtim Rr. "A. Galica (trotuare) + Rr. Baldushk+ Rr. "Europa"; Ndërtim KUN Rrugët Bathore 5; Ndërtim Rrugët Ylbere Bylikbashi (Faik Kulla)+ Rruga Xhemal Kada"; Ndërtim rruga "Lure + Fatos Çupi" Laknas; “Rehabilitim i Digës Rezervuari Paskuqan”, është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël

dhe të mesëm, në kundërshtim me nenin 46, pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 5, por gjithashtu ka hartuar kriteret e cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si vijon:

**a)-** NJP kërkon paraqitjen e **kopjeve të bilanceve** për 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore. Kjo kërkesë, pa asnjë argumentim apo arsyetim, është përdorur me dy standarde nga ana e NJP. Në disa raste (5 raste) është kërkuar që "bilancet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertizë e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar", ndërsa në disa raste të tjera (5 raste) është kërkuar vetëm që "bilancet të jenë të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse".

**b)-** NJP kërkon paraqitjen e **licencave profesionale** me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit.

**c)-** NJP në përcaktimin e **numrit të punonjësve** ka përdorur standarde të dyfishta, thellësisht subjektive dhe kontradiktore. Konkretisht, për punime të së njëjtës natyre është kërkuar një numër më i madh punonjësish në procedura me fond limit (volum punimesh) më të vogël në krahasim me numrin e punonjësve të kërkuar për një procedurë tjetër me fond limit (volum punimesh) më të madh. (P.sh.: Për procedurën me objekt "Ndërtim KUN "Laknas" +KUN" Paralel me rrugën Adem Jashari" me fond limit 31,163,251 lekë pa TVSh janë kërkuar 41 punonjës, kur nga ana tjetër, për procedurën me objekt "Ndërtim KUN Rrugët Bathore 5" me fond limit 13,487,956 lekë pa TVSh (më shumë se 50% më të vogël) janë kërkuar 45 punonjës, pra një numër më i madh.

**ç)-** NJP në të gjitha rastet ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar** dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme (7-12 muaj).

**d)-** NJP në të gjitha rastet ka kërkuar një numër të pa-argumentuar të makinerive/pajisjeve. Nuk ka asnjë analizë teknike ku **sasia e makinerive/pajisjeve** të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volume e tyre apo grafikun e punimeve.

**dh)-** NJP në të gjitha rastet nuk ka argumentuar apo përcaktuar se për cilin zë konkret të punimeve nevojitet një certifikatë ISO konkrete nga ato të kërkuara. Gjithashtu referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e disa ISO-ve të kërkuara nga Njësia e Prokurimit.

**e)-** NJP për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim KUN Rrugët Bathore 5", ka kërkuar që OE ofertues duhet "të ketë kontraktuar një *Ekspert Zjarrfikës* i pajisur me licencë dhe i regjistruar si subjekt në QKR (eksperti), kërkesë kjo e panevojshme dhe e pa-argumentuar pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë lloje punimesh të cilat kërkojnë domosdoshmërisht kontraktimin e një Eksperti Zjarrfikës

**1.1. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit në lidhje me vendosjen e kriterëve për kategoritë e nevojshme të punimeve për zbatimin e kontratës në DST, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**Statusi: Pa zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Dokumenteve të Koncesionit "*Shërbimit të kryerjes së pastrimit, grumbullimit, transportimit, seleksionimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz*" nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të LPP dhe të ligjit për koncesionet. Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikimin, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 "Kontrata për punë publike" pika "5"; neni 61, pika "2", dhe neni 46 të LPP.

Komisioni ka hartuar dokumentet e procedurës konkurruese, në kundërshtim me VKM nr. 575 datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", Kreu V, neni 24 pika "2"; me nenin 23 të ligjit Nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar, pika 1, 2 dhe 5.

- Në lidhje me eksperiencën në shërbimin e pastrimit, nga AK kërkohet që Drejtuesi teknik të ketë eksperiencë jo më pak se 5 vite në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit. Në rast të mosplotësimin në kontratë eksperiencën 5 vjeçare, drejtuesi teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën në ofrimin e shërbimit të pastrimit. Drejtuesi teknik duhet të figurojë në listë pagesat e shoqërisë të paktën 6 muajt e fundit dhe në licencën e shoqërisë. *Vendosja e kriterit mbi eksperiencën në punë, është pa arsye në objektin e prokurimit dhe në gjykimin e audituesit ky kriter pengon dhe nuk nxit pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit duke mos siguruar një trajtim të barabartë të operatorëve dhe nuk është në funksion të këtyre parimeve, veprim ky në kundërshtim me shtojën 9 të DT dhe me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV.*

- Gjithashtu nga AK kërkohet që OE, duhet të kenë të punësuar staf teknik, i cili të figurojë në listë pagesën e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit, si dhe në licencën profesionale të shoqërisë punonjësit si më poshtë: 1 Inxhinier Mekanik, 1 Inxhinier Mjedis, 1 Inxhinier Ndërtimi, 1 Inxhinier Gjeolog, 1 Inxhinier Gjeodet, të cilët nuk duhet të jenë të dy punësuar. Kriteret i inxhinierëve të mësipërm trajton në mënyrë të padrejtë OE të cilët nuk e kanë inxhinierët e mësipërm në licencën e shoqërisë, duke favorizuar operatorë të cilët e kanë këtë inxhinier në licence, ku mjaftonte vetëm prezenca në liste pagese. Vendosja për të paktën 6 muaj në listë pagese, ngushton konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët kanë stafin e sipërcituar mbi 6 muaj. Pra një operator ekonomik i cili plotëson përgjithësisht kriteret kualifikuese, nuk merr pjesë në garë pasi ndonjë nga ekspertët e sipërcituar nuk e ka të punësuar për 6 muaj në listë pagesë. Gjithashtu një operator ekonomik mund ti plotësojë edhe duke realizuar kontratë me shoqëri të specializuar për shërbimet e mësipërme.

- Në pikën 11 nga AK është kërkuar që OE duhet të jetë i pajisur nga QKL me: Leje Mjedisore të lëshuar nga QKL për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh, kodi III.I.A) Licencë nga QKL për grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B) Licencë nga QKL për shërbime ndërhyrëse higjieno sanitare (kodi II 8B). Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik çdo anëtar i bashkimit duhet të paraqesë leje/licencat si më lart. Vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotësojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 74 pika 3. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cili nuk disponon një licencë të përcaktuar si më sipër, nuk mund të kryejë bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh apo të shërbimit, pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit.

- Në pikën 13 nga AK është kërkuar që mjetet teknologjike transportuese, të jenë jo më poshtë se viti i *prodhimit të 2010*. Përcaktimi i vjetërsisë së mjeteve ngushton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, pasi një OE i cili disponon mjete me poshtë se viti 2010, i pajisur me kolaudimin e mjetit dhe lejen e qarkullimit përsëri do të realizonte shërbimin

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve që do zhvillohen Nga verifikimi rezultoi se:, të marrë masa që çdo kriter në lidhje me stafin teknik, licencat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca.

**Statusi: Pa zbatuar**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve rezultoi se, nuk janë zbatuar plotësisht masat e rikërkuar nga KLSH-ja me shkresën nr. 1269/14 prot., datë 21.12.2018 dhe, konkretisht:

- Nga 5 masa organizative të rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë zbatuar 2 masa dhe janë në proces zbatimi 3.
- Nga 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,561,856** lekë është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.12.2020, janë arkëtuar **1,865,974** lekë dhe janë nisur njoftimet për 2 rekomandime për 4 persona në vlerën 147,102 lekë por ende nuk kanë filluar arkëtimet.
- Janë nisur njoftimet për 26 biznese dhe 4 persona debitor por ende nuk kanë filluar arkëtimet në vlerën **505,573** lekë.
- Lidhur me arkëtimin e vlerës **427,102** lekë për 11 persona përfitues të paguar nga fondi i veçantë shpërblime për punë të mirë, rezulton se nga 11 persona në vlerën prej 427,102 lekë, janë arkëtuar nga 7 persona vlera prej **280,000** lekë, duke mbetur pa u arkëtuar edhe nga 4 persona vlera prej 147,102 lekë.
- Nga vlera debitorë prej **49,781,264** lekë, për 248 subjekte, rezulton se është arkëtuar vlera prej 5,985,352 lekë, nga 65 subjekte, është pa arkëtuar vlera prej 43,795,912 lekë nga 183 subjekte.
- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet nga 4,226 persona debitor në vlerën totale të pa arkëtuar prej **285,035,451** lekë, deri me date 31.12.2020 janë arkëtuar vlerat prej **219,938,509** leke dhe me datë 31.12.2020 rezultojnë debitor 1820 persona në vlerën 65,096,942 lekë.
- Lidhur me regjistrimin në QKB të 45 subjekteve dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën **2,082,685** lekë, rezulton se, vlera e detyrimeve prej 2,082,685 lekë, është regjistruar në kontabilitet si detyrim i bizneseve ndaj bashkisë. Nga vlera prej 2,082,685 lekë, është arkëtuar vlera prej 1,585,974 lekë, duke mbetur pa arkëtuar vlera prej 496,711 lekë. Për 26 subjektet që rezultojnë debitor janë bërë njoftim detyrimet, është bërë kërkesa për pagesë dhe u është dërguar bankave urdhër për bllokimin e llogarive bankare.
- Lidhur me shpërblimin e dëmit në vlerën **2,134,754**lekë nga aplikimi i tarifës për taksat për biznesin e vogël (taksë pastrimi, taksë ndërtesë, taksë gjelbërimi), më të ulta se sa janë miratuar në paketën fiskale me Vendime të Këshillit të Bashkisë, rezultoi se, deri më datë 31.12.2020, është arkëtuar vlera prej **1,585,974** leke, dhe ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 496,711 lekë. Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 269/14 prot., datë 21.12.2018 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz”

**14.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shumave në buxhetin e bashkisë. Të zbatohen plotësisht rekomandimet e pa realizuara dhe rikërkuar nga KLSH-ja me shkresën nr. 1269/14 prot, datë 21.12.2018 të KLSH-së.

**Statusi: Në proces zbatimi**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim rruga “Demokracia”, Loti II, Bathore”, Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (me TVSh)87,758,820 lekë, fituar nga BOE “Kupa” SHPK & “KolaInvest” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,128,914** lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmartjes së punimeve nr. 2428 prot datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Kupa” SHPK & “KolaInvest” SHPK

**10.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,128,914** lekë pa TVSh nga BOE “Kupa” SHPK & “Kola Invest” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit

në kontratën me nr. 2428 prot datë 07.05.2019, me objekt “Ndërtim rruga “Demokracia”, Loti II, Bathore”, Bashkia Kamëz, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi: Në proces zbatimi**

### **C. MASA MUNGESË TË ARDHURASH**

**1.Gjetje nga auditimi:** Vlera e debitorëve nga bizneset deri më datë 31.12.2020 paraqitet rreth **113,329,862 lekë**, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifatat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Kamëz. Vlera e gjobave llogaritet në **966,071 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kamëz. Vlera e debisë nga familjarët deri më datë 31.12.2020 është **512,822,365 lekë**, dhe përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Kamëz. Mbi këto familjarë nuk është aplikuar kamatëvonesë.

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Kamëz të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **627,118,298 lekë**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga viti 2014, kur të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi janë paraqitur pranë pushtetit vendor për përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë deri më datë 31.12.2020 janë paraqitur 12,401 objekte në proces legalizimi. Vlera debitore deri më datë 31.12.2020 është **237,287,232 lekë**, e ardhur e munguar për bashkinë.

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **vlerën 232,245,116 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kamëz të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, takson qytetarët që disponojnë tokë bujqësore sipas të dhënave që disponon nga Formulari 06, si dhe dokumenteve të pronësisë të depozituara nga qytetarët. Vlera e debisë me 31.12.2020, bazuar në listat e nisura nga Drejtoria e MTMP- së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave është 32,386,898 lekë, e ardhur e munguar për Bashkinë.

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave të marr masa me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **32,386,898 lekë**. Përsa i përket gabimeve të bëra në database fillestar ( formularin 06) , të merren masa për mos mbarten nga një vit në tjetrin, e të mos kemi dublime emrash pronarësh e vlera finaciare të pa arkëtuara.

**Statusi: Pa zbatuar**

**4.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Liçensave dhe Kadastrës të jenë të angazhuar për përditësimin e dokumentacionit për të shkuar tek evidentimi i saktë, por gjithmonë në bashkëpunim me ASHK-së, për evidentimin e pronarëve real të këtyre pasurive, si për tokat bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501 “Për Tokën”, ashtu dhe për përditësimin e pronave shtetërore në pronësi të bashkisë Kamëz.

**Statusi: Në proces**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në bashkinë Kamëz gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtuar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 36 subjekte, nga të cilët 7 prej tyre tregtojnë gaz. Grupi auditues përzgjodhi 12 dosje për auditim. Vlera prej 4,348,000 lekë që duhet të ishte arkëtuar nga rinovimi i licencave, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kamëz. Kjo vlerë është llogaritur në bazë të listës së subjekteve që



disponon Bashkia Kamëz. Bashkia Kamëz nuk ka aplikuar gjoba në kundërshtim me Paktën Fiskale ku specifikohet se gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë licencën është 20,000 lekë. Në total gjobat rezultojnë të jenë në vlerë 360,000 lekë mungesë të ardhurash për Bashkinë Kamëz.

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **2,068,000 lekë**.

**Statusi: Në proces zbatimi**

**5.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave të bashkëpunoj me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në mënyrë që të verifikojë nëse ka subjekte që e kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimit apo nëse ka subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë.

**Statusi: Në proces zbatimi**

Në mënyrë analitike për cdo gjetje dhe rekomandim paraqitet në pasqyrën Aneks 2.7, bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

## 2.8. Menaxhimi i aseteve për vitin 2021

*- Menaxhimi i aseteve, inventari dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme .*

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin. Për Bashkinë Kamëz, lista e pronave është miratuar me VKM nr. 775, datë 05.09.2013 ‘Për Miratimin e listës Përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të qarkut Tiranë’ dhe VKM-së nr. 454, datë 22.06.2011 “Për Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Paskuqan, të Qarkut Tiranë”.

Nga totali prej rreth 2000 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Kamëz, përfshirë zonën e Paskuqanit, janë dërguar për certifikim **93 pasuri**, nga të cilat vetëm **47 janë certifikuar**. Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuar me VKM nr. 775/2013 për Bashkinë Kamëz dhe VKM nr. 454/2011 për ish-komunën Paskuqan nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

Inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kamëz është i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se:

*“bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”.*

Statusi	Njësia Administrative Paskuqan	Bashkia Kamëz	Kamëz + Paskuqan
Të Nisura	24	21	93
Të certifikuara	14	33	47

Në këtë inventar, për **pronat me funksioni përdorimi “administratë”**, me numër rendor nga 1-3, rezulton se nuk janë kryer evidentime në terren dhe verifikime juridike si dhe nuk janë regjistruar në kadastrë pasuritë sipas tabelës si mëposhtë:

ZK	Lloji i pronës	Emri i pronës	Sip. Totale m <sup>2</sup>	Nga sip. Totale sa ndërtesë në m <sup>2</sup>	Funksioni	Institucioni që e përdor
2066	Truall +ndërtesë	Agjenci Bankare, lagje nr.4	49.8	49.7	Shërbim bankar	Dega e BK Tiranë, objekti nën pallat
2066	Truall+ ndërtesë	Agjencia e Sigurimeve Shoqërore	48	46	Administratë	Objekti nën pallat kati i parë
206	Truall +ndërtesë	Radiostacioni lagje nr.5 Kamëz	6800	15828	Azil	ATSH

**Në lidhje me pronat me funksion “ekonomik”**, me numër rendor nga 25-30, objekte kryesisht të natyrës magazina bujqësore, janë bërë shënime në inventar se janë të privatizuar, por nuk është konfirmuar statusi juridik, nëse regjistrimet e këtyre privatizimeve janë pasqyruar në kadastrë, nëse janë objekt i ushtrimit të së drejtës së parablerjes në rast shitjeje me ankand si dhe nëse nga totali i sipërfaqeve të privatizuar rezultojnë diferenca që mund të jenë të regjistrueshme për Bashkinë Kamëz.

Zona kadastrale/indeksi i hartës	Lloji i pronës	Emri i pronës	Nga sip. Totale sa ndërtesë në m <sup>2</sup>	Funksioni	Institucioni që e përdor	Shënime
2066	Truall ndërtesë	Tregu Fruta-perime	700	Ekonomik	Bashkia Kamëz	Privatizuar
2066	Truall ndërtesë	Magazinë U.B	270	Ekonomik	Bashkia Kamëz	Privatizuar
2372(216-D)	Truall+Ndërtesë	Ish-oficina e mjeteve bujqësore	8000	Ekonomik	Bashkia Kamëz	Privatizuar
2372(216-D)	Truall+Ndërtesë	Ish-magazina bujqësore Laknas	9600	Ekonomik	Bashkia Kamëz	Privatizuar
2371(232-B)	Truall ndërtesë	Ish-objektet e peshores	220	Ekonomik	Bashkia Kamëz	Privatizuar
2371(232-B)	Truall ndërtesë	Ish-zyrat e pleqve Laknas	600	Ekonomik	Bashkia Kamëz	Privatizuar

Sa u përket pasurive për të cilat Bashkia Kamëz i ka regjistruar në DVASHK Kamëz -Vorë, sipas natyrës së funksionit rezultojnë : 12 shkolla, 3 kopshte, 2 gjimnaze, 3 qendra shëndetësore, 5 sheshe, 2 rezervuarë, 1 Pallati i Kulturës, 6 pasuri të llojit truall ndërsa 14 pasuri të tjera janë të llojit shkëmbore, pemëtoare, arë etj. Pasuritë e llojit truall, pyll dhe livadh nuk janë kontabilizuar sipas çmimeve të referencës përcaktuara në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Nr.	Pasuria	ZK	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Vlera në lekë
1	Truall -Pasuria nr.135/46	2066	472	1500	708,000
2	Truall -Pasuria nr.752/79	2372	3560	2000	7,120,000
3	Truall -Pasuria nr.209/72	2066	472	5000	2,360,000
4	Pyll -Pasuria nr.81	2066	165	10500	1,732,500
5	Livadh	2066	117	3200	374400
6	Truall Pasuria nr.357/49	2372	3560	1125	400,5000
	<b>Totali</b>				<b>16,299,900</b>

**Në lidhje me fondin pyjor**, me VKM nr.433 datë 08.06.2006 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit”, ndryshuar me VKM nr.684

datë 02.09.2020 janë transferuar në Bashkinë Kamëz **7 ekonomi pyjore/kullosore**. Këto pasuri nuk janë regjistruar në DVASHK Kamëz-Vorë dhe nga ana e bashkisë, sektori i pyjeve nuk janë marrë masa për të miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, sipas parashikimeve të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” dhe Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Nr.	Ekonomia pyjore/kullosore	Nënngastra	Sipërfaqja në Ha	Kategoria e përdorimit
1	Zall Her-Prisk	71a	23.78	Pyll
2	Zall Her	72a	29.77	Pyll
3	Zall Her	73a	20.13	Pyll
4	Zall Her	74a	22.23	Pyll
5	Zall Her	75a	25.71	Pyll
6	Zall Her	77a	15.44	Pyll
7	Zall Her	78a	18.2	Pyll

Produkti përfundimtar për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të bashkisë Kamëz është përgatitur nga konsorciumi i kompanive të kontraktuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe është dorëzuar pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë, për miratimin përfundimtar dhe certifikimin e produktit. Në Bashkinë Kamëz, struktura përgjegjëse e pyjeve, nuk është e përditësuar me ndryshimet e reja të legjislacionit në fushën e pyjeve, dhe konkretisht me VKM-në nr.171, datë 18.03.2022, “Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor si dhe manualët e përdorimit të programit ALFIS”.

**Titulli gjetjes 1:** Mos regjistrimi i pasurive të paluajtshme të bashkisë Kamëz, përfshirë fondin pyjor, mungesa e përditësimit të inventarit të pasurive të paluajtshme dhe mospasqyrimi si vlerë kontabël e 6 pasurive të llojit truall, pyll dhe livadh me vlerë 16,299,900 lekë.

**Situata:**

Nga totali prej rreth 2000 pasuri që i janë transferuar Bashkisë Kamëz, përfshirë zonën e Paskuqanit, janë dërguar për certifikim 93 pasuri, nga të cilat vetëm 47 janë certifikuar. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Në lidhje me fondin pyjor, 7 ekonomi pyjore/kullosore nuk janë regjistruar në DVASHK Kamëz-Vorë dhe nga ana e bashkisë ende nuk janë miratuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, pasi nuk përfunduar procesi i certifikimit të pasurive. Sa u përket pasurive për të cilat Bashkia Kamëz i ka regjistruar në DVASHK Kamëz -Vorë, sipas natyrës së funksionit rezultojnë 6 pasuri të llojit truall, pyll dhe livadh me vlerë 16,299,900 lekë.

**Kriteri:**

Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. VKM nr.775/2013 për transferimi Bashkinë Kamëz dhe VKM nr.454/2011 për ish-komunën Paskuqan, VKM nr.433 datë 08.06.2006 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit”, të ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos përditësimi i inventarit të pasurive dhe mos regjistrimin e pasurive në pronësi të bashkisë sjell si pasojë riskun e zaptimit të pasurive, mosvënien në përdorim në funksion të komunitetit dhe potencialisht mungesë të ardhurash nga qiratë që mund të mblidhen nga këto pasuri.

**Shkaku:**

Mungesë burimesh logjistike dhe njerëzore në bashkinë Kamëz, mos marrja e masave për përditësimin e inventarit si dhe mos rakordim me DVASHK Kamëz-Vorë mbi statusin juridik të pasurive.

**Rëndësia: E lartë****Për këtë rekomandojmë:**

Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet strukturës së menaxhimit të aseteve dhe Drejtorisë Ekonomike bashkia Kamëz, të marrë masa për përditësimin e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në kadastër.

Të behet kontabilizimi i vlerave për 6 pasuri të llojit truall, pyll dhe livadh në shumën **16,299,900 lekë**.

***- Auditimi mbi shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për dhënie me qira të aseteve të bashkisë***

Bashkia Kamëz ka lidhur 7 kontrata qiraje, nga të cilat 4 kontrata kanë për objekt sipërfaqet brenda Pallatit të Kulturës, 2 kontrata kanë për objekt sipërfaqe përkatësisht pyjore dhe tokë pa fryt, ndërsa 1 kontratë ka për objekt dhënien me qira të stadiumit për aktivitetet e klubit sportiv Kastrioti.

Sa u përket mbledhjes së të ardhurave, konstatohet se për të 7 subjektet nuk ka detyrime të pashlyera në lidhje me pagesat e qirave. Për subjektin “Skela Syla” konstatohet se ndonëse i ka shlyer detyrimet në total, pagesa nuk kryhen brenda intervaleve kohore, çdo muaj, të parashikuar në kontratë. Për vitin 2021 ka paguar vlerën për 10 muaj (paguar në janar 2021 për 3 muaj, qershor 2021 për tre muaj, tetor 2021 për 4 muaj), ndërsa për dy muaj vlera është paguar në shkurt 2022, pra është vepruar jo në përputhje me nenin 6 të kontratës nr. 2281 prot. date 04.03.2021 dhe nenin 6 të kontratës 729 rep, 630 kol datë 01.04.2019 ku cilësohet “pagesa e qirasë do të jete mujore dhe do të paguhet brenda datës 10 te fillimit te çdo muaji...”.

Nr.	Qiramarrës	Objekti	Vlera	Kohëzgjatja	Detyrimi 2021	Vlera e arkëtuar 2021	Vlera e arketuar 2022 per llogari te vitit 2021
1	Klubi Sportiv Kastrioti	Zhvillimin e ndeshjeve të ekipit "Kastrioti në stadiumin e qytetit"	30,000 lekë/muaj	01.09.2020-31.05.2021	150,000	150,000	
2	Banka OTP Albania sh.a	Vendosja e një A.T.M (bankomat) një ambient me sipërfaqe 1.5 metra	20,000 lekë/muaj	06.03.2020- (3 vite nga nënshkrimi)	240,000	200,000	40,000
3	Banka e Tiranës	Dhënia me qira e një sipërfaqe. 165 metra ambient brenda Pallatit të Kulturës	165 metra*530 lekë për metra 2 (vlera 87,450 leke/muaj)	15.07.2020-14.07.2021	1.049,400	918,225	131,175
4	"Bioproduct" shpk	Dhënia me qira e pasurisë shtetërore e llojit: "Zallishte"	66,990 (lekë/vit)	21.01.2019-24.01.2039 (20 vite nga nënshkrimi)	66,990	66,990	
5	Petrit Syla	Ka dy kontrata me sip. totale 211m2	54,620 leke/muaj	01.04.2019-31.03.2029 (10 vite)	603,600	485,360	118,240
6	Shoqëria "Gemini" shpk	Dhënia me qira për përdorim e sipërfaqes prej 0.8530 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor publik, ekonomia pyjore Terkuze Droje, ngastra nr. 8	375,320 lekë/vit	29.04.2021-29.05.2031	375,320	375,320	

1. ***Nga auditimi i kontratës me nr.25 rep, 126 kol datë 24.01.2019*** mes bashkisë Kamëz dhe shoqërisë “Bio Pruduct Shpk”, me objekt dhënien me qira të pasurisë së llojit “zallishte”, nr.154, vol.200 zk 2372 me sipërfaqe 12400 m<sup>2</sup>, me afat 20 vjeçar, rezulton se:

Bashkia Kamëz e ka regjistruar këtë pasuri në Zyrën e RPP, duke disponuar edhe certifikatën e pronësisë, si pasuri e cila i ka kaluar në pronësi me vendimin nr.775 datë 05.0.2013 të KM.

Me shkresën nr.ext prot., datë 11.12.2012 është mbajtur një relacion për miratimin në parim të dhënies me qira pa konkurrim, në bazë të kërkesës që shoqëria “Bioproducts shpk” ka paraqitur,

protokolluar me nr.6318 prot., datë 22.11.2018, me objekt “Ngritje ambientesh agroturizmi për ofrim ushqimi dhe ambiente për argëtim në fermë”. Në këtë relacion theksohet se nga plan biznesi i paraqitur nga shoqëria “Bioproducts” investimi në pronën e marrë me qira për zhvillimin e aktivitetit të agroturizmit do të jetë në vlerën 110, 000,000 lekë.

Me vendimin nr.144 datë 19.12.2018 të Këshillit Bashkiak Kamëz është miratuar në parim dhënia me qira pa konkurrim në favor të shoqërisë “BioProducts shpk të pasurisë së llojit “zallishte” me sipërfaqe 12400 m<sup>2</sup>.

Me urdhrin nr.116 datë 28.01.2019 është ngritur grupi i punës për dorëzimin e pasurisë së dhënë. Nga Proces-verbali për dorëzimin e pasurisë me nr.769 prot, datë 11.2.2019, rezulton se nuk ka të dhëna për vlerën e pronësisë pasi nuk ka dokumentacion kontabël mbi vlerën e administruar në vite.

**Në aspektin procedural**, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se së pari, në dosjen përkatëse të kontratës së qirasë, e cila nuk ka inventar, mungon dokumentacioni i detyrueshëm sipas VKM nr.54/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe dhënien me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe udhëzimit nr. 13, datë 26.4.2018 në zbatim të VKM përkatëse si vijon:

*Propozimin për dhënien me qira ose enfiteozë, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira, sipas Kreut II, pika (a) të VKM-së nr.54/2014.*

*Planbiznesi i hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i përcaktuar në VKM, i cili duhet të përmbajë siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë ose personit fizik, në çdo faqe të tij;*

*Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;*

*Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet deklaratat mbi NIPT/NUIS, deklaratat për shlyerjen e detyrimeve tatimore, deklaratat mbi administratorin dhe subjektin juridik nëse është në ndjekje penale si dhe vërtetimin se nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;*

**Së dyti**, sipas pikës 6 shkronja (c) të VKM nr. 54/2014, të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira për tokat e pafrytshme e ka ministria përgjegjëse për ekonominë. Afati i lidhjes së kontratës për këto pasuri është deri në 10 (dhjetë) vjet. Ndërkohë, në relacionin përkatës është arsyetuar përmes germës (b), e cila përcakton se të drejtën e lidhjes së kontratës e ka organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore të institucionit, që jep qira deri në 20 vjet për sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup>. Por, në rastin konkret bëhet fjalë për tokë pa fryt, e cila ka të përcaktuar qartë një rregullim të posaçëm, madje e detajuar në pikën 4 të Kreut II, se:

*“Për objektet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, pas përgatitjes së dokumentacionit, drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që ka në administrim pasurinë që do të jepet me qira ose enfiteozë, e përcjell atë në organin që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, i cili, me urdhër të titullarit të tij, fillon procedurat për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”.*

Në zbatim të pikës 6/c, të kreut I të VKM-së, institucioni që përgatit dokumentacionin merr konfirmimin, se pasuria është “tokë e pafrytshme” nga Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në Qarkun përkatës. Tokat e pafrytshme lejohet të jepen me qira, për qëllime blegtorale, bujqësore, kulturore, industriale etj., sipas objektit të veprimtarisë së subjektit qiramarrës. Të drejtën e lidhjes së kontratës për pasurinë “tokë e pafrytshme” e ka ministria përgjegjëse për ekonominë.

Relacioni është nënshkruar nga Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Investimeve Publike z. **Arbër Tola**, Drejtoria e Financës znj. **Vjollca Smaçi** dhe Drejtoria e Çështjeve ligjore dhe Prokurimeve Publike z. **Atli Hoti**.

**Në aspektin e zbatimit të detyrimeve kontraktuale**, duke qenë se kjo është një kontratë qiraje e lidhur përmes një procedure që përjashtohet nga konkurrimi, duhen plotësuar dy kushte:

- (i) *natyra e investimit në bazë të së cilës dhënia me qira e një pasurie duhet të ketë për objekt ushtrimin e aktiviteteve në fushën e sportit, kulturës, turizmit dhe trashëgimisë kulturore;*
- (ii) *investimi që duhet realizuar duhet të jetë në vlerën e 100,000,000 lekë.*

Në lidhje me këtë çështje konstatohet se nga ana e subjektit përkatës, për qiramarrësin është përcaktuar detyrimi kontraktual për kryerjen e investimit në vlerën 110,000,000 lekë, ku brenda dy viteve të para duhet të investojë vlerën prej 25,000,000 lekë, në vitin e tretë deri në vitin e katërt do të investohet në vlerën 35,000,000 lekë dhe gjatë vitit të pestë do të investohet në vlerën 50,000,000 lekë. Ky detyrim kontraktual nuk është zbatuar nga ana e subjektit, duke qenë se nga nënshkrimi i kontratës e deri në vitin 2021 kur lind detyrimi, brenda 2 viteve nga lidhja e kontratës, nuk është kryer asnjë lloj punimi. Arsyet kanë të bëjnë me shkaqe të pavarura nga subjekti, pasi kundër këtij projekti ka një proces gjyqësor të nisur nga banorët e zonës së Laknasit. Konkretisht, me Vendimin nr. 825(80-2022-846) datë 16.03.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka konstatuar si absolutisht të pavlefshme lejen zhvillimore nr.801 datë 02.05.019 dhe lejen e ndërtimit nr.932 datë 27.06.2019 lëshuar nga bashkia Kamëz për subjektin “Bioproduct shpk”.

Sa i përket detyrimit financiar, sipas informacionit të përcjellë nga drejtoria e financës së Bashkisë Kamëz, subjekti ka shlyer detyrimin vjetor të përcaktuar në kontratë.

2. ***Nga auditimi i kontratës me nr.2281 datë 04.03.2021*** mes Bashkisë Kamëz dhe subjektit “Petrit Syla”, me objekt dhënien me qira të pasurisë shtetërore ambiente brenda pallatit të kulturës të llojit “ndërtesë” pjesa e nëndheshme, me sipërfaqe 101.4 m<sup>2</sup>, në administrim të bashkisë Kamëz, me vlerë 300 lekë/ m<sup>2</sup>, rezulton se:

-Kontrata përkatëse vjen si plotësim i kontratës nr.792 rep, nr.630 kol datë 01.04.2019, mes bashkisë Kamëz dhe z. Petrit Syla, e cila ka patur si objekt dhënien me qira të pasurisë shtetërore ambiente brenda pallatit të kulturës të llojit “ndërtesë” me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, me afat 10 vjeçar, kundrejt vlerës prej 24,200 lekë/muaj në emër të subjektit “Skela Syla shpk”. Përmes procesverbalit nr.7118 prot., datë 22.11.2019 nga grupi i punës për verifikimin në terren, ngritur me urdhrin nr.650 datë 22.11.2019 nga Kryetari i Bashkisë, rezultoi se subjekti, përpos sipërfaqes prej 110 m<sup>2</sup>, shfrytëzonte një sipërfaqe tepër prej 101.4 m<sup>2</sup> në katin e nëndheshëm, e cila nuk ishte objekt i kontratës e për pasojë përmes shkresës nr.7282 prot, datë 11.12.2019 subjekti është njoftuar për lirimin e menjëhershëm të hapësirës publike. Me shkresën nr. 7347 datë 03.12.2019 subjekti ka dorëzuar kërkesën për marrjen me qira të sipërfaqes përkatëse që e shfrytëzonte jashtë marrëdhënies kontraktore.

Në aspektin procedural, për të dy kontratat, përkatësisht të datave 01.04.2019 dhe 04.03.2021 nga verifikimi rezulton se:

***Së pari***, dosjet përkatëse janë të painventarizuara, pa gjurmë auditimi dhe mungon dokumentacioni i detyrueshëm sipas VKM nr.54/2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe dhënien me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe udhëzimit nr. 13, datë 26.4.2018 në zbatim të VKM përkatëse si vijon:

*propozimin për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira, sipas Kreut II, pika (a) të VKM-së nr.54/2014 për kontratën e datës 04.03.2021;*

*Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet deklaratat mbi NIPT/NUIS, deklaratat për shlyerjen e detyrimeve tatimore, deklarata mbi administratorin dhe subjektin juridik nëse është në ndjekje penale si dhe vërtetimin se nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, për të dyja kontratat.*

*Për kontratën e datës 04.03.2021 mungon procesverbali i dorëzimit të objektit.*

**Së dyti**, kontrata me nr.2281 datë 04.03.2021 është lidhur në kundërshtim me pikën 5, shkronja (e) të Kreut I të VKM, e cila përcakton se:

*“shtesat në kontratë për sipërfaqet që kërkohen nga qirumarrësi për të shtuar ose për të përmirësuar veprimtarinë bëhen për sipërfaqe jo më shumë se 50% e sipërfaqes totale të marrë me qira dhe vetëm në rastet kur sipërfaqja shtesë shtrihet në kufi me sipërfaqen e kontratës brenda së njëjtës zonë kadastrale”.*

Në këtë rast, kontrata është nënshkruar me sipërfaqe mbi 50% të sipërfaqes totale të marrë me qira. Sipas udhëzimit nr. 13, në zbatim të pikës 5-e, të kreut I të VKM-së, shtesat në kontratë për sipërfaqet funksionale, në kufi me objektin e kontratës së qirasë, për sipërfaqe jo më shumë se 50% e sipërfaqes totale të marrë me qira dhe kur subjekti qiramarrës është i rregullt me zbatimin e detyrimeve kontraktore, do të bëhen me aneks-kontratë, sipas dokumentacionit të përgatitur, nga institucioni që ka në administrim objektet sipas pikës 1 të kreut II të VKM-së.

**Së treti**, për kontratën me nr.792 rep, nr.630 kol datë 01.04.2019, rezulton se :

*Me shkresën nr.965 datë 20.02.2019 është bërë njoftimi për dhënien me qira të ambienteve brenda pallatit të Kulturës me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup> (80+30 m<sup>2</sup>), drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik*

*Me shkresën nr.1182/2 datë 13.03.2019 është mbajtur procesverbali për zhvillimin e konkurrit dhe dhënien me qira, ku është paraqitur një ofertues, subjekti “Skela Syla”, i cili është shpallur fitues*

*Subjekti ka paraqitur planin e biznesin, ku ka parashikuar të investojë në vlerën 23,097,034 lekë dhe do të punësojë një staf prej 10 punonjësish.*

*Procesverbalit të dorëzimit të objektit, me nr. 1556 prot., datë 02.04.2019 i mungon përshkrimi kontabël i objektit që jepet me qira ose enfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës. **Grupi i punës për dorëzimin e procesverbalit përbëhet nga z. Faik Sula, z.Mehdi Hoxha, znj.Marsela Gecaj, z.Haxhi Damzi.***

Në lidhje me zbatimin e detyrimeve kontraktore, në zbatim të pikës 2-c, të kreut VI të VKM- së, njësia monitoruese në Bashkinë Kamëz nuk ka kryer detyrat si mëposhtë:

*Nuk ka monitoruar respektimin e kushteve të kontratës në lidhje me investimet dhe punësimet e kryera, por ka bërë verifikim, përmes Drejtorisë së Financës, vetëm për detyrimet e pagesës së qirasë.*

Për rrjedhojë, zbatimi i këtyre detyrimeve sipas pikës 13 të udhëzimit nr. 13, datë 26.4.2018 në zbatim të VKM nr.54/2018 është parakusht për lidhjen e kontratës me nr.2281 datë 04.03.2021, e konsideruar si shtesë mbi kontratën e mëparshme.

Njësia monitoruese e kontratave të qirasë , sipas urdhrin nr.233 datë 29.03.2019 është Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Ujërave, me **Drejtor z. Faik Sula (2019 deri qershor 2021)**, cila ka kryer verifikim vetëm në lidhje me detyrimet mujore, por nuk ka kryer verifikime çdo 6 muaj në lidhje me zbatimin e detyrimeve sa u përket kushteve të kontratës për investimet dhe nivelin e punësimeve.

3. ***Nga auditimi i kontratës me nr. 4584 prot., datë 19.06.2020*** mes Bashkisë Kamëz dhe shoqërisë **“Tirana Bank”**, rinovuar me kontratën nr.7155/1 prot., datë 21.07.2021, me objekt dhënien me qira të sipërfaqes prej 165 m<sup>2</sup> brenda Pallatit të Kulturës, kundrejt çmimit 530 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton se:

Me vendimin nr.49 datë 02.06.2020 është miratuar në parim dhënia me qira e ambienteve brenda të Pallatit të Kulturës, të llojit “ndërtesë” me sipërfaqe 165 m<sup>2</sup>

Me urdhrin nr.238 datë 16.06.2020 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës për mbledhjen e kërkesave të interesit dhe ofertave ekonomike për dhënien me qira të sipërfaqes prej 165 m<sup>2</sup>, i përbërë nga znj. Uarda Elezi, përgjegjëse e zyrës ligjore, z. Ardjen Markola, specialist pranë sektorit ligjor dhe z. Ernest Sinani, specialist pranë MTPT-së, bordit të kullimit dhe pyjeve. Sipas këtij urdhri, ky grup brenda 5 ditëve duhet të hartonte relacionin “Për mbledhjen e kërkesave të interesit dhe ofertave ekonomike, si dhe propozimin për ofertën ekonomike më të volitshme.

Me kërkesën e datës 16.06.2020, protokolluar në bashki me nr.4471 datë 17.06.2020 ka paraqitur ofertën subjekti “Tirana Bank”, për marrjen me qira me vlerë 530 lekë/m<sup>2</sup>

Me kërkesën e datës 15.06.2020, protokolluar me nr.4551 prot., datë 18.06.2020 në Bashki ka paraqitur ofertën Personi Fizik Sabri Kotoroja me vlerën 350 lekë/m<sup>2</sup>;

Me kërkesë nr.4450 datë 18.06.2020 ka paraqitur ofertën personi fizik z.Isak Lama me vlerë 230 lekë /m<sup>2</sup>;

Në përfundim, është lidhur kontrata me subjektin “Tirana Bank”.

#### **Nga ana procedurale rezulton se:**

- Mungon relacionin për mbledhjen e kërkesave dhe ofertave ekonomike, sipas pikës 3 të Urdhrit nr.236 datë 16.06.2006.

- Në kushtet kur kjo procedurë ka parashikuar mbledhjen e ofertave, mungon njoftimi i shpalljes apo dokumentimi sesi janë përzgjedhur apo kanë dorëzuar ofertën tre subjektet e mësipërme, veprime në kundërshtim me pikën 6, kreu II të VKM nr.54/2014.

- Në kundërshtim me pikën 5, të Kreut II të VKM nr.57/2014, shkronjat (b)-(dh), në urdhrin e titullarit të institucionit për dhënien me qira ose enfiteozë nuk janë përcaktuar pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, sipas pikave 3 ose 4 të kreut I të këtij vendimi, të cilat caktohen, rast pas rasti, nga titullari i institucionit; vendi, data dhe ora, ku paraqiten dokumentet;

- Mungon procesverbali i zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

- Të tre ofertuesit, përfshirë subjektin fitues me të cilën është lidhur kontrata, nuk kanë paraqitur dokumentet e detyrueshme sipas pikës 7, Kreu II, konkretisht planbизнесin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen; certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR; NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore; vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

4. ***Nga auditimi i kontratës nr. 4546 datë 29.04.2021*** lidhur mes Bashkisë Kamëz dhe shoqërisë “Gemini” shpk me përfaqësues z. Hasan Bara me objekt dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor kombëtar me sipërfaqe 0.8530 ha kundrejt vlerës 375,320 lekë ha/ vit, përlllogaritur sipas VKM nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar me VKM nr.1064/2010, rezultoi se:

-Me shkresën nr.1857 prot., datë 24.02.2021, shoqëria “Gemini “ shpk ka bërë kërkesën për të lidhur kontratën e qirasë për këtë sipërfaqe, për të cilën ka qenë në marrëdhënie qiraje me organet e qeverisjes vendore që e kanë patur në administrim, konkretisht me ish-komunën Nikël dhe Bashkinë Krujë.

Duke ju referuar VKM nr.360 datë 29.05.2019 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo territorial të njërive të vetëqeverisjes vendore”, territori ku subjekti ushtron aktivitetin në fushën e inerteve gjendet brenda kufijve administrativë të Bashkisë Kamëz e si rrjedhojë është kërkuar lidhja e kontratës me këtë bashki.



- **Nga verifikimi i dokumentacionit është konstatuar se :**

Ekonomia pyjore Terkuze-Droje nuk bën pjesë në listën e inventarit të fondit pyjor të kaluar me Vendimin nr.443 datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit”, të ndryshuar. **Për pasojë, Bashkia Kamëz nuk disponon certifikatë pronësie për këtë pasuri.**

Bashkia Kamëz nuk ka administruar dokumentet kadastrale mbi të dhënat e pasurisë, konfigurimin hartografik dhe statusit juridik të pronësisë nga DVASHK Kamëz-Vorë

Objekti i aktivitetit “shesh depozitimi të materialeve inerte” është në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”.

Nga verifikimi në ortofoto, rezulton se subjekti shfrytëzon një sipërfaqe prej 2 ha dhe ose rreth 11470 ha më shumë sesa ka paraqitur në planvendosje.

- Në lidhje me kontratat e qirasë së lidhur mes bashkisë Kamëz dhe subjekteve private , janë audituar kontratat sipas tabelës si mëposhtë:

Nr.	Qiradhënës	Objekti	Vlera
1	Lulëzim Matranxhi	Marrja me qira e një sipërfaqeje prej 105 m2 (njëqind e pesë metër katror) për ambiente punë : "Kopësht për fëmijë".	35.000 lekë/ muaj (01.10.2020-31.12.2021) 35.000 lekë/ muaj (09.03.2022-2023)
2	Pëllumb Veli Mehmeti përfaqësuar nga znj. Trëndafile Veli Mehmeti	Marrja me qira e një sipërfaqeje prej 1250 m2 në total, nga këto 544.1 m2 ndërtesë, ambient i cili do të përdoret për zyrat e Ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërim & Treg si dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.	199,000 lekë/muaj
3	Gentí Jegeni	Marrja me qira e një sipërfaqeje prej 280.78 m2 (dyqind e tetëdhjetë pikë shtatëdhjetë e tetë metër katror) ambient në të cilin do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre nëpunësit e Bashkisë Kamëz, konkretisht administrata e Lagjes Bathore.	100.000 lekë/muaj

**Nga auditimi i kontratës nr. 8438 prot, datë 21.10.2020** mes bashkisë Kamëz dhe subjektit privat z. Lulëzim Matranxhi, për marrjen me qira të një sipërfaqeje prej 105 m<sup>2</sup> kundrejt shumës 35,000 lekë, u konstatua se: -Mungon dosja e inventarizuar e praktikës së marrjes me qira, e për rrjedhojë nuk ka gjurmë auditimi; Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës; Mungon shpallja publike; Dokumentacioni i dorëzimit të ofertave dhe relacioni për vlerësimin e tyre; Procesverbali i marrjes në dorëzim; Si përfundim, për këtë kontratë qiraje nuk rezulton që të jetë kryer një procedurë konkurrimi me shpallje publike.

**Nga auditimi i kontratës nr. 3597 prot., datë 15.05.2020** mes bashkisë Kamëz dhe subjektit privat z. Pëllumb Veli Mehmeti, për marrjen me qira të një sipërfaqeje prej 705.9 m<sup>2</sup> truall dhe 544 m<sup>2</sup> ndërtesë kundrejt vlerës prej 199,000 lekë me afat 2 vjeçar e rinovim automatik për 1 vit, u konstatua se: Mungon dosja e inventarizuar e praktikës së marrjes me qira, e për rrjedhojë nuk ka gjurmë auditimi; Mungon urdhri për ngritjen e grupit të punës; Mungon shpallja publike; Dokumentacioni i dorëzimit të ofertave dhe relacioni për vlerësimin e tyre; Kartela e pasurisë së paluajtshme është e parifreksuar dhe daton në vitin 2017; Kontrata është e panoterizuar; Si përfundim, për këtë kontratë qiraje nuk rezulton që të jetë kryer një procedurë konkurrimi me shpallje.

**Nga auditimi i kontratës nr. 6714 prot, datë 06.11.2019** mes bashkisë Kamëz dhe subjektit privat z. Gent Jegeni, për marrjen me qira të një sipërfaqeje prej 280.78 m<sup>2</sup> ndërtesë kundrejt vlerës prej 100,000 lekë me afat 5 vjeçar u konstatua se: Mungon dosja e inventarizuar e praktikës së marrjes me qira, e për rrjedhojë nuk ka gjurmë auditimi; Me urdhrin nr.620 datë 04.11.2019 është ngritur grupi i punës, i përbërë nga z.Ylli Shehu, znj. Flora Muca dhe z. Sherif Lita për marrjen me qira të ambienteve në lagjen Bathore dhe përcaktimin e kushteve që duhet

të plotësojnë ambientet; Me procesverbalin nr.620/1 datë 06.11.2019, grupi i punës shprehet se sipërfaqja prej 186.5 m<sup>2</sup> e ambienteve në godinën ekzistuese , kundrejt vlerës 85,000 lekë në muaj, për shkak të fluksit të qytetarëve nuk është funksionale. Për këtë shkak, grupi i punës arsyeton marrjen me qira të një sipërfaqeje më të madhe; Mungon shpallja e publike; Dokumentacioni i dorëzimit të ofertave dhe relacioni për vlerësimin e tyre; Kartela e pasurisë së paluajtshme është e parifreskuar dhe daton në vitin 2017; Kontrata është e panoterizuar.

Në lidhje me kontratat e mësipërme, ku Bashkia Kamëz është në cilësinë e qiramarrësit, konstatohet se nuk identifikohet një kriter i posaçëm e i qartë, p.sh një VKM apo udhëzim i brendshëm, mbi mënyrën sesi duhen realizuar këto procedura. Kjo për arsyen kryesore se ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 7 i përjashton këto kontrata qiraje nga objekti i prokurimit publik.

Sa më sipër, nga ana e Bashkisë Kamëz duhet marrë masa për miratimin e një urdhri të brendshëm për “Ngritjen e Komisionit të Përhershëm për marrjen me qira të objekteve, për qëllime të aktiviteteve të Bashkisë”, ku të përcaktohet :

- Kushtet dhe specifikimet teknike për ambientet
- Të kryejë një procedurë konkurruese nëpërmjet publikimit të kërkesës për ofertë
- Të hartojë procesverbal për ofertën fituese dhe relacionin përkatës mbi kriteret e vlerësimit të ofertave, përfshirë raportin përmbledhës.

**Titulli gjetjes 2:** Mos zbatimi i kuadrit rregullator në procedurat e dhënie me qira të pasurive të paluajtshme të bashkisë Kamëz.

**Situata:**

Nga auditimi i kontratës me nr.25 rep, 126 kol datë 24.01.2019 me shoqërinë “Bio Prudct Shpk, kontratës me nr.2281 datë 04.03.2021 me subjektin “Petrit Syla, kontratës me nr. 4584 prot., datë 19.06.2020 me shoqërinë “Tirana Bank”, kontratës me nr.4546 datë me shoqërinë “Gemini” shpk janë vërejtur mangësi të dokumentacionit të detyrueshëm si dhe moszbatimi i kriterëve proceduariale.

**Kriteri:**

VKM nr.54/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe dhënien me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe udhëzimit nr. 13, datë 26.4.2018 në zbatim të VKM përkatëse.

**Ndikimi/Efekti:**

Kryerja e procedurave që kanë sjellë një konkurrin jo të plotë.

**Shkaku:**

Moszbatimi i kuadrit rregullator.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Kamëz të marrë masa për plotësimin e dosjeve përkatëse me dokumentacionin e detyrueshëm, si dhe të kryejë monitorime për zbatimin e kushteve të kontratës për nivelin e punësimit dhe investimeve nga subjektet çdo 6 muaj.

- *Dhënia me qira e tokave bujqësore, procedurat e ndjekura*

Nga bashkia Kamëz nuk janë realizuar procedura për dhënien me qira të tokave bujqësore. Sipas dokumentacionin qe disponon drejtoria MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, sipërfaqja totale e tokës bujqësore është 1658 ha, nga të cilat sipërfaqja prej 1388 ha është ndarë sipas ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 ‘Për Tokën’.

Tokë Bujqësore Gjithsej	1658 ha	741.1 ha
Ndare me ligjin 7501	1388 ha	Pa info

Në këtë rast, për diferencën prej 270 ha, që supozohet të jetë e lirë nga ana e Bashkisë Kamëz, marrë parasysh nivelin e lartë të legalizimeve të cilat e ndryshojnë automatikisht zërin kadastral nga “arë në” truall”, duhet verifikuar në bashkëpunim me DVASHK-Kamëz Vorë se cilat parcela apo ngastra rezultojnë të lira për t’u administruar dhe dhënë me qira nga bashkia. Për këtë qëllim, me shkresën nr.424 prot, datë 10.06.2020, Bashkia Kamëz i ka dërguar një shkresë DVASHK-së përkatëse që t’i vihet në dispozicion një kopje e Printimeve të Treta për gjithë territorin, për efekt edhe të përlogaritjes reale të faturave për taksës bujqësore.

- Vlerësimi i punës për tokat bujqësore, azhurnimet e kryera mbi zbatimin e ligjshmërisë për veprimet e kryera në marrëdhëniet e ndryshimeve të pronësisë dhe regjistrimi në ASHK

**Titulli gjetjes 3:** Nga Bashkia Kamëz janë përcjell për regjistrim në Drejtorinë Vendore të ASHK Kamëz-Vorë akte të marrjes së tokës në përdorim dhe jo në pronësi.

#### **Situata:**

1. Nga auditimi i dosjes në emër të z. Fatos Xhafer Noreca, me shkresën nr.434 datë 17.07.2019 është dërguar dokumentacioni për regjistrimin e Aktit të Marrjes së Tokës në Përdorim (AMTP) me sipërfaqe 4200 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në relacionin shpjegues, me nr. 434 prot., datë 17.07.202 përcaktohet se:

*“Në bazë të verifikimit në terren dhe dokumentacionit që disponon Drejtoria e Kadastrës, rezulton se familja e z. Fator Noreci është trajtuar me tokë në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, me një sipërfaqe 4200 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 196, ZK 2066-Kamëz. Qytetari disponon Aktin e Marrjes së Tokës në Përdorim të dhënë nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, kurse Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nuk e disponon, për arsye se e ka humbur. Duke qene përpara këtij fakti që z.Fatos Noreci është pronar i sipërfaqes, po ju përcjellim për regjistrim fillestar dokumentacionin”.*

2. Nga auditimi i dosjes së z. Ismail Hamza Bruti (trashëgimtarët) për regjistrimin e Aktit të Marrjes së Tokës, me sipërfaqe totale 4800 m<sup>2</sup>, rezulton se me shkresën nr.7663 prot, datë 16.12.2019 është dërguar dokumentacioni për regjistrim fillestar vetëm për ngastrën nr.17 me sipërfaqe 2800 m<sup>2</sup> në emër të trashëgimtareve. Në relacionin shpjegues përcaktohet se familja e z. Ismail Hamza Brete është trajtuar me tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për Tokën”, por në këtë dosje mungon formulari nr.6 që provon se qytetari është trajtuar me pronë dhe korrespondenca përkatëse për konfirmim nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut.

E njëjta problematikë rezulton edhe në praktikat si më poshtë:

Në AMTP në emër të z. Fadil Baftjar Dragjosi për regjistrimin e sipërfaqes 1840 m<sup>2</sup> arë, dërguar me shkresën nr.395 datë 27.06.2019

Në AMTP në emër të z. Fatmir Muharrem Sela me sipërfaqe 4800 m<sup>2</sup> dërguar me shkresën nr.403 datë 05.07.2019

Në AMTP në emër të z. Besim Asllan Sela, me sipërfaqe 9600 m<sup>2</sup> arë

Në AMTP në emër të z. Besim Bajram Sela, me sipërfaqe 8000 m<sup>2</sup> arë

Në AMTP në emër të z. Asllan Ismail Sylja, me sipërfaqe 10670 m<sup>2</sup> arë, dërguar me shkresën nr.427 prot., datë 16.07.2019

Në AMTP në emër të z. Hysen Mustafa Murato, me sipërfaqe 6450 m<sup>2</sup> arë, dërguar me shkresën nr.449 prot., datë 23.07.2019

3. Nga auditimi i dosjes të z. Xhafer Ismail Hasa për regjistrimin e Aktit të Marrjes së Përdorim me sipërfaqe totale 4800 m<sup>2</sup>, rezulton se është dërguar dokumentacioni për regjistrim fillestar vetëm për parcelën nr 8. me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup> në.

Konstatohet se dërgimi i kësaj shkresë është në kundërshtim me VKM nr 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, pasi qytetari disponon Aktin e Marrjes së Tokës në Përdorim, akt ky që është i paregjistruar në kadastrës dhe nuk konsiderohet titull pronësie.

**Kriteri:**

Sa më sipër, konstatohet se dërgimi i kësaj shkresë është në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, e cila ka për objekt Aktin e Marrjes së Tokës në **Pronësi dhe jo të Përdorimit** që disponon qytetari, akt ky që është i paregjistrueshëm në kadastrë nuk konsiderohet titull pronësie. Nga ana tjetër, formularin bashkëlidhur përfshin listën e qytetarëve që kanë marrë tokë në përdorim dhe jo që u është dhënë në pronësi.

**Ndikimi/Efekti:**

Aktin e Marrjes së Tokës në Përdorim është i paregjistrueshëm në kadastrë dhe nuk konsiderohet titull pronësie lehtë.

**Shkaku:**

Zbatim i gabuar i kuadrit rregullator.

**Rëndësia: E lartë**

**Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Kamëz të marrë masa për:

- Mos përcjell për regjistrim ose konfirmim të AMTP-ve në Drejtorinë Vendore të ASHK Kamëz-Vorë praktika ku dokumentacioni mbështetës nuk është në përputhje me kuadrin ligjorë për regjistrim.
- T'i kërkuar DVASHK Kamëz-Vorë mos kryerjen e veprimeve për regjistrimin e praktikave z. Fatos Xhafer Noreca dhe praktika e z. Xhafer Ismail Hasa, pasi AMTP nuk janë në pronësi por në përdorim.

- Mbi menaxhimin dhe administrimin e asetëve objekteve ndërtimore, social kulturor, asetet me funksion ekonomik etj.

Për këtë pikë, është shqyrtuar dokumentacioni në lidhje me pasuritë e paluajtshme që i përkasin sferës së banesave sociale, për të cilat rezulton se me Vendimin nr.54 datë 20.12.2019 të Këshillit Bashkiak Kamëz është miratuar procedura për kontributin dhe krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të bashkisë Kamëz nga ndërtimet e reja. Ky vendim vjen në kuadër të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 19, të ligjit nr.22/2018 “Për strehim social” i cili përcakton se:

“Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m<sup>2</sup>, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

3% E SIPERFAQES TOTALE TE BANIMIT NE FAVOR TE FONDIT TE STREHIMIT SOCIAL				
Nr.	Zhvilluesi	Siperfaqja takuese e banimit (m2)	Nr.Protokoll	
1	"Lala Construction" shpk	214.32	2902	2021
2	"DAEL CONSTRUCTION" shpk & "B I CONSTRUCTION" shpk	219.91	1758	2020

3% E SIPERFAQES TOTALE TE BANIMIT NE FAVOR TE FONDIT TE STREHIMIT SOCIAL				
Nr.	Zhvilluesi	Siperfaqja takuese e banimit (m2)	Nr. Protokoll	
3	"MANE TCI" shpk	526.14	3330	2022
4	"STAR TEK" shpk	570.09	3353	2021
5	"MANE TCI" shpk	254.6	3205	2021
6	"SHIRZANA" shpk	141.31	2035	2021
7	"DEMOLLARI KONSTRUKSION" shpk	142.65	3469	2022
8	"ALES CONSTRUCTION" shpk	265.05	3484	21.04.2022
9	"BUSHGJOKAJ" shpk	95.1	1595	21.04.2020
10	"DEVELALB CONSTRUCTION" shpk	545.58	3502	19.10.2021
11	"DAEL CONSTRUCTION" shpk & "B I CONSTRUCTION" shpk	150.48	3235	27.07.2021
12	"Arb&Trans-2010" shpk	240.12	3831	17.02.2022
13	"RIVIERA" shpk	765.21	3815	10.02.2022
14	"Mehillaj" shpk	261.3	3035	02.06.2021
15	"2ATH" shpk	121.86	2830	17.04.2021
16	"B I Construction" shpk	183.18	2816	15.04.2021
17	"IBA Investments" shpk	225.39	1440	30.12.2019
18	"DAEL CONSTRUCTION" shpk & "B I CONSTRUCTION" shpk	154.47	4285	30.06.2022
19	"SHIRZANA" shpk	196.68	3419	25.09.2021
20	Erzeni	389.8	4155	07.06.2022
21				
22	<b>TOTAL.</b>	<b>5663.24 m2</b>		

Ndryshe nga ky përcaktim ligjor, që ve theksin në kalimin në pronësi të bashkisë të të paktën 3% të sipërfaqes ndërtimore për banim, në godinën për të cilën është dhënë leja ose në pamundësi në një godinë tjetër, në VKB nr.54/2019 ndërtuesve u është atribuar e drejta e zgjedhjes, që në rast të mos dorëzimit të sipërfaqes së ndërtimit, të konvertojnë sipërfaqen takuese në vlerë leku, sipas çmimeve të referencave.

Nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit janë marrë masa për aplikimin në dokumentacionin e lejes së ndërtimit të detyrimit ligjit për 3% të sipërfaqes ndërtimore për banim.

Megjithatë, problematika e konstatuar ka të bëjë me mënyrën sesi do të zbatohet ky detyrim. Konkretisht dokumentacioni i lejes së ndërtimit përmban deklaratat noteriale me ndërtuesit dhe akt-marrëveshjet, por këto të fundit janë të natyrës deklarative që subjekti merr përsipër detyrimin prej 3%, por duke mos përcaktuar nëse do ta zbatojë duke ofruar sipërfaqe ndërtimi apo konvertuar si detyrim në vlerë. Po ashtu, akt-marrëveshjet nuk janë të shoqëruar me planimetri dhe dokumentacion që individualizon sipërfaqen 3% në projektin e ndërtimit. Kjo dhe për arsyen pasi VKB Kamëz ka parashikuar që kalimi fizik i pasurive të fituar në këtë kuadër, të bëhen jo më vonë se në momentin e lëshimit të certifikatës së përdorimit (për të gjitha subjektet sipas tabelës si më sipër, ende nuk janë lëshuar certifikata përdorimi). Po ashtu, sipas akt-marrëveshjeve, palët kanë rënë dakord që transferimi i titullit të pronësisë të 3% dhe regjistrimi i titullit të pronësisë do të bëhet në favor dhe emër të Bashkisë Kamëz përmes nënshkrimit të një kontrate përfundimtare, fakt ky që i bën aktmarrëveshjet aktuale që të jenë të natyrës së ndërmjetme, e për rrjedhojë zbatimi real i detyrimit do të përcaktohet në marrëveshjen përfundimtare me lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Si konkluzion, Vendimin nr.54 datë 20.12.2019 të Këshillit Bashkiak Kamëz, pika 6, e cila parashikon konvertimin në lekë të detyrimit për të dorëzuar të paktën 3% të sipërfaqe ndërtimore për banim është në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr.22/2018 "Për strehim social".

**Titulli gjetjes 4:** Mbi krijimin e fondit publik të banesave sociale .

**Situata:**

Me Vendimin nr.54 datë 20.12.2019 të Këshillit Bashkiak Kamëz është miratuar procedura për kontributin dhe krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të bashkisë Kamëz nga ndërtimet e reja. Ndryshe nga detyrimi i ligjit nr.22/2018 “Për strehim social, që ve theksin në kalimin në pronësi të bashkisë të të paktën 3% të sipërfaqes ndërtimore për banim, në godinën për të cilën është dhënë leja ose në pamundësi në një godinë tjetër, në VKB nr.54/2019 ndërtuesve u është atribuuar e drejta e zgjedhjes, që në rast të mos dorëzimit të sipërfaqes së ndërtimit, të konvertojnë sipërfaqen takuese në vlerë leku, sipas çmimeve të referencave.

**Kriteri:**

Ligji nr.22/2018 “Për strehim social”.

**Ndikimi/Efekti:**

Nga të dhënat e administruara rezultojnë një sipërfaqe prej 5663.24 m<sup>2</sup> për 20 leje ndërtimi që duhet t'i dorëzohet si fond banesash bashkisë Kamëz.

**Shkaku:**

Moszbatim i plotë i kuadrit rregullator.

**Rëndësia: E mesme**

**Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Kamëz të vlerësojë marrjen e masave që detyrimin e çdo subjekti për dorëzimin 3% të sipërfaqes së ndërtimit si fond banesash të ndajë 50% të sipërfaqes në vlerë dhe 50% si banesë sociale 6.

Nga subjekti audituar Bashkia Kamëz nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e Projektraport Auditimit mbi gjetjet e konstatuara nga menaxhimi aseteve.

**2.9. Të ndryshme të dala gjatë auditimit (shqyrtim ankesash).**

**Verifikimi i ankesës së qytetarëve banues në rrugën “ Abdi Bej Toptani”, Bashkia Kamëz**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1023/1, datë 15.11.2021, pika “Të ndryshme”, mbahet ky akt verifikimi nga audituesit e KLSH-së Z. Alush Zaçe dhe z. Kristaq Gjurgjaj, u krye verifikimi i ankesës së qytetarëve banues në rrugën “Abdi Bej Toptani”, Bashkia Kamëz, protokolluar në KLSH me nr. 71 prot., datë 18.01.2023, me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave për siguri rrugore në rrugën “ Abdi Bej Toptani”, Valias, Bashkia Kamëz”.

Në këtë kërkesë/ankesë të 24 qytetarëve, citohet mungesa e plotë e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale, që ka shkaktuar aksidente të shumta, të cilat fatmirësisht deri në këtë kohë, nuk kanë qenë me pasojë vdekjen.

Kjo ankesë i është drejtuar edhe Bashkisë Kamëz.

U kërkua dokumentacioni i nevojshëm për këtë ankesë dhe rezultoi se;

Objekti “Ndërtim rruga Abdi Bej Toptani” është realizuar në vitin 2017 me kontratën e sipërmarrjes nr. 269, datë 11.05.2017. Në preventivin e punimeve nuk është parashikuar asnjë lek për sinjalistikë rrugore.

Me shkresën përcjellëse nr. 21/3, datë 31.01.2023, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, ka njoftuar Bashkinë Kamëz për masat e marra për sigurinë rrugore në këtë aks rrugor, pas marrjes së ankesës.

Në këtë shkresë, njoftohet se nga ana e kësaj ndërmarrje, janë në pritje që brenda 5 ditëve të bëjnë plotësimin e këtij segmenti rrugor me 7 vendkalime për këmbësorë dhe 24 tabela rrugore.

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në vlerën 716,700,299 lekë, detyrime këto të trashëguara që nga viti 2003, të cilat nuk janë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me shpresë arkëtimi dhe pa shpresë arkëtimi, veprime në kundërshtim me rubrikën 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publiku”, të udhëzimit nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrë masa për të analizuar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 716,700,299 lekë, për të evidentuar klasifikimin e debitorëve me dhe pa shpresë arkëtimi, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021, nga Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz është kryer inventari fizik për llogaritë 202, 210, 212, 214, 218, 31 dhe 32, ndërsa për llogarinë 213 inventari është mbyllur vetëm me gjendjen kontabël të tyre, për të cilën informacioni kontabël është i pasaktë, veprime këto në kundërshtim me pikën 74, kreu IV, “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në pikën nr. pikën 2.3, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrin masa për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e aktiveve në Bashkisë Kamëz.

**Brenda datës 31.12.2023**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatua se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” me kundërparti në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar”, ka gjendje vlerën 61,600,632 lekë. Kjo gjendje përbën garancitë prej 5% të vlerës së investimit të cilat u mbahen operatorëve ekonomik si garanci për kontratat e nënshkruara. Nga verifikimi analitik i kësaj llogarie, vlera 283,214 lekë i përket viteve 2006-2007 dhe rezulton ende e pa tërhequr. Këto garanci punimesh janë të vjetra dhe normalisht duhet të ishin paguar në favor të operatorëve ekonomik ose duhet të ishin mbajtur si penalitet për shkak të mospërbushjes së kontratës në kohë apo defekteve gjatë periudhës së garancisë.

Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit dhe Ekonomike, nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli III, rubrika 3.1, pika 30 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit në bashkëpunim Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Kamëz dhe me Degën e Thesarit të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet që janë marrë në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratë, të bëjnë njoftimet e subjekteve për marrjen e garancive të punimeve

në masën 5%, ose vlera të kalojë në favor të autoritetit kontraktor për mospërbushje të kushteve të kontratës.

#### **Brenda datës 30.06.2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi menaxhimin e aseteve në Bashkinë Kamëz, rezulton se nga totali prej rreth 2000 pasuri që i janë transferuar kësaj bashkie, përfshirë zonën e Paskuqanit, janë dërguar për regjistrim **93 pasuri**, nga të cilat vetëm **47 janë regjistruar**. Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuar me VKM nr. 775/2013 për Bashkinë Kamëz dhe VKM nr. 454/2011 për ish- Komunën Paskuqan nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Kamëz-Vorë mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Inventari i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kamëz është i papërditësuar, veprime në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Sa u përket pasurive për të cilat Bashkia Kamëz i ka regjistruar në DVASHK Kamëz -Vorë, sipas natyrës së funksionit rezultojnë **6 pasuri** të llojit truall, pyll dhe livadh me vlerë **16,299,900 lekë** të cilat nuk janë kontabilizuar sipas çmimeve të referencës përcaktuara në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet Strukturës së Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtorisë Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrin masa për përditësimin e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në DVASHK Kamëz -Vorë.

**4.2. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz, të marrë masa për kontabilizimin e vlerës 16,299,900 lekë të 6 pasurive të llojit truall, pyll dhe livadh të regjistruara në DVASHK Kamëz -Vorë.

#### **Brenda datës 31.12.2023**

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkisë Kamëz me VKM nr. 433 datë 08.06.2006 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit”, të ndryshuar, janë transferuar 7 ekonomi pyjore/kullosore. Këto pasuri nuk janë regjistruar në DVASHK Kamëz-Vorë dhe nga ana e bashkisë, për shkak të mos përfundimit të regjistrimit fillestar, ende nuk janë hartuar plane mbarështimi për menaxhimin e tyre me qëllim dhënien në përdorim, sipas parashikimeve të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet” dhe Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrisë të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Struktura përgjegjëse e pyjeve, nuk është e përditësuar me ndryshimet e reja të legjislacionit në fushën e pyjeve, dhe konkretisht me VKM-në nr.171, datë 18.03.2022, “Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullosor si dhe manualët e përdorimit të programit ALFIS” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit (strukturat përgjegjëse), të rakordojë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve mbi statusin e regjistrimit fillestar të ekonomive pyjore/kullosore për pasqyrimin e sipërfaqeve përkatëse të këtyre pasurive në fondin dixhital të pyjeve ALFIS.

#### **Brenda datës 31.12.2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës me nr. 2281 datë 04.03.2021 ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe subjektit “**Petrit Sylja**”, me objekt dhënien me qira të pasurisë shtetërore ambiente brenda pallatit të kulturës të llojit “ndërtesë” me sipërfaqe 101.4 m<sup>2</sup>, e miratuar si shtesë për plotësimin e kontratës së mëparshme datë 01.04.2019, *rezulton se:*



Kontrata me nr. 2281 datë 04.03.2021 është lidhur në kundërshtim me pikën 5, germa (e) të Kreut I-rë të VKM nr. 54/2014, datë 05.02.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, e cila përcakton se: “*shtesat në kontratë për sipërfaqet që kërkohen nga qiramarrësi për të shtuar ose për të përmirësuar veprimtarinë bëhen për sipërfaqe jo më shumë se 50% e sipërfaqes totale të marrë me qira dhe vetëm në rastet kur sipërfaqja shtesë shtrihet në kufi me sipërfaqen e kontratës brenda së njëjtës zonë kadastrale*”, pasi është lidhur për një sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>, ndërkohë që duhej 50% e kontratës fillestare ose 50.7 m<sup>2</sup>.

Për këtë subjekt konstatohet se ndonëse i ka shlyer detyrimet në total, pagesa nuk kryhen brenda intervaleve kohore, çdo muaj, të parashikuar në kontratë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore në Bashkinë Kamëz, të marrin masa që për çdo shtesë kontrate në të ardhmen të mos kapërcejë nivelin mbi 50% të sipërfaqes së përcaktuar në kontratën bazë, si dhe arkëtimin e detyrimeve kontraktuale sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

#### Në vazhdimësi

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës me nr. 4584 prot., datë 19.06.2020 ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe shoqërisë “**Tirana Bank**”, rinovuar me kontratën nr. 7155/1 prot., datë 21.07.2021, me objekt dhënien me qira të sipërfaqes prej 165 m<sup>2</sup> brenda Pallatit të Kulturës, kundrejt çmimit 530 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton se:

- Mungon relacionin për mbledhjen e kërkesave dhe ofertave ekonomike, sipas **pikës 3** të Urdhrit nr. 236 datë 16.06.2006.

- Në kushtet kur kjo procedurë ka parashikuar mbledhjen e ofertave, mungon njoftimi i shpalljes apo dokumentimi sesi janë përzgjedhur apo kanë dorëzuar ofertën tre subjektet që kanë marrë pjesë, veprime në kundërshtim me **pikën 6, kreu II** të VKM nr. 54/2014, datë 05.02.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar.

- Të tre ofertuesit, përfshirë subjektin fitues me të cilën është lidhur kontrata, nuk kanë paraqitur dokumentet e detyrueshme sipas **pikës 7, kreu II**, konkretisht planbiznesin e hollësishtëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen; certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR; NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore; vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Çështjeve Ligjore në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve Bashkia Kamëz, të marrin masa për plotësimin e dosjes me planin e punësimit dhe investimeve, si dhe për çdo procedurë konkurrimi në të ardhmen ta shoqërojë me relacionin për mbledhjen e ofertave, ku të jenë përcaktuar qartë kriteret e konkurrimit dhe sistemi i pikëzimit të ofertave.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës nr. 4546 datë 29.04.2021 lidhur ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe shoqërisë “Gemini” shpk me objekt dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor kombëtar me sipërfaqe 0.8530 ha kundrejt vlerës 375,320 lekë ha/vit, përllëgaritur sipas VKM nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar me VKM nr. 1064/2010, rezultoi se:

- Ekonomia pyjore Terkuze-Droje nuk bën pjesë në listën e inventarit të fondit pyjor të kaluar me Vendimin nr. 443 datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit”, të ndryshuar. Për pasojë, Bashkia Kamëz nuk disponon certifikatë pronësie për këtë pasuri.

- Bashkia Kamëz nuk ka administruar dokumentet kadastrale mbi të dhënat e pasurisë, konfigurimin hartografik dhe statusin juridik të pronësisë nga DVASHK Kamëz-Vorë.
- Objekti i aktivitetit “shesh depozitimi të materialeve inerte” është në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.
- Nga verifikimi në ortofoto, rezulton se subjekti shfrytëzon një sipërfaqe prej 2 ha dhe ose rreth 11470 ha më shumë sesa ka paraqitur në planvendosje (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për kryerjen një verifikimit në terren për sipërfaqen reale që shfrytëzon subjekti përkatës, duke hartuar një aneks kontrate dhe llogaritur detyrimin për sipërfaqen mbi sipërfaqen e kontratës bazë, si dhe të përcaktohet detyrimi për zëvendësimin e sipërfaqes së shpyllëzuar nga aktiviteti i subjektit.

**Brenda datës 30.06.02023**

**8.2. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore në Bashkinë Kamëz, në të ardhmen të mos lidhin kontrata qiraje në pasuri të cilat nuk janë në pronësi të bashkisë dhe të regjistruara me certifikatë pronësie në DVASHK Kamëz-Vorë.

**Në vazhdimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me zbatimin e detyrimeve kontraktore për të gjitha kontratat e qirave rezulton se njësia monitoruese e kontratave të qirasë të realizuar nga Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit (strukturat përgjegjëse), ngritur sipas urdhrin nr. 233 datë 29.03.2019, ka kryer verifikime vetëm në lidhje me detyrimet mujore, por nuk ka kryer verifikime çdo 6 muaj në lidhje me zbatimin e detyrimeve sa u përket kushteve të kontratës për investimet dhe nivelin e punësimeve, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54/2014, datë 05.02.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit (strukturat përgjegjëse) Bashkia Kamëz, të marrë masa për kryerjen çdo 6 muaj të verifikimit të kushteve të kontratave të lidhura, në lidhje me nivelin e investimeve dhe të punësimit. Për këtë qëllim, ky raport të jetë pjesë integrale e dokumentacionit të shqyrtimit të çdo procesi për rinovim kontrate.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Me Vendimin të KB nr. 54 datë 20.12.2019 është miratuar procedura për kontributin dhe krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të Bashkisë Kamëz nga ndërtimet e reja. Ndryshe nga detyrimi i ligjit nr. 22/2018 “Për strehim social”, që ve theksin në kalimin në pronësi të bashkisë të të paktën 3% të sipërfaqes ndërtimore për banim, në godinën për të cilën është dhënë leja ose në pamundësi në një godinë tjetër, në pikën 6 të Vendimin e KB nr.54/2019 ndërtuesve u është atribuar e drejta e zgjedhjes, që në rast të mos dorëzimit të sipërfaqes së ndërtimit, të konvertojnë sipërfaqen takuese në vlerë leku, sipas çmimeve të referencave, në kundërshtim me nenin 19, të ligjit nr. 22/2018, datë 3.5.2018 “Për strehim social”.

Nga të dhënat e administruara rezulton një sipërfaqe prej 5663.24 m<sup>2</sup> për 20 leje ndërtimi që duhet t’i dorëzohet si fond banesash Bashkisë Kamëz. Si konkluzion, Vendimi nr.54 datë 20.12.2019 të Këshillit Bashkiak Kamëz. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim Territorit, të marrin masa që detyrimin e çdo subjekti për dorëzimin 3% të sipërfaqes së ndërtimit si fond banesash të ndajë 50% të sipërfaqes në vlerë dhe 50% si banesë sociale 6.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi regjistrimin e AMTP-ve të banorëve, rezultoi se në **2 raste**, konkretisht: praktika e z. Fatos Xhafer Noreca dhe praktika e z. Xhafer Ismail Hasa, nga Bashkia Kamëz janë përcjell për regjistrim në Drejtorinë Vendore të ASHK Kamëz-Vorë akte të marrjes së tokës në përdorim. Dërgimi i këtij dokumentacioni është në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, e cila ka për objekt Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi dhe jo të përdorimit, akt ky që është i pa regjistrueshëm në kadastër dhe nuk konsiderohet titull pronësie.

Në **7 raste**, nga auditimi i procedurave për regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, rezultoi se mungon formulari nr.6 që provon se qytetari është trajtuar me pronë dhe korrespondenca përkatëse për konfirmim nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut. Gjithashtu dosjet ishin të pa inventarizuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 152-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandim:** Bashkia Kamëz të marr masa për:

- Mos përcjell për regjistrim ose konfirmim të AMTP-ve në Drejtorinë Vendore të ASHK Kamëz-Vorë, praktika ku dokumentacioni mbështetës nuk është në përputhje me kuadrin ligjorë për regjistrim.

- T’i kërkojë DVASHK Kamëz-Vorë mos kryerjen e veprimeve për regjistrimin e praktikave të z. Fatos Xhafer Noreca dhe praktika e z. Xhafer Ismail Hasa, pasi AMTP nuk janë në pronësi por në përdorim.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës ushtrimore objekt auditimi, kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), ku në vitin 2021 ka gjithsej 11 shkresa për ndryshime në buxhet. Të gjitha ndryshimet janë miratuar me VKB dhe janë konfirmuar nga Prefekti. Ndryshimet e shumta në buxhet, tregojnë për planifikime jorealiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar si dhe nëpërmjet një analize realiste të situatës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të shoqërohen me sa më pak ndryshime dhe vetëm kur është nevoja e domosdoshme dhe e pashmangshme, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 31-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit, në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera në Bashkinë Kamëz, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

#### **Në vazhdimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi realizimin e të ardhurave për vitin 2021, rezultoi se ato janë realizuar në vlerën 792,636 mijë lekë nga vlera 1,473,934 mijë lekë të parashikuara ose në masën 53.77%. Mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore ka çuar në mos likuidimin e faturave të shpenzimeve dhe rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhës ushtrimore, pasi mbi bazën të ardhurave të planifikuara është parashikuar kryerja e shpenzimeve buxhetore të vitit 2021.

Niveli i ulët i arkëtimit të të ardhurave tregon se kemi të bëjmë më parashikim jo të mirë argumentuar të të ardhurave nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit, etj, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së shpenzimeve, në një mjet joreal, jo të qëndrueshëm dhe efektiv, veprime në

kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 31-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandim:** Bashkia Kamëz (strukturat përgjegjëse), të marrin masa që planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

#### **Menjëherë dhe vazhdimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Kamëz në fund të vitit 31.12.2021 raporton detyrime të prapambetura në vlerën 261,171,535 lekë, të cilat nuk janë likuiduar për shkak të mungesës së fondeve si rrjedhojë e mosrealizimit të të ardhurave në nivelet e planifikuara. Detyrimet e prapambetura janë një pengesë e konsiderueshme në mirëmenaxhimin e financave vendore, duke sjellë probleme në realizimin e shpenzimeve publike për ofrimin e shërbimeve dhe kryerjen e investimeve. Praktika e mos likuidimit në afatin e përcaktuar të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe mos shlyerja në kohë e tyre, krijon risk për pagesa penalitetesh duke rënduar në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore, veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014. Ligji nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”..

Situata financiare e Bashkisë Kamëz është normale në nivelin e 15.5% (1,684,353 /261,171,535) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës & Kontabilitetit, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një analizë për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vlerën 261,171,535 lekë, si dhe të hartojë një grafik për likuidimin e tyre sipas radhës së pagesave.

Të raportojë periodikisht në MFE si dhe të saktësojë vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve rezulton se:

Në total janë rekomanduar gjithsej **68 masa** të cilat janë pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 58 masa ose 85 %, janë në proces zbatimi 8 masa ose 11.6 % dhe nuk janë zbatuar 2 masa ose 3.4% e tyre, si më poshtë vijon:

**a. Nga 16 masa organizative**, të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar **13 masa**, në proces zbatimi **1 (një)** masë dhe nuk janë zbatuar **2 masa**.

**b. Nga 15 masa shpërblim dëmi me vlerë 7,260 mijë lekë**, pranuar nga subjekti, janë zbatuar 14 masa me vlerë 6,131,882 lekë dhe në proces zbatimi (në gjykatë) 1 masë me vlerë 1,128,914 lekë.

**c. Nga 6 masa për mos efektivitet të fondeve me vlerë 237,884 mijë lekë**, pranuar nga subjekti, janë zbatuar plotësisht, ku për personat përgjegjës janë dhënë masa disiplinore sipas aneksit 7.2 bashkëlidhur Raport Auditimit.

**d. Nga 6 masa mungesë të ardhurash me vlerë 901,750 mijë lekë**, pranuar nga subjekti, është zbatuar 1 (një) masë në vlerën 250 mijë lekë dhe janë në proces zbatimi 5 masa me vlerë 901,500 mijë lekë, ku janë arkëtuara vlera 7,474 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera **894,026 mijë lekë**, e cila është kryesisht detyrime nga taksat e tarifatat vendore dhe vlerën më të lartë e zënë abonentët familjarë.

**d. Nga 10 masa disiplinore**, të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

e. *Nga 15 masa administrative*, pranuar nga subjekti. Nga bashkia janë aplikuar penalitete në vlerën 900 mijë lekë, vlerë e cila është arkëtuar, sipas aneksi 7.3 bashkëlidhur Raport Auditimit, konkretisht:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit me objekt "Punë publike", me vlerë 341,522,287 lekë pa TVSH, të zhvilluara gjatë vitit 2020, konkretisht për procedurat: "Ndërtim KUN "Laknas" +KUN" Paralel me rrugën Adem Jashari; Ndërtim Rr. Deja + Rr. Bilal Xhaferrri + Rr. Bujar Bishanaku; Rr. Hali Hoxha + Rr. Islam Spahia+ Rr.Ded Gjon Luli (Fund); Ndërtim rruga " Nik Ndreka "; Ndërtim KUN "Skejave"+ KUN" Mustafa Lita"; Ndërtim Rr. "A. Galica (trotuare) + Rr. Baldushk+ Rr. "Europa"; Ndërtim KUN Rrugët Bathore 5; Ndërtim Rrugët Ylbere Bylikbashi (Faik Kulla)+ Rruga Xhemal Kada"; Ndërtim rruga "Lure + Fatos Çupi" Laknas; "Rehabilitim i Digës Rezervuari Paskuqan", është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, në kundërshtim me nenin 46, pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 5, por gjithashtu ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si vijon:

**a)-** NJP kërkon paraqitjen e **kopjeve të bilanceve** për 3 (tre) vitet e fundit ushtrimorë. Kjo kërkesë, pa asnjë argumentim apo arsyetim, është përdorur me dy standarde nga ana e NJP. Në disa raste (5 raste) është kërkuar që "bilancet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar", ndërsa në disa raste të tjera (5 raste) është kërkuar vetëm që "bilancet të jenë të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse".

**b)-** NJP kërkon paraqitjen e **licencave profesionale** me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit.

**c)-** NJP në përcaktimin e **numrit të punonjësve** ka përdorur standarde të dyfishta, thellësisht subjektive dhe kontradiktore. Konkretisht, për punime të së njëjtës natyre është kërkuar një numër më i madh punonjësish në procedura me fond limit (volum punimesh) më të vogël në krahasim me numrin e punonjësve të kërkuar për një procedurë tjetër me fond limit (volum punimesh) më të madh. (P.sh.: Për procedurën me objekt "Ndërtim KUN "Laknas" +KUN" Paralel me rrugën Adem Jashari" me fond limit 31,163,251 lekë pa TVSh janë kërkuar 41 punonjës, kur nga ana tjetër, për procedurën me objekt "Ndërtim KUN Rrugët Bathore 5" me fond limit 13,487,956 lekë pa TVSh (më shumë se 50% më të vogël) janë kërkuar 45 punonjës, pra një numër më i madh.

**ç)-** NJP në të gjitha rastet ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar** dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme (7-12 muaj).

**d)-** NJP në të gjitha rastet ka kërkuar një numër të pa-argumentuar të makinerive/pajisjeve. Nuk ka asnjë analizë teknike ku **sasia e makinerive/pajisjeve** të jetë përcaktuar në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volume e tyre apo grafikun e punimeve.

**dh)-** NJP në të gjitha rastet nuk ka argumentuar apo përcaktuar se për cilin zë konkret të punimeve nevojitet një certifikatë ISO konkrete nga ato të kërkuara. Gjithashtu referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e disa ISO-ve të kërkuara nga Njësia e Prokurimit.

**e)-** NJP për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim KUN Rrugët Bathore 5", ka kërkuar që OE ofertues duhet "të ketë kontraktuar një *Ekspert Zjarrfikës* i pajisur me licencë dhe i regjistruar si subjekt në QKR (eksperti), kërkesë kjo e panevojshme dhe e pa-argumentuar pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë lloje punimesh të cilat kërkojnë domosdoshmërisht kontraktimin e një Eksperti Zjarrfikës

**1.1. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit në lidhje me vendosjen e kriterëve për kategoritë e nevojshme të punimeve për zbatimin e kontratës në DST, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**Statusi: Pa zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Dokumenteve të Koncesionit "*Shërbimit të kryerjes së pastrimit, grumbullimit, transportimit, seleksionimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz*" nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të LPP dhe të ligjit për koncesionet. Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 26 "*Kontrata për punë publike*" pika "5"; neni 61, pika "2", dhe nenit 46 të LPP.

Komisioni ka hartuar dokumentet e procedurës konkurruese, në kundërshtim me VKM nr. 575 datë 10.07.2013 "*Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat*", Kreu V, neni 24 pika "2"; me nenin 23 të ligjit Nr. 125/2013 "*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*", i ndryshuar, pika 1, 2 dhe 5.

- Në lidhje me eksperiencën në shërbimin e pastrimit, nga AK kërkohet që Drejtuesi teknik të ketë eksperiencë jo më pak se 5 vite në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit. Në rast të mosplotësimit në kontratë eksperiencën 5 vjeçare, drejtuesi teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën në ofrimin e shërbimit të pastrimit. Drejtuesi teknik duhet të figurojë në listë pagesat e shoqërisë të paktën 6 muajt e fundit dhe në licencën e shoqërisë. *Vendosja e kriterit mbi eksperiencën në punë, është pa arsye në objektin e prokurimit dhe në gjykimin e audituesit ky kriter pengon dhe nuk nxit pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit duke mos siguruar një trajtim të barabartë të operatorëve dhe nuk është në funksion të këtyre parimeve, veprim ky në kundërshtim me shtojën 9 të DT dhe me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 kreu IV.*

- Gjithashtu nga AK kërkohet që OE, duhet të kenë të punësuar staf teknik, i cili të figurojë në listë pagesën e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit, *si dhe në licencën profesionale të shoqërisë* punonjësit si më poshtë: 1 Inxhinier Mekanik, 1 Inxhinier Mjedisi, 1 Inxhinier Ndërtimi, 1 Inxhinier Gjeolog, 1 Inxhinier Gjeodet, të cilët nuk duhet të jenë të dy punësuar. Kriteret i inxhinierëve të mësipërm trajton në mënyrë të padrejtë OE të cilët nuk e kanë inxhinierët e mësipërm *në licencën e shoqërisë*, duke favorizuar operatorë të cilët e kanë këtë Inxhinier në licence, ku mjaftonte vetëm prezenca në liste pagese. Vendosja për të paktën 6 muaj në listë pagese, ngushton konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE të cilët kanë stafin e sipërcituar mbi 6 muaj. Pra një operator ekonomik i cili plotëson përgjithësisht kriteret kualifikuese, nuk merr pjesë në garë pasi ndonjë nga ekspertët e sipërcituar nuk e ka të punësuar për 6 muaj në listë pagesë. Gjithashtu një operator ekonomik mund ti plotësojë edhe duke realizuar kontratë me shoqëri të specializuar për shërbimet e mësipërme.

- Në pikën 11 nga AK është kërkuar që OE duhet të jetë i pajisur nga QKL me: Leje Mjedisore të lëshuar nga QKL për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh, kodi III.I.A) Licencë nga QKL për grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B) Licencë nga QKL për shërbime ndërhyrëse higjieno sanitare (kodi II 8B). Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik çdo anëtar i bashkimit duhet të paraqesë leje/licencat si më lart. Vendosja e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotësojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 74 pika 3. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon një licencë

të përcaktuar si më sipër, nuk mund të kryejë bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh apo të shërbimit, pra përjashtohen OE *duke i mohuar mundësinë e bashkimit*. - Në pikën 13 nga AK është kërkuar që mjetet teknologjike transportuese, të jenë jo më poshtë se viti i *prodhimit të 2010*. Përcaktimi i vjetërsisë së mjeteve ngushton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, pasi një OE i cili disponon mjete me poshtë se viti 2010, i pajisur me kolaudimin e mjetit dhe lejen e qarkullimit përsëri do të realizonte shërbimin

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve që do zhvillohen Nga verifikimi rezulton se:, të marrë masa që çdo kriter në lidhje me stafin teknik, licencat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca.

#### **Statusi: Pa zbatuar**

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 447/3 datë 23.02.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 147-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 447/3,prot, datë 23.02.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz”.

#### **Brenda datës 30.06.2023**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “Punë publike”, të zhvilluara gjatë vitit 2021, është konstatuar se NJP jo vetëm ka hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nuk stimulojnë pjesëmarrjen e OE në garë, por janë kriteret të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, *ku ndër më kryesore janë:*

**a)-** NJP kërkon paraqitjen e **kopjeve të bilanceve** për 3 (tre) vitet e fundit ushtrimorë. Kjo kërkesë, pa asnjë argumentim apo arsyetim, është përdorur me dy standarde nga ana e NJP, pasi në disa raste është kërkuar që “bilancet të jenë të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar”, ndërsa në raste të tjera është kërkuar vetëm që “bilancet të jenë të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse”.

**b)-** Janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe natyrën e objektit të prokurimit, *konkretisht:* NP-11/A; NP – 3/E; NP-12/D; NS – 4/E; NS – 18/B; NP-2/C; NS-2/B; NS-12/B; NS-13/B; NS-14/B; NP-1/B, NP-2/C, NP-3/C, NS-2/B, NS-4/B, NS-12/B, NS-13/A.

**c)-** Në përcaktimin e numrit të punonjësve janë përdorur standarde të dyfishta dhe kontradiktore. Konkretisht, për punime të së njëjtës natyre është kërkuar një numër më i madh punonjësish në procedura me fond limit (volum punimesh) më të vogël në krahasim me numrin e punonjësve të kërkuar për një procedurë tjetër me fond limit (volum punimesh) më të madh. (P.sh.: Për procedurën me objekt “Ndertim Rruga Demokracia Lot III, Bathore” me fond limit 147,987 mijë lekë pa TVSh janë kërkuar 100 punonjës, kur nga ana tjetër, për procedurën me objekt “Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare “Kamza e Re” me fond limit 66,780 mijë lekë pa TVSh (*më shumë se 44.8% më të vogël*) janë kërkuar 100 punonjës, pra një numër i barabartë punonjësish.

Gjithashtu, për procedurën me objekt “Ndertim Rruga Demokracia Lot III, Bathore” me fond limit 147,987 mijë lekë pa TVSh janë kërkuar 100 punonjës, kur nga ana tjetër, për procedurën me objekt “Rindërtimi i çerdhes “Valias” në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias” me fond limit 82,267 mijë lekë pa TVSh (*rreth 55.7% më të vogël*) janë kërkuar 130 punonjës, pra një numër më i madh punonjësish prej 30 punonjës.

d)- Nga NJP në kriteret e përcaktuara janë kërkuar “Inxhinier – Auditues energjie”, “Artitekt”, “Ekspert Zjarrfikës: etj, të panevojshme dhe e pa-argumentuar, pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë punime që të argumentojë kërkesat e mësipërme.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Prokurimit Publik, Bashkia Kamëz, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën e fondit limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasë dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Me shkresën nr. *ska*, datë 2.3.2021 të shefit të M.Z.SH dhe miratim të Zv/Kryetarit të Bashkisë Kamëz z. Hasan Bara është kërkuar blerja e një mjeti për M.Z.SH.

Nga auditimi, konstatohet se asnjë nga anëtarët e komisionit mbi aplikimin e specifikimeve teknike nuk është i profilit (ing. Mekanik). Gjithashtu konstatohet fakti se në kriteret e aplikuara nga komisioni i hartimit të specifikimeve teknike, nuk është kërkuar që për procedurën e blerjes së mjeteve, shoqëritë pjesëmarrës duhet të jenë të licencuara/ ose autorizim në QKL për këtë lloje aktiviteti, veprime në kundërshtim me pikën 3.3 të Udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, nenet 56-*Titullari i AK ose zyrtari i autorizuar* dhe 57- *Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit* të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe nenit 12/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për Autoriparimin, Shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” ndryshuar me ligjin nr. 10137 / 2009” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa që në procedura me aktivitet të veçanta të përcaktojë specialist të fushën së objektit të prokuruar, si në hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e procedurës, kjo për të siguruar efektivitet të fondeve të prokuruar.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 4054 prot., datë 19.04.2021, me objekt “*Rikonstruksion i shkollës së mesme Ibrahim Rugova*”, Bashkia Kamëz dhe verifikimit në terren, rezultoi se zërat e punës “*Shtresë tartani fusha sportive dhe pista e hedhjes*” dhe “*Ulluk shkarkimi vertikal me bakër me D=120 mm*”, nuk janë realizuar sipas emërimit në preventiv. Në dosjen teknike nuk administrohet asnjë dokument për trajtimin e zërave të realizuar si zëra të rinj pune, për të cilat duhet të ishte bërë negociimi i çmimit, veprim është në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.3 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1. Rekomandim:** Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve të marrë masa që nëpërmjet stafit teknik të angazhuar për ndjekjen e kontratës, para pagesave të situacioneve, të verifikohen zërat



e punës të realizuar në fakt dhe për zërat e rinj të punës të përcaktohen çmimet sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi në terren i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3963 prot, datë 15.04.2021, me objekt “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Ahmet Zogu*”, Bashkia Kamëz, rezultoi se zëri i punës “Shtresë parketi laminat”, i cili është kryer në palestrën e shkollës në sasinë 398 m<sup>2</sup>, ka pësuar defekt në pjesën anësore të palestrës, në një gjatësi prej rreth 6 ml. Gjithashtu janë vënë re edhe probleme lagështie në korridorin dhe dhomat e zhveshjes në pjesën lidhëse të shkollës me palestrën, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.3 (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1. Rekomandim:** Drejtorja e Projekteve dhe Investimeve të marrë masa që nëpërmjet grupi të marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit, para lirim të garancisë së defekteve, të detyrojë sipërmarrësin e punimeve të bëjë riparimin e defekteve të shtresës së parketit në palestrën e shkollës.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi aktivitetin e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, mbi dhënien e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, rezulton se:

- **Në një rast**, nuk është respektuar përdorimi i lejuar i tokës, *konkretisht:*

Në lejen objekt shërbimesh 1-2 kate me zhvillues shoqëria “Vëllezërit Hallaçi” shpk me adresë Rruga “Nato” lagjja Valias, Bashkia Kamëz, dhe Objekti “Godinë banimi dhe shërbimi 1-3 kat” e zhvillues z. Fatjon Hidaj me adresë Rruga “Dajti” lagjja Bathore nr.5, Bashkia Kamëz prot,2359.

- **Në 5 raste**, nuk është respektuar distanca e lejuar nga kufiri i pronës, *konkretisht:*

- Objekt shërbimesh 1-2 kate me zhvillues shoqëria “Vëllezërit Hallaçi” shpk me adresë Rruga “Nato” lagjja Valias, Bashkia Kamëz.

- Objekti “Godinë banimi dhe shërbimi 1-3 kat” me zhvillues z. Fatjon Hidaj ADRESA: Rruga “Dajti” lagjja Bathore nr.5, Bashkia Kamëz prot,2359.

- Objekti “Ndërtese 2kat (zyra 1kat, magazinë grumbullimi 1kat)” me zhvillues z. Filip Zefi ADRESA: Rruga “Tetova” lagjja nr.4 Kamëz, Bashkia Kamëz prot.2057.

- Zhvilluesit: z. Simon Dokaj, subjekti ndërtues me të dhënat; shoqëria “Eri -06”sh.p.k me licencë nr.NZ .5314/3 leja e ndërtimit per punimet: “Godinë polifunksionale 4 kat me 1 kat podrum me destinacion banimi” me adresë Rruga “Gjergj Kastriot Skënderbeu” lagjja Frutikulture.

- Zhvilluesit shoqëria “MEHILLAJ” shpk subjekti ndërtues me të dhënat e mëposhtme: shoqëria “MEHILLAJ” shpk me licencë nz. 2961/6 leja e ndërtimit per punimet: “ Godinë banimi dhe shërbimi 9kat me 1kat nëntoke” ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Rruga “Roma” lagjja nr.1 Kamëz.

- *Në një rast nuk është respektuar Intensiteti i lejuar, konkretisht:*

Në lejen “Leje ndërtimi” objekti: “Godinë shërbimi 1kat”, me zhvillues shoqëria “Lugano Home Collection” shpk me adresë Rruga “Monte Karlo” lagjja nr.4 Kamëz, Bashkia Kamëz.

- **Në 2 raste**, nuk është respektuar distanca e lejuar nga objekti në objekt, *konkretisht:*

- Zhvilluesit: z. Simon Dokaj subjekti ndërtues me të dhënat e mëposhtme: shoqëria “ERI -06”sh.p.k me licencë nr.nz .5314/3 leja e ndërtimit per punimet: “Godinë Polifunksionale 4kat me 1kat podrum me destinacion banimi” *adresa e realizimit të punimeve:* Rruga “Gjergj Kastriot Skënderbeu” lagjja Frutikulture.

- Zhvilluesit: Shoqëria “Lala Konstruksion -2010 shpk subjekti ndërtues me të dhënat e mëposhtme: shoqëria “Lala Konstruksion -2010”shpk me licencë . nz 6376/1 leja e ndërtimit per punimet: “ 2 Godinë banimi dhe shërbimi 1,2 dhe 8kat me 1kat nëntoke” adresa e realizimit të punimeve: Rruga “Bavaria” Lagjja nr.2 Kamëz

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronja (a) e nenit nenet 9 dhe nenet 34, 35, 38 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 144-147, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1 Rekomandimi:** Nga ana e Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Kamëz të merren masa për:

- Respektimin e lejuar të përdorimi të tokës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës sipas legjislacionit në fuqi.
- Respektimin e intensitetit të ndërtimit në zbatim të planit të përgjithshëm vendore.

#### **Menjëherë dhe vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i dokumentacionit mbi strukturën dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Kamëz, *rezulton se:*

- Nga ballafaqimi i dy fotografimeve ajrore nga sistemi google earth dhe google maps, u konstatuan disa raste të ndërtimeve për të cilat Drejtoria e Planifikim Zhvillimi Territorit Bashkia Kamëz nuk kishte dijëni, që do të thotë nuk kishte lëshuar leje zhvillimi apo ndërtimi për këto ndërtime. Nga ana e IMT Bashkia Kamëz po ashtu nuk është mbajtur asnjë proces-verbal kundërvajtjeje apo vendim pezullimi, gjobe, prishje për këto objekteve, gjë e cila tregon se nga IMT Bashkia Kamëz nuk ka informacion mbi ndërtimet e ndryshme pa leje që zhvillohen në territorin e kësaj bashkie.

- Për objektet të cilat janë me leje ndërtimi miratuar nga DPZHT nuk është bërë inspektim nga IMT Bashkia Kamëz për të verifikuar nëse këto objekte të cilat ndërtohen respektojnë projektin e miratuar apo shtojnë volume në lartësi apo në njollën e miratuar, ndryshojnë në formë , në planimetritë e miratuara etj.

- Struktura organizative të IMT Bashkia Kamëz, rezulton se 3 nga inspektorët janë pa arsimin përkatës konformë legjislacionit në fuqi.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 4, 5 dhe 11 të ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit:”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 144-147, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandimi:** Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kamëz, të marri masa për:

- Kryerjen e kontrolleve të vazhdueshme në territorin e bashkisë për të gjitha ndërtimet e zhvilluara në këtë zonë me ose pa leje ndërtimi dhe për rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje të ushtrijë kompetencat në zbatim të akteve ligjore e nënligjore për kontrollin e territorit.

- Të ushtrijë kontrolle të vazhdueshme në të gjitha subjektet e pajisura me leje ndërtimi duke filluar nga piketimi i objektit dhe deri për mbylljen e tij, për mos devijimin e lejes së ndërtimit të miratuar nga DPZHT dhe Kryetari i Bashkisë, kjo në zbatim të ligjit për kontrollin e territorit.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**21.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e organikës të Inspektoriati Mbrojtjes Territorit vendore bashkia Kamëz me specialist me arsim përkatës sipas kuadrit ligjor në fuqi.

**Brenda datës 30.06.2023**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi mënyrën e llogaritjes së TNI nga specialistë të Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) Bashkia Kamëz, u konstatua se kjo taksë nuk është llogaritur në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas specialistëve të DPZHT, taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogarit në zbatim të Vendimit të KB nr. 29, datë 16.3.2021 “Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020”.

Kjo mënyrë llogaritje është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 46 *Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*, si dhe me nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Gjithashtu sqarohet se TNI është taks ndërtimi në infrastrukturë që paguhet para fazës së marrjes së lejes së ndërtimit, e cila ka të bëjë me sipërfaqen e ndërtimit për ndikimin në infrastrukturë dhe jo me fazën e shitjes ose kalim pronësie (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 144-147, të Projekt Raportit të Auditimit*).

**22.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit (DPZHT) dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Kamëz, të analizojnë paraprakisht në Këshillin Bashkiak ndryshimin e Vendimit të KB nr. 29, datë 16.3.2021 “Për një ndryshim në VKB nr. 167 datë 23.12.2020”, mbi mënyrën e llogaritjes së Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), në përputhje me nenin 46 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, me qëllim llogaritjen e saktë të Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë (TNI), për të mos shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kamëz.

#### Në vazhdimësi

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i ankesës së banorëve të rrugës “Abdi Bej Toptani”, Bashkia Kamëz, protokolluar në KLSH me nr. 71 prot., datë 18.01.2023, me lëndë “Kërkesë për marrjen e masave për siguri rrugore në rrugën “Abdi Bej Toptani”, Valias, Bashkia Kamëz”, rezultoi se kjo rrugë ishte në mungesë totale të sinjalistikës rrugore dhe për pasojë ka patur aksidente të shumta rrugore, ne kundërshtim me kodin rrugore (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1. Rekomandim:** Bashkia Kamëz të marrë masa që nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të bëhet plotësimi i këtij segmenti rrugor me sinjalistikën e duhur horizontale dhe vertikale, në mënyrë që të shmangin në maksimum aksidentet rrugore.

#### Menjëherë

## B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,167,771 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruktion i shkollës “Kamza e re””, Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 66,659,236 lekë, realizuar nga BOE “Britania” & “Colombo” & “Ndërtimi” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **437,741 lekë** pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4049 prot., datë 16.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Britania” & “Colombo” & “Ndërtimi” SHPK (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha

shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **437,741 lekë pa TVSh** nga BOE “**Britania**” & “**Colombo**” & “**Ndërtimi**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4049 prot., datë 16.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2023**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i kopshtit “Zall Mner”, Bashkia Kamëz*”, me vlerë kontrate (pa TVSh) 70,900,000 lekë, realizuar nga BOE “**Almo Konstruksion**” & “**Ulza**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **338,752 lekë** pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6137 prot., datë 14.06.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “**Almo Konstruksion**” & “**Ulza**” SHPK (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **338,752 lekë** pa TVSh nga BOE “**Almo Konstruksion**” & “**Ulza**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6137 prot., datë 14.06.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2023**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i kopshtit Kamza e Re*”, Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 29,987,757 lekë, realizuar nga OE “**Euro-Alb**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **273,821 lekë** pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4802 prot., datë 10.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE “**Euro-Alb**” SHPK (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **273,821 lekë pa TVSh** nga OE “**Euro-Alb**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4802 prot., datë 10.05.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i shkollës së mesme Ibrahim Rugova*”, Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 177,814,562 lekë, realizuar nga BOE “**Egeu Stone**” & “**Pesë Vëllezërit**” & “**Boshnjaku B**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **479,700 lekë** pa TVSh, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4054 prot., datë 19.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “**Egeu Stone**” & “**Pesë Vëllezërit**” & “**Boshnjaku B**” SHPK (*Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha

shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **479,700 lekë pa TVSh** nga BOE “Egeu Stone” & “Pesë Vëllezërit” & “Boshnjaku B” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4054 prot., datë 19.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2023**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Ahmet Zogu”, Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (pa TVSh) 163,308,600 lekë, realizuar nga OE “4-AM” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **185,843 lekë pa TVSh**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3963 prot., datë 15.04.2021 të lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE “4-AM” SHPK (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit bashkia Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **185,843 lekë pa TVSh** nga OE “4-AM” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3963 prot., datë 15.04.2021, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu””, Bashkia Kamëz, me vlerë kontrate (pa TVSh) 57,121,020 lekë, realizuar nga BOE “KUPA” & “LIQENI VII” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **192,914 lekë pa TVSh**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3440 prot., datë 01.04.2021 të lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Kupa” SHPK & “Liqeni VII” SHPK (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.4.4 faqet 125-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën **192,914 lekë pa TVSh** nga BOE “KUPA” SHPK & “LIQENI VII” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 prot datë 12.05.2021 me objekt “Rikonstruksion i kopshtit “Ahmet Zogu””, Bashkia Kamëz, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.06.2023**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se sipas procesverbal vlerësimit të hartuar nga KVO, thuhet se OE “AVDULI” shpk me ofertë ekonomike 9,845,800 leke pa TVSh është përjashtuar pasi nuk është respektuar afati 5 ditor për paraqitjen e dokumentacionit. Me shkresën nr. 9635, datë 14.10.2021 Bashkia Kamëz i është drejtuar shoqërisë “ATLANTIK” sha për konfiskimin e sigurimit të ofertës më vlerë 259,000 lekë, vlerë kjo e paarkëtuar, veprime në kundërshtim me pikën 6 të nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës & Kontabilitetit të marrin masa për bllokimin e llogarisë dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës në shumën **259,000 lekë** nga shoqëria “ATLANTIK” shpk.

**Brenda datës 30.06.2023**

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 18 procedurave me fond limit 1,846,197 mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 5 procedura me vlerë të fondit limit 526,921 mijë lekë ose 28.4% e vlerës së fondit limit të audituar, ku;

- Në **2 procedura** me fond limit **149,047 mijë lekë**, OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

- Në **4 procedura** me fond limit **377,874 mijë lekë**, KVO duhet të vijonte vlerësimin e procedurës me OE mbetur në garë, pasi OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit", *konkretisht praktikat:*

- "Ndertim rruga "Havzi Nela" Paskuqan 1" me fond limit 12,972 mijë lekë.

- "Ndertim rruga "Luz i Vogël" & "Rrethimi i Varrezave Bathore" me fond limit 70,269 mijë lekë.

- "Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare "Kamza e Re" me fond limit 66,780 mijë lekë.

- "Rindërtimi i godinës administrative, ne zonën e re per zhvillim te detyruar ne fshatin Valias" me fond limit 82,267 mijë lekë.

- "Rikonstruksion i kopshtit "Zall Mner"" me fond limit 71,400 mijë lekë.

- "Riforcim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Kamëz" me fond limit 223,232 mijë lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësive publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

## **D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se në planin e të ardhurave të vitit 2021, Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka përfshirë debitorët e taksë së tokës që për vitin 2020 rezultojnë në vlerën 32,386,698 lekë.

Referuar nenit 23, të ligjit nr. 9632 "Për sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar në pronësi ose përdorim të taksapaguesit, e cila vërtetohet sipas dokumentacionit AMTP ose nga të dhëna të marra nga

formulari nr.6, që disponon bashkia ose duke ngritur grupe pune për verifikim të sipërfaqeve në vend të tokave që disponojnë qytetarët.

Për vitin 2021 sipas Vendimit të KB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar, është përcaktuar në vlerën 4,500 lekë/ha/vit, kjo si tokë e kategorisë së tretë. Nga të dhënat Bashkia Kamëz disponon 2399 ha tokë bujqësore, sipas formularit nr.6 nga ku rezulton e ndarë për 2599 familje për sipërfaqen 2129 ha. Planifikimi i taksës së tokës nga viti në vit është bërë pa patur një databazë të saktë për ndryshimet që kanë ndodhur në pakësimin e kësaj sipërfaqe nga ndërtimet e reja dhe ato informale si dhe transaksionet që janë kryer ndër vite për shitblerjen e saj duke ndryshuar pronarë për pasojë numri i familjeve debitore nga viti në vit vjen në rritje (*ndarë tokë për 2599 familje dhe me datë 31.12.2021 rezultojnë debitorë 6703 familje në vlerën 36,566,509 lekë*). Gjithashtu dhe vlera e debisë (*me datë 31.12.2020 vlera debisë në shumën 32,386,898 lekë dhe në fund të vitit 2021 në shumën 36,566,509 lekë*) vjen me rritje për vlerën 4,179,611 lekë.

Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave nuk ka bashkëpunuar me DPKZHT Bashkia Kamëz, për të marrë informacion lidhur me sipërfaqet që kanë kaluar për ndërtim objektesh, si dhe nga ASHK për ato sipërfaqe me transaksion për shitje tokash apo për regjistrim të lejeve të ndërtimit.

Nga të dhënat e Drejtoria e MTPM, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave sipas listave që administron kjo drejtori rezultojnë se janë debitorë më datë 31.12.2021 për taksë toke gjithsej **6703 familje në vlerën 36,566,509 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9632 “Për sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 23 dhe VKB nr. 55, datë 20.12.2019 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e MTPM-se dhe Bordit Kullimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marr masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës në vlerën **36,566,509 lekë** ndaj **6703 familjeve**.

**Brenda datës 30.06.2023**

**1.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz të ngrejë grup pune me specialist të fushës për saktësimin e sipërfaqes së tokës arë, pasi nuk janë reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur si rezultat i zënies së saj nga ndërtimet pa leje e me leje ndërtimi, si dhe transaksionet e ndryshme që janë kryer nëpërmjet ASHK, duke ndryshuar pronarë.

**Brenda datës 31.12.2023**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI), konstatohet se nga ALUIZNI-t Tiranë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Tiranë. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2014 deri më 31.12.2021, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **8467 persona** me vlerë **270,787,856 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kamëz**.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3 dhe VKB nr. 167, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa e ndryshime në VKB nr. 55, datë 20.12.2019” pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **270,787,856 lekë** ndajë **8467 personave**, sipas listës që administrohet nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Kamëz.

**Brenda datës 31.12.2023**

**2.2 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz të bashkëpunojë me Drejtorinë e ASHK Tiranë ose Ujësjetllës Kanalizime sh.a Kamëz, për lidhjen e një aktmarrëveshje si Agjent Tatimorë në arkëtimin e detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për 8467 ndërtimet e raje për uljen e borxhit në vlerën **270,787,856 lekë**.

**2.3 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Kamëz nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Tiranë, që të mos pajisë me çertifikata pronësie subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore në mënyrë progresive, janë krijuar debitor në vlerën gjithsej **323,708,712 lekë**, nga të cilët: *444 subjekte të biznesit të vogël, biznesit të madh dhe aktivitet transporti në vlerën 121,835,012 lekë dhe 18 660 familje për taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën 201,873,700 lekë.*

Sipas të dhënave edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 444 subjekte debitorë në vlerën 121,835 mijë lekë, janë aktiv 404 subjekte ose 91 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa në vlerën 117,081 lekë ose 79 % e vlerës së debitorëve, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Kreut XI-“*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime.

Nga totali prej 19 104 debitorë me vlerë 323,708,712 lekë (*debitorë të biznesit për 444 subjekte në vlerën 121,835,012 lekë dhe debitorë familjarë 18 660 familje në vlerën 201,873,700 lekë*), nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vijuar me procedurat e arkëtimin të detyrimeve në zbatim të Kreut XI-“*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, janë dërguar për bllokim të llogarive bankare me shkresën nr. 8965, datë 21.09.2021 për 1078 subjekte, barrë siguruese për automjetet me shkresën nr. 9372, datë 06.10.2021 për 1004 subjekte, barrë hipotekore për pronat me shkresën nr. 9371, datë 06.10.2021 për 1004 subjekte nga të cilët kanë arkëtuar detyrime për vitin 2021 në vlerën 33,891,820 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 45-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën **323,708,712 lekë**.

**Brenda datës 31.12.2023**

## **E. MASA DISIPLINORE**

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “*Llojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i



punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “*Masa disiplinore*”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kamëz të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **13 (trembëdhjetë) punonjësit**, si më poshtë:

**1. Zj. Shpresa GJOKROSA**, me detyrë Përgjegjëse e Njesisë së Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të Hartimit të DST.

**2. Z. Skënder SELITA**, me detyrë Specialist në Njësinë e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Hartimit të DST.

**3. Zj. Suela Vladi**, me detyrë Specialist në Njësinë e Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Hartimit të DST.

**4. Z. Luan MARKU**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit, në cilësinë e anëtarit të Hartimit të DST.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikat:*

- “Rikonstruksion i rrugës Luz i Vogël + Rrethim i Varrezave”,
- “Ndertim Rruga Demokracia Lot III, Bathore” me fond limit 147,987 mijë lekë.
- “Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare “Niko Hoxha” me fond limit 189,845 mijë lekë.
- “Rikonstruksionin e shkollës se mesme “Ibrahim Rugova” me fond limit 178,500 mijë lekë.
- “Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare “Ahmet Zogu” me fond limit 163,800 mijë lekë.
- “Rikonstruksionin e shkollës 9 vjeçare “Kamza e Re” me fond limit 66,780 mijë lekë.
- “Rindërtimi i godinës administrative, ne zonën e re per zhvillim te detyruar ne fshatin Valias” me fond limit 82,267 mijë lekë.
- “Riforcim i njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Kamëz” me fond limit 223,232 mijë lekë.
- “Rindërtimi i godinës administrative, ne zonën e re per zhvillim te detyruar ne fshatin Valias” me fond limit 203,034 mijë lekë.
- “Rikonstruksion gjimnazit “Isa Boletini” me fond limit 292,810 mijë lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5. Z. Evis GJIKA**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike, në cilësinë e Kryetarit të KVO.

**6. Z. Luan Dedaj**, me detyrë Drejtor i Çështjeve Ligjore, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**7. Z. Ramadan HYSA**, me detyrë Specialist i Sektorit të Infrastrukturës dhe Investimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**8. Z. Urada ELEZI**, me detyrë Këshilltar i Kryetarit për Diasporën, në cilësinë e anëtarit të KVO

**9. Zj. Emanuela MËZIU**, me detyrë Specialist Projektimi në Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, *konkretisht:*

- “Ndertim rruga "Havzi Nela" Paskuqan 1” me fond limit 12,972 mijë lekë.

- “Ndertim rruga "Luz i Vogël" & "Rrethimi i Varrezave Bathore" me fond limit 70,369 mijë lekë.

- “Rikonstrukcionin e shkollës 9 vjeçare “Kamza e Re” me fond limit 66,780 mijë lekë.

- “Rindërtimi i godinës administrative, ne zonën e re per zhvillim te detyruar ne fshatin Valias” me fond limit 82,267 mijë lekë.

- “Rikonstrukcion i kopshtit "Zall Mner"” me fond limit 71,400 mijë lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10. Z. Faik SULA**, në cilësinë e Drejtorit të MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Ujërave, nuk ka kryer verifikime çdo 6 muaj në lidhje me zbatimin e detyrimeve sa u përket kushteve të për investimet dhe nivelin e punësimeve, në kuadër të detyrimeve kontraktore për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme të bashkisë.

**11. Z. Ernest SINANI**, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për dhënien me qira, ku në një rast nuk janë respektuar procedurat e përcaktuar në VKM nr.54/2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe dhënien me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 152-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**12. Z. Erlend BABALLEKU** me detyrë Drejtori i DPZHT.

**13. Zj. Fiqirete RUSTEMAJ** me detyrë Specialiste Sektori në DPZHT

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Miratimin e lejeve të ndërtimit në shkelje të shkronjës (a) e nenit nenet 9 dhe nenet 34, 35, 38 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar akteve ligjore, për:

Mos respektimin e përdorimit të lejuar i tokës

Mos respektimin e distancave të lejuara të kufirit të pronës.

Mos respektimin e lejuar të distancave nga objekti në objekt

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 139-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit për të cilët do merret masë disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

#### **G. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**

Për **5 ish- punonjësit** e mëposhtëm, ndaj të cilëve nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre, *konkretisht*:

1. **Z. Hasan BARA**, me detyrë ish- Zv/Kryetari Bashkia Kamëz.

2. **Z. Arbër TOLA**, me detyrë ish- Drejtor i PZHT.

3. **Z. Atli HOTI**, me detyrë ish- drejtor i Drejtor i Çështjeve Ligjore.

4. **Z. Ardjen MARKOLA**, me detyrë ish- Specialist pranë Sektorit Çështjeve Ligjore.

5. **Z. Robert DERVISHI** me detyrë ish- Përgjegjës Sektori i DPZHT.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

## V. ANEKSET

Anekset e mëposhtme, tabelat dhe pasqyrat janë pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit, ku në mënyrë më të zgjeruar trajtohen çështje të caktuara.

### Aneksi nr. 1

#### Materialiteti dhe faktorët e riskut për subjektin Bashkia Kamëz

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër transfertave).

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogaritë u vlerësua nga 0.7 deri 2; dhe
- ✓ Peshat specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

*Në 000/lekë*

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	437,912	0.70	7
Sigurime Shoqërore (601)	69,951	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	178,545	0.70	3
Subvencione (603)		0.60	0
Princila + Interesa		0.60	0
Investime të brend. (230-231)	2,122,245	2.00	92
Te tjera transfer. korren (604)	26,884	0.70	0
<b>Total</b>	<b>2,835,537</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>56,711</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>56,711</b>		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	5,671		
<b>Nëntotali</b>	<b>51,040</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>45,936</b>		
Emërtimi i të ardhurave	Vlera	Faktori i Riskut (mund të jetë 0.7 ose 2 ose 3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	3,395,964	0.70	34
Të ardhura te treshëguara	69,924	0.70	1
Të ardhurat e veta	788,144	0.70	8

<b>Total</b>	<b>4,254,033</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti</b>	<b>85,081</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>85,081</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	8,508		
<b>Nëntotali</b>	<b>76,573</b>		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>68,915</b>		
<i>Shenim: Te dhenat jane marra nga pasqyrat e subjektit sipas faktit dhe rakorduara me Degen e Thesarit</i>			

## **MBI VLERËSIMIN E RISKUT BASHKIA KAMËZ.**

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza*), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticismit profesional nga ana e audituesve.

- U kryc planifikimi dhe identifikimi i riskut të auditimit. Njohja me subjektin që auditohet për të kuptuar të gjithë elementët e mjedisit të kontrollit. U identifikuan dhe vlerësuan zonat kryesore të llogarisë dhe shënimeve shpjeguese për të përcaktuar pohimet kryesore të auditimit në bazë të materialitetit të përcaktuar.

-U përcaktua strategjia dhe vlerësimi i riskut duke identifikuar klasat e transaksioneve dhe kontrolleve kyçe. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara. U përcaktuan kontrollet kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar i riskut (*i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese*). U përcaktuan testet e kontrolleve dhe testet thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.

- U ekzekutuan procedurat e testimit si testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

Pasqyra e lejeve ndërtimit me sipërfaqe mbi 250 m<sup>2</sup>.

EMERTIME	ZHVILLUES	SIPERFA QJA NDERTIM IT	Tarifa e ndikimit ne infrastru ktuRE	VITI	VLERE E PREVENTI VIT
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Idajet Marku</u>	325m <sup>2</sup>	435 951	2021	10 898 767
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Bi Konstruksion</u>	12854m <sup>2</sup>	28 978 584	2021	384 012 496
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Simon Dokaj</u>	1648.34m <sup>2</sup>	3 851 445	2021	58 876 227
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>ZATH</u>	5465m <sup>2</sup>	12 190 335	2021	178 504 912
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Mahmut Himallari</u>	1240m <sup>2</sup>	1 985 124	2021	49 628 098
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Lala Konstruksion</u>	8632m <sup>2</sup>	18 272 154	2021	258 941 384
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Ibrahim Matranxhi</u>	306.8m <sup>2</sup>	394 091	2021	98 522 568
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Mehillal shpk</u>	10910m <sup>2</sup>	24 526 088	2021	356 031 401
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>ManeTCI</u>	532.6m <sup>2</sup>	1 832 746	2021	20 463 654
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Arben Refatlari</u>	665.8m <sup>2</sup>	855 233	2021	21 380 836
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Idriz Cara</u>	280m <sup>2</sup>	359 666	2021	8 991 640
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Ervis Shurdha</u>	435m <sup>2</sup>	921 815	2021	23 045 368
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Ramazan Doku</u>	1418.22m <sup>2</sup>	1 833 399	2021	834 958
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Hairi Korbi</u>	275.2m <sup>2</sup>	353 500	2021	8 837 498
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Fatmir Poleshi</u>	400m <sup>2</sup>	522 185	2021	13 054 637
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Haxhi Islami</u>	265.68m <sup>2</sup>	341 272	2021	8 531 782
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>ManeTCI</u>	21803m <sup>2</sup>	43 204 261	2021	1 010 662 740
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Marash Yukaj</u>	299.3m <sup>2</sup>	388 068	2021	9 701 692
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Bi Konstruksion</u>	9925m <sup>2</sup>	20 764 255	2021	297 750 000
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Drita Vladi</u>	335m <sup>2</sup>	436400	2021	10 909 996
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Ljiman Afmataj</u>	627.5m <sup>2</sup>	806 036	2021	20 150 908
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Lugono Home Collection</u>	1085m <sup>2</sup>	1 439427	2021	35 985 662
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>ManeTCI</u>	11885m <sup>2</sup>	21 913 462	2021	1 010 662 740
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Startek</u>	31767m <sup>2</sup>	56 231 542	2021	1 082 283 579
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Agim Ferati</u>	789m <sup>2</sup>	27 092 200	2021	1 092 200
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Rasim Dervishi</u>	372m <sup>2</sup>	491 971	2021	12 299 279
Leje ndërtimi per ndertim te ri me sipërfaqe me te madhe se 250	<u>Esat Pira</u>	900m <sup>2</sup>	28 901 700	2021	1 156 068

EMERTIME	ZHVILLUES	SIPERFAQJA NDETIMIT	Tarifa e ndikimit ne infrastruktura	VITI	VLERA E PREVENTI VIT
Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250	<b>Petrit Bojini</b>	279.6m <sup>2</sup>	473 561	2021	11 839 022
Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250	<b>Alii Totraku</b>	352.8m <sup>2</sup>	453 179	2021	11 329 466
Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250	<b>Shirzana shpk</b>	5676m <sup>2</sup>	12 554 494	2021	170 252 464
Leje ndertimi per ndertim te ri me siperfaqe me te madhe se 250	<b>Astracolor</b>	600m <sup>2</sup>	770 678	2021	19 267 800
- Në pikën 11 nga AK është kërkuar që OE duhet të jetë i pajisur nga QKL me: Leje Mjedisore të lëshuar nga QKL për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh, kodi III.I.A) Licencë nga QKL për grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B) Licencë nga QKL për shërbime ndërhyrëse higjieno sanitare (kodi II 8B). Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik çdo anëtar i bashkimit duhet të paraqesë leje/ licencat si më lart. Vendosija e kriterit se në rastin e BOE secili prej operatorëve ekonomikë duhet të plotësojë këtë kriter është i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 74 pika 3. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme zvogëlon konkurrencën, pasi një operator, i cilit nuk disponon një licencë të përcaktuar si më sipër, nuk mund të kryejë bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh apo të shërbimit, pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit.

- Në pikën 13 nga AK është kërkuar që mjetet teknologjike transportuese, të jenë jo më poshtë se viti i prodhimit të 2010. Përcaktimi i vjetërsisë së mjeteve ngushton pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, pasi një OE i cili disponon mjete me poshtë se viti 2010, i pajisur me kolaudimin e mjetit dhe lejen e qarkullimit përsëri do të realizonte shërbimin. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve që do zhvillohen Nga verifikimi rezulton se:, të marrë masa që çdo kriter në lidhje me stafin teknik, licencat profesionale apo mjetet, të jenë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, në mënyrë që të stimulohet konkurrenca.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara për vitin 2021, u konstatua se nga AK nuk janë marrë masa për përmisimin e gjendjes, pasi evidentohen raste të aplikimit të kriterëve të paargumentuara.*

**Statu: Pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Kamëz në DST të procedurës së PPP me objekt “*Shërbimit të kryerjes së pastrimit, grumbullimit, transportimit, seleksionimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kamëz*”, nuk është kërkuar vlerësim për kapacitetin teknik në lidhje me realizimin e projektit të stacionit të transferimit, apo studio konsulentë (kontrate konsulence). Nga AK nuk është kërkuar që OE, duhet të plotësojë kriter kualifikues për “Projektim” nga vet ai, ose nëpërmjet një studio projektimi të licencuar dhe të kontraktuar specifikisht, me kushtet që të paraqesë licencën profesionale të projektimit të vlefshme për kategoritë kryesore në lidhje me stacionin e transferimit. AK nuk ka hartuar kërkesa shtesë në lidhje me projektimin e veprës si shërbime të ngjashme me objektin e procedurës konkurruese, të cilat janë zbatuar ose janë finalizuar me sukses më parë. Veprimet e mësipërme mund të rrisojnë që projekt-zbatimi i veprës të ketë mangësi dhe që mund të rrisojë kosto jo në përputhshmëri me parimet e ekonomikitetit, eficensë dhe efektivitetit dhe në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar, me ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit”, VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 121-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, Njësia e Prokurimit në procedurat e koncesioneve të punëve që do zhvillohen. Nga verifikimi rezulton se:, të marrë masa që të kërkohen për realizimin e projekteve të veçanta, studio projektuese të licencuara, në mënyrë që të garantohet cilësia dhe jetëgjatësia e veprës, në përputhje me parashikimet ligjore.

**Statu: Zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Ndërtim KUN Kamëz rruga Skënderbeu deri te Kujtesa, rruga Dibra dhe rruga Dritëro Agolli*”, Bashkia Kamëz, u

konstatua se situacioni pjesor progresiv, ishte i pashoqëruara me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 8.1 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15/02/2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.3. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 164-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz në të ardhmen të marren masa që kontratat e punimeve civile, situacionet pjesore të shoqërohen me libreza masash pjesore, në mënyrë që pagesat pjesore të argumentohen mbi bazën e volumeve të llogaritura.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga auditimi i zbatimit të kontratave për vitin 2021, u konstatua se volumet pjesore të situacionuara janë shoqëruar me libreza pjesore të masave. Gjithashtu dhe situacioni nr. 1, për objektin “Ndërtim rruga Harku i Triumfit”, është shoqëruar me librezën e masave.*

**Statusi: Zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

- Në Bashkinë Kamëz nuk është hartuar plani i trajnimeve për periudhën objekt auditimi.
- Nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Vetëm 8.4 % e total punonjësve ose 19 punonjës të aparatit të Bashkisë Kamëz kanë kryer trajnime për periudhën 2019- 2020, nga të cilët 5 punonjës për vitin 2020 kanë kryer trajnimin e detyrueshëm të ASP- ës. Në vitin 2018 nuk janë kryer trajnime.
- Vendet vakante në aparatin e Bashkisë Kamëz, mbartin risqe të cenimit të performancës së aktivitetit të institucionit. Në strukturën e aparatit të Bashkisë Kamëz deri në 31 dhjetor 2020 ka 26 vende vakante.
- Në këtë Njësi Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar dhe të drejtorisë së burimeve njerëzore.
- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara për vitet 2018 dhe 2019 të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm.

Bashkia Kamëz nuk ka miratuar Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” për vitet 2018 dhe 2019. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 22-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Kamëz të merren masa për zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së: Hartimin e planit të trajnimeve; Kryerjen e trajnimeve specifikisht për GMS në fushën e Menaxhimit të Riskut dhe atë të MFK; Aplikimin e programeve elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar dhe të drejtorisë së burimeve njerëzore; Zhvillimin e mbledhjeve të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin. Miratimin e Planit të Punës Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga Bashkia Kamëz është hartuar plani i trajnimeve për vitin 2022, për të gjitha drejtoritë e bashkisë, bazuar në trajnimet që ofrohen nga ASPA. Me shkresën nr. 4339/1 datë 10.06.2022, Bashkia Kamëz është drejtuar ASPA, me listën e punonjësve që do të trajnohen sipas pozicioneve të punës.*

*Mbledhjet e GMS janë të dokumentuara. Është hartuar plani vjetor i punës për funksionimin e grupit të menaxhimit të riskut. GMS është mbledhur periodikisht. Janë zhvilluar mbledhje më datë 22.11.21, 05.01.22, 27.01.22, 15.03.22, 26.04.22, 26.05.22. Raporti i monitorimit për 4- mujorin e parë 2022 është diskutuar dhe miratuar nga GMS me shkresën nr. 4524/1 prot. datë 20.05.2022.*

**Statusi: Zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kamëz konstatohet se: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 26-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz të marr masa për ngritjen e Komitetit të Auditimit, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga Bashkia Kamëz me aktin me nr. 527 prot. datë 24.06.2022 (akti bashkëlidhur), është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Kamëz, në përputhje me VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike".*

**Statusi: Zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 265,387,540 lekë. Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të palikujduara i zënë Investimet në vlerën 208,125,590 lekë ose 78 %. Pastaj vijnë Mallra dhe Shërbime në vlerën 55,261,950 lekë ose 21 %, vlerë e palikujduara i cili i përket "Eco Cleaning" ShPK, koncesionarc për pastrimin e qytetit. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 2,000,000 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ku 1,275,395 lekë janë detyrime nga vendime gjyqësore lidhur me personelin dhe 724,605 lekë detyrime nga vendimet gjyqësore lidhur me shpronësimet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia Kamëz të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar veprimi për këtë qëllim.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, u konstatua se detyrimet e prapambetura janë ulur nga një vit në tjetrin. Kështu nga vlera 265 milion lekë që ishim më datë 31.12.2020, me datë 31.12.2021 janë në vlerën 261 milion lekë, gjë e cila është në proces.*

**Statusi: Zbatuar**

**8. Gjetje nga auditimi:** Totali i investimeve të kryera nga FZHR gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 është në vlerën 861,169.626 lekë. Në periudhën në auditim, në vitet 2018 deri në vitin 2020 FZHR ka likuiduar vlerën 446,338,405 lekë dhe Bashkia Kamëz ka likuiduar vlerën 39,671,239 lekë. Deri në 31.12.2020 vlera e palikujduara arrin në total 434,167,363 lekë nga të cilat 402,300,454 lekë është detyrim i FZHR-së dhe 31,866,909 lekë detyrim i Bashkisë Kamëz *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa që për detyrimet e mbetura të palikujduara në fund të vitit 2020 me burim financimi nga FZHR në vlerën 402,300,454 lekë të kërkohet nëpërmjet planifikimit buxhetor dhe korrespondencës zyrtare lëvrimit i fondeve të përcaktuara për likuidimin e kontratave të investimeve deri në vlerë të plotë. Ndërsa për vlerën e faturave të palikujduara në vlerën 31,866,909 lekë me burim financimi të ardhurat e Bashkisë të merren masa që në buxhetimin e vitit pasardhës të ketë prioritet mbulimin me fonde i këtyre faturave për mbylljen përfundimtare të tyre.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga auditimi, konstatohet se në fund të vitit 2021, vlera e detyrimeve të palikujduara me burim financimi nga FZHR është 0 (zero) lekë, kjo dhe me të ardhurat e bashkisë.*

**Statusi: Zbatuar**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nuk është kontabilizuar vlera e përditësuar në llogarinë 26 "AAF" me vlerën e kapitalit me 100 % aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kamëz në "UK Kamëz" Sh. A më konkretisht në llogarinë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*". Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël 371,846,000 lekë. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 371,846,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të përditësuar në kontabilitet dhe për të regjistruar pjesëmarrjes 100 % në kapitalin aksionar të "UK Kamëz" sh.a me vlerë kontabël 371,846,000 lekë në debi të llogarisë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, u konstatua se bërë sistemimi i kapitalit aksionar i UKK Kamëz sh.a. llogaria 26 "pjesëmarrje në kapitalin e vet".*

**Statusi: Zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Kamëz ka marr me qira 2 ambiente në pronësi të Z. Fadil Jata me pagesë mujore 120,000 lekë dhe Z. Izet Ahmetaj 60,000 lekë mujore për 150 m<sup>2</sup>. Të dyja kontratat janë lidhur për një afat 5 vjeçar dhe janë të likuiduara nga Bashkia Kamëz.

Në lidhje me ambientet të cilat Bashkia ka marr me qira grupi auditues konstaton se Bashkia nuk ka ndjekur një procedurë transparente për publikun (edhe nëpërmjet faqes së ëeb-it) ku të njoftohen dhe të kenë mundësi aplikimi qytetarët të cilët disponojnë një ambient brenda kërkesave të përcaktuara nga Bashkia Kamëz. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Kamëz të ndjek procedurat për publikun (edhe nëpërmjet faqes së ëeb-it) në mënyrë transparente në lidhje me ambientet e marra me qira nga njësia që të njoftohen dhe të kenë mundësi aplikimi qytetarët të cilët disponojnë një ambient brenda kërkesave të përcaktuara nga Bashkia.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Në faqen zyrtare të bashkisë janë publikuar kërkesa për ambientet me qera. Konkretisht në qershor 2022 është publikuar kërkesa për marrje me qera ambientesh për stacionin e zjarrfikësës në Paskuqan.*

**Statusi: Zbatuar**

**11. Gjetje nga auditimi:** U konstatuan gabime në regjistrimin e aplikuesve në librat e protokolleve dhe mungesa të dokumenteve në dosjet e përfitueseve.

Nga kontrolli i procesit të regjistrimit të aplikuesve në Librat e Protokollit 2020, në Njësinë Administrative Kamëz, Bathore dhe Paskuqan u konstatua se kanë aplikuar dhe janë regjistruar 2732 aplikantë. Grupi i auditimit ka konstatuar se:

- ka regjistrime të cilat edhe pse nuk është i njëjti individ kanë kaluar me fraksion në të gjithë Librin e Protokollit nuk është shënuar emri i specialistes së angazhuar në pranimin e aplikimeve të qytetarëve dhe të regjistrimeve të aplikimeve të tyre në sistemin online.
- mungojnë numrit rendor, ka patur kalime të numrit rendor duke cenuar renditjen e saktë sipas numrit pasardhës.
- nga nr. 1190 prot. deri në 1195 nuk kanë të regjistruar datën e aplikimit.
- në Librin e Protokollit në nr. prot. 849, nuk është regjistruar asgjë ndërkohë me nr. 849 ka qenë pjesë e vendimeve të Këshillit Bashkiak një qytetar me nivelin e dëmtimit DS3 ka mungesa të adresave.
- emri, mbiemri i aplikuesëve dhe nr. i prot. (39 raste) janë korrigjuar me korrektor, veprim i cili bie në kundërshtim me rregullat e plotësimit të Librit të Protokollit.
- nr. i prot. 646 është lënë bosh, pa asnjë emër aplikanti.
- nga nr. i prot. 480 deri në nr. e prot. 672 nuk ka asnjë datë të aplikimit të qytetarëve
- numri i fundit në Librin e Protokollit është 672 ndërkohë numrat e përfshirë në Vendimet e Këshillit Bashkiak kalojnë numrin ku kemi edhe 2 qytetar me numrat e protokollit 925 dhe 926
- në 5 raste të dublikimit të nr. të protokollit, një qytetar me të njëjtin nr. prot. një që nuk është regjistruar në Librin e Protokollit dhe një që është regjistruar në Librin e Protokollit.
- Kontrolli i dosjeve të përfitueseve:
- certifikata familjare për disa aplikues, e vendosur në dosje është lëshuar më datë 26.11.2019 dhe për disa aplikues të tjerë në datat në vazhdim ka patur mungesa në dosje përsa i përket certifikatës familjare si në rastin e z. Hysni Halil Bukaci.
- dosjet kanë fizikisht vërtetimin e lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative", disa kanë certifikatën për vërtetim pronësie ose vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, por kanë në mungesë kontratën e energjisë elektrike ose kontratën e shërbimit nga ujësjellësi në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 90, datë 03.08.2020 "*Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative dhe lagjeve si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfutur nga programet e rindërtimit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 62-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Rindërtimit të bashkëpunojë me komisionet e ngritura dhe të plotësojë dosjet me dokumentet që janë në mungesë.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë pajisur dosjet me dokumentacionin e duhur ligjor, dosja e Hysni Halil Bukaci është pajisur me certifikatë familjare.*

**Statusi: Zbatuar**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve në Drejtorinë e Strehimit, u konstatua se, për rastin e z. Shkëlqim Sul Peca, VKB nr. 44, datë 11.12.2019, ka aplikuar në muajin shtator 2020 (sipas dosjes fizike), për arsye mungese fondi pagesën e muajit shtator e tetor e ka përfituar në muajin nëntor 2020 (pra ka marr 3 muaj bashkë dhe vazhdon të trajtohet me pagesë mujore, ndërkohë nuk e ka përfituar bonusin e qirasë që nga data e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

Në rastin ku është përfituar vlera prej 32,000 lekë në një muaj, korrik 2020 nga znj. Nadire Sulejman Sala, VKB nr. 84, datë 17.07.2020, e cila është në kundërshtim me VKB- n ku janë përcaktuar vlerat për strukturë apartamenti dhe nuk ka vijuar ta marr Nga verifikimi rezulton se:

Duke qenë se Vendime të Këshillit Bashkiak nuk kanë fuqi para vepruese pra pagesa bëhet pas miratimit në Këshillin Bashkiak duhet të kishte kaluar bonusi i qerasë që nga momenti që ka kaluar me VKB. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 66-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Strehimit të pasqyrojë si dhe të njoftojë të gjithë familjet të cilat nga dëmtimi i banesave të tyre janë detyruar të marrin ambiente me qira të tërheqin vlerat që i takojnë për të përfituar sipas VKB-s ku janë përcaktuar vlerat për strukturë apartamenti.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë evidentuar familjet që kanë marrë ambiente me qera dhe janë njoftuar për të tërhequr vlerat që ju takojnë. Nga Bashkia Kamëz aktualisht trajtohen 445 familje me Bonus qeraje.*

**Statusi: Zbatuar**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga 20 dosjet e analizuara nga grupi auditues të gjitha kanë fizikisht vërtetimin e lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative”, por kanë në mungesë kontratën e energjisë elektrike ose kontratën e shërbimit nga ujęsjellësi në kundërshtim me VKB nr. 90, datë 03.08.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative dhe lagjeve si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga programet e rindërtimit”. Nga këto dosje, 3 prej tyre kanë certifikatën për vërtetim pronësie ose vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, 5 prej tyre kanë vërtetim për aplikim për legalizimin e objektit pa leje (vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë) dhe 4 prej tyre kanë kontratë me “UK Kamëz” Sh. A.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Rindërtimit në bashkëpunim me Komisionin e Posaçëm duhet t'i kërkojnë përfitueseve që kanë përfituar nga granti i rikonstruksionit, 8 prej të cilëve nuk e kanë paraqitur kontratën e energjisë elektrike ose kontratën e shërbimit nga ujęsjellësi dhe ta bëjnë pjesë të dosjeve të përfitueseve.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë pajisur dosjet me dokumentacionin e duhur ligjor, 2 dosje janë pajisur me vërtetim nga ASHK, ndërsa 6 dosje janë pajisur me vërtetime nga ujęsjellësi.*

- *Fatime Bajram Bulica, vërtetim nga UKK-ja nr. 1447 prot, date 29.06.2022*
- *Shkelzen Bajram Hasa Vertetim nga ASHK-ja date 21.10.2020*
- *Mentor Xhemali Toluli (Topallaj), vërtetim nga UKK-ja nr. 1449 prot, date 29.06.2022.*
- *Ermal Agim Lleshi, vërtetim nga UKK-ja nr. 1452 prot, date 29.06.2022*
- *Xhevahire Mislum Doçi, vërtetim nga UKK-ja nr. 1456 prot, date 30.06.2022*
- *Arjan Ramazan Islamaj, vërtetim nga UKK-ja nr. 1457 prot, date 30.06.2022*
- *Sali Han Koldashi, Vertetim nga ASHK-ja nr. 7811 prot, date 04.10.2019*
- *Fatmir Vesel Lashi, vërtetim nga UKK-ja nr. 1451 prot, date 29.06.2022*

**Statusi: Zbatuar**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve rezultoi se, nuk janë zbatuar plotësisht masat e rikërkuar nga KLSH-ja me shkresën nr. 1269/14 prot., datë 21.12.2018 dhe, konkretisht:

- Nga 5 masa organizative të rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë zbatuar 2 masa dhe janë në proces zbatimi 3.

- Nga 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,561,856 lekë** është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.12.2020, janë arkëtuar **1,865,974lekë** dhe janë nisur njoftimet për 2 rekomandime për 4 persona në vlerën 147,102 lekë por ende nuk kanë filluar arkëtimet.

-Janë nisur njoftimet për 26 biznese dhe 4 persona debitor por ende nuk kanë filluar arkëtimet në vlerën **505,573 lekë**.

- Lidhur me arkëtimin e vlerës **427,102 lekë** për 11 persona përfitues të paguar nga fondi i veçantë shpërblime për punë të mirë, rezulton se nga 11 persona në vlerën prej 427,102 lekë, janë arkëtuar nga 7 persona vlera prej **280,000 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar edhe nga 4 persona vlera prej 147,102 lekë.

- Nga vlera debitorë prej **49,781,264 lekë**, për 248 subjekte, rezulton se është arkëtuar vlera prej 5,985,352 lekë, nga 65 subjekte, është pa arkëtuar vlera prej 43,795,912 lekë nga 183 subjekte.

- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet nga 4,226 persona debitor në vlerën totale të pa arkëtuar prej **285,035,451 lekë**, deri me date 31.12.2020 janë arkëtuar vlerat prej **219,938,509 leke dhe me datë 31.12.2020** rezultojnë debitor 1820 persona në vlerën 65,096,942 lekë.

- Lidhur me regjistrimin në QKB të 45 subjekteve dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën **2,082,685 lekë**, rezulton se, vlera e detyrimeve prej **2,082,685 lekë**, është regjistruar në kontabilitet si detyrim i bizneseve ndaj bashkisë. Nga vlera prej **2,082,685 lekë**, është arkëtuar vlera prej **1,585,974 lekë**, duke mbetur pa arkëtuar vlera prej **496,711 lekë**. Për 26 subjektet që rezultojnë debitor janë bërë njoftim detyrimet, është bërë kërkesa për pagesë dhe u është dërguar bankave urdhër për bllokimin e llogarive bankare.

- Lidhur me shpërblimin e dëmit në vlerën **2,134,754lekë** nga aplikimi i tarifës për taksat për biznesin e vogël (taksë pastrimi, taksë ndërtese, taksë gjelbërimi), më të ulta se sa janë miratuar në paketën fiskale me Vendime të Këshillit të Bashkisë, rezultoi se, deri më datë 31.12.2020, është arkëtuar vlera prej **1,585,974 leke**, dhe ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej **496,711 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në shkëlqje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit" dhe shkresën nr. 269/14 prot., datë 21.12.2018 "Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kamëz" (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 167-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërorë. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shumave në buxhetin e bashkisë. Të zbatohen plotësisht rekomandimet e pa realizuara dhe rikërkuar nga KLSH-ja me shkresën nr. 1269/14 prot, datë 21.12.2018 të KLSH-së.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Bashkia Kamëz për uljen e debisë së taksave familjare ka marrë masa si me poshtë: Janë shpërndarë me anë të Faturistëve të Agjentit Tatimor UKK sha, 21,174 njoftim detyrime për vitin 2022. Nuk ofrohet asnjë shërbim pranë zyrave të institucionit Bashki pa u shlyer detyrimet vendore me anë të formularit të shërbimit si dhe sistemi i Operatorit Online të shërbimeve One Stop Shp. I jemi drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile për familjet Aktive me përditësimet e fundit dhe janë reflektuar në sistemin e DTTV-së. Vijon puna për realizimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 1269/14 prot., datë 21.12.2018.*

**Statusi: Në proces zbatimi**

**15 Gjetje nga auditimi:** Në 3 (tre) raste nga auditimi i zbatimit të procedurës të dhënies së lejes infrastrukurore, respektivisht:

-Për lejen infrastrukurore nr. 502, datë 28.08.2018 me objekt "Ndërtim Shkolla 9-vjeçare Frutikulture" u konstatua se leja nuk përmbush kërkesat teknike sepse nuk janë përcaktuar treguesit zhvillimor dhe kondicionet urbane urbanistike, si; sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura; sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë; lartësia maksimale e ndërtimit nga niveli 0 i ndërtimit; numri i kateve mbi dhe nën tokë; gjithashtu në sistemin elektronik e-lejet, mungon Deklarata e përgjegjësisë së projektuesit të licensuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjisllacionin në fuqi; Mungojnë Licencat e projektuesve dhe mungon vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, që subjekti ndërtues ka shlyer taksat dhe tarifat vendore, të parashikuara nga pushteti vendor.

- Për lejen infrastrukturore nr. 962, datë 11.07.2019 me objekt "Rehabilitimi i digës" Liqeni i Paskuqanit" Bashkia Kamëz, u konstatua se është dhënë leja në mungesë të Licencës së inxhinierit topograf, mungon Deklarata e projektuesit të licencuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi.

-Për lejen infrastrukturore nr. 2130, datë 22.10.2020 me objekt "Ndërtim rrugët Azem Galica (trotuare) + Baldushk dhe Europa" lagjia Zall Mner , Frutikulturë Bashkia Kamëz me zhvillues Bashkia Kamëz, në pronë të Bashkisë Kamëz" u konstatua se leja është dhënë në mungesë të dokumenteve: Planimetria e projektit nuk është konfirmuar nga UK Kamëz si dhe në dokumentacionin e dorëzuar elektronikisht konstatohet se mungon Raporti Gjeologjik i objektit si dhe Rilevimi topografik i sipërfaqes së objektit "Ndërtim rrugët Azem Galica (trotuare) + Baldushk dhe Europa" lagjia Zall Mner, Frutikulturë Bashkia Kamëz me zhvillues Bashkia Kamëz, në pronë Bashkia Kamëz bashkë me licencën e projektimit. Sa trajtuar janë miratuar këto leje në mungesë të dokumentacionit të plotë. Ky veprim është bërë në kundërshtim me Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 29, 43 dhe 44 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, nenet 10; 14 dhe 20 të VKM nr. 408, datë 13/05/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 172-174 të Raportit të Auditimit).

**15.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Kamëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që nga verifikimi rezulton se: të miratojmë leje infrastrukturore dhe zhvillimore vetëm atëherë kur të jetë hartuar dhe plotësuar i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor i parashikuar në kuadrin ligjor në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Shqyrtimi dhe miratimi i lejeve infrastrukturore dhe zhvillimore është bërë vetëm atëherë kur është hartuar dhe plotësuar i gjithë dokumentacioni i parashikuar në kuadrin ligjor në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit, konkretisht bazuar në Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" dhe VKM-në nr. 408/2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar.*

**Statusi: Zbatuar**

**16 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për kontratën e shërbimit "Kontratë për dhënien me koncesion/PPP të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për qytetin e Kamëzës" me vlerë 1,620,000,000 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Alko Impex General Construction" & "2T" SHPK me nr. 1107 rep dhe nr. 486/4 kol, datë 23.05.2018, sipas marrëveshjes nr. 2285 kol, nr. 2973 rep, datë 13.04.2018, me afat realizimi 12 vjetësh, u konstatua se:

- NjZP nuk ka mbajtur proces verbale dhe situacione mujore për masën e kryerjes së shërbimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 6, pika 6.2 "Mbikëqyrja e përgjithshme e shërbimit" të kontratës koncesionare dhe ngarkon me përgjegjësi Anëtarët e NJZP.

- Nga Koncesionari nuk janë hartuar grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve dhe nuk janë miratuar nga Autoriteti Kontraktor, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me pikën 3.3 "Grafikët e punimeve" aneksi 3.

- Nga Koncesionari nuk janë hartuar grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës...Në grafikët e shërbimeve duhet të përcaktohet saktë:

- Oraret e operimit në secilin vendgrumbullim mbetjesh.
- Llojin, targën dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
- Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
- Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 6.2/f "Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim" aneksi 3.

- Nga Koncesionari, lidhur me fshirjen e rrugëve dhe trotuareve, nuk është përcaktuar grafiku i punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, nuk është përcaktuar orari i operimit në secilin rrugë dhe trotuar si dhe nuk është përcaktuar numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh, veprime këto në kundërshtim me pikën 7.3, shkronjat c, d, e, f Aneksi 3.

- Nga Koncesionari, lidhur me fshirjen e rrugëve me makineri teknologjike, nuk është përcaktuar grafiku i punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, nuk është përcaktuar orari i operimit në secilin

rrugë si dhe lloji dhe itinerari i makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin, veprime këto në kundërshtim me pikën 8.3, shkronjat a, b, c, d, e, f Aneksi 3.

- Nga Koncesionari, lidhur me larjen e rrugëve me makineri teknologjike, nuk është përcaktuar grafiku i punimeve për realizimin e shërbimit të larjes së rrugëve.. nuk është përcaktuar orari i operimit në secilin rrugë si dhe lloji dhe itinerari i makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin, veprime këto në kundërshtim me pikën 9.3, (1,2,3,4,5) Aneksi 3. Sa më sipër trajtuar, është në kundërshtim me Dokumentet e Tenderit; Specifikimet Teknike; kërkesat e kontratës nr. 1107 rep dhe nr. 486/4 kol, datë 23.05.2018, aneksi 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 127/158/163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:** NjZP për kontratën koncesionare me objekt “Kontratë për dhënie me koncesion/PPP të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për qytetin e Kamëz”, të marrë masa që Nga verifikimi rezulton se: përgjatë ekzekutimit të kontratës t’i kërkojë JV “Alko Impex General Construction” & “2T” SHPK, të plotësojë dokumentet për:

- Hartimin e proces-verbaleve dhe situacione mujore për masën e kryerjes së shërbimeve sipas preventivit ofertues.

- Hartimin e grafikëve të shërbimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve; grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës; grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës; grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të larjes së rrugëve, sipas preventivit dhe të miratuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor.

**Nga verifikimi rezulton se:**

Janë hartuar proces verbalet dhe situacionet mujore sipas preventivit fitues, janë hartuar grafikët e shërbimeve për transportin, larjen, dezinfektimin e kontejnerëve.

**Statusi: Zbatuar**

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim shkolla 9-vjeçare, lagjia Frutikulturë Kamëz” Bashkia Kamëz, me vlerë 191,926,116 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori “4 A-M” SHPK, rezultuan në objekt zbatimi i zërit të punimeve “F.V Dyer druri cilësia I” jo në përputhje me specifikimet teknike. Ky zë pune nuk është realizuar në konformitet me zërin 2.383/1 por është realizua sipas zërit 2.388/1 “F.V Dyer të brendshme tamburatë të rimesuara” ku dyert nuk janë dru, por janë prodhuar me material tamburatë të rimesuara duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **777,701 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4875 prot datë 12.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe Kontraktorit “4 A-M” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4faqe 128-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **777,701 lekë pa TVSH** nga Kontraktori “4 A-M” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike me nr. 4875 prot, datë 12.09.2018 me objekt “Ndërtim shkolla 9-vjeçare, lagjia Frutikulturë Kamëz”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera jo në përputhje me specifikimet teknike.

**Nga verifikimi rezulton se:**

Vlera e detyrimit është arkëtuar me faturë në bankë datë 08.04.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.

**Statusi: Zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim “Drini” lagje nr. 1 Bathore” Bashkia Kamëz, me vlerë 110,272,306 lekë me TVSH, fituar nga BOE “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volum pune të zërit të punimeve: Punime në trotuar, në vlerën **139,461 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1202/1 prot datë 06.03.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe BOE “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **139,461 lekë pa TVSH** nga BOE “Klajger Konstruksion” SHPK & “Varaku-E” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në



kontratën me nr. 1202/1 prot, datë 06.03.2019 me objekt “Ndërtim rruga “Drini” lagjia nr. 1, Bathore”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzimit nr. 339 datë 24.03.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim rruga “Zanave” lagje nr. 1 Bathore” Bashkia Kamëz, me vlerë 130,910,935 lekë me TVSH, fituar nga kontraktori “Kthella” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volum pune të zërit të punimeve: Punime në trotuar, në vlerën **362,934 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5015 prot datë 18.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe kontraktorit “Kthella” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 154-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **362,934 lekë pa TVSH** nga Kontraktori “Kthella” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5015 prot, datë 18.09.2018 të kontratës me objekt “Ndërtim rruga “Zanave” lagje nr. 1, Bathore”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve në trotuar të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Arkëtuar me faturë në bankë datë 20.04.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rruga “Konispol” + rruga “Zef Llesh Doçi” + Nd. trotuare Rr. “Lura” + Nd. Rr. Tirana + Berati + Fusha e Sportit” Bashkia Kamëz, me vlerë 66,570,821 lekë me TVSH, fituar nga kontraktori “EVEREST” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volum pune të zërit të punimeve: Punime në trotuar, në vlerën **386,400 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 375 prot datë 23.01.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe kontraktorit “Everest”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **386,400 lekë pa TVSH** nga Kontraktori “Everest” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 375 prot, datë 23.01.2019 të kontratës me objekt “Rruga “Konispol” + rruga “Zef Llesh Doçi” + Nd. trotuare Rr. “Lura” + Nd. Rr. Tirana + Berati + Fusha e Sportit”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve në trotuar të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzimit nr. 781 datë 16.06.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim rruga “Konferenca e Mukjes” Bashkia Kamëz, me vlerë 85,708,228.80 lekë me TVSH, fituar nga BOE “Arb & Trans - 2010” SHPK dhe “Sireta 2F” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve: “Shtresë binderi me zall lavatrice, 5 cm , me makineri” dhe “Shtresë asfaltobetoni 4 cm + spërkatje me emulsion”, në vlerën **3,248,750 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6335 prot datë 22.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe BOE “Arb & Trans - 2010” SHPK dhe “Sireta 2F” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 133-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,248,750 lekë pa TVSH** nga BOE “Arb & Trans - 2010” SHPK dhe “Sireta 2F” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6335 prot, datë 22.11.2018 të kontratës me objekt “Ndërtim rruga “Konferenca e

Mukjes”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 326 prot. dt. 13.04.22 është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e kërkesës së subjektit "ARB & Trans -2010" shpk. Nga grupi i punës është mbajtur proces verbali nr. 326/1 prot. datë 15.05.22, i cili ka përcaktuar zërat e punimeve të pa argumentuara në vlerën 702,075 lekë. Vlerat e paargumentuara janë arkëtuar me faturë në bankë datë 23.06.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim rruga “Kosova, Monarkia Shqiptare, Monte Karlo” Bashkia Kamëz, me vlerë 85,762,101 lekë me TVSH, fituar nga OE “Shpresa - AL” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërin e punimeve: “F.V. Bordurë 15x35 cm”, në vlerën 120,152 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6244 prot datë 15.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe OE “Shpresa AL” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 136-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 120,152 lekë pa TVSH nga Kontraktori “Shpresa - AL” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6244 prot, datë 15.11.2018 të kontratës me objekt “Ndërtim rruga “Kosova, Monarkia Shqiptare, Monte Karlo””, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve në trotuar të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzim nr. 838 datë 21.06.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim rruga Berzhitë + Zadrime + Asdreni” Bashkia Kamëz, me vlerë 47,086,506 lekë me TVSH, fituar nga JV “Britania” SHPK & “Klajger Konstruksion” SHPK, rezultuan në objekt punime ndërtimi të kryera jo sipas ST dhe diferenca në volume pune për zërin e punimeve: “F.V. Bordurë 15x35 cm”; “Shtresë asfaltobeton 1x4 cm”, në vlerën 1,980,333 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kushtet e kontratës e sipërmarrjes me nr. 6786/1 prot datë 19.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe JV “Britania” SHPK & “Klajger Konstruksion” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa që të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve me kolaudatorin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë trashësinë e shtresave asfaltikë në rrugën Zadrime mbi bazën e matjeve me karrotazh të kryera nga laborator i akredituar bazuar nga fakti i auditimit në terren ku trashësia e binderit dhe asfaltobetonit rezultuan jo në përputhje me specifikimet teknike. Në rast të kundërt bashkia Kamëz të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 1,980,333 lekë pa TVSH nga Kontraktori JV “Britania” SHPK & “Klajger Konstruksion” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6786/1 prot, datë 19.12.2018 të kontratës me objekt “Ndërtim rruga Berzhitë + Zadrime + Asdreni”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve në shtresat asfaltike të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 257 prot. datë 11.03.22 është ngritur grupi i punës për shqyrtimin dhe analizimin e zërave të punimeve. Nga grupi i punës është mbajtur proces verbali nr. 257/1 prot. datë 08.04.22, i cili ka përcaktuar zërat e punimeve të pa argumentuara në vlerën 502,596 lekë. Vlerat e paargumentuara janë mbajtur me urdhër shpenzim nr. 697 datë 06.06.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim rruga “Mustafa Lita” Babrru Kodër e kuqe - Bulcesh” Bashkia Kamëz, me vlerë 47,999,999 lekë me TVSH, fituar nga kontraktori “Sireta 2F” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërat e punimeve: “Transport dheu me auto deri në 5 km” dhe “Shtresë asfaltobeton 4

cm + spërkatje me emulsion”, në vlerën 222,770 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 518 prot datë 30.01.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe kontraktori “ Sireta 2F” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 222,770 lekë pa TVSH nga Kontraktori “Sireta 2F” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 518 prot, datë 30.01.2019 të kontratës me objekt “Ndërtim rruga “Mustafa Lita” Babrru Kodër e kuqe - Bulcesh”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzim nr. 340 datë 24.03.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim rrugët (Iliria + Burimi + Mbretëresha Zuzanë)” Bashkia Kamëz, me vlerë 37,564,380 lekë me TVSH, fituar nga kontraktori “Ndregjoni” SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune për zërin e punimeve “ Shtresë binderi t=6cm”, në vlerën 263,894 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5767 prot datë 24.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kamëz dhe kontraktori “Ndregjoni” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4. faqe 141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 263,894 lekë pa TVSH nga Kontraktori “Ndregjoni” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5767 prot, datë 24.10.2018 të kontratës me objekt “Ndërtim rrugët (Iliria + Burimi + Mbretëresha Zuzanë)”, Bashkia Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është arkëtuar me faturë në bankë me datë 29.03.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim rruga “Demokracia”, Loti II, Bathore”, Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (me TVSh)87,758,820 lekë, fituar nga BOE “Kupa” SHPK & “KolaInvest” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,128,914 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2428 prot datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “Kupa” SHPK & “KolaInvest” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 142-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,128,914 lekë pa TVSh nga BOE “Kupa” SHPK & “Kola Invest” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2428 prot datë 07.05.2019, me objekt “Ndërtim rruga “Demokracia”, Loti II, Bathore”, Bashkia Kamëz, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga bashkia është bere kërkesë dhe është dërguar në gjykatën Administrative te Shkalles se pare Tirane, me shkresën nr. 10778 prot date 18.11.2022.*

**Statusi: Detyre ne proces zbatimi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtim KVIN “1 Maj”, paralel me rrugën 1 Maj”, Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (me TVSh) 7,676,280 lekë, fituar nga BOE “Britania” SHPK & “Ndërtimi” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 413,300 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3858 prot datë 29.05.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor

Bashkia Kamëz dhe BOE "Britania" SHPK & "Ndërtimi" SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 144-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **413,300 lekë pa TVSh** nga BOE "Britania" SHPK & "Ndërtimi" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3858 prot datë 29.05.2020, me objekt "Ndërtim KUN "1 Maj", paralel me rrugën 1 Maj", Bashkia Kamëz, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzimit nr. 921 datë 06.07.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërtim rrugët Hasan Zylfia (trotuare), Rruga Sali Vranishti (trotuare)", Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (me TVSh) 29,951,461 lekë, fituar nga OE "Junik" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 449,187 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8479 prot datë 22.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE "Junik" SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 147-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **449,187 lekë pa TVSH** nga OE "Junik" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8479 prot datë 22.10.2020, me objekt "Ndërtim rrugët Hasan Zylfia (trotuare), Rruga Sali Vranishti (trotuare)", Bashkia Kamëz, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzim nr. 489 datë 21.04.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërtim ura Paskuqan 1", Bashkia Kamëz, me vlerë të kontratës (me TVSH) 102,917,980 lekë, fituar nga OE "4 AM" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 864,600 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8000 prot datë 12.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE "4 AM" SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 151-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **864,600 lekë pa TVSH** nga OE "4 AM" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8000 prot datë 12.10.2020, me objekt "Ndërtim ura Paskuqan 1", Bashkia Kamëz, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është arkëtuar me faturë në bankë datë 08.04.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**14. Gjetje nga auditimi:** Objekti i kontratës "Ndërtim KUN Kamëz rruga Skënderbeu deri te Kujtesa, rruga Dibra dhe rruga Dritero Agolli" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3915 prot. datë 09.07.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Kamëz, dhe OE "Arjeil" shpk. Vlera e kontratës është 44,131,680 lekë me TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 289,492 lekë pa TVSH, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 165-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën **289,492 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Vlera e detyrimit është mbajtur me urdhër shpenzim nr. 835 datë 21.06.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**15. Gjetje nga auditimi:** Objekti i kontratës "Ndërtim rrugë Blloku Babrru Kodër e Kuqe" është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2835 prot. datë 27.05.2019, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Kamëz dhe OE "Bami" ShPK. Vlera e kontratës është 46,156,323 lekë me TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi dhe në këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,243,000 lekë pa TVSH, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të cilat rezultuan të paargumentuara në vlerën **1,243,000 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare, për arkëtimin e vlerës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 257 prot. datë 11.03.22 është ngritur grupi i punës për shqyrtimin dhe analizimin e zërave të punimeve. Nga grupi i punës është mbajtur proces verbali datë 08.04.22, i cili ka përcaktuar zërat e punimeve të pa argumentuara në vlerën 637,320 lekë. Vlerat e paargumentuara janë mbajtur me urdhër shpenzim nr. 763 datë 08.06.2022, sipas aneks 7.1 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 9 procedurave me vlerë totale të fondit limit 435,550,405 lekë pa TVSH, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP-së si pasojë e vlerësimit nga KVO jo të drejtë të fondeve publike për vlerën **237,884,936** lekë pa TVSH e fondit të prokuruar, nga të cilat **8,547,477** lekë pa TVSH si diferenca midis ofertave të OE në klasifikimin (ai fitues dhe ai me vlerë më të ulët), në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, respektivisht:

**1.1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rehabilitim i Digës Rezervuari Paskuqan" (2019), me fond limit 54,029,760 lekë pa TVSH, me fitues BOE "Vllaznia Ndërtimi I.S + Ndregjoni" shpk me vlerë të ofertës 53,221,580 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO dhe KSHA ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **212,223** lekë pa TVSH, në kushtet kur asnjë prej ofertuesve nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Ndërtim rrugë (Sado Koshenko+Seglidhese Kaci +Sali Vranishti)" (2019), me fond limit 15,266,767 lekë pa TVSH, me fitues BOE "KUPA" shpk& "SELAMI" shpk me vlerë të ofertës 14,021,728 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **1,776,008** lekë pa TVSH, në kushtet kur asnjë prej ofertuesve nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 102-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rruga (Havzineli+Iliakici+Jeronim De Rada)" (2019), me fond limit 35,852,855 lekë pa TVSH, me fitues BOE "KUPA" shpk& "SELAMI" shpk me vlerë të ofertës 31,943,004 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO

ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **3,000,092 lekë (31.943.004–28.942.912)**, në kushtet kur asnjë prej ofertuesve nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 100-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim Rruga “Sllövë”; “Prezë” “AsimVokshi”; “Ali Pashë Tepelena”; “Farkë”; “Bërxullë”seg; “Bërxullë” seg; “Farkë” (2020), me fond limit 46,313,179 lekë pa TVSH, me fitues OE “UDHA” shpk me vlerë të ofertës 46,112,635 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **46,112,635 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim Rrugët Ylberë Bylikbashi (Faik Kulla)+ Rruga Xhemal Kada” (2020), me fond limit 46,313,179 lekë pa TVSH, me fitues BOE “SIRETA 2F” shpk& “EURO-ALB” shpk me vlerë të ofertës 25,555,555 lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **25,555,555 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim rruga “Lure + Fatos Çupi” Laknas” (2020), me fond limit 42,750,567 lekë pa TVSH, me fitues BOE “BRITANIA” shpk& “NDERTIMI” shpk me vlerë të ofertës 40,782,385lekë pa TVSH, ku ka rezultuar se KSHA ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të Dokumenteve Standarde të Tenderit, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **40,782,385 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 110-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.(1-6) Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për **vlerën 237,884,936 lekë** pa TVSH e fondit të prokuruar, nga të cilat **8,547,477 lekë pa TVSH** si diferenca midis ofertave të OE në klasifikimin (ai fitues dhe ai me vlerë më të ulët). Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST. Grupi i punës ka hartuar relacionin me nr. 242/1 prot. datë 22.04.2022, ku ka nxjerrë përgjegjësitë dhe i ka propozuar Drejtorisë Burimeve Njerëzore fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës.

Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë marrë masat disiplinore, sipas aneksi 7.2 bashkëlidhur aktit.

**Statusi: Zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës me objekt “Rehabilitim i Digës Rezervuari Paskuqan”, zhvilluar në vitin 2019, me fond limit 54.029.760 lekë pa TVSH, nga KVO është kualifikuar dhe propozuar për t’u shpallur fitues BOE “Alko Impex General Konstruksion” & “2T” shpk si të vetmin që plotëson kriteret e pjesëmarrjes, me vlerën e ofertës ekonomike prej 53,009,357 lekë pa TVSH. Në lidhje me klasifikimin, në datën 24.06.2019 ka paraqitur ankesë (nr. 3467 prot.,) OE “Vllaznia Ndërtimi I.S + Ndrejoni” dhe më pas në datën 01.07.2019 ka paraqitur ankesë (nr. 3703 prot.,) BOE “Alko Impex General Konstruksion” & “2 T” shpk. Më pas, Titullari i AK ka zbatuar pjesërisht sipas LPP procedurën ligjore të kërkuar në lidhje me ankimin e paraqitur nga OE “Vllaznia Ndërtimi I.S + Ndrejoni”, në lidhje me ankimin e paraqitur nga OE “Alko Impex General Konstruksion”& “2 T”. Në rastin e ankesës së BOE “Alko Impex General Konstruksion” & “2 T” në kundërshtim të plotë me LPP, titullari i AK jo vetëm nuk ka pezulluar procedurën e prokurimit por nuk ka ngarkuar gjithashtu asnjë zyrtar apo komision për shqyrtimin e ankesës duke kryer personalisht me shkresën nr. 3703/1prot., datë 02.07.2019 “Kthim përgjigje” njoftimin e BOE “Alko Impex General Konstruksion” & “2 T” shpk dhe duke bërë me dije këta të fundit se ankesa nuk merret në konsideratë.

Në këto kushte nga veprimet dhe mosveprimet e tij si pasojë e të cilave pas rivlerësimit kanë sjellë ndryshimin e klasifikimit midis OE kanë bërë të mundur përdorimin e fondeve jo në përputhje me parimet e përdorimit me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publik në vlerën 212,223 lekë (53,221,580– 53,009,357), si diferenca midis ofertës të OE të renditur të parin në klasifikimin fillestar dhe asaj të shpallur pas fazës së ankimeve. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1; pika 2, shkronja (d), neni 63; dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 78, pika 2 dhe 6/a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet 97-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 212,223 lekë. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST. Grupi i punës ka hartuar relacionin me nr. 242/1 prot. datë 22.04.2022, ku ka nxjerrë përgjegjësitë dhe i ka propozuar Drejtorisë Burimeve Njerëzore fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës.*

*Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë marrë masat disiplinore, sipas aneksi 7.2 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurës me objekt “Ndërtim KUN Rrugët Kamëz”, zhvilluar në vitin 2019, me fond limit 39,097,860 lekë pa TVSH, nga KVO është kualifikuar dhe propozuar për tu shpallur fitues BOE “Arjeil” shpk & “4 A-M” shpk, si të vetmin ofertues që plotëson kriteret e pjesëmarrjes, me vlerën e ofertës ekonomike prej 36,776,400 lekë pa TVSH. Referuar procesverbaleve përkatës të datës 20.06.2019 si dhe njoftimit të fituesit rezultoi se KVO-ja, pasi ka kualifikuar BOE “Arjeil” shpk & “4 A-M” shpk, si të vetmin ofertues që plotëson kriteret e pjesëmarrjes, ka s’kualifikuar 4 OE të tjerë me arsyetimin si vijon: “OE nuk ka paraqitur certifikatë për konformitetin e tubave të betonit, certifikatë për prodhim a shitje të tubave të betonit, dokumentacion për disponueshmërinë e makinerisë për prodhimin e tubave të betonit...”. Arsyeja e përdorur nga KVO-ja për s’kualifikimin e 4 OE të tjerë, e cila është e njëjtë në të katër rastet, nuk qëndron sepse, AK në datën 22.05.2019 ka njoftuar në SPE nëpërmjet shtojcës së datës 20.05.2019 heqjen e kriterit të sipërcituar.

Nga sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë pasi, për të gjithë OE pjesëmarrës, mangësia në plotësimin e kriterit të sipërcituar nuk qëndron. Në rastin konkret, veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të KVO-së kanë sjellë si pasojë përdorimin e fondeve jo në përputhje me parimet e përdorimit me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publik në vlerën 2,406,400 lekë (36,776,400– 34,370,180), si diferenca midis ofertës të OE të shpallur fitues dhe asaj me vlerën më të ulët të s’kualifikuar pa të drejtë nga KVO-ja, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2, shkronja (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO-së. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 99-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 2,406,400 lekë. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST. Grupi*

*i punës ka hartuar relacionin me nr. 242/1 prot. datë 22.04.2022, ku ka nxjerrë përgjegjësitë dhe i ka propozuar Drejtorisë Burimeve Njerëzore fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës.*  
*Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë marrë masat disiplinore, sipas aneksi 7.2 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit "Ndërtim rruga (Bërzhitë + Zadrime + Asdreni), lagja 4 Bathore", oferta e OE "Company Riviera 2008" shpk, me vlerë 30.076.792 lekë pa TVSH, ka qenë në përputhje me parimet e ekonomikitetit dhe eficiencës, bazuar kritereve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Kontrata "Rivitalizim Urban i qendrës Qyteti Rrogozhinë" në vlerën 149,983,775 me TVSH i përmbush plotësisht kriteret e kontratës së ngjashme për ndërtim rruge. Në gjykimin e audituesit s'kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, sepse në preventivin e punimeve të kontratës së paraqitur si punim i ngjashëm vetëm kapitulli I "Punime për infrastrukturën rrugore, pedonale, asfaltim, kullimi i ujerave të shiut" në vlerë 56,418,663 lekë pa TVSH dhe kapitulli II "Punime për infrastrukturën rrugore, pedonale, asfaltim, kullimi i ujerave të shiut", në vlerën 25,961,108 lekë pa TVSH, rrjedhimisht e përmbush plotësisht kriterin e punimeve të ngjashme pikën 2.3/1. Veprimet e KVO-së nuk janë në përputhje të plotë me LPP. Me raportin përmbledhës datë 03.12.2018, miratohet raporti përmbledhës nga Ish-Kryetari i Bashkisë, ku miratohet fituesi i procedurës BOE "Britania" & "Klajger Konstruksion", me ofertë 39.238.755 lekë pa TVSH. Diferenca e vlerës prej 10,994,355 lekë me TVSH (39.238.755 lekë - 30.076.792 lekë = 9,161,963 lekë x 20%), midis ofertës së "Company Riviera 2008" shpk dhe ofertën e BOE "Britania" & "Klajger Konstruksion", ka shkaktuar përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e përdorimit me ekonomikitet, efience dhe efektivitet dhe ngarkon me përgjegjësi KVO-në. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 10,994,355 lekë. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST. Grupi i punës ka hartuar relacionin me nr. 242/1 prot. datë 22.04.2022, ku ka nxjerrë përgjegjësitë dhe i ka propozuar Drejtorisë Burimeve Njerëzore fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës.*

*Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë marrë masat disiplinore, sipas aneksi 7.2 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit "Ndërtim rruga "Drini" lagja nr. 1 Bathore", oferta e BOE "Kacdedja" & "Agri Konstruksion" shpk, me vlerë 90,148,550 lekë pa TVSH, ka qenë e duhura për Bashkinë Kamëz, në përputhje me parimet e ekonomikitetit dhe eficiencës, bazuar kritereve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. BOE "Kacdedja" & "Agri Konstruksion" u s'kualifikua pasi automjetet Rrull BOM, AG BË viti 2003 dhe Rrul DYNAPAC CA25 janë marrë me qira nga ofertues, por janë paraqitur edhe nga ofertues tjetër, ku u konstatua se s'kualifikim është i padrejtë i BOE. KVO nuk ka sqaruar se ku janë dhënë këto mjete, çfarë afatesh përdorimi kanë pasi të dyja mjetet janë në pronësi të vetë ofertuesit "Agri Konstruksion" shpk, çka nënkupton plotësimin e këtij kriteri nga ky i fundit. Në raste KVO mund t'i kishin lindur dyshime për përdorimin e dyfishtë të mjeteve, atëherë bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 1. Gjithashtu referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 3. Oferta më e leverdishme e BOE "Kacdedja" shpk & "Agri Konstruksion" shpk, me vlerë 90,148,550 lekë pa TVSH, është më e leverdishme, në përputhje me parimet e ekonomikitetit dhe eficensës. Interpretimi i pikave në raportin nga KVO, të operatorëve ekonomik nuk do të cenonte objektin e prokurimit. Pra nëse AK do të qëndronte parimeve të çmimit më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike. Diferenca e vlerës prej 2,094,046 lekë me TVSH (91,893,589 lekë - 90,148,550 lekë = 1,745,039 lekë x 20%), midis ofertës së BOE "Kacdedja" shpk & "Agri Konstruksion" shpk dhe ofertën e BOE fitues



"Klajger konstruksion" shpk& "Varaku E", përbën përdorim të fondeve publike jo në përputhje me parimet e përdorimit me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **2,094,046 lekë**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST. Grupi i punës ka hartuar relacionin me nr. 242/1 prot. datë 22.04.2022, ku ka nxjerrë përgjegjësitë dhe i ka propozuar Drejtorisë Burimeve Njerëzore fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës.*

*Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë marrë masat disiplinore, sipas aneksi 7.2 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit " Ndërtim rruga Mustafa Lita ", Oferta e OE "Alesio" shpk, me vlerë 31,215,812 lekë pa TVSH, ka qenë më e leverdishme për Bashkinë Kamëz, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është **qmimi më i ulët**. S'kualifikimi i këtij OE është plotësisht i padrejtë, pasi referuar dokumenteve të tenderit (DT), mbi punimet e ngjashme.

Mbështetja ligjore e cituar nga KVO ku OE nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme sipas përcaktimeve të LPP-se nenit 61/3 "Nënkontraktimi, rregullon marrëdhëniet e OE me AK dhe nuk ka të bëjë me Nënkontraktorit, të cilin në rastin konkret operatori "Alesio" shpk, ka paraqitur kontratat e ngjashme dhe që e plotëson plotësisht kriterin e përcaktuar mbi punimet e ngjashme siç është kërkuar në DT (Deklarata sipas shtojcës 9, Kontratën dhe Situacionin përfundimtar. OE ka paraqitur si kontrata të ngjashme nënkontraktimit me operatorët ekonomikë: "Delta" sh.a, "Shpresa-AL" SHPK, "AlkoImpex" SHPK, "Junivers" SHPK, "Gjikuria" SHPK dhe "Alba Konstruksion" SHPK).

Oferta e operatorit "Alesio" shpk, me vlerë 31,215,812 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për Bashkinë Kamëz, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është **qmimi më i ulët**. Diferenca e vlerës prej **10,541,025 lekë me TVSH** (40,000,000 lekë - 31,215,812 lekë = 8,784,188 lekë x 20%), midis ofertës së "Alesio", shpk dhe ofertën e BOE "Sireta 2F", ka shkaktuar përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e përdorimit me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Kamëz, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **10,541,025 lekë**. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022 është ngritur grupi i punës për nxjerrjen e përgjegjësive për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST. Grupi i punës ka hartuar relacionin me nr. 242/1 prot. datë 22.04.2022, ku ka nxjerrë përgjegjësitë dhe i ka propozuar Drejtorisë Burimeve Njerëzore fillimin e ecurisë disiplinore për personat përgjegjës.*

*Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore janë marrë masat disiplinore, sipas aneksi 7.2 bashkëlidhur aktit.*

**Statusi: Zbatuar**

## **E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)**

**1.Gjetje nga auditimi:** Vlera e debitorëve nga bizneset deri më datë 31.12.2020 paraqitet rreth **113,329,862 lekë**, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifave vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Kamëz. Vlera e gjobave llogaritet në **966,071 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kamëz. Vlera e debisë nga familjarët deri më datë 31.12.2020 është **512,822,365 lekë**, dhe përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Kamëz. Mbi këto familjarë nuk është aplikuar kamatëvonesë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Kamëz të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **627,118,298 lekë**.

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Bashkia Kamëz për uljen e debisë së taksave familjare ka marrë masa si me poshtë:*

- *Janë shpërndarë me anë të Faturistëve të Agjentit Tatimor UKK sha, 21,174 njoftim detyrime për vitin 2022. Nuk ofrohet asnjë shërbim pranë zyrave të Bashkisë pa u shlyer detyrimet vendore me anë të formularit të shërbimit si dhe sistemi i Operatorit Online të shërbimeve One Stop Shp.*
- *I jemi drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile për familjet Aktive përditësimet e fundit dhe janë reflektuar në sistemin e DTTV-së.*

*Po përgatiten urdhër bllokimit e llogarive bankare për subjektet debitor.*

**Statusi: Në proces zbatimi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga viti 2014, kur të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi janë paraqitur pranë pushtetit vendor për përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë deri më datë 31.12.2020 janë paraqitur 12,401 objekte në proces legalizimi. Vlera debitorë deri më datë 31.12.2020 është **237,287,232 lekë**, e ardhur e munguar për bashkinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën **237,287,232 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kamëz të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë marrë masat për arkëtimin e taksës së ndikimit në instruktorë, ku nga vlera e rekomanduar prej 237,287,232 lekë është arkëtuar vlera 4,834,116 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 232,453,116 lekë.*

**Statusi: Në proces zbatimi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Me bashkinë kanë lidhur kontratë 6 subjekte mbi marrjen me qira të 6 objekteve të saj. Nga të cilat sipas afateve të lidhura në kontrata rezultojnë 3 të lidhura rishtazi në vitin 2019 dhe 3 të lidhura në vitin 2020. Bashkisë Kamëz për vitin 2019 i janë arkëtuar nga subjektet 284,790 lekë dhe për vitin 2020 vlera prej 1,120,715. Vlera e paarkëtuar deri më datë 31.12.2020 nga Bashkia Kamëz si pasojë e mos pagesave nga ana e subjekteve arrin në vlerën **250,000 lekë**, e ardhur e munguar. Nga grupi i auditimit është marr parasysh situata e shkaktuar si pasojë e Covid 2019, duke mos lejuar zhvillimin e ndeshjeve, dhe duke sjellë mos arkëtim nga Klubi Kukësi sh.a, i cili e ka të përcaktuar në kontratë se paguan 50,000 për çdo ndeshje të zhvilluar. Problematike shfaqen pagesat të cilat janë kryera nga subjektet por nuk janë kryer çdo muaj, referuar kontratës së nënshkruar përjashtuar "Bio Products" SHPK dhe Klubi "Kukësi" SHA të cilat kanë marrëveshje me kushte të tjera midis tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 45-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e MTPM-se, Bordit të Kullimit+Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Zyrën Juridike të marrë masa për ndjekjen dhe kthimin e detyrimit në vlerën **250,000 lekë**.

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Banka OTP Albania ka arkëtuar detyrimin me datë 06.08.2021, kjo sipas ditarit të ardhurave. Me shkresën nr. 759 prot. datë 27.01.2022, i është kërkuar "Klubit Sportiv Kastrioti" arkëtimin e detyrimit ndaj Bashkisë Kamëz.*

**Statusi: Zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, takson qytetarët që disponojnë tokë bujqësore sipas të dhënave që disponon nga Formulari 06, si dhe dokumenteve të pronësisë të depozituara nga qytetarët. Vlera e debisë me 31.12.2020, bazuar në listat e nisura nga Drejtoria e MTMP- së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave është 32,386,898 lekë, e ardhur e munguar për Bashkinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e MTPM-së, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave të marr masa me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **32,386,898 lekë**. Përsa i përket gabimeve të bëra në database fillestar ( formularin 06 ), të merren masa për mos mbarten nga një vit në tjetrin, e të mos kemi dublime emrash pronarësh e vlera finaciare të pa arkëtuara.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë marrë masat për sistemimin e gabimeve të bëra në database fillestar, rast pas rasti. Problemi kryesor është se toka bujqësore është kthyer në tokë truall dhe zgjidhja vjen pas funksionimit të kadastrës urbane.*

**Statusi: Pa zbatuar**

**4.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Çështjeve Ligjore, Liçensave dhe Kadastrës të jenë të angazhuar për përditësimin e dokumentacionit për të shkuar tek evidentimi i saktë, por gjithmonë në bashkëpunim me ASHK-së, për evidentimin e pronarëve real të këtyre pasurive, si për tokat bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501 “Për Tokën”, ashtu dhe për përditësimin e pronave shtetërore në pronësi të bashkisë Kamëz.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë ngritur dy grupe pune (njëri grup mbulon zonat kadastrale 2884, 1066 dhe 3992 ndërsa grupi tjetër mbulon zonat kadastrale 2066, 1649, 3993 dhe 2372) që bëjnë verifikimin në terren, sipas rastit të pronave shtet apo pronave të ndara sipas ligjit nr.7501 “Për Tokën”. Per vitin 2020 dhe 2021 janë certifikuar 29 prona shtet.*

**Statusi: Në proces**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në bashkinë Kamëz gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 36 subjekte, nga të cilët 7 prej tyre tregtojnë gaz. Grupi auditues përzgjedhi 12 dosje për auditim. Vlera prej 4,348,000 lekë që duhet të ishte arkëtuar nga rinovimi i licencave, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kamëz. Kjo vlerë është llogaritur në bazë të listës së subjekteve që disponon Bashkia Kamëz. Bashkia Kamëz nuk ka aplikuar gjoha në kundërshtim me Paketën Fiskale ku specifikohet se gjoha për fillim e aktivitetit pa marrë licencën është 20,000 lekë. Në total gjobat rezultojnë të jenë në vlerë 360,000 lekë mungesë të ardhurash për Bashkinë Kamëz. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **4,708,000 lekë**.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Nga vlera rekomanduar prej 4,708,000 lekë është arkëtuar vlera prej 2,640,000 lekë, duke mbetur për arkëtim vlera 2,068,000 lekë. Për vlerën e paarkëtuar janë dërguar njoftim detyrimet dhe do të vazhdohet me procedurat e mëtejshme ligjore.*

**Statusi: Në proces zbatimi**

**5.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Transportit Lejeve dhe Licencave të bashkëpunoj me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në mënyrë që të verifikojë nëse ka subjekte që e kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimit apo nëse ka subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë.

**Nga verifikimi rezulton se:**

*Për vitin 2021 me shkresën nr. 757 date 27.01.2021, DTLL është kërkuar bashkëpunimi për konfirmimin e listave të subjekteve me DTTV Bashkia Kamëz, mbi subjekte që e kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimit, subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë.*

**Statusi: Në proces zbatimi**

## F. MASAT DISIPLINORE.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 "Llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë"; shkronja (b) e nenit 9 "Masa disiplinore ", të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kamëz të vlerësojë shkeljet e konstatuara** në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për punonjësit e atakuar.

### **Rekomandimi: Masa Disiplinore**

- Në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentat e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Bazuar në aktin e mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022, janë ndjekur procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore.*

*Janë dhënë masa disiplinore për tetë punonjës, me aktet:*

*Nr. 4036/1 prot. datë 24.05.2022, nr. 4039/1 prot. datë 24.05.2022, nr. 4040/1 prot. datë 24.05.2022, nr. 4035/1 prot. datë 24.05.2022, nr. 4037/1 prot. datë 24.05.2022, nr. 4038/1 datë 24.05.2022 dhe nr. 4617 prot. datë 24.05.2022, (për punonjësit në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe anëtare të KVO, sipas Aneksit 7.2 bashkëlidhur.*

**Statusi: Zbatuar**

### **Rekomandimi: Masa Disiplinore**

- Në mos marrjen e masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII, neni 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.
- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Janë dhënë masa disiplinore për punonjësit e DTTV- se, me aktet: nr. 884/1 prot. datë 01.02.2022, nr. 886/1 prot. datë 01.02.2022, nr. 882/1 prot. datë 01.02.2022, sipas Aneksit 7.2 bashkëlidhur.*

**Statusi: Zbatuar**

### **Rekomandimi: Masa Disiplinore**

- Në moszbatimin e disa zërave pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike për kontratat për punët publike të audituara dhe të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 3 datë 15/02/2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" Kreu II, Pika 3.2.

### **Nga verifikimi rezulton se:**

*Me urdhër nr. 242 prot. datë 10.03.2022, është ngritur grupi i punës për vlerësimin e rekomandimeve të KLSH. Grupi i punës bazuar në gjetjen e KLSH i ka propozuar IVMT, marrjen e masave dënim me gjobe për 15 mbikëqyrës punimesh në vlerën 900,000 lekë. IVMT me vendimet dënim me gjobe, nr. 5 datë 11.05.2022, nr. 6 datë 11.05.2022, nr. 7 datë 11.05.2022, nr. 8 datë 11.05.2022, nr. 9 datë 11.05.2022, nr. 10 datë 11.05.2022, nr. 11 datë 11.05.2022, nr. 12 datë 11.05.2022, nr. 13 datë 11.05.2022, nr. 14 datë 11.05.2022, nr. 15 datë 12.05.2022, nr. 16 datë 12.05.2022, nr. 17 datë 12.05.2022, nr. 18 datë 12.05.2022, nr. 19 datë 12.05.2022.*

*Bazuar në gjobat e vendosura nga IVMT për mbikëqyrësit e punimeve në vlerën total 900,000 lekë, është arkëtuar vlera prej 900,000 lekë, pa arkëtuar vlera prej 0 lekë. (sipas Aneksit 7.3 bashkëlidhur).*

**Statusi: Zbatuar**